

Profilet e komuniteteve të Kosovës

2024

OSBE

Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Profilet e komuniteteve të Kosovës

2024

Profili i Komunitetit **Shqiptar të Kosovës**

Profili i Komuniteteve **Ashkali të Kosovës**

Profili i Komunitetit **Boshnjak të Kosovës**

Profili i Komunitetit **Kroat të Kosovës**

Profili i Komuniteteve **Egjiptiane të Kosovës**

Profili i Komunitetit **Goran të Kosovës**

Profili i Komunitetit **Malazez të Kosovës**

Profili i Komuniteteve **Rome të Kosovës**

Profili i Komunitetit **Serb të Kosovës**

Profili i Komunitetit **Turk të Kosovës**

Hyrje nga shefi i Misionit

Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka kënaqësinë që të paraqesë edicionin e tretë të profileve të komuniteteve. Këto dhjetë profile, të botuara në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, ofrojnë një pasqyrë të përditësuar dhe gjithëpërfshirëse të komuniteteve në Kosovë, si vijimësi e edicionit të fundit të vitit 2010. Ato bazohen në të dhënat përkitazi me komunitetet e ndryshme të Kosovës të mbledhura nga burime si në nivelin komunal ashtu edhe në atë qeveritar.

Qëllimi ynë ka qenë të ofrojmë informata faktike gjithëpërfshirëse rreth komuniteteve në Kosovë që, duke u nisur nga përvoja jonë e gjertanishme, mund të jenë të dobishme për palët e interesit, politikëbërësit dhe hulumtuesit. Shpresojmë që këto profile të shërbejnë njëherazi edhe për ngritje më të gjerësishme të vetëdijes për përbërjen e larmishme të shoqërisë së Kosovës. Metodologjia bazë e përdorur për përpilimin e këtyre profileve përputhet me atë të edicioneve paraprake, dhe ky edicion nuk synon t'i shqyrtojë në mënyrë kronologjike zhvillimet e lidhura me komunitetet që nga edicioni i vitit 2010, por përkundrazi, të paraqesë një pasqyrë të përgjithshme të të gjitha komuniteteve për periudhën deri në dhjetor të vitit 2023, duke u bazuar në informatat në dispozicion. Jemi përpjekur të evidentojmë përparimin e shënuar në përmirësimin e gëzimit të të drejtave të komuniteteve, por edhe sfidat ekzistuese me të cilat përballen komunitetet e ndryshme.

Të dhënat cilësore për këtë botim janë mbledhur nga të anketuarit në nivel qeveritar e komunal dhe përfaqësuesit e komuniteteve, ndërsa ekipet në terren të OSBE-së kanë ofruar informata shtesë bazuar në monitorimin tonë afatgjatë dhe njohjen e gjendjes në terren. Për të siguruar mbulueshmëri sa më të gjerë, Misioni i OSBE-së është mbështetur në dokumentet ekzistuese të OSBE-së, bazat e të dhënave nga burime të hapura, statistika dhe artikuj të botuar nga organizata të ndryshme ndërkombëtare e vendore. Vazhdon akoma të jetë e vështirë që të sigurohen të dhëna të sakta të kategorizuara sipas komuniteteve dhe/ose gjinisë. Për shembull, informatat mbi madhësinë e komuniteteve bazohen në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, të përplotësuara me vlerësimet e fundit të Misionit të OSBE-së dhe informatat e ofruara nga përfaqësuesit e komuniteteve. Planifikojmë që, sapo të jenë në dispozicion informatat e hollësishme nga regjistrimi i popullsisë i vitit 2024, profilet t'i përditësojmë edhe një herë. Në ndërkohë, vlerësimet tona të përafërta të madhësisë së komuniteteve joshumicë janë vetëm një prej elementëve që këto profile të komuniteteve ofrojnë për lexuesit.

Më konkretisht, ky botim ofron një pasqyrë cilësore dhe, aty ku është e zbatueshme, sasiore për të dhjetë komunitetet: shqiptarët e Kosovës, ashkallitë e Kosovës, boshnjakët e Kosovës, kroatët e Kosovës, egjiptianët e Kosovës, goranët e Kosovës, malazezët e Kosovës, romët e Kosovës, serbët e Kosovës dhe turqit e Kosovës. Ai fokusohet në komunat ku komunitetet në fjalë përbëjnë komunitet joshumicë, duke ofruar për gjithsecilin një pasqyrë të gjendjes sipas fushave kryesore tematike: siguria dhe rendi; pjesëmarrja dhe përfaqësimi; punësimi dhe gjendja socio-ekonomike; qasja në infrastrukturë dhe shërbime publike; qasja në shërbime sociale, shëndetësi dhe mirëqenie; qasja në arsim; qasja në drejtësi; përdorimi i gjuhës dhe mediat; trashëgimia kulturore dhe fetare, liritë fetare; të drejtat pronësore; si edhe kthimi dhe riintegrimi. Qasja jonë e ndërthurur mëton t'i shpërfaqë përvojat dhe shqetësimet e veçanta të grave e vajzave nga radhët e komuniteteve joshumicë. Komentet e lexuesve lidhur me këtë edicion janë më se të mirëpritura.

Ndërkohë që evidenton përparimin e dukshëm të bërë në disa fusha, ky edicion i profileve të komuniteteve vë po ashtu në dukje edhe sfidat që vazhdojnë t'ua pamundësojnë shumë njerëzve gëzimin e plotë të të drejtave dhe lirive të tyre. Institucionet e Kosovës, institucionet përkatëse të Serbisë, bashkësia ndërkombëtare dhe shoqëria civile kanë gjithsecila një rol për ta luajtur në zgjidhjen e problematikave të pazgjidhura dhe sigurimin e bashkëpunimit të shtuar me komunitetet dhe ndërmjet tyre. Për këtë qëllim, duhet të sigurojmë që strukturat përkatëse si Këshilli Konsultativ për Komunitete në nivel qendror, ose komitetet për komunitete dhe mekanizmat komunalë të sigurisë në nivel komunal, të jenë në gjendje që ta arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Përkujdesja që të gjitha komunitetet të mund t'i gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre është thelbësore për ndërtimin e paqes së qëndrueshme. Misioni i OSBE-së shpreson që ky edicion i profileve të komuniteteve të shërbejë si burim i dobishëm për të gjithë, në Kosovë dhe më gjerë, që po bëjnë punë të palodhshme për të gjetur mënyra kreative dhe të qëndrueshme për t'u ndihmuar të gjitha komuniteteve në Kosovë të përparojnë.



Ambasador Michael Davenport
Shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë

Foto: Yllka Fetahaj

Profili i komunitetit

shqiptar të Kosovës

osbe

Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Profili i komunitetit shqiptar të Kosovës

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, komuniteti shqiptar i Kosovës është më i madhi në Kosovë.¹

Shqiptarët e Kosovës përbëjnë komunitetin shumicë në shumicën e komunave. Ata janë komunitet joshumicë në 11 komuna: Mitrovicë Veriore (rreth 2,000), Zubin Potok (afro 1,200), Zveçan (rreth 500) dhe Leposaviq (rreth 200) në rajonin e Mitrovicës, si dhe në Novobërdë (rreth 4,500-5,000),² Shtërpçë (rreth 3,800³),⁴ Klllokot (rreth 1,600),⁵ Partesh,⁶ Ranillug (rreth 200),⁷ Mamushë (gati gjashtë për qind) dhe Graçanicë (rreth 23 për qind).⁸ Ky profil ka në fokus **shqiptarët e Kosovës** në komunat ku ata përbëjnë pakicë numerike, mirëpo, duke mbajtur parasysh pozitën e tyre të përgjithshme si shumicë në Kosovë, ai përmban informata edhe për zonat ku ky komunitet është shumicë.

1 Regjistrimi i vitit 2011 nuk i ka përfshirë katër komunat veriore ku shqiptarët e Kosovës janë komunitet joshumicë. Prandaj, përqindja e vërtetë e komunitetit shqiptar të Kosovës në krahasim me numrin e përgjithshëm të popullsisë mund të jetë më e ulët.

2 Nënkryetari për komunitete (NKK) i Novobërdës.

3 Diku 1,000 shqiptarë të Kosovës jetojnë në Ferizaj, ndërkohë që kanë vendbanimin e regjistruar në Shtërpçë. Ato nuk janë përfshirë në vlerësimin e madhësisë së komunitetit.

4 NKK i Shtërpçës.

5 NKK i Klllokotit.

6 Nuk ka të dhëna për madhësinë e komunitetit.

7 Anëtar i Komitetit për Komunitete të Ranillugut.

8 OSBE, *Profilet e komunave* 2018,

Faktet dhe çështjet kryesore

- Prej komunave ku **shqiptarët e Kosovës** janë komuniteti joshumicë, siguria është shqetësim kryesisht në Mitrovicën Veriore.
- Nxënësit **shqiptarë të Kosovës** i ndjekin mësimet sipas planprogramit në gjuhën shqipe.
- Nxënësit **shqiptarë të Kosovës** nuk kanë mundësi që ta mësojnë gjuhën serbe në shkollat me planprogram të Kosovës, ashtu siç nxënësve serbë të Kosovës nuk u ofrohet lëndë për mësimin e gjuhës shqipe në shkollat me planprogram serb. Mosmësimi i gjuhës e kufizon ndjeshëm ndërveprimin ndërmjet komuniteteve dhe i minon përpjekjet për nxitje të dialogut ndërmjet komuniteteve në arsim.
- Në kuptimin e qasjes në arsim, sfida kryesore për nxënësit **shqiptarë të Kosovës** vazhdon të jetë transporti.
- Lokacionet ku kthimi është përcjellë me vështirësi janë identifikuar kryesisht në rajonin e Mitrovicës.

1. Siguria dhe rendi

Prej komunave ku shqiptarët e Kosovës përbëjnë komunitet joshumicë, siguria është shqetësim madhor kryesisht në Mitrovicën Veriore ku komunitetet jetojnë në afërsi të njëra-tjetrës.

Shpeshtësia dhe serioziteti i incidenteve të sigurisë që si çak kanë **shqiptarët e Kosovës** në komunat në jug të lumit Ibër ku komuniteti përbën pakicë numerike është përgjithësisht shumë më e ulët.⁹

Në vitin 2017 është shënuar rritje e numrit të incidenteve ndërmjet dy komuniteteve në Mitrovicën Veriore, ku **shqiptarët e Kosovës** radhiteshin si i dyti komunitet më i prekur nga incidentet ndëretnike, pas komunitetit serb të Kosovës. Që atëherë, numri i incidenteve të sigurisë që prekin komunitetin ka shënuar luhataje, me një rritje të lehtë në vitet 2022 dhe 2023.¹⁰

Incidentet në Mitrovicën Veriore që kanë pasur çak **shqiptarët e Kosovës** janë regjistruar kryesisht afër urës kryesore, në rrugën "Mbreti Petri" në zonën e destinuar për qarkullim të këmbësorëve. Në afërsi të zonave etnikisht të përziera të "Tre Soliterat", në lagjen "Mëhalla e Boshnjakëve" dhe në lagjen etnikisht të përzier të Suhodollit.¹¹ Incidentet në fjalë ishin kryesisht përlëshje mes të rinjve, dhe përfshinin shpesh përdorimin e thikave. Në disa raste, të rinjtë shqiptarë dhe serbë të Kosovës janë lidhur përmes rrjeteve sociale dhe kanë organizuar "incidente të hedhjes së gurëve" në urën kryesore, ca sosh në vijimësi të "sfidave" të postuara në rrjetet sociale nga **shqiptarët e Kosovës** për të shkuar në Mitrovicë Veriore dhe për të bërë selfie para monumentit të Car L Lazarit. Në një tjetër incident të këtillë, "sfida" ishte të shkosh në kodrën e Zveçanit dhe të vjedhësh një flamur serb nga maja e rrënojave të kalasë mesjetare. Këto incidente çuan në hakmarrje dhe në një cikël të mëtejshëm të ndodhive të ngjashme. Për shkak të shpeshtësisë së tyre, në urën kryesore u vendosën kamera vëzhgimi.

⁹ Në tetor të vitit 2020, në fshatin Plemetin të komunës së Obiliqit, katër të dyshuar të mitur serbë të Kosovës kanë sulmuar fizikisht një të mitur shqiptar të Kosovës, duke i shkakuar lëndime. Në nëntor të vitit 2020, person(a) të panjohur i vunë flakën një billboardi me llogon e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dhe slogonin "Liria ka emër" në rrugën rajonale që çon në Graçanicë, komunë me shumicë serbe. Në prill të vitit 2022, mediat raportuan se në një rrugë në fshatin Babimoc të komunës së Obiliqit dhe në disa prej dyerve të shtëpive të banorëve shqiptarë të Kosovës të këtij fshati ishte shkruar me sprej germa "Z". Në shtator të vitit 2022, një shqiptar i Kosovës në fshatin Prelluzhë të komunës së Vushtrisë raportoi në Policinë e Kosovës se person(a) të panjohur kishin hequr një flamur nga pjesa e përparme e shtëpisë së tij dhe e kishin djegur atë.

¹⁰ Sipas monitorimit të brendshëm të OSBE-së, ka ndodhur 45 incidente në 2013, 36 në 2014, 30 në 2015, 30 në 2016, 43 në 2017, 29 në 2018, 40 në 2019, 52 në 2020, 52 në 2020, 42, 55 në 2023.

¹¹ Në qershor të vitit 2017, një shqiptar i Kosovës u sulmua nga tre persona teksa po ngiste biçikletën në zonën e destinuar për qarkullim të këmbësorëve. Sipas pohimeve, ai ra nga biçikleta ndërsa sulmuesit vazhduan ta sulmonin. Në tetor të vitit 2017, një shqiptar i Kosovës u sulmua fizikisht nga dy persona në rrugën "Knjaz Miloš", e në gusht 2021 në shëtitoren përgjatë lumit Ibër, gjegjësisht në lagjen etnikisht të përzier të Suhodollit. Në qershor të vitit 2018, dy të rinj shqiptarë të Kosovës u sulmuan fizikisht nga disa persona në afërsi të "Tre Soliterave" në Mitrovicën Veriore. Njëra nga viktimat pësoi lëndime të shkaktuara me një shufër metalike. Në nëntor të vitit 2023, Policia e Kosovës i arrestoi dy serbë të Kosovës të dyshuar për sulme fizike dhe fyerje ndaj dy shqiptarëve të Kosovës për shkak të kombësisë së tyre në lagjen me etnikisht të përzier "Mëhalla e Boshnjakëve" në Mitrovicën Veriore. Në dhjetor të vitit 2023, në lagjen Suhodoll në Mitrovicën Veriore, një shqiptar i Kosovës raportoi se një shtëpi në ndërtim e sipër ishte dëmtuar dhe vandalizuar me mbishkrime të zeza në mure (kryqi me katër shkronja "S" dhe 2 "SRB" dhe "tu smo" (ne jemi këtu) në alfabetin cirilik).

Më 24 shtator 2023, në fshatin Banjskë të komunës së Zveçanit, njësitet e Policisë së Kosovës u sulmuan me armë zjarri, duke lënë të vdekur një polic **shqiptar të Kosovës** dhe dy të tjerë të plagosur.¹² Më pas, Policia e Kosovës nisi një operacion në zonën në fjalë. Sipas kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti,¹³ rreth 30 sulmues serbë të Kosovës u përleshën me Policinë e Kosovës. Tre sulmues u vranë në operacion, ndërsa gjashtë u arrestuan.

Në komunat ku përbëjnë pakicë numerike, **shqiptarët e Kosovës** janë të përfaqësuar mirë në Policinë e Kosovës. Në vitin 2023 janë vendosur pika kontrolli policor në fshatrat me shumicë serbe të Kosovës në komunat Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan (ku janë të punësuar nëntë policë **shqiptarë të Kosovës**).

Në Komitetet Lokale të Sigurisë Publike (KLSP) janë 562 pjesëtarë të komunitetit **shqiptar të Kosovës**.¹⁴

12 Shih [në shqip, serbisht dhe anglisht]: <https://www.facebook.com/KosovoPolice/posts/614030167603912> (qasur në dhjetor 2023).

13 Shih [në serbisht]: <https://kossev.info/kurti-u-banjskoj-30-tesko-naoruzanih-ljudi-opkoljeni-su-trazim-od-njih-da-se-predaju/> (qasur në dhjetor 2023).

14 Në nëntor 2023.

2. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi

Komuniteti shqiptar i Kosovës është i përfaqësuar në komitetet për komunitete (KK) në 36 komuna, përfshirë këtu në nëntë nga 11 komunat ku ky i fundit përbën pakicë numerike.¹⁵

Shqiptarët e Kosovës kryesojnë me KK-të në 14 komuna, përfshirë këtu në tetë nga 11 komunat ku komuniteti përbën pakicë numerike.¹⁶ Gjashtë nga 16 nënkryetarë të komunave për komunitete¹⁷ dhe gjashtë nga dhjetë zëvendëskryesues për komunitete të kuvendit komunal (ZKKKK) janë shqiptarë të Kosovës (që të gjithë burra).¹⁸

Komuniteti shqiptar i Kosovës përfaqësohet në zyrat komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK) në 22 komuna, me gjithsej 34 anëtarë (12 gra).¹⁹ Shqiptarët e Kosovës mbajnë pozitën e shefit të ZKKK-së në 12 komuna.²⁰ Më konkretisht, komuniteti shqiptar i Kosovës është i përfaqësuar në ZKKK në shtatë nga 11 komunat ku ky komunitet është pakicë numerike.²¹

Dhjetë pjesëtarë të komunitetit shqiptar të Kosovës shërbejnë si anëtarë të Këshillave Komunalë për Siguri në Bashkësisë (KKSB) në këto komuna ku komuniteti është në pakicë numerike: katër burra në Novobërdë dhe nga një burrë në Kllokot, Partesh, Ranillug, Shtërpçë, Graçanicë dhe Mamushë.

Në asnjë nga komunat veriore nuk ka organizatë aktive joqeveritare të shqiptarëve të Kosovës. OJQ "Community Building Mitrovica" (CBM), me seli në Mitrovicën Jugore, herë pas here organizon aktivitete për të rinjtë në Mitrovicën Veriore dhe Zubin Potok. OJQ "Minatori i ri" nga fshati Kishnicë vepron në komunën e Graçanicës.

15 Shqiptarët e Kosovës nuk janë të përfaqësuar në Partesh. KK nuk u themelua në Leposaviq pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme në prill të vitit 2023.

16 Pjesëtarët e komunitetit shqiptar të Kosovës janë kryesues të KK në Glllogoc, Hani i Elezit, Junik, Kaçanik, Klinë, Kllokot, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë Veriore, Novobërdë, Ranillug, Shtërpçë, Zubin Potok dhe Zveçan.

17 Shqiptarët e Kosovës mbajnë pozitën e nënkryetarit për komunitete (NKK) në Graçanicë, Kllokot, Mamushë, Novobërdë, Ranillug dhe Shtërpçë. Vlen të ceket se pozita e NKK-së në Graçanicë ka qenë e zbrazët gjatë tërë kohëzgjatjes së mandatit 2017–2021. Leutrim Ajeti (nga radhët e Aleanca Shqiptare për Graçanicën) u emërua në këtë pozitë më 2 shkurt 2022. Veç Graçanicës, shqiptarët e Kosovës duhet ta mbajnë pozitën e NKK-së në Mitrovicën Veriore, meqë përfaqësojnë komunitetin më të madh joshumicë në këtë komunë (sipas botimit të OSBE-së "Profillet e komunave 2018"), megjithatë, NKK nuk është emëruar gjatë periudhës për të cilën raportohet.

18 Shqiptarët e Kosovës mbajnë pozitën e ZKKKK në Graçanicë, Kllokot, Mamushë, Mitrovicë Veriore, Novobërdë dhe Shtërpçë.

19 Në Leposaviq, Mitrovicë Veriore dhe Zubin Potok, ZKKK-të nuk janë themeluar zyrtarisht, ndonëse zyra me funksione të ngjashme si Zyrat Komunale për Komunitete (ZKK) ekzistojnë. Rast i tillë është ZKK në Zubin Potok. Në Leposaviq dhe Mitrovicë Veriore, zyrat e ngjashme me ZKKK-në (të quajtura përkatësisht ZKKK dhe Drejtoria Komunale për Komunitete, Kthim dhe Informacion) udhëhiqen nga drejtorë të emëruar politikisht. Këto zyra janë themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2007/30 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë, neni 23(11). Shqiptarët e Kosovës janë të përfaqësuar në ZKK-të në Leposaviq (pesë anëtarë) dhe Zubin Potok (gjashtë anëtarë).

20 Glllogoc, Hani i Elezit, Junik, Kaçanik, Kllokot, Malishevë, Mamushë, Podujevë, Prishtinë, Ranillug, Suharekë dhe Zveçan. Shqiptarët e Kosovës mbajnë pozitën e shefit të ZKK në Leposaviq dhe Zubin Potok.

21 Komuniteti shqiptar i Kosovës nuk është i përfaqësuar në ZKKK në Graçanicë, Mitrovicë Veriore, Partesh dhe Shtërpçë. Në Kllokot, Mamushë, Ranillug dhe Zveçan, shqiptarët e Kosovës mbajnë pozitën e shefit të ZKKK. Në Leposaviq dhe Zubin Potok ata janë shefa të ZKK-ve.

3. Punësimi dhe gjendja socio-ekonomike

Mirëqenia socio-ekonomike e komunitetit shqiptar të Kosovës ndikohet nga shkalla e gjithmbarshme e ulët e punësimit në Kosovë. Të punësuarit në Kosovë ka të ngjarë të jetojnë në varfëri, ngaqë familjet kanë mesatarisht vetëm një anëtar të punësuar dhe madhësi prej 5.3 anëtarësh. (Norma e varfërisë në mesin e të punësuarve në Bashkimin Evropian ishte 9.4 për qind.²²)

Në komunat ku shqiptarët e Kosovës nuk përbëjnë shumicën, ekonomia është e bazuar kryesisht në bujqësi dhe biznese të vogla tregtare.²³

Në rajonin e Mitrovicës, në komunat ku komuniteti banon në zona urbane, siç është Mitrovica Veriore, shqiptarët e Kosovës mbajnë shpesh pozita me përgjegjësi në komunë, ose punojnë në sektorin privat. Ndërtimtaria vazhdon të jetë kategoria kryesore e sektorit privat që krijon mundësi punësimi për shqiptarët e Kosovës. Disa syresh zotërojnë biznese të vogla. Të dhënat nga Zyra për Çështje të Komuniteteve në kuadër të Zyrës e Kryeministrit shpalosin se rreth 90 për qind e pjesëtarëve të komunitetit shqiptar të Kosovës në Leposaviq dhe 60 për qind në Zubin Potok janë të papunë,²⁴ ku sipas bashkëbiseduesve, rreth 30 për qind e pjesëtarëve të papunë të këtij komuniteti janë gra. Në komunat ku shqiptarët e Kosovës jetojnë në zona rurale, si në Zubin Potok, Zveçan, Graçanicë dhe Ranillug, burim kryesor i të ardhurave është bujqësia, me përjashtim të disa pjesëtarëve të komunitetit që udhëtojnë për të punuar në qytetet e afërta.

Tetë shqiptarë të Kosovës janë të punësuar në komunën e Mamushës në të gjitha nivelet (përfshirë atë menaxherial). Vetëm dy prej tyre banojnë në Mamushë, ndërkaq pjesa tjetër janë nga qytetet dhe fshatrat përreth.

Në Graçanicë, tre shqiptarë të Kosovës punojnë në shërbimin civil komunal dhe katër në ndërmarrje publike lokale. Në sektorin privat, pjesëtarët e komunitetit punojnë kryesisht në fushën e gastronomisë dhe tregtisë. Papunësia, sipas ZKKK-së, prek kryesisht gratë e moshës mbi 35 vjeç.

Në rajonin e Mitrovicës, sipas zyrave komunale në katër komunat veriore ku shqiptarët e Kosovës janë pakicë numerike, rreth 4 - 30 për qind²⁵ e pjesëtarëve të komunitetit shqiptar të Kosovës janë të punësuar në sektorin publik, dhe atë kryesisht në institucione

22 Rrjeti Evropian i Politikave Sociale, "Varfëria në mesin e të punësuarve në Kosovë", 2019 në dispozicion në: <https://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=21105&langId=en>. (qasur në dhjetor 2023).

23 Raporti i OSBE-së "Profilet e komunave" (2018). Mungojnë të dhënat për shkallën e punësimit në sektorin privat, përfshirë për numrin e të punësuarve sipas komunitetit.

24 Nuk ka shifra të sakta për shkallën e papunësisë në Zveçan.

25 Katër për qind në Mitrovicë Veriore, pesë për qind në Zubin Potok, 20 për qind në Leposaviq, 30 për qind në Zveçan.

qeveritare si komuna, zyrat për punë sociale, sektori i arsimit dhe Policia e Kosovës.

Gjendja ekonomike e komunitetit **shqiptar të Kosovës** ndikohet edhe nga pozita gjeografike dhe burimet natyrore në komunat ku ata banojnë. Në komunën e Kllokotit, ku toka është pjellore dhe e pasur me ujëra minerale, komuniteti është i angazhuar në banja rehabilitimi, bujqësi dhe në industrinë e mbushjes së ujit të pijshëm.²⁶ **Shqiptarët e Kosovës** në Shtërpcë merren kryesisht me blegtori, prodhim të mjedërës dhe mjaltit, mbushje të ujit të pijshëm dhe turizëm – ata drejtojnë shumicën e restoranteve dhe kafeneve në zonën e Brezovicës. Për pjesëtarët e komunitetit që banojnë në Ranillug, aktivitet kryesor ekonomik është bujqësia, e përplotësuar me punë ndërtimore sezonale në komunat e tjera. **Shqiptarët e Kosovës** në Novobërdë i zotërojnë gurthyesit që operojnë në fshatrat Stanishor dhe Strazhë, si dhe dyqane ushqimore, kafene dhe restorante.²⁷

Rreth 150 **shqiptarë të Kosovës** janë të punësuar në shërbimin komunal të Novobërdës (sektorët e administratës komunale, shëndetësisë dhe arsimit, qendra për punë sociale dhe brigada e zjarrfikësve),²⁸ 250 në institucionet komunale të Shtërpcës (përfshirë këtu 36 në administratën komunale, 18 në sektorin e shëndetësisë dhe 90 në arsim, si dhe në kompanitë e shërbimeve publike të tilla si Posta dhe Telekom i Kosovës, sektori i sigurisë, Kompania Kosovare për Shpërndarjen e Energjisë Elektrike (KEDS) dhe Policia e Kosovës), tre në administratën komunale të Ranillugut²⁹ dhe 32 në administratën komunale dhe sektorin e arsimit në Kllokot.³⁰

Gjithsej 1,400 **shqiptarë të Kosovës** (përfshirë ata që *de facto* banojnë në Ferizaj) janë të regjistruar si punëkërkues në komunën e Shtërpcës, 130 në Novobërdë,³¹ 33 në zyrën komunale për punësim të Vitisë (edhe pse banojnë në Kllokot) dhe dhjetë në Ranillug.³²

Ekonomia joformale në Kosovë vlerësohet të përbëjë afro 38 për qind të PBV-së.³³ Ndërkohë që dukuria si e tillë është e përhapur, numri i saktë i **shqiptarëve të Kosovës** të angazhuar në punë joformale nuk dihet, por besohet se shifrat janë të larta. Puna joformale është veçanërisht e përhapur në bujqësi (anëtarë të familjes që nuk paguhen) dhe ndërtimtari.³⁴ Nuk ka të dhëna për numrin e fëmijëve **shqiptarë të Kosovës** të përfshirë në punën e fëmijëve.

26 Nënkrjetari për komunitete i komunës së Kllokotit.

27 Nënkrjetari për komunitete i komunës së Novobërdës.

28 Po aty.

29 Zyra komunale për komunitete dhe kthim në Ranillug.

30 Zyra e personelit në komunën e Kllokotit.

31 Zyra komunale për punësim në Novobërdë.

32 Anëtar i komitetit për komunitete në komunën e Ranillugut. Nuk ka të dhëna të kategorizuara sipas gjinisë.

33 FMN, Dokument pune, *Shpjegim i ekonomisë në hije në Evropë, madhësisë, shkaqeve dhe opsioneve të politikave* (2019), f. 19.

34 Banka Botërore, *Diagnostifikim i vendeve të punës në Kosovë* (2018), f. 42.

4. Qasja në infrastrukturë dhe shërbime publike

Qasja e gjithmbarshme në infrastrukturë dhe shërbime publike është përmirësuar, përfshirë nëpërmjet projekteve të zgjerimit të infrastrukturës rrugore dhe modernizimit të rrjetit të energjisë elektrike.

Megjithatë, problemet e përsëritura, duke filluar nga ndërprerjet e energjisë elektrike, mungesa e sistemeve të kanalizimit në zonat rurale, infrastruktura e dobët rrugore e deri te grumbullimi i parregullt i mbeturinave, vazhdojnë të jenë të pranishme.

Në rajonin e Gjilanit, gjendja e përgjithshme e infrastrukturës rrugore në komunat Shtërpçë, Kllokot dhe Ranillug, ku shqiptarët e Kosovës janë në pakicë numerike, është e mirë, ndërkohë që në komunën e Novobërdës vazhdon të jetë e keqe. Shumica e rrugëve kryesore që lidhin fshatrat e largëta me qytetin e Novobërdës nuk janë të asfaltuara, ose kanë trotuare të dëmtuara.

Furnizimi i rregullt me ujë të pijshëm vazhdon të përbëjë problem në komunën e Ranillugut. Për shkak të mungesës së një marrëveshjeje ndërmjet komunës dhe KEDS-it për borxhin ekzistues të energjisë elektrike, sistemi i ujësjellësit në fshatrat Kllokot dhe Mogillë të banuara nga shqiptarë dhe serbë të Kosovës nuk është funksional. Ujësjellësi në Novobërdë nuk i plotëson nevojat e banorëve. Fshati Bostan dhe vendbanimet Qulkovc, Tullar dhe Makresh, të banuara nga banorë shqiptarë të Kosovës, romë të Kosovës dhe serbë të Kosovës, janë më të prekura nga ndërprerjet e furnizimit me ujë. Fshati Llabjan, që konsiderohet të jetë një nga fshatrat më të mëdha të shqiptarëve të Kosovës në këtë komunë, me rreth 1,400 banorë, ka sistem të furnizimit me ujë i cili nuk është funksional për shkak të mosmarrëveshjeve për tokën për vendndodhjen e puseve dhe rezervuarëve.

Lagjja "Rid" në komunën e Ranillugut nuk ka as ujësjellës e as kanalizim, ndërsa banorët e Dubovës në këtë komunë kanë instaluar në mënyrë të pavarur sistemin e kanalizimit. Në fshatin Mogillë të komunës së Kllokotit është instaluar ndriçimi rrugor, por ai funksionon vetëm në lagjet e banuara me komunitetin serb të Kosovës dhe rreth kishës ortodokse serbe.³⁵

³⁵ Kryetari i fshatit Mogillë dhe nënkryetari për komunitete i Kllokotit.

Në rajonin e Mitrovicës, qasja e komunitetit **shqiptar të Kosovës** në ujë të pijshëm dhe energji elektrike është përmirësuar. Në vitin 2018 janë evidentuar ndërprerje të shpeshta në lagjen etnikisht të përzier "Lagjja e Doktorëve" në Mitrovicën Veriore, por që atëherë ka pasur përmirësime. Të gjitha rrugët lokale janë të asfaltuara, përfshirë në fshatrat si Cerajë dhe Bistricë e Shalës në komunën e Leposaviqit, të cilat janë asfaltuar në vitet 2022-2023. Në Mitrovicë Veriore, të gjithë pjesëtarët e komunitetit kanë qasje në rrjetin e kanalizimit të qytetit, ashtu si dhe fshatrat Çabër në Zubin Potok dhe Lipë në Zveçan. Banorët e tre fshatrave të Leposaviqit i menaxhojnë ujërat e zeza individualisht pasi nuk janë të kyçur në rrjetin e kanalizimit.

Nuk ka ndriçim rrugor në asnjërin prej lokaliteteve në komunat e Zveçanit dhe Leposaviqit, si dhe në vendbanimet e përziera Kroi i Vitakut dhe pjesë të Suhodollit në Mitrovicë Veriore.

5. Qasja në shërbime sociale, përfshirë këtu edhe kujdesin shëndetësor

Shqiptarët e Kosovës në komunat e rajonit të Mitrovicës ku përbëjnë pakicë numerike (gjegjësisht Mitrovicë Veriore, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq) i shfrytëzojnë më së shumti institucionet shëndetësore të drejtuara nga Kosova, në veçanti spitalin në Mitrovicë Jugore.³⁶

Ngjashëm, pjesëtarët e komunitetit që jetojnë në komunat tjera me shumicë serbe të Kosovës në vise tjera të vendit, si në Ranillug, Kllokot dhe Novobërdë, kanë tendencë t'i përdorin institucionet shëndetësore të drejtuara nga Kosova në komunat fqinje. Në Shtërpcë, gjegjësisht në fshatrat Brod dhe Drajkoc, ka qendra shëndetësore të drejtuara nga Kosova të cilat i përdor komuniteti **shqiptar i Kosovës**, kurse **shqiptarët e Kosovës** që jetojnë në fshatin Jasenovik të banuar me serbë dhe **shqiptarë të Kosovës** e përdorin klinikën shëndetësore të fshatit të drejtuar nga Beogradi. Institucione shëndetësore të drejtuara nga Kosova ka dhe në komunat me shumicë serbe të Kosovës, përfshirë këtu Graçanicën, Shtërpcën dhe Novobërdën. **Shqiptarët e Kosovës** të cilët banojnë në Graçanicë i përdorin kryesisht institucionet shëndetësore që ndodhen në Prishtinë.

³⁶ Që nga dhjetori i vitit 2020, një qendër shëndetësore e administruar nga Kosova është e hapur në fshatin Bistricë e Shalës, të cilën e përdorin banorët e atyshëm dhe banorët e fshatrave Koshtovë dhe Cerajë të komunës së Leposaviqit. Qendra punon nga e hëna deri të premten, me një mjek që vjen nga Mitrovica Jugore çdo të enjte. Në fshatin Çabër të komunës së Zubin Potokut Ekziston një qendër shëndetësore, që është e hapur gjatë ditëve të punës, me një mjek vizitor nga Mitrovica Jugore. Në Zveçan ekzistojnë dy qendra shëndetësore, njëra në Lipë dhe tjetra në fshatin Zhazhë, që të dyja janë të hapura për pacientë nga e hëna deri të premten, ndërsa një mjek e viziton qendrën në Lipë të martën e në Zhazhë të enjten. Pjesëtarët e komunitetit shqiptar të Kosovës nga Boletini e përdorin qendrën shëndetësore në Lipë të Zveçanit për shkak të afërsisë së saj.

6. Qasja në arsim

Nxënësit dhe studentët shqiptarë të Kosovës vijnë në mesimin në shqip. Gjithsej 300.989 shqiptarë të Kosovës ishin të regjistruar në arsimin parauniversitar në Kosovë në vitin akademik 2023–2024.³⁷

Arsimi parauniversitar në gjuhën shqipe ofrohet në nëntë nga dhjetë komunat në të cilat komuniteti shqiptar i Kosovës është në pakicë numerike.³⁸ Shqiptarët e Kosovës që jetojnë në komunat më të vogla si Ranillugu, Kllokoti dhe Graçanica përballen me vështirësi në qasjen në arsimin në shqip dhe duhet të udhëtojnë në komunat fqinje. Arsimi parauniversitar në shqip nuk është në dispozicion në Ranillug, por komuna ofron transport për nxënësit shqiptarë të Kosovës që vijnë në shkollat në qytetin e Kamenicës. Me përjashtim të Novobërdës (Llabjan) dhe Shtërpçës (Firajë), në shtatë komunat e mbetura arsimi në shqip është i kufizuar në nivelin fillor dhe atë të mesëm të ulët. Shqiptarët e Kosovës nga këto komuna udhëtojnë në komunat fqinje me shumicë shqiptare për të vijuar shkollimin e mesëm të lartë në shqip.

Transporti dhe infrastruktura shkollore vazhdojnë të jenë çështjet kryesore që pengojnë qasjen në arsim. Në komunën e Zveçanit nuk ka autobus shkollore për nxënësit nga Lipa dhe Zhazha që ndjekin arsimin e mesëm të ulët në Boletin. Mungesa e transportit të organizuar dhe të subvencionuar në shkollat e mesme të larta në Mitrovicë të Jugut pengon vijimin në shkollë nga nxënësit që vijnë nga familjet e cenushme. Po ashtu, nuk ofrohet transport për në shkollën në Kodrën e Minatorëve (Mitrovicë e Veriut). Një problem i ngjashëm haset edhe nga nxënësit në komunën e Novobërdës që ndjekin shkollën e mesme në fshatin Llabjan. Në mungesë të transportit publik, automjetet private mbeten e vetmja mënyrë për nxënësit për të udhëtuar për në shkollë, duke diskriminuar ata që nuk kanë automjete.

Në përgjithësi, nuk janë raportuar probleme në shpërndarjen e teksteve mësimore në gjuhën shqipe në gjithë Kosovën. Më 24 gusht 2023, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) njoftoi se prindërit duhet t'i blejnë tekstet shkollore për klasat 1 deri 5 dhe më pas do të rimbursohen bazuar në aplikimin në internet.

³⁷ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, *Shënime statistikore 2023/2024 (2022)*, *Shënime statistikore 2023-24-Edukimi parauniversitar.pdf*

³⁸ Këto komuna përfshijnë Graçanicën, Kllokotin, Leposaviqin, Mamushën, Mitrovicën e Veriut, Novobërdën, Shtërpçën, Zubin Potokun dhe Zveçanin.

Ky vendim shkaktoi disa shqetësime,³⁹ veçanërisht për komunitetet më të cenueshme dhe familjet në gjendje të rëndë ekonomike.

Arsimi universitar në shqip ofrohet nga shtatë universitete publike në Ferizaj, Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë e Jugut, Pejë, Prishtinë dhe Prizren.

Ndërveprimi i nxënësve **shqiptarë të Kosovës** me nxënësit që ndjekin kurrikulën në gjuhën serbe është shumë i kufizuar. Në komunat me shumicë serbe në veri të lumit Ibër, ndërveprimi mes nxënësve **shqiptarë të Kosovës** dhe atyre serbë është pothuajse joekzistent për shkak të mungesës së "shkollave me dy sisteme arsimore në të njëjtën ndërtesë".⁴⁰ Në rajone të tjera, 14 shkolla të tilla që mbajnë mësim me të dy kurrikulat nën një çati, ofrojnë potencial të madh për ndërveprim të shtuar; megjithatë, në praktikë nuk shfrytëzohen këto mundësi. Një përjashtim është shkolla në fshatin Jasenovik në Novobërdë, ku ndërveprimi mes nxënësve **shqiptarë të Kosovës** dhe atyre serbë është përmirësuar ndjeshëm pas zbatimit të projektit të Qendrës së Dialogut Nansen, me mbështetje nga Misioni i OSBE-së. Megjithatë, një nga pengesat më të mëdha për dialog ndërmjet komuniteteve është se gjuha serbe nuk mësohet në shkollat me kurrikulën e Kosovës dhe gjuha shqipe nuk mësohet në shkollat me kurrikulën e Serbisë. Për sa i përket ndërveprimit mes nxënësve **shqiptarë të Kosovës** dhe atyre që ndjekin mësimin me kurrikulë në gjuhët boshnjake dhe turke, situata ndryshon ndërmjet komunave.

39 Ndër shqetësimet më të raportuara ishin: nevoja që familjet të udhëtojnë në qytete të tjera për shkak të mungesës së teksteve në librari; qasja e kufizuar në internet dhe vështirësitë për të dorëzuar kërkesën për rimbursim përmes platformës në internet; mungesa e udhëzimeve të qarta dhe vonesat në pranimin e subvencioneve. Si rezultat, shumë nxënës e filluan vitin shkollor pa libra shkollorë.

40 "Shkollat në të njëjtën ndërtesë me dy sisteme arsimore" janë shkollat që funksionojnë brenda të njëjtave ndërtesa dhe ofrojnë arsimim nën dy sisteme të ndryshme, konkretisht kurrikula e Kosovës dhe ajo e Serbisë. Këto shkolla ndonjëherë quhen "shkolla të përziera", ndonëse nxënësit dhe klasat nuk janë të përziera.

7. Qasja në drejtësi

Monitorimi në terren i OSBE-së sugjeron se anëtarët e komunitetit shqiptar të Kosovës në përgjithësi janë në dijeni për shërbimet e ofruara nga Agjencia e Ndihmës Juridike Falas (ANJF), Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë (IAP) dhe Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV).

Shumica e punonjësve të tre institucioneve janë shqiptarë të Kosovës: 27 nga 32 punonjës në ANJF (19 gra); 68 nga 74 punonjës në IAP,⁴¹ duke përfshirë katër nga pesë Zëvendësavokatët e Popullit (dy burra, dy gra); dhe 29 nga 32 punonjës në ZMNV (22 burra, shtatë gra). Për më tepër, një numër i konsiderueshëm (1,341 nga 1,383 anëtarë) në Odën e Avokatëve të Kosovës (OAK), janë shqiptarë të Kosovës (1,032 burra, 309 gra).

Pjesëtarët e komunitetit me më së shumti dijeni për këto shërbime janë ata që punojnë ose angazhohen me institucionet komunale, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat, si dhe studentët. Nuk është raportuar ose vërejtur që komuniteti shqiptar i Kosovës të ketë përjetuar sfida specifike në qasjen në shërbimet e ndihmës juridike falas. Megjithatë, bashkëbiseduesit nga katër komunat veriore në Kosovë ndanë mendimin se opinioni publik në përgjithësi – veçanërisht komuniteti shqiptar i Kosovës në komunat ku janë në pakicë numerike – duhet të jetë më të informuar për këto shërbime.⁴² Bashkëbiseduesit shqiptarë të Kosovës nga katër komunat veriore treguan se do të kërkonin shërbime juridike në komunat me shumicë shqiptare të Kosovës. Fushatat ndërgjegjësuese që targetojnë komunitetin më të gjerë, veçanërisht familjet që jetojnë në zonat rurale, mund të jenë më efektive, për shembull, përmes përpjekjeve për të rritur dukshmërinë e ANJF-së.

IAP është institucioni i vetëm që kryen vizita të rregullta mujore⁴³ dhe të atypëratyshme në komuna të ndryshme (ndonëse jo në rajonin e Prishtinës, ku vizitat kryhen bazuar në nevojat e identifikuar të qytetarëve), duke i dhënë një dukshmëri më të mirë se dy ofruesit e tjerë të shërbimeve juridike.

Çdo tetor, ZMNV, nën kujdesin e Zyrës së Kryeprokurorit dhe me mbështetjen e Ambasadës së SHBA-së, organizon "Javën e të drejtave të viktimave të krimit". Megjithëse janë realizuar disa fushata informuese nga institucione të ndryshme, përfshirë ZMNV-në, Ministrinë e Drejtësisë dhe OAK-un, dhe informacioni është ndarë me viktimat gjatë kërkimit të

41 IAP ka arritur bilanc gjinor në stafin e tij (rreth 50 për qind).

42 Sipas raportimit të OSBE-së nga rajoni i Mitrovicës Jugore.

43 Duke përfshirë të ashtuquajturat "Ditët e hapura", kontaktim në terren çdo muaj me qëllim të komunikimit të drejtpërdrejtë me anëtarët e komunitetit mbi sfidat e ndryshme të të drejtave të njeriut.

shërbimeve, **shqiptarët e Kosovës** kanë të kuptuar të kufizuar të mundësive për kompensimin e viktimave të krimit (KVK) apo nuk i kuptojnë fare.

Ekipet mobile të ANJF-së gjithashtu kontribuojnë në përmirësimin e qasjes në shërbimet juridike duke arritur te komunitetet joshumicë dhe duke zbatuar fushata informuese dhe ndërgjegjësuese. Në vitin 2023, me mbështetjen e USAID-it, ANJF-ja shpërndau fletëpalosje dhe postera në gjuhën angleze, shqipe, serbe dhe turke, si dhe në alfabetin Braille. Ngjashëm janë shpërndarë në shqip e serbisht video dhe postime në mediat sociale gjatë Javës së Ndihmës Juridike Falas, me moton "Mburo të drejtat tuaja".

Komuniteti **shqiptar i Kosovës** që jeton në komunat ku ata janë në pakicë numerike, ka qasje të papenguar në të gjitha shërbimet e ofruara në këto komuna, pasi shërbimet janë të disponueshme në gjuhën shqipe. Në të gjithë Kosovën, të tri institucionet kanë staf shumëgjuhësh që mund të komunikojnë dhe ofrojnë shërbime në gjuhën shqipe. ZMNV mbështetet në stafin e saj shumëgjuhësh për të ofruar përkthim, sipas nevojës, ose përdor shërbime përkthimi të ofruara nga Prokuroria Themelore përkatëse.

Për sa i përket përfituesve të shërbimeve,⁴⁴ në vitin 2023, ZNJF ofroi shërbime për 6,070 persona (duke përfshirë 2,883 gra), nga të cilët 5,214 ishin anëtarë të komunitetit **shqiptar të Kosovës**. Në vitin 2023, IAP pranoi gjithsej 1,660 ankesa (1,162 burra dhe 498 gra),⁴⁵ që përfshinin 4,296 persona. Nga numri total i ankesave, 1,409 janë bërë nga **shqiptarët e Kosovës**. ZNJF trajtoi 2,883 raste në vitin 2023, nga të cilat 2,554 viktima ishin **shqiptarë të Kosovës**.⁴⁶ Anëtarët e komunitetit janë të lirë të zgjedhin përfaqësuesit e tyre ligjorë. Megjithatë, në rast të përfaqësimit sipas detyrës zyrtare në çështjet penale, OAK cakton avokatët sipas listës dhe radhës së avokatëve në regjistrin e tyre, të cilët flasin rrjedhshëm gjuhën e komunitetit që përfaqësojnë ose janë pjesëtarë të komunitetit përkatës.

Shqiptarët e Kosovës, duke i përfshirë ata që jetojnë në katër komunat veriore, nuk kanë vështirësi me qasjen në sistemin gjyqësor si pasojë e pengesave gjuhësore, si dhe nuk kanë raportuar ndonjë diskriminim në bazë të komunitetit të tyre. Megjithatë, janë ngritur shqetësime për udhëtimet e gjata deri në komunat me shumicë shqiptare, në rastet kur pjesëtarët e komunitetit nga komuna e Leposaviqit janë palë në procedura gjyqësore.

44 Informacioni është ofruar nga ZNJF, ZMNV, IAP dhe OAK në dhjetor 2023 dhe janar 2024.

45 Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë, *Raporti Vjetor 2023*.

46 Nuk janë ofruar të dhëna të ndara sipas gjinisë, edhe pse shumica e përfituesve të ZNJF-së janë gra, viktima të dhunës në familje.

8. Përdorimi i gjuhës dhe media

Në komunat ku shqiptarët e Kosovës janë në pakicë numerike, komuniteti përgjithësisht ka liri të përdorë gjuhën e tij, si në hapësira private ashtu dhe në ato publike. Shqipja është gjuhë zyrtare në Kosovë, sipas Kushtetutës dhe ligjit për përdorimin e gjuhëve të miratuar më 2006.⁴⁷

Megjithatë, përkundër bazës së fortë ligjore, shërbimet komunale të përkthimit vazhdojnë të jenë të cilësisë së dobët. Komunitetet janë përgjithësisht të ngarkuara me numër të madh dokumentesh dhe takimesh që kërkojnë përkthim.

Në të gjitha komunat në rajonin e Gjilanit ku shqiptarët e Kosovës janë pakicë numerike, pjesëtarët e komunitetit përdorin gjuhën shqipe në hapësirat publike dhe për qasje në shërbime komunale ose publike. Situata e ngjashme është edhe në komunën e Graçanicës, në rajonin e Prishtinës, ku shqiptarët e Kosovës përdorin lirshëm gjuhën e tyre amtare në hapësira publike. Megjithatë, ka pasur raportime për vështirësi në qasjen në shërbime komunale, veçanërisht për sa i përket lëshimit të dokumenteve në të dy gjuhët zyrtare.⁴⁸ Në rajonin e Prizrenit, veçanërisht në komunën e Mamushës, të banuar kryesisht nga turqit e Kosovës, komuniteti shqiptar i Kosovës gjithashtu përdor gjuhën shqipe në hapësira publike.

Situata është pak më e ndryshme në katër komunat veriore të Kosovës.⁴⁹ Në këto komuna, shqiptarët e Kosovës kryesisht përdorin gjuhën e tyre amtare në shtëpitë e tyre, por më rrallë në hapësira publike. Ndonëse shqiptarët e Kosovës të gjeneratave më të vjetra në këto komuna flasin rrjedhshëm serbisht, gjeneratat më të reja e flasin më pak. Për shkak të kësaj pengese gjuhësore dhe shqetësimeve të sigurisë, janë të rralla rastet e ndërveprimit me serbët e Kosovës në komunat veriore. Shpeshherë kur kërkojnë shërbime komunale, pjesëtarët e komunitetit shqiptar të Kosovës në këto katër komuna përdorin zyrat e komuniteteve komunale në fshatra për drejtimin e kërkesave në departamente të ndryshme.

Ka pasur raportime për dëmtimin e tabelave në gjuhën shqipe në zonat ku shqiptarët e Kosovës janë një pakicë numerike.⁵⁰

47 Ligji për përdorimin e gjuhëve, nr. 02/L-37 (2006), <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2440> (qasur në vitin 2023).

48 Sipas monitorimit të brendshëm të Misionit të OSBE-së, të realizuar në periudhën 2021 deri prill 2023.

49 Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan dhe Mitrovicë e Veriut.

50 Raste të tilla janë vërejtur në Shtërpçë, Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan, Mitrovicë e Veriut dhe Graçanicë. Për më tepër, në Kllokot ka qenë një rast i dy mbishkrimeve të dëmtuara, fillimisht në shqip në rrugën kryesore, në dy tabela që tregonin drejtimin për në Kllokot, si dhe një tjetër që tregonte drejtimin për në Gjilan. Në Kllokot, një ekip shumetnik u angazhua në pastrimin e të dyja tabelave të dëmtuara, me të rinj nga Kllokoti dhe Shtërpca dhe Ferizaj, për të përçuar një mesazh për të gjithë qytetarët, se të dyja gjuhët në komunë janë të barabarta dhe, rrjedhimisht, respektohen në mënyrë të barabartë.

Në raste të tilla autoritetet lokale zakonisht nuk lëshojnë deklarata publike që dënojnë këto incidente.⁵¹ Ka pasur disa ankesa nga **shqiptarët e Kosovës** për shkelje të të drejtave gjuhësore.⁵²

Dokumentet e përgjithshme për opinionin publik ofrohen në të gjitha gjuhët zyrtare, ashtu si dhe shumica e vendimeve komunale, megjithëse me pak vonesë. Për gjuhën shqipe, 19 komuna deklaruan se kanë numër të mjaftueshëm përkthyesish, ndërsa në 18 komuna numri i përkthyesve ishte i pamjaftueshëm.⁵³ Përkthimi në shqip është përgjithësisht i disponueshëm në seanca publike, por jo gjithmonë.⁵⁴ Për më tepër, nëpunësit civilë që punojnë në komunat ku **shqiptarët e Kosovës** janë në pakicë nuk mund të komunikojnë në të gjitha gjuhët zyrtare me qytetarët; kjo paaftësi është veçanërisht e vërtetë për më të rinjtë. Në komunat e Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit, mungesa e përkthyesve, interpretëve dhe personelit që flet të dyja gjuhët zyrtare e bën më të vështirë komunikimin në të gjitha gjuhët zyrtare. Në nivel të fshatit, pjesëtarët e komunitetit **shqiptar të Kosovës** flasin shqip në zyrat e mirëqenies sociale. Përkundër sfidave, është shënuar progres në këto komuna.⁵⁵

Komuniteti **shqiptar i Kosovës** ka qasje të përgjithshme në mediat elektronike dhe të shtypura në shqip. Sipas Komisionit të Pavarur të Mediave, 73 stacione televizive dhe të radios janë licencuar për transmetim në shqip në frekuenca tokësore. Për më tepër, komisioni ka licencuar 108 kanale televizive që transmetojnë në shqip duke përdorur shërbimet e 34 operatorëve të licencuar kabllorë.⁵⁶ Shumica e kanaleve të radios dhe televizionit me mbulim të gjerë janë të disponueshme në katër komunat veriore.

51 Komunat e Ranillugut, Novobërdës dhe Parteshit shpjeguan se dënimet publike nuk janë lëshuar për shkak të mungesës së kompetencave të mbikëqyrjes komunale mbi rrugët rajonale, në të cilat tabelat dëmtohen më së shpeshti.

52 Në Ranillug, Zyra e Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ) iu përgjigj një ankese të pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për këtë komunë me rekomandimin që i gjithë komunikimi zyrtar të bëhet edhe në shqip. Ngjashëm, komuna e Parteshit mori rekomandime nga ZKGJ në lidhje me dështimin e saj për të përdorur të dy gjuhët zyrtare në mënyrë të barabartë.

53 Zyra e Komisionerit të Gjuhëve, *Raporti Vjetor për Pajtueshmërinë Gjuhësore në Komuna* (2019):

54 Në Partesh, për shembull, përkthimi është ofruar vetëm gjatë takimeve të KKS-së dhe takimeve publike në të cilat marrin pjesë anëtarët e Policisë së Kosovës, meqë organet e tjera komunale (si komiteti për kthim dhe riintegrim, komiteti për politikë dhe financa, dhe asambleja komunale) janë të përbëra tërësisht nga serbët e Kosovës.

55 Shembujt përfshijnë rekrutimin e një përkthyesi në komunën e Zveçanit dhe emërimin e pikave të kontaktit për gjuhët në Zubin Potok dhe Leposaviq, ndërsa në Mitrovicën Veriore ende nuk është emëruar pika e kontaktit për gjuhën.

56 Komisioni i Pavarur i Mediave, <http://www.kpm-ks.org/telicencuarit/306/llojet-e-licencave/306> (qasur në dhjetor 2023).

9. Trashëgimia kulturore dhe fetare, liritë fetare

Në komunën e Leposaviqit, myslimanët sunitë nga komuniteti shqiptar i Kosovës banojnë në fshatrat Koshtovë, Bistricë dhe Cerrajë. Në komunën e Zveçanit, shqiptarët myslimanë të Kosovës jetojnë në fshatrat Lipë, Boletin dhe Zhazhë. Në fshatin Çabër, në komunën e Zubin Potokut, shqiptarët e Kosovës janë praktikues të fesë islame.

Shqiptarët e Kosovës të fesë islame në komunën e Novobërdës kryesisht banojnë në fshatrat Llabjan, Pasjak dhe Makresh i Ulët, në komunën e Ranillugut, në vendbanimet Crep, Duboc dhe Rid, si dhe në komunën e Shtërpcës komuniteti mysliman banon në fshatrat Brod, Firajë, Drajkovcë, Kashtanjevë, Izhancë, Biti e Poshtme dhe Biti e Epërme.

Janë disa vende të trashëgimisë që janë me rëndësi për komunitetin shqiptar të Kosovës në komunat ku janë në pakicë numerike. Ruajtja, gëzimi dhe mbrojtja e kësaj trashëgimie kulturore është përgjithësisht pa probleme. Në rajonin e Prizrenit nuk ka vende specifike të trashëgimisë kulturore apo fetare të rëndësishme për shqiptarët e Kosovës në komunat ku ata janë në pakicë numerike.⁵⁷ Bazuar në vëzhgimet nga terreni, shqiptarët e Kosovës mund t'i ushtrojnë lirshëm besimet dhe praktikat fetare në komunën e Mamushës, ku shqiptarët e Kosovës marrin pjesë në lutje në të njëjtat xhami me komunitetin turk dhe atë rom të Kosovës. Në rajonin e Mitrovicës, Kulla e Isa Boletinit, në fshatin Boletin në komunën e Zveçanit, është rëndësi të veçantë për shqiptarët e Kosovës.⁵⁸ Një vend tjetër me rëndësi është xhamia e Mazhidit e ndërtuar në vitin 1778 nga osmanët, e cila ndodhet në Mitrovicë të Veriut; kjo xhami u shkatërrua në vitin 1999.

57 Në rajonin e Prizrenit, shqiptarët e Kosovës janë në pozitë të pakicës vetëm në komunën e Mamushës, ku ata përbëjnë rreth 5.4 për qind të popullsisë totale (turqit e Kosovës përbëjnë shumicën).

58 Ky vend është shndërruar në qendër përkujtimore që nderon Isa Boletinin, luftëtar shqiptar i lirisë nga fshati Boletin gjatë luftës për pavarësinë e Shqipërisë në vitin 1912.

10. Të drejtat pronësore

Komuniteti shqiptar i Kosovës, përfshirë në vendet ku janë pakicë numerike, përballet me sfida në këtë fushë, duke përfshirë me kompensim të pamjaftueshëm për pronën e shpronësuar, qasjen e pamjaftueshme në banim social dhe uzurpime të paligjshme.

Kjo është veçanërisht e tillë në komunat veriore, ku ata hasin vështirësi të mëdha për t'u kthyer në shtëpitë e tyre dhe për të pasur qasje në pronën e tyre. Megjithatë, kohëve të fundit janë vërejtur disa iniciativa pozitive nga institucionet.

Në vitin 2023, institucionet e Mitrovicës Veriore⁵⁹ filluan rindërtimin e shtëpive të dëmtuara si rezultat i konfliktit të vitit 1999 në Kosovë. Ministria e Qeverisjes Lokale është duke financuar rindërtimin e dhjetë shtëpive, ndërsa Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës financon rindërtimin e 30 shtëpive.

Në periudhën midis vitit 2021 dhe 2023, komunat në të gjithë Kosovën kanë lëshuar 7,788 vendime për legalizim, duke ofruar për palët e prekura tituj pronësor në mënyrë formale përmes regjistrimit në regjistrin kadastral.

Në vitin 2021, në Mitrovicën e Veriut u raportua një rast i uzurpimit të paligjshëm.

Komuniteti shqiptar i Kosovës që jeton në qytetin e Novobërdës përballet me probleme me shpronësimin e pronës si pasojë e projekteve të mëdha infrastrukturore që lidhin Prishtinën me rajonin e Gjilanit. Ndërsa shpronësimi është legjitim dhe i rregulluar me kuadrin ligjor, duhet të bëhet kompensim i mjaftueshëm për pronarët e prekur të të gjitha komuniteteve. Disa pronarë kanë konsideruar se shumatat e propozuara për kompensim janë të pamjaftueshme dhe i kanë sfiduar ato në gjykatë. Në janar të vitit 2020, në Degën e Gjykatës në Novobërdë (Gjykata Themelore e Gjilanit) janë parashtruar 28 ankesa, duke kundërshtuar vendimet për kompensimin e pronës së shpronësuar. Pronarët pretendojnë se autoritetet kanë nënvlerësuar pronat e tyre dhe kanë kërkuar rritje të kompensimit.

Uzurpimi dhe riuzurpimi i paligjshëm i pronave vazhdon të jetë sfidë për komunitetin shqiptar të Kosovës në Mitrovicën e Veriut. Megjithatë, Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) ka qenë më e suksesshme në trajtimin e këtij problemi se pararendësja e saj.

⁵⁹ Ministria e Qeverisjes Lokale dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkëpunim me komunën e Mitrovicës Veriore

Në vitin 2024, jashtë periudhës së raportimit, AKKVP ka lëshuar 24 urdhra për dëbim (nga gjithsej 42), të cilat janë në pritje të përmbartimit.

Në maj të vitit 2015, Ministria për Komunitete dhe Kthim themeloi një Grup Ndërmintor Pune për Kthimin (GPNMK) për të inkurajuar kthimin e familjeve shqiptare të Kosovës në Kroin e Vitakut, lagje kjo e përzier në Mitrovicën e Veriut dhe një nga dy zonat e vështira për kthim në rajonin e Mitrovicës. Deri tani, GPNMK ka lëshuar leje ndërtimi për tri shtëpi të shqiptarëve të Kosovës në Kroin e Vitakut, nga gjashtë sa janë dorëzuar (tri kërkesa janë në pritje). Megjithatë, rindërtimi i shtëpive të shqiptarëve të Kosovës në këtë lagje mbetet përgjithësisht i pazgjidhur.

Ndryshe, shqiptarët e Kosovës që jetojnë në komunën e Graçanicës ose në komunën me shumicë turke të Mamushës, kanë qasje të barabartë dhe të plotë në pronë dhe banim.

11. Kthimi dhe riintegrimi

Kushtet e sigurisë, mungesa e mundësive socio-ekonomike dhe pakënaqësia me klimën aktuale politike në Mitrovicën e Veriut janë shtytësit kryesorë për shumë persona të zhvendosur shqiptarë të Kosovës me origjinë nga komunat veriore për të mos u kthyer.

Sipas të dhënave të UNHCR-së, nga viti 2015 vetëm 158 shqiptarë të Kosovës janë kthyer vullnetarisht nga zhvendosja në shtëpitë e tyre të para konfliktit.⁶⁰ UNHCR gjithashtu raportoi se gjithsej 6,900 individë vazhdojnë të jenë të zhvendosur brenda vendit, të gjithë nga rajoni i Mitrovicës.⁶¹

Projektet e ndërtimit dhe rindërtimit të mbështetura nga Këshilli Danez i Refugjatëve dhe Ambasada Britanike u ndaluan në vitin 2016, me një vendim të lëshuar nga Inspektorati i Mitrovicës Veriore.⁶² Në vitet 2015 dhe 2016 janë mbajtur një numër protestash lidhur me kthimin e pjesëtarëve të komunitetit shqiptar të Kosovës në lagjen Kroj i Vitakut, veçanërisht. Në lagje të tjera si Lagja e Doktorëve, komuniteti lokal vazhdoi të përballlet me sfida si pasojë e klimës politike, megjithëse u ndërtuan ose rindërtuan një numër shtëpish.

Në vitin 2018, Këshilli Danez për Refugjatë organizoi një aktivitet "shko-dhe-shih"⁶³ në komunën e Mitrovicës së Veriut.

Në vitin 2023, Ministria për Komunitete dhe Kthim ndërmori një hap të rëndësishëm duke publikuar thirrjen për ofrimin e ndihmës thelbësore për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë.⁶⁴ Kjo nismë kishte për qëllim adresimin e nevojave të tyre të ndryshme, përfshirë ofrimin e ushqimit dhe materialeve joushqimore, si dhe mbështetjen me ndërtimin dhe rindërtimin e shtëpive. Për më tepër, Ministria zgjeroi intervenimin e saj me synim të forcimit të sektorit bujqësor, duke ofruar subvencione për praktikat e qëndrueshme bujqësore. Në të njëjtën kohë ka pasur përpjekje specifike për mbështetjen e bizneseve të vogla të komuniteteve. Si rezultat i prekshëm i këtyre përpjekjeve, Ministria mbështeti 25 familje shqiptare të Kosovës, duke u ofruar atyre materiale ushqimore dhe joushqimore, përfshirë materiale ndërtimore.

60 Në vitin 2015, ishin gjithsej 20 shqiptarë të Kosovës të kthyer (në Istog- 1, në Mitrovicën e Veriut - 14 dhe në Zveçan – 5); në vitin 2016, 39 të kthyer (në Mitrovicë- 30 dhe në Zveçan – 9); në vitin 2017, 11 të kthyer janë raportuar në Mitrovicë; në vitin 2018, kanë qenë 43 të kthyer në Mitrovicë; dhe në vitin 2019, janë raportuar dy të kthyer në Mitrovicë. Zyra e Shefit të Misionit, Prishtinë, Pasqyrë statistikore 28 (dhjetor 2019).

61 Po aty.

62 Regjistruar nga monitoruesit në terren të OSBE-së në vitin 2016.

63 Vizitat "shko-dhe-shih" u ofrojnë personave të zhvendosur mundësi që të mbledhin informacion të dorës së parë për kushtet në vendin e tyre të origjinës dhe të ndërveprojnë dhe flasin drejtpërdrejt me komunitetin pritës për të marrë vendim të informuar për kthimin ose një zgjidhje tjetër të qëndrueshme.

64 Vendimi për vendosjen e procedurave për ofrimin e ndihmës nga Ministria për Komunitete dhe Kthim për anëtarët e komuniteteve joshumicë është lëshuar më 2 shkurt 2023. [Vendim i procedurave per ofrimin e ndihmes-Odlika o proceduri pruzenja pomoci compressed compressed-compressed \(1\).pdf \(rks-gov.net\)](#), (qasur në dhjetor 2023).

Në tetor të vitit 2023, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës shpalli fillimin e rindërtimit të 21 shtëpive dhe katër renovimeve për kthimin e shqiptarëve të Kosovës në Kroin e Vitakut, në komunën e Mitrovicës Veriore.⁶⁵ Ngjashëm, në tetor të vitit 2023, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) filloi punën për rindërtimin dhe renovimin e shtëpive për katër familje shqiptare të Kosovës në Cerajë dhe Bisticë të Shalës në komunën e Leposaviqit, si pjesë e programit të saj "Ndërtimi dhe rindërtimi i shtëpive për komunitetet joshumicë."⁶⁶ Për më tepër, në dhjetor të vitit 2023, MAPL publikoi një thirrje publike për operatorët ekonomikë për të shprehur interesim për ndërtimin e shtëpive për komunitetet joshumicë në komunat e Mitrovicës Veriore, Zveçanit, Leposaviqit dhe Zubin Potokut.⁶⁷

65 Raport i mediumit Kossev, <https://kossev.info/the-re-construction-of-albanian-owned-houses-in-brdjani-has-begun/?fbclid=IwAR2SjTsWlJaFXEEMVB0uTyQP-WxPw206LGpznqdkUULl8VG7er0OcrBcEk> (qasur në dhjetor 2023).

66 Shpallja e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, <https://mapl.rks-gov.net/organizimi/departamentet/ndertimi-dhe-renovimi-i-shtepive-per-komunitetet-jo-shumice/> (qasur në dhjetor 2023).

67 Po aty.



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Foto: Haris Alija

Profili i komunitetit

ashkali të Kosovës

osbe

Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Profili i komunitetit ashkali të Kosovës

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, 15,436 pjesëtarë të komunitetit ashkali të Kosovës¹ banojnë në Kosovë, që përbëjnë 0.89 për qind të popullsisë së përgjithshme.² Megjithatë jo të gjithë ashkalitë e Kosovës morën pjesë në regjistrimin e popullsisë i cili nuk u mbajt në katër komunat veriore.

Bazuar në dhënat e siguruara nga regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 dhe profilet komunale të OSBE-së të vitit 2018, vlerësohet se komuniteti përbënë afërsisht 0.83 për qind e popullsisë së përgjithshme.

Komuniteti ashkali i Kosovës nuk është shumicë në asnjë rajon apo komunë në Kosovë. Ashkalitë e Kosovës janë komuniteti i dytë më i madh në komunën e Ferizajt, ku ata përbëjnë rreth 3.35 për qind të popullsisë, pas shqiptarëve të Kosovës (me rreth 96 për qind). Ata janë komuniteti i dytë më i madh edhe në komunat e Mitrovicës Jugore, ku përbëjnë rreth një për qind të popullsisë, Podujevës (më pak se një për qind), Fushë Kosovës (rreth nëntë për qind), Lipjanit (mbi tre për qind), Shtimes (rreth tre për qind), Rahovecit³ (më pak se një për qind), Malishevës (28 pjesëtarë të komunitetit) dhe Suharekës⁴ (rreth 0.83 për qind e popullsisë).

Numër më i vogël i pjesëtarëve të komunitetit ashkali të Kosovës jetojnë gjetkë në Kosovë.⁵ Në komunën e Prishtinës, në vitin 2021, kishte 122 familje (rreth 530 banorë), shumica me banim në periferi në lagjen *Kodra e Trimave*. Në Obiliq ka rreth 700 deri në 800 pjesëtarë të komunitetit ashkali të Kosovës, shumica e të cilëve banojnë në qytetin e Obiliqit dhe në fshatrat Plemetin, Milloshevë dhe Carravodicë. Në komunën e Graçanicës jetojnë rreth 150 deri 200 pjesëtarë të komunitetit ashkali të Kosovës, shumica banojnë në qytetin e Graçanicës dhe në fshatrat Radevë, Skullan, dhe Suhadoll.

¹ Romët, ashkalitë dhe egjiptianët e identifikojnë veten si persona që u përkasin tri komuniteteve të veçanta, dhe si të tillë njihen nga kadri ligjor i Kosovës, institucionet e Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare. Misioni i OSBE-së në Kosovë e njëj plotësisht ekzistencën e tre komuniteteve të dallueshme dhe në këtë publikim është përpjekur të nxjerrë në pah karakteristikat dhe përvojat e tyre dalluese. Megjithatë, për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme të zëbërthyer për këto komunitete në disa komuna, pjesë të këtij profili përfshijnë shifra që përfaqësojnë romët, ashkalitë dhe egjiptianët së bashku.

² Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave në Kosovë, *Komunitetet pakicë në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011 në Kosovë: Analiza dhe Rekomandime*, <https://www.ecmikosovo.org/uploads/3engA.pdf> (qasur më 27 janar 2022).

³ Rreth 500 pjesëtarë të komunitetit.

⁴ Rreth 650 pjesëtarë të komunitetit.

⁵ OSBE, *Profilet Komunale 2018* 2018 (2019).

Numër i ngjashëm i pjesëtarëve të komunitetit jeton në komunën e Shtimes, shumica në qytetin e Shtimes dhe në fshatrat Gjurkoc, Vojnoc dhe Davidoc. Në komunën e Gjakovës jetojnë rreth 600 pjesëtarë të komunitetit [ashkali të Kosovës](#), në Klinë mes 80 dhe 100, dhe in Deçan 42.

Rreth 2,200 pjesëtarë të komunitetit [ashkali të Kosovës](#) banojnë në rajonin e Mitrovicës. Në komunën e Mitrovicës Jugore banojnë 168 familje (600 pjesëtarë) të cilët jetojnë në lagjen Adem Voca, 52 familje (rreth 380 pjesëtarë) në lagjen 2 Korriku, 12 familje (90 pjesëtarë) në Shipol, dhe një familje me pesë anëtarë në qytetin e Mitrovicës Jugore. Në komunën e Mitrovicës Veriore, janë pesë familje me 37 pjesëtarë që jetojnë në Mëhallën e Boshnjakëve. Në Podujevë janë 152 familje (857 pjesëtarë). Në komunën e Vushtrrisë ka 17 familje (96 pjesëtarë) në Prelluzhë, dhjetë familje (50 pjesëtarë) në Vushtrri, pesë familje (30 pjesëtarë) në Stanoc dhe gjashtë familje (35 pjesëtarë) në Bukosh. Në komunën e Skënderajt (periferi) ka katër familje me 20 pjesëtarë.

Faktet dhe problemet kryesore

- Në disa incidente, pronat e ashkalive të Kosovës janë prekur nga zjarret.
- Komuniteti ashkali i Kosovës është prekur edhe nga incidentet që kanë përfshirë sulme fizike.
- Si një nga komunitetet më të vogla joshumicë, komuniteti ashkali i Kosovës nuk e ka asnjë ministër në qeverinë e formuar në vitin 2021. Nga 120 deputetët e Kuvendit një është ashkali i Kosovës.
- Pjesëmarrja politike e pjesëtarëve të komunitetit ashkali të Kosovës, veçanërisht e grave, është përgjithësisht e ulët.
- Komuniteti ashkali i Kosovës ballafaqohet me varfëri dhe kushte të vështira socio-ekonomike.
- Komuniteti përballlet me shkallë të lartë të papunësisë dhe qasje të pabarabartë në mundësitë e punësimit.
- Puna e fëmijëve, përfshirë trafikimin e fëmijëve, prekin komunitetin ashkali të Kosovës.
- Ashkalitë e Kosovës kanë më shumë gjasa që të përjashtohen nga skemat e asistencës sociale.
- Komuniteti përballlet me pengesa financiare dhe logjistike rreth qasjes në shërbime të kujdesit shëndetësor, si dhe me diskriminim në baza etnike.
- Komuniteti ashkali i Kosovës përballlet me sfida në qasjen dhe gëzimin e të drejtave pronësore dhe banesore, pasi shumë prej tyre nuk posedojnë tokë, ndërsa të tjerët përballen me mungesë të titujve pronësorë, lejeve të ndërtimit apo regjistrimit formal të transaksioneve pronësore.

1. Siguria dhe rendi

Situata e sigurisë së komunitetit ashkali të Kosovës është përmirësuar gradualisht gjatë pesë viteve të fundit, me përjashtim të vitit 2019, kur numri i incidenteve që prekin këtë komunitet u rrit në krahasim me vitin paraprak, dhe në vitin 2020, kur numri i incidenteve u rrit në fillim të Pandemisë COVID-19.⁶

Krahas numrit të lartë të vjedhjeve që prekin këtë komunitet, janë regjistruar edhe incidente tjera të rënda, shumica prej të cilave kishin të bënin me sulme fizike, përfshirë përdorimin e armëve.⁷ Rastet e zjarrvënieve apo zjarrit kanë qenë relativisht të shpeshta. Policia e Kosovës rrallëherë jep informacione për hetimin dhe ndjekjen penale të këtyre rasteve, në shumicën e të cilave nuk dihet origjina e zjarreve. Ka pasur dy raste të vandalizmit në një varrezë ku janë varrosur pjesëtarët e komunitetit ashkali të Kosovës.⁸ Llojet e tjera të incidenteve të raportuara kanë përfshirë diskriminimin⁹ dhe dhunën me bazë gjinore, si sulmet seksuale, përdhunimet dhe trafikimi me njerëz.¹⁰

Vlen të theksohet se që nga viti 2019, në Policinë e Kosovës kanë qenë 20 pjesëtarë të komunitetit ashkali të Kosovës. Në vitin 2023, ky numër mbeti i njëjtë (vetëm burra). Ata shërbejnë në Policinë e Kosovës në Mitrovicë të Jugut, Mitrovicë të Veriut, Pejë, Istog, Klinë, Gjakovë, Rahovec, Malishevë, Suhareke dhe në nënstacionin e Prelluzhës në komunën e Vustrisë.

Janë tetë pjesëtarë të komunitetit ashkali Kosovës në Komitetet Lokale të Sigurisë Publike (KLSP).

6 Sipas monitorimit të brendshëm të bërë nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, ka pasur 13 incidente në vitin 2013; 21 në vitin 2014; 11 në 2015; 11 në 2016; shtatë në 2017; nëntë në 2018; 15 në 2019; 14 në 2020; 14 në 2021; 15 në 2022 dhe 12 në vitin 2023.

7 Shqiptarët e Kosovës janë arrestuar për therje me thikë të pjesëtarëve të komunitetit ashkali të Kosovës në Klinë në gusht të vitit 2017, në Ferizaj në korrik të vitit 2019, dhe në fshatin Magurë të komunës së Lipjanit, në mars të vitit 2020. Në qershor të vitit 2021, në Mitrovicën e Jugut, një shqiptar i Kosovës u shkaktoi lëndime trupore tre grave të komunitetit ashkali të Kosovës, duke përdorur shufër metalike dhe sprej piper, pas së cilës u arrestua. Në korrik të vitit 2021, një shqiptar i Kosovës u arrestua për sulm fizik ndaj të miturit ashkali në Mitrovicën e Jugut. Në shtator të vitit 2022, në Suharekë, një shqiptar i Kosovës e kishte sulmuar një 9 vjeçar, pjesëtar i komunitetit ashkali të Kosovës. Në nëntor të vitit 2022, në Prishtinë, një shqiptar i Kosovës e kishte sulmuar fizikisht me shufër metalike një ashkali të Kosovës.

8 Në dhjetor të vitit 2018 në fshatin Besi, komuna e Prishtinës, një ashkali i Kosovës, raportoi se një shqiptar i Kosovës e kishte lëvruar tokën me traktor duke dëmtuar varrezat e anëtarëve të familjes së tij. Policia e Kosovës ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka arrestuar të dyshuarin.

9 Në nëntor të vitit 2021, ministri i administrimit të pushtetit lokal, z. Elbert Krasniqi, ka raportuar në faqen e tij në Facebook se pjesëtarët e komunitetit ashkali të Kosovës nuk janë shërbyer në një bar/restorant në Gjakovë, duke bërë thirrje që të bojkotohen baret dhe restorantet në të cilat ndodh diskriminimi. Deklarata e tij u miratua nga ministrja e drejtësisë, znj. Albulena Haxhiu dhe nga disa përfaqësues të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës.

10 Në shkurt të vitit 2020 në Gjakovë, i dyshuari mashkull shqiptar i Kosovës u arrestua pasi kishte ngacmuar seksualisht një viktimë femër të mitur të komunitetit ashkali të Kosovës. Në mars të vitit 2020, Policia e Kosovës raportoi se një shqiptar i Kosovës i kishte ngacmuar seksualisht dy vajza të komunitetit ashkali të Kosovës (të mitura nën moshën 14 vjeçare) dhe që e kishte arrestuar të dyshuarin. Në nëntor të vitit 2020 në Ferizaj është arrestuar një shqiptar i Kosovës, pasi e kishte shfrytëzuar dhe manipuluar një grua të komunitetit ashkali të Kosovës (me aftësi të zvogëluar mendore), duke e trafikuar atë me persona të ndryshëm. Pesë shqiptarë të Kosovës dhe një shtetas i Republikës së Shqipërisë janë arrestuar nën dyshimin e shfrytëzimit seksual. Në maj të vitit 2021, dy shqiptarë të Kosovës janë paraburgosur për veprën penale "Trafikimi me njerëz" për shkak se kanë shfrytëzuar një grua të komunitetit ashkali të Kosovës.

2. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi

Asnjëri nga ministrat në qeverinë e formuar në vitin 2021 nuk është nga komuniteti ashkali i Kosovës; megjithatë, zëvendësministri i industrisë, ndërmarrësisë dhe tregtisë, Resul Makreshi, është nga Partia Ashkalitë për Integrim (PAI).

Më parë ai ka qenë zëvendësministër i financave. Egzonit Jakupi shërben si këshilltari i parë ndonjëherë i kryeministrit nga radhët e komunitetit ashkali të Kosovës. Qazim Rrahmani nga PAI ka shërbyer si zëvendësministër i kulturës, rinisë dhe sporteve në qeverinë e kaluar. Komuniteti përfaqësohet në Kuvend nga Bekim Arifi i partisë PAI.

Në zgjedhjet e vitit 2019 ka marrë pjesë edhe Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK). Dy burra aktualisht mbajnë dy vendet e rezervuara për komunitetin në Këshillin Konsultativ për Komunitete.

Komuniteti është i përfaqësuar në 19 komitete të komuniteteve (KK) në mbarë Kosovën¹¹ me 26 anëtarë të KK (21 burra dhe pesë gra).¹² Ashkalitë e Kosovës nuk janë të përfaqësuar në KK në nëntë komuna ku banojnë pjesëtarët e komunitetit.¹³ Në shtatë komuna, KK-të kryesohen nga burra ashkali të Kosovës: Ferizaj, Fushë Kosovë, Obiliq, Podujevë, Rahovec, Shtime, dhe Suharekë.

Përderisa asnjë zëvendëskryesues për komunitete i kuvendeve komunale (ZKXXX) nuk është ashkali i Kosovës, në Ferizaj dhe Lipjan nënkryetarët e komunës për komunitete (NKK) janë burra nga ky komunitet.¹⁴

11 Deçan, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Graçanicë, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Skënderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri.

12 Përfaqësimi i grave ashkali të Kosovës brenda KK-ve mbetet veçanërisht sfidues (19 përqind).

13 Ky komunitet nuk është i përfaqësuar në Dragash, Gjilan, Istog, Kaçanik, Mamushë, Mitrovicë e Veriut, Novobërdë, Pejë, Shtërpocë. Vlerësimet e banorëve për komunat Leposaviq, Mitrovicë e Veriut Zubin Potok dhe Zveçan bazohen në Profilet komunale të vitit 2018 për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare të regjistrimit të popullsisë.

14 Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, ashkalitë e Kosovës përfaqësojnë komunitetin më të madh joshumicë në komunën e Fushë Kosovës dhe në bazë të kuartit ligjor në fuqi në kohën e emërimit, ky komunitet duhet të mbajë pozitën e nënkryetarit të komunës për komunitete (NKK). Mirëpo, në vitin 2022, Kuvendi Komunal i Fushë Kosovës e ka emëruar Suhat Ademin (Koalicioni Iniciativa për Fushë Kosovë i komuniteteve Egyptian-Ashkali, IFKEA), si NKK nga radhët e komunitetit egjiptian të Kosovës. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) e kundërshtoi këtë emërim, gjë që shpui në padi kundër kuvendit komunal. Gjykata më vonë vendosi kundër kundërshtimit të MAPL-së. Vlen të përmendet se Udhëzimi i ri Administrativ për procedurën e emërimit të NKK-ve në komuna i miratuar në dhjetor 2023 (UA nr. 03/2023) hoqi kriterin që nënkryetari të jetë nga komuniteti më i madh joshumicë me banim në komunë.

Shtatë burra **ashkali të Kosovës** janë anëtarë të zyrave komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK) në dy komuna.¹⁵ Në Ferizaj pozitën e shefit të ZKKK-së e mban një **ashkali i Kosovës**.¹⁶

Në këshillat komunalë për siguri në bashkësi (KKS) janë 15 pjesëtarë të komunitetit **ashkali të Kosovës** si vijon: një grua dhe një burrë në Ferizaj, nga një burrë në Mitrovicë të Jugut, Skenderaj, Vushtrri, Podujevë, Fushë Kosovë, Graçanicë, Lipjan, Shtime, Prishtinë, Malishevë dhe Suharekë, dhe nga një grua në Gjakovë dhe Klinë.

Disa nga organizatat e njohura joqeveritare (OJQ) të udhëhequra nga **ashkalitë e Kosovës** dhe/ose që punojnë në çështje që prekin komunitetin **ashkali të Kosovës** janë "Roma Versitas Kosovo", "Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve" (VoRAE), "Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane (RROGRAEK)", "Advancing Together" "Terre des Hommes", "The Ideas Partnership", "Qendra e Dokumentimit të Romëve dhe Ashkalive", dhe OJQ "Balkan Sunflowers". Në Ferizaj, janë aktive "Bashkimi Rinor e Ardhmja e Ndritur (BRAN)" dhe "Gëzimi Ynë Rinor" (GYR). Në Mitrovicën Jugore, janë aktive "Zëri i Rinisë Rome dhe Ashkalive të Mitrovicës (ZRRAM)" dhe "Perparimi Rinori i Ashkalive të Mitrovicës (PRAM)". Derisa në Gjakovë janë aktive OJQ-të: "Roma in Action", "Bethany Christian Service", "Arena", "Prosperiteti", "Iniciativa për Veprim", "Ec vetë" dhe "Qendra Kreative – Cërmjan". Në Klinë, është aktive OJQ-ja lokale "Syri Vizionit" nga Peja dhe "JETA" është aktive në Deçan.

Në Podujevë, janë aktive OJQ-të e udhëhequra nga komuniteti **ashkali i Kosovës** "Qëndrimi", "Shpresa Demokratike" dhe "Një Hap Me Ne". Për më tepër, OJQ-ja "Mundësia" e udhëhequr nga shqiptarët e Kosovës punon në çështjet që prekin gratë nga komunitetet joshumicë. "Përparimi i Komuniteteve" është aktiv në komunën e Suharekës. Fokusi kryesor i saj është arsimiti.

¹⁵ Në Ferizaj dhe Lipjan.

¹⁶ Një ashkali i Kosovës u emërua kryesues i ZKK-së në Mitrovicën e Veriut pas zgjedhjeve komunale të mbajtura në prill të vitit 2023.

3. Punësimi dhe gjendja socio-ekonomike

Vështirësitë socio-ekonomike të komunitetit ashkali të Kosovës rrjedhin nga shkalla e lartë e papunësisë dhe qasja e pabarabartë në mundësi. Ngjashëm me komunitetin rom dhe egjiptian të Kosovës, komuniteti ashkali i Kosovës vuan nga shkalla më e lartë e varfërisë në krahasim me komunitetet tjera në Kosovë.¹⁷

Mungesa e kualifikimeve dhe shkathtësive në mesin e pjesëtarëve të komunitetit ashkali të Kosovës pengon qasjen e tyre në mundësitë e punësimit dhe rrit përjashtimin socio-ekonomik. Në vitin 2023, shkalla e papunësisë në radhët e komunitetit rom dhe ashkali të Kosovës ishte mbi 90 për qind.¹⁸ Papunësia, ndonëse e përhapur, prek veçanërisht të rinjtë dhe personat mbi 45 vjeç. Në vitin 2018, 95,890 persona nga të gjitha komunitetet janë regjistruar si të papunë, 2.8 për nga të cilët janë pjesëtarë të komunitetit ashkali të Kosovës.¹⁹ Deri në fund të vitit 2018, gjithsej 1,409 ashkali të Kosovës janë regjistruar si punëkërkuar aktivë në 17 komuna.²⁰

Një numër i madh i të rinjve nga komuniteti ashkali i Kosovës të moshës 18 deri në 24 vjeç karakterizohen si persona që nuk janë të kyçur në arsim, punësim apo trajnim (NEET). Së bashku me romët dhe egjiptianët e Kosovës, ashkallitë e Kosovës përbëjnë 78 për qind të të rinjve me status NEET. Sa i përket gjinisë, rreth 88 për qind e grave nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës klasifikohen si NEET dhe shkalla e tyre e punësimit është jashtëzakonisht e ulët – katër për qind. Vetëm 37 për qind e grave nga këto tri komunitete kanë perceptim pozitiv për jetën, në krahasim me 51 për qind të grave nga komunitetet tjera në Kosovë.²¹ Mundësitë e punësimit në sektorin privat janë të kufizuara dhe ashkallitë e Kosovës zakonisht janë të angazhuar në sektorin joformal, duke mbajtur punë të pasigurta, me aftësi të ulëta, me paga të ulëta dhe me status të ulët,²² të tilla si ndërtimet sezonale ose punët bujqësore, prerja e drunjëve dhe grumbullimi i hekurishteve dhe materialeve të riciklueshme. Disa nga ta janë të përfshirë në biznese të vogla tradicionale, si zejtaria ose muzika tradicionale.²³ Disa pjesëtarë të komunitetit kërkojnë lëmshë për të fituar të ardhura ditore.

17 Komisioni Evropian - Raporti i vitit për Kosovën, f. 31.

18 Shih Komisioni Evropian, Dokumenti i Punës, *Raporti për Kosovën 2023* (2023), f. 100

19 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, *Puna dhe Punësimi në Kosovë. Raporti Vjetor 2018* (2019), f. 19.

20 Deçan; Ferizaj (mes janarit dhe dhjetorit 2023, 33 individë nga radhët e komunitetit ashkali të Kosovës (14 burra dhe 19 gra) janë regjistruar sërish si punëkërkuar aktivë në në qendrën rajonale të punësimit, derisa numri i përgjithshëm i individëve nga radhët e komunitetit ashkali të Kosovës të regjistruar si punëkërkuar aktivë, nga dhjetori 2023, është 85 (40 burra dhe 45 gra); Fushë Kosovë; Graçanicë; Istog; Kamenicë; Klinë; Mamushë; Novobërdë; Mitrovicë Jugore; Obiliq; Podujevë; Shtime; Rahovec; Prizren; Vushtrri, Viti (15 individë).

21 Shih Organizata Ndërkombëtare të Punës, *Perspektiva e të rinjve romë, ashkali dhe egjiptianë për mundësitë e punës së denjë dhe sfidat në Kosovë* (2018), f. 21.

22 Shih Komisioni Evropian - Raporti i vitit për Kosovën, f. 67.

23 Raporti i OSBE-së Vështrim i përgjithshëm i romëve, fq. 21.

Pak pjesëtarë të komunitetit **ashkali të Kosovës** janë të punësuar në shërbimin civil, veçanërisht në nivel qeveritar. Shumica mbajnë punë të nivelit teknik ose administrativ, ku gratë janë të nën-përfaqësuar.²⁴ Përveç shërbimit civil, pjesëtarët e komunitetit **ashkali të Kosovës** janë më të angazhuar në punët e sektorit publik në krahasim me komunitetin rom të Kosovës, kryesisht në sektorin e shëndetësisë dhe arsimit, ujësjellësit, ndërmarrjeve të shërbimeve komunale dhe të mbeturinave, si dhe në Doganën e Kosovës, Policinë e Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës.²⁵

Në komunën e Prizrenit, shkalla e lartë e papunësisë prek të rinjtë dhe personat mbi moshën 45 vjeçare, burra dhe gra. Aktualisht janë 68 punëkërkuar aktivë nga komuniteti, gjysma e tyre gra. Dy gra punojnë në komunën e Prizrenit në punë mirëmbajtjeje/pastrimi dhe tri janë infermiere në një spital lokal, ndërsa dhjetë burra janë të punësuar në kompaninë publike "EcoRegioni", ku punojnë në pastrim dhe grumbullim të mbeturinave. Në sektorin privat, pjesëtarët e komunitetit janë kryesisht të punësuar në sektorin e supermarketeve/gastronomisë/ shërbimeve si arkëtarë dhe pastrues. Në zonat rurale, komuniteti merret me bujqësi. Ka projekte dhe kurse të ndryshme të drejtuara nga ministrinë dhe OJQ-të që janë në dispozicion për pjesëtarët e komunitetit. Në komunën e Suharekës, që nga viti 2023, tre burra janë regjistruar si punëkërkuar aktivë. Disa pjesëtarë të komunitetit janë të punësuar në kompaninë e pijeve "Golden Eagle"; ndërsa gratë nga radhët e komunitetit **ashkali të Kosovës** punojnë në një fabrikë të prodhimit të çantave në Mamushë.

Në rajonin e Prishtinës, komuna e Lipjanit ka parë një përmirësim sa i përket punësimit në sektorin privat, por jo në institucionet publike. Në Shtime, disa pjesëtarë të komunitetit janë duke punuar në sektorin publik në komunë, ose në mbledhjen e mbeturinave. Rreth 100-150 janë të punësuar në sektorin privat. Në Obiliq, shtatë pjesëtarë të komunitetit **ashkali të Kosovës** janë të punësuar në sektorin publik. Në Prishtinë, asnjë **ashkali i Kosovës** nuk është i punësuar në komunë, institucione komunale apo ndërmarrje publike lokale. Shumica dërrmuese punojnë në sektorin privat, në veçanti kompanitë e pastrimit që operojnë gjithashtu si kontraktorë komunalë dhe si shitës në dyqane ushqimore. Disa **ashkali të Kosovës** në qytet gjenerojnë fitim të vogël nga grumbullimi i mbeturinave. Në Graçanicë nuk ka asnjë **ashkali të Kosovës** të punësuar në sektorin publik, ndërsa ka rreth 20 burra nga komuniteti që punojnë në sektorin privat.

Gjendja e përgjithshme ekonomike e komunitetit **ashkali të Kosovës** në Ferizaj po përmirësohet ngadalë.²⁶ Janë 64 **ashkali të Kosovës** të punësuar në sektorin publik, të cilët punojnë në komunë, në spitale, në korporatë elektrike, ose si policë dhe zjarrfikës. Gjithashtu janë 155 **ashkali të Kosovës** të punësuar në sektorin privat.²⁷ Megjithatë, shumë familje ende varen nga asistenca sociale, ku 211 familje nga komuniteti **ashkali i Kosovës** (1,084 individë) pranojnë asistencë të tillë.²⁸ Shumë gra kanë gjetur punësim në marketet e komunës ose në qendra tregtare në Prishtinë.²⁹

24 OSBE, *Përfaqësimi i komuniteteve në Shërbimin Civil në Kosovë* (2017), f. 17 dhe 23

25 Deçan; Ferizaj; Graçanicë; Istog; Klinë; Lipjan; Mitrovicë Veriore; Mitrovicë Jugore; Novobërdë; Podujevë; Prishtinë; Prizren; Vushtrri. Shih: Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Vështrim i përgjithshëm i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë* (2020), fq.13.

26 Përfaqësuesi nga zyra e zëvendëskryetarit të komunës për komunitete dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.

27 Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.

28 Qendra për Punë Sociale në Ferizaj.

29 OJQ BRAN.

Në rajonin e Gjilanit, sipas një përfaqësuesi të komunitetit, nuk ka asnjë ashkali të Kosovës të punësuar në sektorin publik në komunën e Vitisë; vetëm një nga 16 pjesëtarët e komunitetit që janë në moshë pune (nga 38 pjesëtarë të komunitetit sa janë gjithsej) është pronar i një biznesi privat. Njëzet e tre anëtarë të komunitetit pranojnë ndihmë sociale dhe dy pranojnë pension. Komuniteti ashkali i Kosovës në fshatin Pozharan, të komunës së Vitisë, jeton në kushte veçanërisht të vështira ekonomike, me banim joadekuat dhe shkallë të lartë të papunësisë. Pjesëtarët e këtij komuniteti janë të angazhuar kryesisht në punë sezonale si mirëmbajtje dhe ndërtimtari ose herë pas here me projekte të OJQ-ve.³⁰

Papunësia është e lartë në të gjitha komunat ku banon komuniteti ashkali i Kosovës në rajonin e Mitrovicës. Në komunën e Mitrovicës Jugore, nuk ka të punësuar në sektorin publik nga radhët e komunitetit ashkali të Kosovës. Një numër shumë i vogël i pjesëtarëve të komunitetit punojnë çdo ditë në kompani private, kryesisht në ndërtimtari. Në komunën e Podujevës, ashkallitë e Kosovës janë të punësuar si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, por nuk ka të dhëna të detajuara për këtë komunitet. Në komunën e Vushtrrisë, vetëm tre anëtarë të komunitetit ashkali të Kosovës (të gjithë burra) punojnë në sektorin publik - në Policinë e Kosovës, në sektorin e arsimit si mësimdhënës dhe si pastrues.

Projekte të gjenerimit të të ardhurave u janë ofruar anëtarëve të komunitetit ashkali të Kosovës, shpesh duke synuar edhe komunitetet rom dhe egjiptian të Kosovës, nga organizata të ndryshme ndërkombëtare, qeveritare dhe joqeveritare. Bashkimi Evropian (BE)-Programi i Stabilizimit të Komunitetit,³¹ tani në fazën e katërt, ka ofruar mbi 900 grante³² për bizneset e reja dhe ekzistuese në pronësi të komuniteteve joshumicë në mbarë Kosovën, duke përfshirë edhe ato nga komuniteti ashkali i Kosovës. Në Mitrovicën e Jugut, për shembull, Këshilli Danez për Refugjatë mbështeti themelimin e "inkubatorit të biznesit" në lagjen Adem Voca të banuar kryesisht me ashkali dhe romë të Kosovës, i cili përbëhet nga afërsisht dhjetë biznese lokale, të drejtuar nga dhe për pjesëtarët e komunitetit. Pjesëtarët e komunitetit ashkali të Kosovës në rajon mund të përfitojnë nga iniciativat e qendrës rajonale të punësimit. Disa iniciativa përfshijnë programin e subvencionimit të pagave, përmes të cilit pjesëtarët e komunitetit pranojnë pagesa shtesë ndërsa punojnë për kompanitë partnere private, si dhe programin që ofron trajnim profesional për personat e riatdhesuar dhe personat në asistencë sociale.

Komuniteti Ashkali i Kosovës në rajonin e Pejës banon kryesisht në komunën e Gjakovës. Gjendja e tyre ekonomike është e ngjashme me atë të pjesëtarëve të komunitetit që jetojnë në vendet tjera. Në komunën e Rahovecit, për shembull, vetëm tetë (dy prej të cilëve gra) nga rreth 500 pjesëtarë të komunitetit janë të regjistruar si punëkërkues aktivë, ndërsa shumica janë përfituese të asistencës sociale.

30 Përfaqësuesi i komunitetit ashkali të Kosovës në Viti.

31 Programi i Stabilizimit të Komunitetit i BE-së, i realizuar nga viti 2010, është tani në fazën e tij të katërt, dhe ka mbështetur rreth 900 mikro-ndërmarrje të reja dhe ekzistuese duke kontribuar kështu në zbatimin e projekteve të zhvillimit individual dhe të komunitetit. Është program i financuar nga BE-ja i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë në partneritet me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK) dhe zbatohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM). Shih: Misioni i Organizatës Ndërkombëtare për Migrim në Kosovë, *EU – Programi i Stabilizimit të Komunitetit*, <https://kosovo.iom.int/news/eu-community-stabilization-programme> (Qasur në dhjetor 2023).

32 Po aty.

Ata që janë të punësuar punojnë në pastrim, mirëmbajtje, ndërtim dhe zejtari. Ata që jetojnë në zona rurale merren me bujqësi.

Puna e fëmijëve është veçanërisht e përhapur në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës (rreth 17 përqind krahasuar me 11 përqind sa është niveli për mbarë Kosovën).³³ Nuk ka të dhënat e sakta, të zbërthyer për këtë komunitet. Puna e fëmijëve është e lidhur ngushtë me nivelet e varfërisë së familjes, arritjet e kufizuara në arsim, si dhe mungesën e kujdesit dhe mbikëqyrjes prindërore.³⁴ Ekziston dallim i konsiderueshëm gjinor, pasi në punën e fëmijëve janë të përfshirë më shumë djem.³⁵ Fëmijët mbledhin kanaçe nga koshat e mbeturinave, pastrojnë dritaret e veturave, shesin sende në rrugë dhe kafene, si dhe lypin para. Përveç kësaj, 13 për qind e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës punojnë në kushte të rrezikshme, duke përfshirë punën fizike në fusha, prerjen e pemëve, operimin e makinerive bujqësore, spërkatjen e pesticideve, korrijen, shirjen ose punën në thertore dhe miniera.³⁶ Në përgjithësi, puna e fëmijëve minon qasjen në arsim dhe ka ndikim negativ në cilësinë e tij, duke kufizuar mundësitë dhe duke kontribuar në vazhdimin e zinxhirit të përjashtimit social.

Ashkalitë e Kosovës, së bashku me romët dhe egjiptianët e Kosovës, besohet se përbëjnë grupin e dytë më të madh të azilkërkuësve nga Kosova në vendet e BE-së.³⁷ Shumë nga ta identifikojnë varfërinë, mungesën e mirëqenies sociale dhe sigurimit shëndetësor, si dhe mungesën e mundësive për punësim si arsyt kryesore për migrim.³⁸ Ka edhe migrim sezonal për të kërkuar punë si në BE ashtu edhe në vendet fqinje si Shqipëria, Maqedonia e Veriut ose Mali i Zi.

Në vitin 2022, qeveria e Kosovës krijoi platformë për luftimin e diskriminimit ndaj pjesëtarëve të tre komuniteteve për t'ua mundësuar atyre që të raportojnë incidentet e diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike. Në vitin 2023, Qeveria krijoi ekip ndërinstitucional për promovimin e punësimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për të rritur punësimin e tre komuniteteve në shërbimin civil dhe gjtëkë.

33 Shih Organizata Ndërkombëtare të Punës, *Perspektivat e Romëve*, fq. 24.

34 Zyra për Qeverisje të Mirë, *Planifikimi dhe vlerësimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve* (2012), fq. 25; UNICEF, *Analizë e gjendjes së fëmijëve dhe grave në Kosovë* (2017), f. 89.

35 Shih Organizata Ndërkombëtare të Punës, *Perspektivat e Romëve*, fq. 23-24.

36 Shih UNICEF, *Analizë e situatës*, fq. 91; Organizata Ndërkombëtare të Punës, *Perspektivat e Romëve*, fq. 24; Banka Botërore, *Anketë e grupeve me tregues të shumëfishtë 2013-14, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian* fq. 128.

37 Shih Zyra Evropiane për Mbështetjen e Azilit, azilkërkuësit nga Ballkani Perëndimor: analizë krahasuese e trendeve, faktorët shtytës-tërheqës dhe reagimet – Përditësim (2015), fq. 10; Shih gjithashtu, Zyra Evropiane për Mbështetjen e Azilit, *azilkërkuësit nga Ballkani Perëndimor* (2013), fq. 23.

38 OSBE, *Raport i vlerësimit të drejtave të komuniteteve* (2015), fq.26.

4. Qasja në infrastrukturë dhe shërbime publike

Komuniteti ashkali i Kosovës herë pas here ka probleme me ndërprerje të energjisë elektrike dhe furnizimit me ujë të pijshëm në zonat ku ata banojnë. Nuk ka gjithmonë qasje në infrastrukturë adekuate, siç janë rrugët e asfaltuara dhe ndriçimi i tyre në zonat rurale, dhe ka shumë fshatra pa sistem të kanalizimit.

Menaxhimi i mbeturinave është i parregullt dhe deponitë ilegale të mbeturinave shpesh ndodhen në afërsi të zonave të banuara nga komuniteti ashkali i Kosovës. Megjithatë, ka pasur përmirësime të dukshme nga investimet komunale vitet e fundit në zonat e banuara nga komuniteti ashkali i Kosovës në mbarë Kosovën.

Pas investimeve të bëra në bazë të rekomandimeve të zyrave komunale dhe mekanizmave për mbrojtjen e komuniteteve, komuniteti ashkali i Kosovës në komunën e Ferizajt ka qasje të mirë në infrastrukturë dhe shërbime publike, siç është asfaltimi i rrugëve dhe trotuareve në lagjen urbane Halit Ibishi.³⁹ Në të gjitha lagjet urbane të banuara nga komuniteti ashkali i Kosovës (Sallahane, Halit Ibishi, Koce Xoxe dhe Geriq) dhe në fshatrat Dubravë e Koshare, ndriçimi i rrugëve është funksional dhe furnizimi me ujë raportohet se është i mirë. Në vitin 2019, drejtoria komunale për shërbime publike në Ferizaj ka pastruar dy deponi ilegale të mbeturinave, një në Dubravë dhe një në Sallahane.

Megjithatë, shumë pjesëtarë të komunitetit në komunën e Ferizajt kanë nevojë për ndërtim apo rindërtim të banesave. Sipas kreut të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK), në periudhën janar 2015 dhe korrik 2017, rreth 170 kërkesa që kanë të bëjnë me ndërtimin apo rindërtimin e shtëpive janë paraqitur nga pjesëtarët e komunitetit ashkali të Kosovës.⁴⁰ Disa nga kërkesat u plotësuan përmes partneritetit të komunës me OJQ-në VoRAE. Për shkak të mungesës së financimit, lëndët e mbetura janë përcjellë në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK) dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Në tetor të vitit 2018, komuna e Ferizajt nënshkroi Memorandum Mirëkuptimi me MPMS-në për ndërtimin e dhjetë shtëpive për familjet e komunitetit ashkali të Kosovës. Në vitin 2019 janë miratuar për ndërtim 37 shtëpi në Ferizaj, 33 janë përfunduar në vitin 2019 dhe katër në vitin 2020.

39 ZKKK.

40 OSBE, Vështrim i përgjithshëm i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, f. 12.

Deri më 31 dhjetor 2023, 125 familje të komunitetit **ashkali të Kosovës** në Ferizaj kishin dorëzuar kërkesa për ndërtimin ose rindërtimin e shtëpive pas thirrjes së hapur të MAPL-së në vitin 2023, por vetëm tetë kërkesa për rindërtim dhe një kërkesë për ndërtim të ri janë miratuar deri më tani, dhe kërkesat e mbetura janë në pritje.⁴¹

Në rajonin e Prizrenit, shumica e pjesëtarëve të komunitetit **ashkali të Kosovës** jetojnë në lagjet e komuniteteve të përziera në qytetet e Prizrenit, Suharekës dhe Rahovecit, dhe në fshatrat Gejlance, Leshan, Tërnje, Xërxe, Ratkoc dhe Radost. Një numër më i vogël jetojnë në komunën e Malishevës. Qasja në infrastrukturë, shërbime publike dhe banim është përgjithësisht e mirë në rajon. Megjithatë, në zonat rurale komuniteti vuan herë pas here nga ndërprerjet e energjisë elektrike dhe furnizimit me ujë të pijshëm. Menaxhimi i mbeturinave është i parregullt dhe deponitë ilegale të mbeturinave shpesh ndodhen në afërsi të zonave të banuara. Përveç kësaj, një numër i familjeve të komunitetit **ashkali të Kosovës** mbështeten në ndihmën nga zyrat komunale për komunitete dhe kthim, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet publike në nivel komunal dhe qeveritar.⁴²

Në rajonin e Pejës, shumica e pjesëtarëve të komunitetit banojnë në qytetin e Gjakovës, dhe në fshatrat Brekoc, Skivjan dhe Piskot. Gjatë vitit 2022 dhe 2023, janë bërë përmirësime të infrastrukturës në zonat e komunës së Gjakovës ku banon komuniteti. Shtëpitë janë rinovuar apo ndërtuar dhe rrugët janë asfaltuar apo ndërtuar në fshatin Skivjan dhe në lagjet "Brekoc", "Mahalla e Sefes" dhe "Mehmet Hyseni".⁴³

Në rajonin e Prishtinës, shumica e shtëpive në lagjet e urbanizuara ku banojnë pjesëtarët e komunitetit **ashkali të Kosovës** nuk kanë leje ndërtimi dhe parcelat e tokës nuk janë në pronësi të banorëve të tyre. Në Fushë Kosovë, Zyra e Kryeministrit ndërtoi 280 shtëpi për romët, ashkalitë dhe egjiptianët e Kosovës; 34 shtëpi janë ndërtuar nga MPMS, dhe janë tri shtëpi në ndërtim e sipër të financuara nga MKK-ja. Megjithatë, në lagjet 28 dhe 29, pjesëtarët e komunitetit ende furnizohen me ujë jo të pijshëm nga pusët.⁴⁴ Pjesëtarët e komunitetit në njësi banimi individuale të përhershme kanë qasje të duhur në energji elektrike, furnizim me ujë, kanalizim dhe ndriçim funksional të rrugëve, falë mbështetjes së organizatave ndërkombëtare dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, e cila ka kompensuar buxhetin e ulët komunal. Në Lipjan janë duke u ndërtuar dhe financuar 11 shtëpi nga MPMS.⁴⁵ Në Shtime janë ndërtuar 15 shtëpi për komunitetin **ashkali të Kosovës**; Rrugët dhe kanalizimet janë në gjendje të mirë, ndërsa kapaciteti i energjisë elektrike është shumë i dobët. Në fshatin Plemetin, komuna e Obiliqit, rruga, sistemi i kanalizimit dhe ndriçimi i rrugëve kanë nevojë për riparim. Sipas pjesëtarëve të komunitetit, ata aplikuan për rinovimin e shtëpive, por vetëm disave prej tyre iu rinovuan shtëpitë.

41 Nënkyetari i komunës për komunitete; Kryetar i Komitetit për Komunitete.

42 Po aty, p. 90.

43 Duhet të theksohet se nuk ka të dhëna të zëbërthyer për këta përfitues, kështu që nuk ka informacion përfundimtar nëse ata i përkasin komuniteteve ashkali, romë apo egjiptianë të Kosovës.

44 OSBE, *Vështrim i përgjithshëm i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë*, P. 16.

45 Memorandumi i Mirëkuptimit u nënshkrua më 16.04.2019 ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe komunës së Lipjanit për ndërtimin e shtëpive.

Në rajonin e Mitrovicës, qasja në shërbime, energji elektrike, ujë dhe grumbullim të mbeturinave është përgjithësisht e kënaqshme, ndërsa në disa zona, veçanërisht në lagjen Adem Voca në Mitrovicën Jugore, ndërprerjet e herëpashershme të ujit dhe rrymës, grumbullimi i mbeturinave për shkak të mospagesës së faturave të shërbimeve dhe problemet me sistemin e kanalizimit dhe kullimit gjatë përmytjeve, vazhdojnë të paraqesin problem.

5. Qasja në shërbime sociale përfshirë ato shëndetësore

Komuniteti ashkali i Kosovës përfiton nga ndihma sociale e ofruar nga Qeveria, ndërsa disa pjesëtarë pranojnë edhe asistencë sociale nga institucionet e drejtuara nga Beogradi. Në mars të vitit 2019, 3,581 ashkali të Kosovës (1,372 burra, 2,209 gra) pranonin asistencë sociale nga Qeveria.⁴⁶

Në Ferizaj, që nga dhjetori i vitit 2023, 211 familje ashkali të Kosovës (1,084 individë) në të gjithë komunën kanë pranuar asistencë sociale.⁴⁷ Në komunën e Vitisë, 23 individë ashkali të Kosovës pranojnë asistencë sociale dhe dy të tjerë marrin pensione.⁴⁸ Në përgjithësi, legjislacioni aktual i mirëqenies sociale parasheh kriteret më të rrepta për familje që të kualifikohen për pranim të ndihmës sociale, ndërsa përkufizimi i ngushtë *"Familjet që jetojnë në bashkësi familjare"* ka efekt negativ në familjet me shumë breza të komunitetit ashkali të Kosovës.⁴⁹ Sipas ZKKK-së në Ferizaj, ky largim ishte në përputhje me kriteret e përcaktuara për të gjitha komunitetet dhe jo për shkak të diskriminimit kundër familjeve të komunitetit rom dhe ashkali të Kosovës.⁵⁰

Pjesëtarët e komuniteteve në rajonin e Mitrovicës raportuan se shumica pranojnë asistencë sociale. Sipas kreut të ZKKK-së në komunën e Podujevës, 66 familje të komunitetit ashkali të Kosovës (363 anëtarë) pranojnë asistencë sociale.

Mungesa e dokumentacionit personal ka qene tradicionalisht sfidë për pjesëtarët e komunitetit ashkali të Kosovës. Në total, 93 për qind e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës nën moshën pesë vjeçare janë raportuar të jenë regjistruar.⁵¹ Nuk ka të dhëna të sakta të ndara në komunitet rreth numrit të pjesëtarëve të komunitetit që nuk janë të regjistruar. Ka mungesë të njohurisë në komunitet rreth procedurave përkatëse për regjistrimin civil.⁵²

Institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë disa masa për rritjen e regjistrimit në regjistrat civilë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës,⁵³ duke përfshirë ofrimin e ditëve të regjistrimit falas.⁵⁴

46 OSBE, *Pasqyrë e komuniteteve ashkali, rom dhe egjiptian në Kosovë*, ff. 4-5. Nuk ka të dhëna të besueshme për ndihmën sociale të ofruar nga institucionet e drejtuara nga Beogradi

47 Qendra për Mirëqenie Sociale në Ferizaj.

48 Përfaqësues i komunitetit ashkali të Kosovës.

49 Institucioni i Avokatit të Popullit, *Raporti Vjetor 2018 (2019)*, f. 100; OSBE, *Raporti i vlerësimit të të drejtave të komuniteteve – edicioni i katërt (2015)*, f. 26.

50 ZKKK

51 Banka Botërore, *Anketa e grupimeve me tregues të shumëfishtë 2013–2014 (janar 2016)*, f. 126–127.

52 *Id.*

53 OSBE, *Raporti i Vlerësimit të të Drejtave të Komuniteteve, Edicioni i Katërt 2015*, f. 25-26.

54 Këshilli i Evropës, *Komiteti këshillues për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Opinioni i katërt për Kosovën*, ACFC/OP/IV(2017)001, §78, f. 30.

Komuna e Ferizajt, për shembull, ofron regjistrim falas për pjesëtarët e komunitetit ashkali të Kosovës si dhe ndërmerr rregullisht masa për rritjen e regjistrimit civil të komunitetit, pa kosto.⁵⁵ Të gjitha lindjet e foshnjave të komunitetit ashkali të Kosovës regjistrohen.⁵⁶ OJQ-ja Programi për të Drejtat Civile në Kosovë (CRPK) ka qenë aktive në mbarë Kosovën në vetëdijesimin dhe raportimin për sfidat e regjistrimit civil dhe ka vepruar në bashkëpunim të ngushtë me ZKKK-të.

Shëndeti më i dobët në mesin e pjesëtarëve të komunitetit ashkali të Kosovës, ashtu si te komuniteti rom dhe ai egjiptian i Kosovës, është kryesisht për shkak të kushteve të këqija të jetesës, sanitarisë, higjienës bazë dhe vaksinimeve, si dhe përdorimit të pamjaftueshëm të shërbimeve të mjekësisë parandaluese.⁵⁷ Ushqyeshmëria e dobët, kequshqyerja dhe zvogëlimi i jetëgjatësisë janë çështje që ndodhin vazhdimisht.⁵⁸ Për më tepër, shkalla e vdekshmërisë foshnjore në mesin e këtyre tre komuniteteve është tre herë më e lartë se mesatarja e Kosovës.⁵⁹ Kjo pasqyron mungesën e vetëdijesimit në komunitet për prioritetet shëndetësore, si rëndësia e vaksinimit dhe masat tjera parandaluese kundër sëmundjeve dhe infeksioneve.

Në vitin 2017, përhapja e fruthit preku në mënyrë joproporcionale komunitetin ashkali të Kosovës, si dhe komunitetet romë dhe egjiptianë të Kosovës, në komunën e Fushë Kosovës.⁶⁰ Në tetor të vitit 2017, mjekët dhe infermierët nga qendra kryesore familjare kanë kryer vaksinim në shtëpi për gjithsej 733 fëmijë të moshës 0-15 vjeç të tre komuniteteve që banojnë në lagje të ndryshme në Fushë Kosovë. Mes viteve 2021 dhe 2023, janë organizuar disa fushata informuese shëndetësore në vendbanimet e banuara kryesisht nga komuniteti ashkali i Kosovës, për të bërë vetëdijesim për rëndësinë e imunizimit në parandalimin e sëmundjeve, duke përfshirë atë të organizuar nga OJQ "Balkan Sunflowers", përkrahur nga UNICEF-i⁶¹. Shërbimet e vaksinimit ofrohen rregullisht nga ekipi i imunizimit, pesë ditë në javë, në qendrat shëndetësore të vendosura në vendbanimet e banuara nga komuniteti ashkali i Kosovës⁶². Në Ferizaj, për shembull, shkalla e fëmijëve të vaksinuar është pothuajse e njëjtë me atë të komunitetit shumicë.

Në vitin 2022, OSBE-ja ndërmori fushatë për të inkurajuar gratë nga komunitetet joshumicë që t'i bëjnë kontrollet mamografike në komunat e Ferizajt dhe Gjilanit, ndërsa në vitin 2023 edhe në komunën e Istogut. Përveç kësaj, OJQ-të dhe qendrat lokale të kujdesit shëndetësor kanë ndërmarrë disa fushata ndërgjegjësimi për shëndetin.⁶³ Mes viteve 2020-2022, shoqëria civile dhe Ministria e Shëndetësisë kanë mbajtur një numër sesionesh informuese në lagjet e komunitetit në Gjakovë për diabetin, hipertensionin, vaksinimin dhe kujdesin shëndetësor për gratë shtatzëna dhe fëmijët. Përveç kësaj, në vitin 2023, OJQ "Prosperiteti" dhe ZKKK realizuan një

55 ZKKK

56 ZKKK

57 Mbrojtësit e të Drejtave Civile, *Muri i anti-gjipsizmit: Romët, Ashkalitë dhe Egjiptianët në Kosovë* (2018), f. 21.; Zyra e Qeverisjes së Mirë, *Strategjia për Përfshirjen e Komunitetit Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021*, fq. 26.

58 Shih KOSANA, Përmbledhje e politikave 4, Qasja dhe përdorimi nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës në shërbimet e kujdesit shëndetësor (nëntor 2015) fq.3.

59 Kosovë, Zyra për Qeverisje të Mirë, *Strategjia*, fq. 27.

60 Vaksinimi filloi pas përhapjes së fruthit, që u vërejt gjatë një ankete rastësore për qasjen në vaksinim për fëmijët që i përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, kryer nga OJQ Balkan Sunflowers.

61 OJQ BRAN.

62 Shefi i Njësisë së Imunizimit, Ferizaj.

63 NGO BRAN si dhe Shefi i Njësisë së Imunizimit, Ferizaj.

aktivitet të bashkëfinancuar nga BE-KiE në Gjakovë, i cili mbështeti gratë nga komuniteti për t'iu qasur ekzaminimeve gjinekologjike dhe mamografisë. Fushatat e mëparshme kushtuar zbulimit të hershëm dhe parandalimit të kancerit të gjirit (përfshirë kontrollet falas) janë zhvilluar në rajonin e Prizrenit, duke shënjestruar veçanërisht gratë, përfshirë ato nga komuniteti **ashkali i Kosovës**.

Shërbimet e kujdesit shëndetësor riprodhues ofrohen falas për gratë në shumicën e komunave.⁶⁴

Megjithëse shërbimet e kujdesit shëndetësor janë përgjithësisht të disponueshme, shfrytëzimi i tyre pengohet nga disa faktorë, si mungesa e edukimit, vështirësitë ekonomike dhe largësia nga institucionet mjekësore dhe barnatoret.⁶⁵ Vështirësitë financiare në qasjen e tyre në kujdes shëndetësor rëndohen nga mungesa e mbulimit universal shëndetësor dhe kushtet e këqija socio-ekonomike.⁶⁶ Pjesëtarët e komunitetit **ashkali të Kosovës** janë më të cenueshëm për të qenë viktimë të diskriminimit në fushën e kujdesit shëndetësor, veçanërisht në ofrimin e shërbimeve shëndetësore.⁶⁷

64 Deçan, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gjilan, Klinë, Lipjan, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Suharekë.

65 Rrjeti i Grave të Kosovës, *Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë* (2016), fq. 51; KOSANA, *Sigurimi i ri kombëtar do të shpëtojë jetë: Jetëgjatësia dhe shëndeti në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës* (2016): f. 43.; KOSANA, *Dokument politikash 4: Qasja dhe përdorimi i shërbimeve shëndetësore nga romët, ashkalitë dhe egjiptianët e Kosovës* (nëntor 2015), f. 3.

66 Shih Komisioni Evropian, *Raporti për Kosovën 2019*, fq. 31.

67 KOSANA, *Sigurimi i ri kombëtar do të shpëtojë jetë: Jetëgjatësia dhe shëndeti në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës* (2016), fq. 46.

6. Qasja në arsim

Komuniteti ashkali i Kosovës kryesisht ndjek shkollat sipas planprogramit të Kosovës.

Megjithatë, fëmijët ashkali të Kosovës që jetojnë në Mitrovicën Veriore dhe shumica dërrmuese e ashkalive të Kosovës të moshës shkollore që jetojnë në lagjen e komuniteteve të përziera Adem Voca në Mitrovicën e Jugut ndjekin shkollat me planprogram të Serbisë në Mitrovicën e Veriut.⁶⁸ Shtatë shkolla fillore me planprogram të Serbisë ndiqen nga nxënës ashkali të Kosovës, pesë prej të cilave ndiqen vetëm nga nxënësit ashkali dhe romë të Kosovës. Në vitin shkollor 2019/2020, në këto shkolla u regjistruan 365 nxënës romë dhe ashkali të Kosovës (198 vajza dhe 167 djem) dhe të gjithë përfunduan vitin akademik pa asnjë rast të braktisjes. Në komunën e Ferizajt, fëmijët ashkali të Kosovës janë të regjistruar në shkolla të përziera etnike. Nuk është raportuar ndonjë segregim i fëmijëve romë, ashkali apo egjiptianë të Kosovës.

Sipas statistikave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), në vitin shkollor 2023/2024 në arsimin parauniversitar janë regjistruar 4,000 ashkali të Kosovës.⁶⁹

Gjatë gjithë shkollimit të tyre, nxënësit ashkali të Kosovës varen shumë nga mbështetja dhe ndihma e qendrave mësimore. Qendrat mësimore ofrojnë orë plotësuese për fëmijët e marginalizuar që vuajnë nga pasojat e përjashtimit socio-ekonomik. Qendrat mësimore kanë qenë kryesisht të varura nga mbështetja e donatorëve. Megjithatë, udhëzimi administrativ i vitit 2018⁷⁰ që synon rregullimin e punës së tyre nëpërmjet regjistrimit parasheh edhe ndarjen e fondeve nga buxhetet qendrore dhe lokale (ndonëse pa përcaktuar masën e këtij detyrimi). Ky proces është penguar nga vonesat dhe mospërbushja në kohë e obligimeve nga institucionet qeveritare dhe komunale, derisa qendrat mësimore vihen në rrezik për shkak të mungesës së fondeve, dhe shumë prej tyre janë detyruar që të mbyllen.⁷¹

68 Shkollat me planprogram të Serbisë në rajonin e Mitrovicës mbajnë të dhëna të ndara sipas komunitetit, megjithatë, nxënësit romë dhe ashkali të Kosovës janë të grupuar në të njëjtën kategori, d.m.th., të gjithë llogariten si 'nxënës romë të Kosovës'.

69 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, *Shënime Statistike 2023/24: Të dhëna për Arsimin Parauniversitar*.

70 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Udhëzimi Administrativ (UA) 19/2018 për Themelimin dhe Funkcionimin e Qendrave Mësimore.

71 Për më shumë mbi Qendrat Mësimore, shih Raporti i OSBE-së Pasqyrë e Qendrave Mësimore në Kosovë dhe Zbatimi i Udhëzimit Administrativ 19/201, (2023).

Një nga sfidat në vlerësimin e ofrimit të arsimit për komunitetin **ashkali të Kosovës** është se ata shpesh grupohen së bashku me romët dhe egjiptianët e Kosovës për qëllime të monitorimit, planifikimit të politikave dhe ndërhyrjeve. Sfidë tjetër është mungesa e përgjithshme e të dhënave të detajuara të zbërthyera për tre komunitetet, duke përfshirë edhe në fushën e arsimit. Mungesa e vetëdijes së prindërve për rëndësinë e ndjekjes së shkollimit konsiderohet gjithashtu faktor i fortë. Për këto arsye, hulumtimi thelbësor për komunitetin **ashkali të Kosovës** bëhet shumë i vështirë. Ndonëse ka ngjashmëri në gjendjen e të tre komuniteteve, secili ka specifikat dhe sfidat e veta, që kërkojnë qasje të ndryshme në politika dhe në zgjidhje.

Sipas informatave të dhëna nga autoritetet komunale dhe OJQ-të⁷² që punojnë në fushën e arsimit, niveli i mosregjistrimit dhe braktisjes në këtë komunitet është ulur me kalimin e kohës. Vitet e fundit, rastet e braktisjes së shkollës kanë të bëjnë kryesisht me migrimin ose ndërrimin e vendbanimit. Ka pasur raste të rralla të braktisjes për shkak të problemeve familjare apo kushteve të vështira social-ekonomike.

Sipas të dhënave të OSBE-së për braktisjen e arsimit të detyrueshëm, të mbledhura mes viteve 2020 dhe 2023, janë regjistruar 19 raste të braktisjeve (nëntë vajza dhe dhjetë djem) nga komuniteti **ashkali i Kosovës** në komunën e Ferizajt.⁷³ Përmes zyrave të vendosura në vendbanimet e banuara nga komuniteti **ashkali i Kosovës**, ZKKK-ja, në bashkëpunim me ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit (EPRBM) dhe Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA), organizon fushata derë më derë dhe takime me prindër të fëmijëve të shkollës kurdo që evidentohen raste të braktisjes. Për shembull, në fillim të vitit 2019, DKA e Ferizajt dhe ZKKK, në bashkëpunim me drejtorin e shkollës, regjistruan 38 raste të braktisjes së shkollës në mesin e fëmijëve të komunitetit **ashkali të Kosovës** të regjistruar në arsimin e detyrueshëm. Pas një sërë takimesh të organizuara nga Drejtoria e Arsimit dhe OJQ-ja lokale BRAN, si dhe fushatës derë më derë të organizuar nga NKK dhe ZKKK, 23 nxënës u kthyen në shkollë.

Në komunat e Gjakovës dhe Istogut, EPRBM-të në arsimin e detyrueshëm dhe shkolla janë veçanërisht aktive në parandalimin e braktisjes së shkollës, duke avokuar për kthim në shkolla për nxënësit që i përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, si dhe duke ndërmarrë masat e duhura (përfshirë vizitat në shtëpi, avokimin me prindërit, orët plotësuese intenzive).

Vijimi i shkollës u përkeqësua dukshëm pas përhapjes së pandemisë COVID-19 dhe ndërprerjes së procesit të rregullt arsimor. Një numër i konsiderueshëm nxënësish nga ky komunitet mbetën jashtë procesit të mësimin online, kryesisht për shkak të mungesës së teknologjisë adekuate dhe mungesës së lidhjes së mirëfilltë të internetit.

⁷² Nevo Koncepti dhe Roma Versitas, dega Prizren.

⁷³ Të dhënat e mbledhura nga ekipet në terren të OSBE-së ndërmjet viteve 2020 dhe 2023 për braktisjen nga ashkalinjtë e Kosovës në rajonin e Gjilanit, shënuan gjithsej 19 raste të braktisjes, tre djem nga klasa I deri në IX, si dhe nëntë vajza e shtatë djem nga klasa VI deri në IX.

Në rajonin e Pejës, të dhënat nga DKA-të për studentët **ashkali të Kosovës** dallojnë nga njëri burim te tjetri. Raportimi i paqëndrueshëm i nxënësve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës për përkatësinë e tyre etnike, si dhe shënimi i të dhënave të gabuara nga mësuesit, konsiderohet si pjesë e problemit. Në shumicën e komunave, baza e të dhënave për regjistrim ofron ndarje sipas moshës, gjinisë dhe komunitetit. Megjithatë, ndarja për komunitete shpesh nuk përputhet me realitetin për shkak të raportimit të pasaktë nga nxënësit dhe/ose mësuesit.

Vajzat dhe gratë nga komunitetet ashkali, egjiptian dhe rom të Kosovës përballen me sfida të tjera në aspektin e qasjes në arsim, për shkak të martesave të fëmijëve dhe/ose të detyruara, si dhe roleve tradicionale gjinore në këto komunitete.⁷⁴ Në përgjithësi, 13.7 për qind e vajzave në këto komunitete nuk e vazhdojnë arsimin e mesëm të lartë, krahasuar me 11.3 për qind të djemve nga këto komunitete⁷⁵. Gjithashtu, katër për qind e vajzave nuk e vazhdojnë shkollën e mesme të ulët nga ajo fillore, krahasuar me 6.1 për qind të djemve nga i njëjti komunitet.⁷⁶ Ndërprerja e shkollimit është, ndër të tjera, pasojë e martesës së fëmijëve.⁷⁷ Megjithatë, është e vështirë të përcaktohet lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet martesës së fëmijëve dhe niveleve të ulëta të vijimit të shkollës në mesin e vajzave nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës. Mungesa e të dhënave të sakta dhe të krahasueshme e të ndara sipas komuniteteve, për numrin e fëmijëve në bashkësi martesore para arritjes së moshës 18 vjeçare e bën të vështirë matjen e efektit negativ të martesave të fëmijëve në arsimimin e vajzave, për të gjitha komunitetet. Në fund të vitit 2023, Qeveria themeloi grupin punues ndërinstitucional për parandalimin dhe raportimin e martesave të hershme në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Sfida të tjera me të cilat ballafaqohen nxënësit dhe studentët **ashkali të Kosovës** janë statusi përgjithësisht i dobët socio-ekonomik i familjeve të tyre dhe sigurimi i parregullt i transportit në disa raste. Kurrikula e Kosovës nuk ofron ndonjë lëndë specifike për komunitetin që nxënësit **ashkali të Kosovës** të mësojnë për identitetin dhe kulturën e tyre.

Në gusht të vitit 2023, MASHTI njoftoi se prindërit do të obligoheshin të blinin tekstet shkollore për klasat 1 deri në 5, dhe më pas do të rimburoheshin për to, me anë të aplikacionit elektronik. Vendimi shkaktoi disa shqetësime veçanërisht për komunitetet më të cenueshme dhe familjet në kushte të këqija ekonomike, të cilat duhej të përdornin mbështetjen e OJQ-ve për t'iu qasur atyre subvencioneve, pasi disa pjesëtarë të komunitetit nuk kishin llogari bankare ose kishin njohuri të pakta të punës me kompjuterë.

74 *Martesa e fëmijëve dhe martesa e hershme janë terma që përdoren në mënyre të ndërsjellët. Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë, "fëmijë" konsiderohet "çdo genie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare". Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e fëmijëve, neni 3. Ligjërish, "martesa e fëmijëve" dhe "martesa e hershme" konsiderohen të njëjta: martesë e një fëmije nën moshën 18 vjeç. *Martesa e detyruar* është martesa në të cilën njëri ose të dy bashkëshortët, pavarësisht moshës, nuk japin pëlqimin. Në Ligjin për Familjen në Kosovë, "Personi i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeçare nuk mund të lidhë martesë" (neni 16), përveç për shkaqe të arsyeshme (neni 16b). Neni 18 thotë se "Martesa nuk do të jetë e plotfuqishme, nëse pëlqimi është arritur përmes shtërngimit, kërcënimit ose lajthimit, apo në mungesë të vullnetit të lirë të llojit tjetër nga ana e bashkëshortëve të ardhshëm.". Ligji Nr. 2004/32 për Familjen (2006) dhe Ligji Nr. 06/L-077 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Familjen Nr. 2004/32.*

75 UNICEF, *Analiza e gjendjes së fëmijëve dhe grave në Kosovë* (2017), Tabela 16: Analiza e rrugëtimit në shkollim për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian sipas gjinisë; fq. 79.

76 Po aty.

77 UNFPA, *Martesa e fëmijëve në Kosovë (Përmbledhje)*, (2014).

Nxënësit **ashkali të Kosovës** zgjedhin arsimin universitar në gjuhën shqipe.⁷⁸ Vendet e rezervuara në universitetet publike për studentët joshqiptarë, duke përfshirë **Ashkalinjtë e Kosovës**, janë në dispozicion. Studentët e universiteteve nga komuniteti **ashkali i Kosovës**, si dhe romët e egjiptianët e Kosovës, janë mbështetur nga OJQ-ja "Roma Versitas" dhe Fondi për Arsimin e Romëve.

Për të mbështetur nxënësit nga komuniteti për vazhdimin e studimeve të tyre, MASHTI, me ndihmën e donatorëve, çdo vit ofron 500 bursa për nxënësit romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës për arsimin e mesëm⁷⁹. Disa komuna ndajnë numër të rezervuar të bursave për studentët nga komunitetet joshumicë. Për shembull, në korrik 2020, komuna e Prizrenit shpalli thirrje për bursa të nivelit universitar për vitin akademik 2020/2021, ku 15 nga 80 bursa u ndanë për studentët e komuniteteve joshumicë. Komuna e Podujevës ofron bursa për shkollat e mesme (bazuar në merita) dhe studentët universitarë (në bazë të kriterëve sociale) nga komuniteti **ashkali i Kosovës**. Komuna e Fushë Kosovës ka financuar dhjetë bursa për nxënës të shkollave të mesme dhe tri për studentë universitarë në vitin akademik 2019/2020. Komuna e Lipjanit e rishikoi rregulloren komunale për bursa pasi nënkryetari për komunitete ngriti nevojën që studentët romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës të përfshihen në programin e masave afirmative. Në vitin 2019, komuna e Ferizajt ndau dy bursa për studentë **ashkali të Kosovës**, një grua dhe një burrë. Megjithatë, sipas nënkryetarit të komunës së Ferizajt, **ashkalinjtë e Kosovës** nuk kanë numër të caktuar të bursave dhe duhet të konkurrojnë me pjesëtarët e komuniteteve të tjera, të cilët mund të kenë më shumë gjasa të përmbushin kriteret. Megjithatë, në vitin 2023, komuna e Ferizajt vendosi t'u japë bursë të gjithë studentëve që regjistrohen në Universitet, pa marrë parasysh përkatësinë e komunitetit. OJQ-të, si Fondi për Arsimin e Romëve, mbështesin studentët romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës në nivel universitar.

OSBE-ja nuk ka regjistruar vështirësi të konsiderueshme apo sistematike në lidhje me ndërveprimin e nxënësve dhe studentëve **ashkali të Kosovës** me ata nga komunitetet tjera.

78 Janë shtatë universitete publike në Kosovë me programe studimi në gjuhën shqipe: në Ferizaj, Gjakovë, Gjiçan, Mitrovicë e Jugut, Pejë, Prishtinë dhe Prizren.

79 [MINISTRY OF EDUCATION COMMITTED TO SUPPORT STUDENTS OF THE ROMA, EGYPTIAN, ASHKALI COMMUNITIES - MASHT \(rks-gov.net\)](https://rks-gov.net)

7. Qasja në drejtësi

Nuk ka përfaqësues të komunitetit ashkali të Kosovës të punësuar në ndonjërin nga institucionet jo-gjyqësore: Agjencia për Ndhimë Juridike Falas (ANJF) Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) dhe Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave (ZMNV). Për më tepër, nuk ka avokatë ashkali të Kosovës të licencuar nga Oda e Avokatëve.

Komuniteti ashkali i Kosovës në përgjithësi gëzon qasje formale në sistemin e drejtësisë. Megjithatë, ekziston mungesë e përgjithshme e njohurive në komunitet për të drejtat dhe procedurat ligjore, por edhe mundësinë e ndihmës juridike falas. Monitoruesit e OSBE-së në terren theksojnë se pjesëtarët e komunitetit ashkali të Kosovës në përgjithësi nuk janë të informuar për shërbimet që ofrohen nga ANJF, IAP dhe ZMNV. Megjithatë, duke qenë që këto institucione kanë seli rajonale, komuniteti ashkali i Kosovës nga disa komuna të rajonit të Prizrenit, por edhe zonat rurale në veçanti, kanë më pak njohuri për shërbimet e ofruara.

Varfëria është pengesa kryesore për qasjen në sistemin ligjor, pasi tarifat gjyqësore, shpenzimet ligjore, e madje edhe transporti, mund të përbëjnë barrë të konsiderueshme financiare. Familjet në zonat e largëta kanë probleme me transportin dhe shpenzimet që lidhen me qasjen në sistemin ligjor. Pjesëtarët e komunitetit më të vetëdijshëm për këto shërbime janë ata që punojnë ose angazhohen me institucionet komunale, organizatat e shoqërisë civile, mediat dhe studentët.

Fushatat vetëdijësuese që mbulojnë komunitetin e gjerë, sidomos familjet që jetojnë në zona rurale, mund të jenë efektive; shembull janë përpjekjet për të rritur dukshmërinë e ANJF-së. Në vitin 2023, me mbështetjen e USAID-it, ANJF-ja shpërndau fletëpalosje dhe posterë në gjuhët angleze, shqipe, serbe dhe turke dhe në alfabetin e brailit. Gjithashtu, video spote e postime të krijuara në rrjetet sociale gjatë javës së ndihmës juridike falas me moton "Mbroni të drejtat tuaja", u shpërndanë në gjuhët zyrtare pra në shqip dhe serbisht. Për më tepër, përfaqësues të këtyre institucioneve marrin pjesë në aktivitete të ndryshme vetëdijësuese të organizuara nga palë të ndryshme.

Në Prizren, Gjilan dhe Prishtinë, ANJF përdor procedura të përsheptuara për të plotësuar nevojat e pjesëtarëve të kategorive të cënueshme të shoqërisë, në kuptimin e qasjes së tyre më të lehtë në institucion(e) dhe lehtësimin e udhëtimit.

Që nga tetori i vitit 2021, IAP ka udhëhequr Forumin për Dialog në mes të Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC), duke përfshirë edhe ato që përfaqësojnë komunitetin **ashkali të Kosovës**.⁸⁰ Në mars të vitit 2023, së bashku me OJQ-në "ROMTEGRA", Avokati i Popullit vizitoi disa familje to komunitetit **ashkali të Kosovës** në Mitrovicë me qëllim të informimit dhe diskutimit të sfidave dhe shqetësimeve të tyre. Në vitin 2023, në bashkëpunim me Qendrën Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC) nga Mitrovica Veriore, Avokati i Popullit u takua me OSHC-të në Mitrovicë dhe Pejë dhe mbajti tryeza për brengat e komuniteteve që lidheshin me respektimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre.⁸¹

Në vitin 2023, IAP-ja publikoi raportin e hartuar sipas detyrës zyrtare, lidhur me mungesën e kushteve të përshtatshme të jetesës për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës të kthyer në Obiliq nga Maqedonia e Veriut.⁸²

Çdo tetor, ZMNV, nën ombrellën e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe me mbështetjen e Ambasadës Amerikane, organizon "Javën e të Drejtave të Viktimave të Krimin". Megjithatë, është mendim i përgjithshëm i palëve të interesit që janë intervistuar se fushata informuese duhet të organizohen gjatë gjithë vitit. Përkundër disa fushatave informuese të ndërmarra nga institucione të ndryshme, duke përfshirë ZMNV-në, Ministrinë e Drejtësisë, OAK-në, si dhe informatat që ndahen me viktimat kur kërkojnë shërbime, ka pak ose aspak njohuri lidhur me kompensimin e viktimave të krimin (KVK).

Në vitin 2023, ANJF-ja ofroi shërbime për 6,070 persona (përfshirë 2,883 gra), prej të cilëve 213 ishin pjesëtarë të komunitetit **ashkali të Kosovës**. Në vitin 2023, IAP pranoi gjithsej 1,660 ankesa (1,162 burra dhe 498 gra),⁸³ që përfshinin 4296 persona. Nga numri i përgjithshëm i ankesave, 22 ishin nga pjesëtarët e komunitetit **ashkali të Kosovës**. ZMNV-ja ka trajtuar 2,883 raste në vitin 2023, 19 nga të cilat kanë të lidhura me pjesëtarët e komunitetit **ashkali të Kosovës** dhe 53 me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, pasi jo çdo rajon i ndan ato në komunitete individuale. Shumica e viktimave ishin gra.

Tek komuniteti **ashkali i Kosovës**, gjuha nuk perceptohet si pengesë në qasjen në institucionet ligjore, pasi gjuha e tyre amtare është shqipja.

80 Qëllimi i Forumit është krijimi i një platforme të përbashkët bashkëpunimi ndërmjet IAP-së dhe OSHC-ve, për avancimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, identifikimin e sfidave dhe shkeljeve të të drejtave dhe lirive themelore, si dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta për promovimin dhe mbrojtjen e tyre.

81 Për më shumë informacion ju lutemi shikoni: <https://oik-rks.org/en/2023/12/05/the-ombudsperson-met-representatives-of-civil-society-organizations-from-the-region-of-peja/> (Qasur në dhjetor 2023).

82 Institucioni i Avokatit të Popullit, *Mungesa e kushteve të përshtatshme të jetesës për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të kthyer në Obiliq, nga Republika e Maqedonisë së Veriut* (2018).

83 *Shih*, Institucioni i Avokatit të Popullit, *Raporti Vjetor 2023*.

8. Përdorimi i gjuhës dhe media

Gjuha amtare e komunitetit ashkali të Kosovës është shqipja.

Në zonat ku ata përbëjnë pakicë, komuniteti flet shqip lirisht në hapësira publike dhe ka qasje në institucionet e nivelit qeveritar. Ata kanë qasje edhe në transmetuesin publik – Radio Televizionin e Kosovës (RTK) përmes redaksisë së tyre dhe programit të dedikuar për komunitetin të quajtur “Zëri i Ashkalive”.⁸⁴

Pjesëtarët e komunitetit ashkali kanë qasje në mediat e shkruara dhe elektronike në gjuhën shqipe.

⁸⁴ Radio Televizioni i Kosovës, “Zëri i Ashkalive”, <https://www.youtube.com/playlist?list=PL2yggqSFvmrqUT9ddxmmjM1lHlo1q3Hsr> (Qasur në dhjetor 2023).

9. Trashëgimia kulturore dhe fetare, liritë fetare

Komuniteti ashkali i Kosovës kryesisht përbëhet nga myslimanë sunitë, megjithëse në Gjakovë, në rajonin e Pejës, ekziston numër i vogël i pjesëtarëve të komunitetit bektashi (sufi) dhe të krishterëve protestantë ungjillorë. Bazuar në vëzhgimet në terren, komuniteti nuk ka raportuar ndonjë problem në aspektin e shprehjes së besimeve fetare dhe kulturore.

Në rajonin e Pejës, komuniteti ashkali ka krijuar marrëdhënie të mira me popullatën shumicë për shkak të gjuhës dhe fesë së tyre të përbashkët. **Ashkalinjtë e Kosovës** shpesh ndjekin ceremonitë fetare në objektet e kultit bashkë me komunitetin shqiptar dhe komunitetet tjera joshqiptare. Varësisht nga feja e tyre, komuniteti **ashkali i Kosovës** në rajonin e Pejës merr pjesë në shërbesat fetare në xhamitë sunitë, kishat ungjillorë protestante ose teqetë bektashiane në Gjakovë.

Për shkak të prapavijave të ndryshme fetare, **ashkalinjtë e Kosovës** festojnë një numër më të madh të ditëve të shenjta fetare, që përfshijnë Fitër Bajramin, Kurban Bajramin, Nevruzin, Ashurën, Krishtlindjet, Pashkët dhe Ditën e Reformimit. Dita përkujtimore e Ashkalive më 15 shkurt është gjithashtu e rëndësishme për komunitetin **ashkali të Kosovës**, si dhe është përmendur në Ligjin për festat zyrtare. Festa e Shën Gjergjit (nga 6 deri më 15 maj) është gjithashtu festë e rëndësishme dhe përkujtohet gjerësisht nga të gjitha komunitetet lokale, pavarësisht nga feja apo përkatësia e tyre etnike. Përfundimisht, **ashkalinjtë e Kosovës** shënojnë edhe fundin e dimrit dhe fillimin e verës.

Një objekt i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore është Xhamia në Sallahane në Ferizaj, rajoni i Gjilanit, e ndërtuar pas vitit 1999 me mbështetjen e diasporës së komunitetit ashkali. Xhamia shfrytëzohet nga **Ashkalinjtë e Kosovës**, shqiptarët e Kosovës, romët e Kosovës dhe një numër i vogël i egjiptianëve të Kosovës. Varrezat dhe xhamia aty pranë, të ndërtuara në vitin 1989 në fshatin Dubravë në Ferizaj, janë objekte të rëndësishme të trashëgimisë fetare të cilat shfrytëzohen pothuajse ekskluzivisht nga komuniteti **ashkali i Kosovës**.

Gjatë periudhës raportuese, nuk ka pasur incidente të mëdha kundër objekteve të trashëgimisë fetare dhe kulturore të komunitetit **ashkali të Kosovës**. Mirëpo, që nga viti 2013, varrezat e ashkalive dhe egjiptianëve të Kosovës që gjenden në fshatin Beleg të komunës së Deçanit, të banuara kryesisht me shqiptarë të Kosovës, kanë qenë në shënjestër të përdhosjes së ashpër, p.sh. banorët lokalë së bashku me fshatarët fqinjë e kanë shfrytëzuar këtë varrezë si vendgrumbullim i mbeturinave.

Rrjedhimisht, pesë nga 35 varre janë mbuluar me mbeturina, duke shkaktuar vështirësi për varrosjen e personave të vdekur, pasi qasja në lokacion dhe hyrja në varreza pengohen nga mbeturinat që vazhdojnë të rriten.

10. Të drejtat pronësore

Komuniteti ashkali i Kosovës përballet me sfida të ngjashme sa i përket pronës, si komunitetet tjera joshumicë që jetojnë në Kosovë. Në rajonet e Gjilanit dhe Pejës, komuniteti ashkali i Kosovës që banon në vendbanime joformale⁸⁵ nuk kanë tituj pronësie për pronat ku jetojnë dhe nuk kanë qasje adekuate në banim social. Megjithatë, janë vërejtur disa ndryshime të vogla pozitive.

Në vitin 2023, 22 prona të familjeve ashkali të Kosovës u legalizuan në mbarë Kosovën duke u siguruar atyre formalizimin e titullit pronësor përmes regjistrimit në regjistrin kadastral. Në vitin 2021, një familje ashkali e Kosovës përfitoi nga ndarja e banesave sociale në komunën e Prizrenit.

Në qytetin e Ferizajt, çështjet kryesore të të drejtave pronësore që prekin komunitetin ashkali të Kosovës shkaktohen nga mungesa e titujve të regjistruar të pronës. Për shkak të gjendjes së tyre të dobët socio-ekonomike, familjet e komunitetit ashkali të Kosovës nuk janë në gjendje të ndërmarrin procedura ligjore dhe administrative për të bërë ndryshime në titujt e pronës në emër të pronarit aktual në regjistrat kadastralë. Si të tilla, ato nuk kanë tituj pronësie mbi pronën që përdorin, gjë që i bën të cenueshme ndaj cilësdo iniciative të mundshme të qeverisë, si shpronësimi apo legalizimi. Për më tepër, duke qenë se nuk kanë tituj pronësie të formalizuar në regjistrin e të drejtave pronësore, ata nuk kualifikohen, për shembull, për subvencione bujqësore të qeverisë ose/dhe nuk mund të marrin kredi nga bankat, gjë që kufizon edhe më shumë gjasat e tyre për prosperitet dhe mirëqenie ekonomike. Sa i përket banimit social, në korrik 2019, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nisi ndërtimin e 33 shtëpive për ashkalishtë e Kosovës në fshatin Dubravë të komunës së Ferizajt, për të adresuar nevojat e tyre për banim. Përveç kësaj, në rajonin e Prishtinës, pjesëtarët e komunitetit ashkali të Kosovës kanë probleme me titujt pronësorë sepse shumë prej tyre kanë jetuar në vendbanime joformale. Në vitet e kaluara, komunat kanë ndërmarrë hapa konkretë për rregullimin e vendbanimeve të tilla. Për shembull, komunat në rajonin e Prishtinës janë të angazhuara në sigurimin e banesave për pjesëtarët e komunitetit ashkali të Kosovës përmes programeve dhe donacioneve të ndryshme. Për më tepër, në rajonin e Pejës, nevojat për banim të komunitetit ashkali të Kosovës po adresohen në mënyrë progresive.

⁸⁵ Vendbanimet joformale janë vendbanime njerëzore, të cilat për një sërë arsyesh nuk plotësojnë kërkesat për njohje ligjore (dhe janë ndërtuar pa respektuar procedurat formale të pronësisë ligjore, transferimit të pronësisë, si dhe rregulloreve të ndërtimit dhe urbanizmit), ekzistojnë në vendet përkatëse, si dhe pengojnë zhvillimin ekonomik. Përderisa ka një larmi të konsiderueshme në rajone për sa i përket manifestimit të tyre, këto vendbanime karakterizohen kryesisht me zotërim joformal apo të pasigurt të tokës, qasje të pamjaftueshme në shërbimet bazë, si në infrastrukturë sociale dhe fizike, ashtu edhe në financim të banimit. Shih: OSBE, Deklarata e Vjenës (2004), f. 1, pika II, <https://locuireinformala.ro/wp-content/uploads/2019/12/Declaratia-de-la-Viena-privind-asezarile-informale-2004.pdf> (Qasur në dhjetor 2023).

Si shembull, në vitin 2019, tre anëtarë të komunitetit ashkali të Kosovës që jetojnë në Brekoc në komunën e Gjakovës përfituan nga ndërtimi i shtëpive përmes projektit “Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë – Faza V” (EU-RRK-V), bashkëfinancuar nga BE dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe zbatuar nga IOM. Për më tepër, disa familje të tjera kanë përfituar edhe nga programi komunal i banimit social.

11. Kthimi dhe riintegrimi

Nuk ka të dhëna të ndara për sa i përket kthimit vullnetar të komunitetit ashkali të Kosovës. Sipas vlerësimeve të UNHCR-së, rreth 7,800 ashkali dhe egjiptianë të Kosovës janë kthyer vullnetarisht në Kosovë nga viti 2000 deri në maj 2023.⁸⁶

Sipas UNHCR-së, që nga viti 2015, rreth 292 individë janë kthyer në komunat Fushë Kosovë (95), Ferizaj (76), Obiliq (64), Graçanicë (14), Pejë, Gjakovë (12 në secilën) dhe Lipjan (11 individë); derisa komunat Rahovec dhe Prishtinë kanë pasur më pak se dhjetë individë të kthyer. Ndërsa, komuniteti ashkali i Kosovës vuan nga të ardhurat e ulëta dhe mundësitë e pamjaftueshme të punësimit, të kthyerit në veçanti përballen me vështirësi ekonomike.

Mbështetja në projekte të financuara nga donatorët, të cilat krijojnë zgjidhje banimi për të kthyerit paraqet sfida - sidomos pasi që pak komuna marrin pjesë në projekte, e të kthyerit potencial nga komunat e tjera duhet të mbështeten në ndihmën sporadike nga MKK-ja. Projekti i financuar nga BE-ja, Kthimi dhe Riintegrimi, i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë në partneritet me MKK-në dhe i zbatuar nga IOM-i, raporton se janë ndërtuar 19 njësi banimi për të kthyerit nga radhët e komunitetit ashkali të Kosovës,⁸⁷ ndërsa 20 individë, kryesisht në rajonin e Pejës, kanë marrë pako të gjenerimit të të ardhurave për të mbështetur riintegrimin e tyre. Ka pasur edhe nisma të tjera që kanë shënjestruar komunitetet e margjinalizuara, duke përfshirë komunitetin ashkali të Kosovës, si në kuadër të BE-së dhe institucioneve të Kosovës, ashtu edhe të organizatave donatore, si Këshilli Danez për Refugjatë dhe Arbeiter-Samariter-Bund.

Në vitin 2023, MKK-ja shpalli thirrje për ofrimin e ndihmës materiale për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë.⁸⁸ Nisma synonte të adresonte nevojat e ndryshme, duke përfshirë sigurimin e artikujve ushqimorë dhe jo-ushqimorë, si dhe mbështetjen për ndërtimin dhe rindërtimin e shtëpive. Për më tepër, Ministria zgjeroi kontaktet e saj për të përforcuar sektorin e bujqësisë, duke ofruar subvencione për të lehtësuar praktikën e qëndrueshme bujqësore. Njëkohësisht, pati përpjekje të përkushtuar për të mbështetur bizneset e vogla brenda këtyre komuniteteve.

⁸⁶ Të dhënat e ndara nga Zyra e Shefit të Misionit të UNHCR-së në Prishtinë. Dhjetor 2023.

⁸⁷ Numri i njërive të banimit të ndërtuara apo rikonstruktura ishte: 11 në Fushë Kosovë, tre në Gjakovë, dy në Istog si dhe një në Obiliq. Të dhënat janë siguruar nga Misioni i IOM-së në Kosovë, si dhe shifrat në fjalë janë pjesë e projektit të BE-së për Kthimin dhe Riintegrimin në Kosovë.

⁸⁸ Vendimi për përcaktimin e procedurave për ofrimin e ndihmës nga Ministria për Komunitete dhe Kthim për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, i nxjerrë më 2 shkurt 2023: [Vendim i procedurave për ofrimin e ndihmës-Odruka o proceduri pruzenja pomoci compressed compressed-compressed \(1\).pdf \(rks-gov.net\)](#). (Qasur në dhjetor 2023).

Ndikimi i këtyre përpjekjeve ishte i prekshëm, pasi Ministria mbështeti me sukses 170 familje të komunitetit ashkali të Kosovës, duke u ofruar atyre artikuj të rëndësishëm, përfshirë materiale ndërtimore. Veçanërisht, iniciativa rezultoi në ndërtimin e tri shtëpive, dy të vendosura në Ferizaj dhe një në Pejë. Përveç këtyre, iniciativat domethënëse të Ministrisë u shtrinë edhe në ofrimin e mbështetjes materiale për pesë familje, në shumën prej 70,069 euro. Kjo ndihmë financiare u orientua në nxitjen e zhvillimit në sektorin e bujqësisë ose mbështetjen e bizneseve të vogla. Veçanërisht u mbështetën pesë familje, dy në Fushë Kosovë dhe nga një familje në Lipjan, Prishtinë dhe Shtime.⁸⁹

89 Të dhënat u ndanë me Misionin e OSBE-së në Kosovë nga Ministria për Komunitete dhe Kthim më 6 shkurt 2024.



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Foto: Šehida Miiftari

Profili i komunitetit

boshnjak të Kosovës



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Profili i komunitetit boshnjak të Kosovës

Komuniteti boshnjak i Kosovës është një nga komunitetet më të mëdha në Kosovë. Duke i kombinuar të dhënat e siguruara nga regjistrimi i popullsisë në Kosovë i vitit 2011 dhe të dhënat e OSBE-së për komunat në veri, vlerësohet se rreth 29.000 pjesëtarë të komunitetit boshnjak të Kosovës jetojnë në Kosovë,¹ që është 1.55 për qind e popullsisë së përgjithshme.

Komuniteti boshnjak i Kosovës nuk është shumicë në asnjë komunë në Kosovë. Komuna e Prizrenit, ku komuniteti përbën rreth 9.4 për qind të popullsisë, ka numrin më të madh të qytetarëve boshnjakë të Kosovës, ndërsa Dragashi radhitet i dyti për nga numri i pjesëtarëve të komunitetit boshnjak të Kosovës, ku ata përbëjnë rreth 12.1 për qind të popullsisë. Për më tepër, boshnjakët e Kosovës janë komuniteti i dytë më i madh në komunën e Pejës², ku ata përbëjnë rreth 3.9 për qind të popullsisë. Një numër më i vogël i boshnjakëve të Kosovës jetojnë gjatë në Kosovë.³ Në Istog janë rreth 1.140 pjesëtarë të komunitetit boshnjakë të Kosovës, në Gjakovë janë 73, në Deçan janë 60, si dhe në Obiliq rreth 40. Në komunën e Prishtinës janë rreth 400 pjesëtarë të komunitetit boshnjakë të Kosovës, ndërsa në Graçanicë janë tetë (dy familje). Në Mitrovicën e Jugut janë rreth 500 qytetarë boshnjakë të Kosovës, në Skenderaj janë 50, në Vushtrri janë rreth 50-60, dhe në Podujevë dhe Glllogoc janë rreth 50-60 në secilën prej tyre. Në vitin 2016 kishte 477 boshnjakë të Kosovës me të drejtë vote (18) në Mitrovicën e Veriut, ndërsa deri në vitin 2020 numri u zvogëlua në 447 votues me të drejtë vote, të dhëna që flasin për një popullsi të përgjithshme të komunitetit në Mitrovicën e Veriut prej rreth 650-700. Në Leposaviq jetojnë rreth 350 boshnjakë të Kosovës.

1 Regjistrimi i vitit 2011 në Kosovë nuk u zhvillua në katër komunat në veri të vendit.

2 Rreth 4500 anëtarë të komunitetit.

3 OSBE, *Profilet e Komunave*, 2018 (2019).

Faktet dhe çështjet kryesore

- Vjedhjet dhe plaçkitjet janë lloji më i zakonshëm i incidenteve të sigurisë që prekin pjesëtarët e komunitetit **boshnjak të Kosovës**.
- Komuniteti **boshnjak i Kosovës** përfaqësohet në qeverinë e formuar në vitin 2021 nga zëvendëskryeministri për çështje të pakicave dhe të drejtat e njeriut.
- Komuniteti ka numrin e tretë më të madh të anëtarëve të Kuvendit dhe në përgjithësi është i përfaqësuar mirë në shërbimin civil në nivel qeveritar dhe komunal, me përjashtim të komunës së Pejës.
- **Boshnjakët e Kosovës** në përgjithësi kanë qasje në infrastrukturë adekuate, përveç në zona të caktuara rurale dhe malore si në komunën e Dragashit.
- Komuniteti preket nga menaxhimi joadekuat i mbeturinave, deponitë ilegale dhe ndotja e mjedisit në Leposaviq dhe në zonën e Gorës në komunën e Dragashit.
- Arsimi në gjuhën boshnjake është në dispozicion për studentët **boshnjakë të Kosovës** sipas kurrikulës së Kosovës.
- Çështjet që lidhen me qasjen në arsimin në gjuhën boshnjake përfshijnë mungesën e teksteve shkollore, numrin e ulët të personelit të kualifikuar për mësimdhënie dhe mosnjohjen e kualifikimeve arsimore të pjesëtarëve të komunitetit që studiojnë në Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë.
- Gjuha boshnjake është gjuhë zyrtare në nivel komunal në komunat e Prizrenit, Dragashit dhe Pejës dhe gjuhë në përdorim zyrtar në komunat e Istogut dhe të Mitrovicës Veriore.⁴
- Mungesa e mundësive ekonomike dhe punësimi mbeten sfida kryesore për riintegrimin e të kthyerve. Në komunën e Dragashit mungon përkrahja e qeverisë për kthimet e asistuara.

⁴ Në përputhje me nenin 2 (3) të Ligjit nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, në komunat e banuara nga një komunitet, gjuha amtare e të cilit nuk është gjuhë zyrtare dhe që përbën së paku pesë për qind të popullsisë së përgjithshme të komunës, gjuha e komunitetit do të ketë statusin e gjuhës zyrtare në komunë dhe është në përdorim të barabartë me gjuhët zyrtare.

Në përputhje me nenin 2 (4) të ligjit nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, në komunat e banuara nga një komunitet, gjuha amtare e të cilit nuk është një nga gjuhët zyrtare në Kosovë dhe që përfaqëson mbi tre për qind të popullsisë e përgjithshme të komunës, gjuha e komunitetit do të ketë statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në komunë në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin 8 dhe komuniteti do të mund të pranojë shërbime dhe të marrë dokumente në gjuhën e tyre sipas kërkesës individuale.

1. Siguria dhe rendi

Para vitit 2017, numri i incidenteve që kishin cak komunitetin boshnjak të Kosovës ishte ndër më të lartët në Kosovë, i dyti për nga numri pas atyre që përfshinin serbët e Kosovës. Megjithatë, që nga viti 2017, numri i incidenteve të sigurisë që prek komunitetin boshnjak të Kosovës ka pësuar rënie graduale.⁵

Përmirësimi i gjendjes së sigurisë është vërejtur në rajonin e Prizrenit, ku ka një numër relativisht të ulët të incidenteve dhe të cilat zakonisht përfshijnë vjedhje, grabitje dhe në disa raste grindje, që nuk lidhen meoemos me përkatësinë etnike. Në Mitrovicën e Veriut, incidentet ndëretnike në përgjithësi janë në rënie, me përjashtim të disa incidenteve sporadike që përfshijnë komunitetin boshnjak të Kosovës, pa ndikim të madh në gjendjen e përgjithshme të sigurisë. I njëjti vlerësim vlen edhe për Prishtinën, ku komuniteti boshnjak i Kosovës është i integruar mirë dhe bashkëpunimi me komunitetet e tjera konsiderohet "i mirë". Barrierat gjuhësore mund të kontribuojnë në dialog më të dobët ndërmjet komuniteteve, pasi jo të gjithë pjesëtarët e komunitetit boshnjak të Kosovës e flasin rrjedhshëm gjuhën shqipe.

Shumica e incidenteve që kanë prekur këtë komunitet janë raportuar në komunat Istog, Pejë, Mitrovicë Veriore dhe Prizren.⁶ Edhe pse shumica dërrmuese e incidenteve ishin vjedhje në fshatin Vitomiricë në Pejë dhe në luginën e Zhupës të banuar nga boshnjakët në Kosovë (Lubinje e Epërme, Manastiricë dhe Lubinje e Poshtme), si dhe në zonën e Podgorës (Lubizhdë) brenda komunës së Prizrenit, kishte disa raste më të rënda si zjarrvënie dhe kërcënime ndaj pjesëtarëve boshnjakë të Policisë së Kosovës.⁷ Komuniteti boshnjak i Kosovës që banon në Mëhallën e Boshnjakëve në Mitrovicën e Veriut, zonë e frekuentuar me shumë biznese dhe dyqane që sjellin klientë nga rajone dhe etni të ndryshme, raportoi për disa incidente të vogla dhe provokime.

⁵ Sipas monitorimit të brendshëm të OSBE-së, 75 incidente kishin ndodhur në vitin 2013, 62 në 2014, 49 në 2015, 53 në 2016, 28 në 2017, 18 në 2018, 24 në 2019, 24 në 2020, 14 në 2021, 20 në 2022 dhe 12 në 2023.

⁶ Në shkurt të vitit 2020, një shqiptar i Kosovës sulmoi fizikisht një boshnjak të Kosovës në fshatin Dobrushë. Në shkurt të vitit 2020, në fshatrat Dobrushë dhe Lubovë, autor(ë) të panjohur kishin hyrë në gjashtë shtëpi të pabanuara të pjesëtarëve të komunitetit boshnjak të Kosovës dhe kanë vjedhur gjësende shtëpiake. Në prill të vitit 2020, zjarri kishte shkatërruar një shtëpi që i përkiste një boshnjaku të Kosovës nga fshati Zllapek i Pejës. Në Obiliq, në shkurt të vitit 2022 zjarri kishte shpërthyer në shtëpinë e një familjeje boshnjake të Kosovës në fshatin e përzier të Plemetinit. Familja e informoi ZKKK-në se kishin gjetur një shishe dhe leckë, të cilat ata pretenduan se shkaktuan zjarrin (një "kokteji molotovi").

⁷ Në gusht të vitit 2020, dy të dyshuar të panjohur hynë në një shtëpi të një boshnjaku të Kosovës në Prizren, ku vodhën 500 euro dhe e lënduan fizikisht viktimën. Në shkurt të vitit 2022 në Obiliq, një shqiptar i Kosovës u arrestua teksa goditi me thikë në shpinë një boshnjak të Kosovës pas një mosmarrëveshje verbale, i cili pësoi lëndime trupore. Në tetor 2022, në fshatin Lubovë, komuna e Istogut, u grabitën tri shtëpi të pabanuara të familjeve boshnjake të Kosovës. Në mars të vitit 2015, një person i panjohur kishte vjedhur dhe më pas djegur shtëpinë e një familjeje të kthyer boshnjake të Kosovës në fshatin Banjë të Istogut. Pronari raportoi se shtëpia ishte vjedhur tre herë që kur familja u kthye nga Mali i Zi në vitin 2008. Në gusht të vitit 2017, në Istog, një polic boshnjak i Kosovës në detyrë ishte kërcënuar dhe ngacmuar verbalisht në rrugë nga një shqiptar i Kosovës, i cili dyshohet se e kërcënoi policin që të mos fliste në gjuhën boshnjake/serbe. Policia e Kosovës arrestoi të dyshuarin. Në mars të vitit 2022, nënkryetari për komunitete nga radhët e komunitetit boshnjakë të Kosovës në Pejë raportoi se ai dhe familja e tij ishin ngacmuar përmes mediave sociale.

Ka pasur gjithashtu edhe përleshje të herëpashershme mes nxënësve të shkollave fillore në një shkollë të përzier sipas kurrikulës së Kosovës në Vitomiricë. Edhe pse shumë të rinj **boshnjakë të Kosovës** e flasin gjuhën shqipe, ka pasur disa incidente kanë prekur pjesëtarët e komunitetit **boshnjak të Kosovës** bazuar në gjuhën që ata kanë zgjedhur për ta folur.⁸

Në vitin 2019, 220 pjesëtarë të komunitetit **boshnjak të Kosovës** u punësuan në Policinë e Kosovës, të vendosur në 17 komuna dhe në pesë departamente të Policisë së Kosovës në mbarë Kosovën.⁹ Deri në vitin 2023, ky numër kishte rënë në 192 (31 gra). Ata shërbejnë në stacionet e Policisë së Kosovës në: Prishtinë, Graçanicë, Lipjan, Fushë Kosovë dhe Gjilan. Nënstacionet policore gjenden në Vitomiricë në Pejë dhe në Zhupë, Prizren, vende me shumicë boshnjake të Kosovës.

Janë 14 pjesëtarë të komunitetit **boshnjak të Kosovës** në komitetet lokale të sigurisë publike (KLSP).

8 Në dhjetor të vitit 2019, një nxënës boshnjak i Kosovës u rrah nga një grup nxënësish shqiptarë të Kosovës në një shkollë të përzier sipas kurrikulës së Kosovës. Në maj të vitit 2021, një i mitur boshnjak i Kosovës u sulmua dhe u godit me thikë nga persona të panjohur në Prizren teksa po ecte në rrugë pranë një shkolle.

9 Pesëdhjetë e katër pjesëtarë të komunitetit boshnjak të Kosovës u punësuan në pikë kalimet kufitare. Një pjesëtar boshnjak i Policisë së Kosovës ishte i vendosur në Deçan, tre në Dragash, katër në Fushë Kosovë, një në Gjakovë, dy në Gjilan, një në Graçanicë, pesë në Istog, tre në Leposaviq, një në Lipjan, dy në Mitrovicën e Jugut, dhjetë në Mitrovicën e Veriut, 42 në Pejë, gjashtë në Prishtinë, 43 në Prizren, një në Rahovec, një në Suharekë dhe një në Vushtrri.

2. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi

Pjesëtarët e komunitetit boshnjak të Kosovës aktualisht mbajnë funksione të larta në qeverinë e Kosovës, duke përfshirë postin e zëvendës-kryeministrit të mbajtur nga Emilija Rexhepi e Partisë së Re Demokratike (NDS).

Rexhepi më parë ka shërbyer si ministre e Administrimit të Pushtetit Lokal. Gjithashtu, Almir Veliji i Bashkimit Socialdemokrat (SDU) shërben si zëvendësministër i Zhvillimit Rajonal në qeverinë aktuale. Rexheplar shërben si zëvendësministër i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Avdullah Djeseviq shërben si zëvendësministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Kushtetuta garanton tri vende në Kuvend për partitë që përfaqësojnë **boshnjakët e Kosovës**. Në zgjedhjet e vitit 2019, dy mandate u fituan nga kandidatët që përfaqësojnë Koalicionin VAKAT (Duda Balje dhe Rasim Demiri) dhe një nga Emilija Rexhepi. Pas emërimit të Rexhepit si zëvendëskryeministre, ajo u zëvendësua nga një kandidate tjetër femër nga NDS, Samra Ilijaz. Pas zgjedhjeve të vitit 2019, Duda Balje u largua nga Koalicioni VAKAT dhe themeloi një parti të re, Bashkimin Social Demokrat (SDU). Përveç Koalicionit VAKAT, NDS dhe SDU, një parti tjetër boshnjake e Kosovës që mori pjesë në zgjedhjet e Kuvendit të vitit 2019 ishte Partia për Veprim Demokratik (SDA). Përveç kësaj, Esmir Kasi kandidoi në zgjedhje si kandidat i pavarur. Gjatë zgjedhjeve të 14 shkurtit të vitit 2021, kandidatët e SDU-së Duda Balje dhe Bahrim Shabani (Koalicioni VAKAT) fituan ulëse në Kuvend, sikurse bëri kandidatja e NDS-së, Samra Ilijaz.

Komuniteti **boshnjak i Kosovës** ka tre përfaqësues në Këshillin Konsultativ për Komunitete (KKK) në Zyrën e Presidentit. Në tetor të vitit 2022, në një takim të organizatave të shoqërisë civile u përzgjedhën anëtarët e rinj **boshnjakë të Kosovës** të KKK-së (një grua dhe dy burra).

Në vitin 2017, komuniteti **boshnjak i Kosovës** përbënte 1.21 për qind të shërbimit civil në nivel qeveritar. Në nivel komunal, komuniteti ishte i nën-përfaqësuar në shërbimin civil në një komunë, gjegjësisht në Pejë.¹⁰

10 OSBE, *Përfaqësimi i komuniteteve në Shërbimin Civil në Kosovë* (2017).

Komuniteti është i përfaqësuar në 14 komitete të komuniteteve (KK) në mbarë Kosovën, me gjithsej 19 anëtarë (dhjetë gra dhe nëntë burra). Komuniteti **boshnjak i Kosovës** është i përfaqësuar në KK e të gjitha komunave me një numër të konsiderueshëm të anëtarëve të komuniteteve.¹¹ Megjithatë, ai nuk është e përfaqësuar në KK në 20 komuna ku banojnë relativisht pak anëtarë të komunitetit, sipas regjistrimit të vitit 2011.¹² Anëtarët e komunitetit (dy gra, dy burra) mbajnë pozitën e kryesuesit të KK në katër komuna.¹³

Një **boshnjak i Kosovës** shërben si nënkryetar i komunës për komunitete në Pejë, ndërsa dy kanë pozitën e zëvendëskryesuesve të kuvendit komunal për komunitete në Dragash dhe Istog.¹⁴

Pjesëtarët e komunitetit **boshnjak të Kosovës** janë të përfaqësuar në gjashtë zyra komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK), me gjithsej 13 anëtarë (pesë gra).¹⁵ Pozitën e kreut të ZKKK-së burrat **boshnjakë të Kosovës** e mbajnë në katër komuna.¹⁶

Janë dhjetë anëtarë të komunitetit **boshnjak të Kosovës** në këshillat komunalë për siguri në bashkësi (KKSB) në këto komuna: nga një grua në komunat Mitrovicë e Jugut, Deçan, Gjakovë, Pejë, Obiliq dhe Prishtinë, dhe nga një burrë në komunat Skenderaj, Istog, Dragash dhe Prizren.

Shoqëria civile boshnjake e Kosovës nuk është veçanërisht aktive. Organizata joqeveritare (OJQ) "Jednakost" (Barazia), e cila promovon të drejtat dhe arsimimin e grave në mesin e komunitetit **boshnjak të Kosovës** në Prizren dhe Dragash, është ndër OJQ-të më të spikatura. Përveç kësaj, OJQ "Plejada" (Pleiad) dhe "Vijece Kongresa Bosnjackih Intelektualaca Kosova" (VKBIK) (Këshilli i Kongresit të Intelektualëve Boshnjakë të Kosovës) janë gjithashtu aktive në rajonin e Prizrenit, kryesisht të fokusuar në ruajtjen dhe promovimin e vlerave kulturore dhe përfshirjes sociale. Në rajonin e Pejës, disa OJQ të vogla si Lejla, Kadin dhe "Centar za Integraciju Mladih" (Qendra për Integrimin e Rinisë) i shërbejnë komunitetit.

11 Domethënë, komunat me më shumë se 1000 anëtarë të komunitetit. Sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 2011, këto komuna janë Dragashi (4100), Istogu (1142), Peja (3786) dhe Prizreni (16896).

12 Komuniteti boshnjakë i Kosovës nuk është i përfaqësuar në KK të komunave si në vijim: Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjilan, Glllogoc, Hani i Elezit, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Novobërdë, Podujevë, Rahovec, Ranillug, Shtime, Shtërpçë, Suharekë dhe Viti. Për më tepër, pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme që u mbajtën në prill të vitit 2023, në Leposaviq nuk u themelua KK. Boshnjakët e Kosovës janë komuniteti i dytë më i nën-përfaqësuar brenda KK-ve.

13 Boshnjakët e Kosovës mbajnë pozitën e kryesuesit të KK-së në Dragash (burrë), Graçanicë (burrë), Istog (grua) dhe Prishtinë (grua).

14 Sipas regjistrimit të vitit 2011, boshnjakët e Kosovës përfaqësojnë komunitetin më të madh joshumicë në komunën e Prizrenit, dhe në bazë të kornizës përkatëse ligjore, një anëtar i komunitetit duhet të mbajë postin e nënkryetarit për komunitete (NNK). Megjithatë, gjatë periudhës raportuese, asnjë NNK nuk ishte emëruar në Prizren.

15 Për më tepër, boshnjakët e Kosovës janë anëtarë të zyrave të ngjashme si ZKKK në Leposaviq dhe Mitrovicën e Veriut. Në të vërtetë, në Leposaviq, Mitrovicë të Veriut dhe Zubin Potok, ZKKK-të nuk janë themeluar zyrtarisht, edhe pse zyrat me funksione të ngjashme ekzistojnë siç janë zyrat komunale për komunitete. Më konkretisht, një Zyrë Komunale për Komunitete funksionon në Zubin Potok. Në Leposaviq dhe Mitrovicë të Veriut, zyrat e ngjashme me ZKKK-në (të quajtura Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, përkatësisht Drejtoria Komunale për Komunitete, Kthim dhe Informacion) drejtohen nga drejtorë të emëruar politikisht. Këto zyra janë themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2007/30 për Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë, neni 23(11).

16 Pjesëtarët e komunitetit boshnjak të Kosovës shërbejnë si kryesues të ZKKK-ve në komunat e Deçanit, Dragashit, Istogut dhe Pejës. Vlen të përmendet se pozita e kreut të ZKKK-së në komunën e Prizrenit ka qenë e lirë në periudhën 2019-2022. Më 11 maj të vitit 2022, kryetari i Komunës së Prizrenit emëroi koordinatoren e ZKKK-së për Kthim, një grua boshnjake të Kosovës, si ushtruese të detyrës së kryesuesit të ZKKK-së. Në dhjetor të vitit 2022, një grua turke e Kosovës u emërua në krye të ZKKK-së së Prizrenit.

Për më tepër, që nga viti 2021, "Mladi Volonteri" (Vullnetarët e rinj) dhe "Žena Vaš Kutak" (Shoqata e grave Këndi Juaj) janë themeluar nga të rinjtë dhe gratë boshnjake të Kosovës, përkatësisht, dhe kanë qenë aktive në mbështetjen e trashëgimisë kulturore të komunitetit dhe aftësive të punësimit të grave të komunitetit. Mitrovica e Jugut është shtëpia e OJQ-së "Saraj" (Saraj).

Në rajonin e Prizrenit, në verën e vitit 2022, përfaqësuesit politikë [boshnjakë të Kosovës](#) kërkuan krijimin e komunës me shumicë [boshnjake të Kosovës](#) "Komuna e Reçanit" në luginën e Zhupës.¹⁷

¹⁷ Ka pasur disa nisma nga lëvizjet politike boshnjake të Kosovës për themelimin e komunës së Reçanit në luginën e Zhupës. Së fundmi, në korrik të vitit 2022, filloi mbledhja e nënshkrimeve për paraqitjen e një kërkesë zyrtare pranë institucioneve përgjegjëse.

3. Punësimi dhe gjendja socio-ekonomike

Gjendja socio-ekonomike e komunitetit boshnjak të Kosovës është afër mesatares në Kosovë. Në mesin e kushteve sfiduese që komuniteti boshnjak i ka përbashkëta me komunitetet e tjera janë punësimi dhe mundësitë ekonomike të kufizuara.

Përveç kësaj, për shumë pjesëtarë të komunitetit, pamundësia për të komunikuar në gjuhën shqipe shpesh paraqet pengesë për qasje në mundësi ekonomike.¹⁸

Shkalla e papunësisë për komunitetin boshnjak të Kosovës në Prizren është 50 për qind, ndërsa në Dragash është rreth 25-30 për qind. Bazuar në të dhënat që janë marrë nga komuna, 24 boshnjakë të Kosovës (nuk ka të dhëna të zëbra të sipas gjinisë) janë të punësuar në administratën komunale të Prizrenit, dhe 15 (të gjithë burra) në Dragash. Në bazë të dhënave statistikore të zyrës së Byrosë Kosovare të Punësimit në Prizren, janë 330 punëkërkues aktivë (169 gra) të regjistruar nga komuniteti boshnjak i Kosovës. Në bazë të dhënave statistikore të zyrës së Byrosë Kosovare të Punësimit në Dragash, janë 11 punëkërkues aktivë (dy gra) të regjistruar nga komuniteti boshnjak i Kosovës.

Në vitin 2018, nga 95,890 persona të regjistruar si të papunë, 1.70 për qind i përkisnin komunitetit boshnjak të Kosovës.¹⁹

Në sektorin publik, komuniteti boshnjak i Kosovës është i përfaqësuar në të gjitha nivelet qeveritare. Pjesëtarët e komunitetit janë më të pranishëm në funksionet vendimmarrëse në nivel komune ku mbajnë 23 për qind të posteve drejtuese, sesa në nivel qeveritar ku mbajnë 12 për qind. Në nivel qeveritar, boshnjakët e Kosovës aktualisht përfaqësohen me pozitën e zëvendëskryeministrit, që konsiderohet si një avancim i madh i përfaqësimit politik për komunitetin. Megjithatë, në kuptim të përgjithshëm, boshnjakët e Kosovës zënë kryesisht punë të nivelit profesional dhe administrativ në qeveri, ku gratë janë pak më shumë të përfaqësuara se burrat. Në nivel komunal, ndonëse proporcionalisht gratë mbajnë pjesën më të madhe të pozitave që përcaktohen,²⁰ ato janë të përfaqësuara dobët.²¹

18 Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave në Kosovë, *Profili i komunitetit: komuniteti boshnjak*, faqe 5.

19 Të dhënat më të fundit nuk janë në dispozicion.

20 Pozitat e përcaktuara për përfaqësimin proporcional të komuniteteve.

21 OSBE, *Përfaqësimi i Komuniteteve në Shërbimin Civil në Kosovë: Raporti vijues* (2017), faqe 14, 17, 22–23.

Në komunën e Prizrenit, 24 **boshnjakë të Kosovës** janë të punësuar në administratën komunale. Në komunën e Dragashit, rreth 15 **boshnjakë të Kosovës** janë të punësuar në sektorin publik. Në Pejë, 95 **boshnjakë të Kosovës** janë të punësuar në sektorin publik (me përfaqësim të barabartë gjinor), duke përfshirë në shërbimin civil komunal dhe në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë. Në Istog, 38 **boshnjakë të Kosovës** janë të punësuar në shërbimin civil (19 gra dhe 19 burra) dhe në sektorët e shëndetësisë dhe arsimit. Në rajonet e Mitrovicës, Prishtinës dhe Gjilanit, disa pjesëtarë të komunitetit janë të punësuar në sektorin publik, afërsisht në proporcion me numrin e banorëve. Megjithatë, pengesat gjuhësore ndonjëherë ua vështirësojnë **boshnjakëve të Kosovës** punësimin në shërbimin civil. Në Obiliq janë pesë pjesëtarë të komunitetit **boshnjak të Kosovës** të cilët janë të punësuar në sektorin publik dhe tre në sektorin privat. Pjesëtarët e tjerë janë kryesisht pensionistë, të cilët punojnë në bujqësi. Në Graçanicë është një pjesëtar i komunitetit **boshnjak të Kosovës**, i cili është i punësuar në sektorin publik dhe një pjesëtar tjetër është në shërbimin shëndetësor publik të drejtuar nga Beogradi. Pjesëtarët e tjerë janë të papunë.

Në rajonin e Mitrovicës, shkalla e punësimit të pjesëtarëve të komunitetit **boshnjak të Kosovës** në sektorin publik është shumë e ulët. **Boshnjakët e Kosovës** janë të punësuar në sektorin publik vetëm në Mitrovicën e Jugut, Mitrovicën e Veriut dhe Leposaviq. Në Mitrovicën e Jugut, një boshnjak (burrë) i Kosovës punon në ZKKK, dy-tre të tjerë si punonjës civil, një grua boshnjake e Kosovës është profesoreshë në Universitetin e Mitrovicës së Jugut dhe shtatë ose tetë gra punojnë si infermiere në mjediset e shëndetësisë publike. Janë rreth dhjetë mësimdhënës **boshnjakë të Kosovës** në shkollat filllore dhe të mesme në Mitrovicën e Jugut. Në administratat e tanishme komunale, tre **boshnjakë të Kosovës** punojnë në Mitrovicën e Veriut: Kryesuesi i KK-së (burrë), drejtoresha e kulturës, rinisë dhe sportit (grua) dhe një anëtare e KK (grua). Në Leposaviq, tre **boshnjakë të Kosovës** punojnë në administratën komunale.

Në komunën e Prizrenit, **boshnjakët e Kosovës** janë të angazhuar kryesisht në sektorin e gastronomisë, meqë shumë restorante në zonën e Zhupës janë në pronësi të tyre. Pjesëtarët e komunitetit kanë qenë gjithashtu të angazhuar në mënyrë aktive në kultivimin e mjedrës në vitet e fundit. Gjendja është e ngjashme në komunën e Dragashit, ku numri i të punësuarve nuk është shumë i lartë dhe shumica e pjesëtarëve të komunitetit janë të vetëpunësuar, kryesisht në sektorin e ndërtimitarisë dhe gastronomisë. Njëqind **boshnjakë të Kosovës** (40 për qind gra, kryesisht të angazhuara në grumbullimin e bimëve barishtore dhe mjedrave) janë të angazhuar në kooperativën "Red Gold" në Prizren, e cila ofron kontrata sezonale çdo vit. Gratë **boshnjake të Kosovës** në fshatrat e Prizrenit më së shumti merren me zejтари, prodhim ushqimi, kujdestari dhe bujqësi. Shumica e grave theksuan se punojnë në cilësi private, pa biznese të regjistruara dhe se angazhimi i tyre ka karakter sezonal për shkak të specifikës së sektorëve të sipërpërmendur ekonomikë në të cilët janë të angazhuara. Një nga sfidat më të mëdha për këto gra është mungesa e tregjeve në dispozicion për të shitur produktet e tyre dhe, ndërkohë që ato zgjedhin të promovojnë punën e tyre përmes mediave sociale, kjo bëhet në një masë të kufizuar për shkak të shkathtësive të pamjaftueshme në marketing.

Në komunat Pejë dhe Istog, ashtu si në rajonin e Mitrovicës dhe Prishtinës, komuniteti është i angazhuar kryesisht në sektorët e bujqësisë dhe gastronomisë, si dhe në punët sezonale të ndërtimit, sektorin e shërbimeve komunale, dyqanet e mobilierisë dhe dyqanet ushqimore. Në rajonin e Gjilanit, **boshnjakët e Kosovës** në përgjithësi punojnë në biznese private apo kompani publike, dhe më pak në bujqësi dhe ndërtimtarë.

Sa i përket projekteve të gjenerimit të të ardhurave, komuniteti **boshnjak i Kosovës** ka përfituar nga Projektet e Stabilizimit të Komunitetit që janë financuar nga Ambasada Britanike dhe që janë zbatuar nga Këshilli Danez për Refugjatët, të cilat janë në dispozicion në komunën e Prizrenit për disa vite. Caritas-i zviceran gjithashtu financoi projekte për gjenerimin e të ardhurave përmes Programit të tij për Kosovën, që kryesisht u përqendrua në prodhimin bujqësor si në komunën e Prizrenit ashtu edhe atë të Dragashit, përmes të cilave kanë përfituar shumë komunitete. Në rajonet e Pejës dhe Gjilanit, komuniteti ka përfituar më së shumti nga projektet e vogla të gjenerimit të të ardhurave në lidhje me blegtorinë dhe bujqësinë dhe që janë mbështetur nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim.

Asnjë rast i punës së fëmijëve nuk është raportuar në komunitetin **boshnjak të Kosovës**. Në disa raste, fëmijët i ndihmojnë prindërit e tyre në bizneset e tyre të vogla gjatë pushimeve verore, të cilat mund të përfshijnë vjeljen e mjedrës ku janë të angazhuar si djemtë ashtu edhe vajzat. Asnjë aktivitet i rëndësishëm në ekonominë joformale nuk është vërejtur në mesin e komunitetit **boshnjak të Kosovës**.

Ashtu si me komunitetet e tjera, **boshnjakët e Kosovës** janë të shtyrë të migrojnë kryesisht për shkak të shkallës së lartë të papunësisë dhe kushteve të këqija ekonomike. Disa **boshnjakë të Kosovës** emigrojnë për të ndjekur mundësitë e arsimit të lartë diku tjetër. Pjesëtarët e komunitetit migrojnë kryesisht në Bosnje dhe Hercegovinë, pjesë të Serbisë (si zona e Sanxhakut dhe Novi Sad), Slloveni dhe Kroaci. Megjithatë, shumë migrojnë gjithashtu në vendet e Evropës Perëndimore (kryesisht Gjermani, Itali, Francë, Belgjikë, Austri dhe Zvicër). Në përgjithësi, pjesëtarët më të rinj të komunitetit migrojnë, ndërsa më shumë persona të moshuar mbesin prapa; kjo dukuri është veçanërisht e dukshme në Dragash dhe në disa fshatra të rajonit të Mitrovicës.

4. Qasja në infrastrukturë dhe shërbime publike

Pjesëtarët e komunitetit boshnjak të Kosovës gëzojnë qasje kryesisht të kënaqshme në infrastrukturë dhe shërbime publike, përveç në disa zona malore rurale, veçanërisht në zonën e Gorës në Dragash dhe luginën e Zhupës në Prizren, ku infrastruktura është e vjetërsuar dhe rrugët janë të këqija.

Në rajonin e Prizrenit, infrastruktura në zonat e banuara nga boshnjakët e Kosovës në qytetin e Prizrenit është adekuate, sikurse është edhe për komunitetet tjera. Ndërprerjet e mëdha të energjisë elektrike në fshatrat boshnjake të Kosovës në luginën e Zhupës janë rralluar në vitet e fundit. Megjithatë, rrugët më të vogla urbane në Prizren paraqesin rrezik për sigurinë në trafik rrugor dhe sigurinë publike për të gjitha komunitetet, përfshirë edhe boshnjakët e Kosovës pasi që nuk ka trotuare të sigurta për këmbësorët.

Në zonat malore të rajonit të Gorës në komunën e Dragashit, boshnjakët e Kosovës dhe komunitetet e tjera vazhdojnë të përballen me mungesë të energjisë elektrike dhe ujit për shkak të rrjeteve të vjetruara të furnizimit dhe mungesës së sistemeve të kanalizimit në disa fshatra. Ndërtimi i një sistemi të përbashkët të furnizimit me ujë për 15 fshatra filloi në vitin 2011, por mbetet i papërfunduar dhe fshatrat mbështeten në sistemet e tyre individuale të furnizimit me ujë.²² Megjithatë, nga buxheti komunal i Dragashit për vitin 2024 u ndanë afërsisht 4.5 milionë euro për projektet e investimeve kapitale, shumica e të cilave do të shpenzohen për zbatimin e një projekti të furnizimit me ujë për 15 fshatra në zonat e Gorës dhe Opojës dhe të qytetit të Dragashit, përfshirë ndërtimi i një impianti për trajtimin e ujit në fshatin Radesh. Problemet me qasjen në ujë të pijshëm janë ende të pranishme në fshatrat Rapqë e Epërme dhe Rapqë e Poshtme, të cilat përballen me mungesa për shkak të rrjetit të vjetër të shpërndarjes së ujit, si dhe mosmarrëveshjeve me fshatin fqinj Kërstec për shkak të rrjetit. Dobësitë e infrastrukturës ekzistuese dhe shtyllat e vjetruara përçuese shkaktojnë ndërprerje sporadike të furnizimit me energji elektrike në disa fshatra të zonës së Gorës, si Restelicë, Zllipotoku, Krushëvë dhe Gllloboçicë, të cilat janë veçanërisht të prekura gjatë stinës së dimrit.

Për më shumë se 30 vjet, nuk kishte pasur asnjë investim në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në rajonin e Gorës derisa komuna e Dragashit arriti një marrëveshje me shkrim me kompaninë komunale Shërbimet e Shpërndarjes së Energjisë në Kosovë (KEDS) në tetor të vitit 2020.

22 OSBE, *Profili e Komunave*, 2018.

Rrjedhimisht, në dhjetor 2020 filloi instalimi i një linje të re kryesore të energjisë elektrike nga qyteti i Dragashit drejt fshatit Restelicë, ku jetojnë boshnjakët dhe goranët e Kosovës. Ajo pritej të lidhte të gjithë fshatrat e zonës dhe të përmirësonte cilësinë e shërbimit. Megjithatë, kjo ndërhyrje është zbatuar vetëm pjesërisht dhe nuk ka trajtuar plotësisht problemet që lidhen me infrastrukturën e rrjetit në zonën e Gorës. Në fund të vitit 2023, KEDS prezantoi planin strategjik për periudhën 2024-2026, duke ofruar plan udhërrëfyes për instalimin e një rrjeti të ri energjetik në fshatrat e zonës së Gorës.

Përveç kësaj, problemet e menaxhimit të mbeturinave në rajonin e Gorës vazhdojnë. Komuna e Dragashit, në bashkëpunim me Agjencinë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA), ka ndërmarrë përpjekje për të mbuluar të gjithë territorin e saj në planin e menaxhimit të mbeturinave komunale. Megjithatë, ka fshatra që ende nuk janë mbuluar. Kështu qëndron gjendja me fshatrat Leshtan, Kërstec, Baçkë, Orqushë, Dikancë dhe,²³ si dhe Restelicë, ku OJQ lokale *Eko Restelica* trajton menaxhimin e mbeturinave me mjetet financiare që i siguron nga kontributet vullnetare të banorëve dhe bizneseve.

Krejt në fund, shembja e shpeshtë e shkëmbinjve në luginën e Zhupës paraqet kërcënim për sigurinë dhe herë pas here bllokon rrugët që lidhin disa fshatra ku jetojnë [boshnjakët e Kosovës](#). Këto rrugë malore janë përgjithësisht të ngushta dhe në gjendje të keqe, duke shkaktuar rreziqe shtesë për banorët. Më 3 shtator të vitit 2023, partia politike boshnjake e Kosovës Naša Inicijativa (Nisma Jonë - NI) organizoi një protestë në fshatin Reçan për shkak të shqetësimeve të sigurisë lidhur me rrëshqitjet e dheut gjatë punimeve për përmirësimin e rrugës rajonale Prizren-Brezovicë, e cila lidh disa fshatra ku kryesisht jetojnë [boshnjakët e Kosovës](#) në luginën e Zhupës. Më 26 shtator të vitit 2023, kryetarët e komunave të Dragashit dhe komunave të Mavrovës dhe Rostushës në Maqedoninë e Veriut u takuan në Shkup për të zyrtarizuar një projekt për asfaltimin e një rruge gjashtë metra të gjerë që lidh qytetet e Mavrovës dhe Dragashit përmes një pikë-kalimi sezonal e që pritet të përfundojë gjatë vitit 2024.

Në komunën e Prizrenit, çështja e menaxhimit të mbeturinave në fshatrat Reçan, Mushnikovë dhe Gornjasellë u rregullua në vitin 2016 kur u zgjidhën mosmarrëveshjet me ofruesit e shërbimeve. Shërbimet e telekomunikacionit gjithashtu janë përmirësuar ndjeshëm në dekadën e fundit në rajonin e Gorës.

Në përgjithësi, [boshnjakët e Kosovës](#) në qytetin e Pejës kanë qasje të qëndrueshme në ujë të pijshëm, energji elektrike, infrastrukturë rrugore dhe grumbullim të mbeturinave, si dhe në banim. Megjithatë, në fshatrat periferike ku jetojnë [boshnjakët e Kosovës](#) në komunën e Pejës, ka raste të mungesës së ujit të pijshëm gjatë periudhës së verës (si në shumë fshatra të tjerë përreth). Ndërprerjet e energjisë elektrike ndodhin gjatë dimrit dhe në kushte me erë të fortë për shkak të rrjetit të vjetër elektrik dhe shtyllave të vjetra elektrike, veçanërisht në Vitomiricë. Përveç kësaj, nuk ka sistem të kanalizimit në fshatrat Vitomiricë në Pejë, Prapaqan në Deçan

²³ Në zonën e Opojës, fshatrat Xërxë dhe Pllajnik, të banuara kryesisht nga shqiptarët e Kosovës, përballen me të njëjtën gjendje. Në rastin e kësaj të fundit, një zyrtar komunal raportoi se kompania e menaxhimit të mbeturinave *Eko Regjioni* nuk është e gatshme që të ofrojë shërbimet e saj për shkak të vendndodhjes së largët të fshatit dhe kostove shtesë që do t'i shkaktonte kompanisë.

apo në disa fshatra në Istog. Gjatë vitit 2021 dhe 2022, në Vitomiricë dhe Zillopek u asfaltuan shumë rrugë të vogla, nga të cilat ka përfituar komuniteti [boshnjak i Kosovës](#) që jeton atje. Në vitin 2023, një rrugë u shtrua në fshatin Prapaqan, pas një kërkesë nga komuniteti.

Nga dhjetë fshatrat ku banojnë [boshnjakët e Kosovës](#) në komunën e Istogut, fshatrat Dobrushë dhe Banjë kanë ndriçim rrugor, dhe vetëm në Dobrushë ka trotuare. Komuna ka mbështetur projekte të tilla si ndriçimi i rrugëve dhe trotuaret në Dobrushë, ndërtimi i sistemit të kanalizimit të fshatit në Gurrakoc, asfaltimi i rrugëve në fshatin Lubovë dhe shtrimi i rrugëve me zhavorr në të gjitha fshatrat, të cilat kanë përmirësuar paksa qasjen në infrastrukturë atje. Përmirësimet vazhduan në vitin 2022 dhe 2023, kur disa rrugë në Dobrushë u asfaltuan ose u shtruan me zhavorr. Për më tepër, në vitin 2023 filluan projektet për instalimin e sistemeve të ujërave të zeza në fshatrat Dobrush dhe Banjë.

Në rajonin e Mitrovicës, furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike janë përmirësuar ndjeshëm gjatë dekadës së fundit. Gjendja e rrugëve rajonale vlerësohet si e mirë, ndërsa asfaltimi i shumicës së rrugëve lokale është i përfunduar ose i planifikuar. Megjithatë, rrugët në fshatrat Kalin, Rëvatskë dhe Jarinjë e Epërme në komunën e Leposaviqit kërkojnë mirëmbajtje ose asfaltim. Gjithashtu, ka probleme me sistemin e kanalizimit në fshatin Jarinjë e Epërme. I gjithë fshati vuan nga problemi i kundërmimit për shkak të problemeve të lidhura me ujërat e zeza. Sipas ish-kryetarit të ZKKK-së, Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) para pesë viteve ka miratuar një projekt për ndërtimin e një sistemi të mirëfilltë të kanalizimit, por projekti nuk është realizuar. Menaxhimi i mbeturinave mbetet çështja më serioze në të gjithë rajonin.

Në Obiliq, përveç transportit, më specifikisht, nga Mazgiti në Obiliq dhe Prishtinë dhe anasjelltas, i gjithë komuniteti ka qasje të kënaqshme në infrastrukturën rrugore, energjinë elektrike, menaxhimin e mbeturinave, furnizimin me ujë, sistemet e kanalizimit dhe ndriçimin e rrugëve. Në Graçanicë, pjesëtarët e komunitetit [boshnjak të Kosovës](#) raportohet se gëzojnë qasje kryesisht të kënaqshme në infrastrukturë dhe në shërbime publike.

Komuniteti [boshnjak i Kosovës](#) ka qasje të papenguar në varreza në të gjitha komunat ku ata jetojnë; pjesëtarët zakonisht i përdorin varreza islamike me komunitete të tjera të së njëjtës fe.

5. Qasja në shërbime sociale, duke përfshirë shërbimet e kujdesit shëndetësor

Komuniteti boshnjak i Kosovës në përgjithësi ka qasje të mirë në shërbime sociale, shëndetësi dhe mirëqenie.

Pjesëtarët e komunitetit në përgjithësi kanë qasje në shërbimet sociale dhe kujdesin shëndetësor përmes sistemit të Kosovës, me përjashtim të komunave të Kosovës me shumicë serbe si Mitrovicë e Veriut, Leposaviq dhe Graçanicë, ku pjesëtarët e komunitetit përdorin kryesisht shërbimet e institucioneve të drejtuara nga Beogradi. Përveç kësaj, pjesëtarët e komunitetit të cilët kanë edhe letërnjoftime serbe, veçanërisht ata nga komuna e Dragashit dhe Prizrenit, përdorin shërbimet shëndetësore të drejtuara nga Beogradi në Graçanicë dhe Mitrovicë të Veriut, ndërsa për raste më të rënda shëndetësore shumë prej tyre i vizitojnë qendrat shëndetësore private dhe klinika në Beograd ose në Shkup, Maqedoni të Veriut.

Qendra shëndetësore në fshatin Vitomiricë të komunës së Pejës, e rinovuar nga komuna dhe Ministria e Shëndetësisë në vitin 2022, i shërben komunitetit boshnjak që jeton atje. Në vitin 2022, OSBE-ja dhe Ministria e Shëndetësisë kanë mbajtur prezantime mbi shëndetin riprodhues dhe kanë ofruar mamografi falas për pjesëtarët e komunitetit në komunën e Pejës.

Në vitin 2018, 262 familje boshnjake (856 persona) kanë gëzuar të drejtën për ndihmë sociale, sipas Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.²⁴ Të dhënat specifike për komunitetin që tregojnë numrin e boshnjakëve që marrin pensione dhe/ose kompensime për aftësinë e kufizuar nuk ishin në dispozicion. Megjithatë, për disa boshnjakë që nuk e flasin rrjedhshëm gjuhën shqipe mund të hasen vështirësi në qasjen në shërbime sociale, të shëndetësisë dhe mirëqenies. Kjo është veçanërisht e shprehur kur informacioni në dispozicion në gjuhën boshnjake ose serbe është i pakët, ose nëse nëpunësi civil përkatës nuk i flet ose nuk i kupton këto gjuhë.

Familjet e cënueshme nga komuniteti boshnjak përballen me vështirësi në marrjen trajtimit mjekësor dhe shërbimeve të tjera, veçanërisht ato që jetojnë në fshatrat e thella të komunës së Dragashit, për shkak të kostos së lartë të transportit për t'ju qasur institucioneve kryesore shëndetësore, përfshirë ato private.

²⁴ Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës, *Raporti Vjetor 2018*, fq. 100.

Megjithatë, gjatë viteve të fundit, qasja fizike dhe përballueshmëria e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë shërbimet e urgjencës, janë përmirësuar për pjesëtarët boshnjakë që jetojnë në zonat rurale, veçanërisht në fshatrat në zonën e Gorës në Dragash dhe në luginën e Zhupës në Prizren. Për shkak të investimeve komunale në institucionet shëndetësore të fshatrave të këtyre zonave, qendrat lokale shëndetësore tani janë të pajisura më mirë dhe ofrojnë shërbime për banorët vendas nga mëngjesi i hershëm deri në orët e vona, çdo ditë, në kuadër të sistemit komunal të kujdesit shëndetësor parësor. Komuniteti i shfrytëzon qendrat kryesore të mjekësisë familjare në qytetet e Prizrenit dhe Dragashit përveç shërbimeve të ofruara në spitalin rajonal të Prizrenit, ndërsa disa mjekë [boshnjakë të Kosovës](#) kanë ordinancat e tyre private dhe ofrojnë shërbime për komunitete të ndryshme në rajonin e Prizrenit.

Në vitet e fundit, ka pasur mungesë të fushatave lidhur me shëndetin publik që synojnë enkas komunitetin boshnjak.²⁵ Megjithatë, komuniteti ka përfituar nga fushatat lidhur me shëndetin që synojnë të gjitha komunitetet, siç është ajo për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit. Më 27 tetor 2023, së bashku me OJQ-në [boshnjake të Kosovës](#) "Barazia" dhe një obstetër/gjinekolog lokal, OSBE-ja ka organizuar një prezantim informativ mbi kancerin e gjirit në fshatin Reçan (komuna e Prizrenit) për gratë [boshnjake të Kosovës](#) nga lugina e Zhupës, për të diskutuar lidhur me parandalimin, zbulimin e hershëm, simptomat dhe trajtimin e kancerit të gjirit.²⁶ Gjatë këtij aktiviteti, kryesuesja e grupit lokal të grave në Prizren (GLG), Ymran Fusha, foli për të arriturat e GLG-së dhe përpjekjet e vazhdueshme për të lehtësuar qasjen e grave në kujdesin shëndetësor dhe kontrollet pa pagesë në institucionet mjekësore të komunës. Në këtë drejtim, gjatë tetorit 2023, GLG-të e Prizrenit dhe Dragashit i kanë bashkuar forcat për të ofruar kontrolle mamografike pa pagesë në qendrën kryesore të mjekësisë familjare në Prizren, me mbështetjen e OSBE-së.

Gjatë pandemisë COVID-19, komuniteti ka përfituar nga masat standarde të siguruara nga qeveria, krahas intervenimeve të nivelit lokal të vëna në dispozicion kryesisht përmes ZKKK-ve për familjet më të cenueshme, si dhe asistencë të përgjithshme të ofruar nga komunat që ofrohej për të gjitha komunitetet, përfshirë atë boshnjakë.

²⁵ Rrjeti i Grave të Kosovës, *Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë* (2016), fq. 51, 54. (Shikuar së fundi në dhjetor 2023).

²⁶ Shih [në anglisht] në: [Ne vazhdojmë të mbështesim ndërjegjësimin... - Misioni i OSBE-së në Kosovë | Facebook](#) (shikuar së fundi në dhjetor 2023).

6. Qasja në arsim

Nxënësit boshnjakë të Kosovës kryesisht vijojnë mësimin në gjuhën boshnjake që zbaton kurrikulën e Kosovës. Megjithatë, një numër i vogël nxënësish vijojnë mësimin në gjuhën shqipe, serbe dhe/ose turke për arsye të ndryshme.

Arsimi sipas kurrikulës së Kosovës në gjuhën boshnjake ofrohet në shtatë komuna.²⁷ Në dispozicion në gjuhën boshnjake janë lëndët specifike për komunitetin, siç është ajo e gjuhës, historisë, muzikës dhe artit. Për mësimin e gjuhës shqipe ofrohen kurse në kuadër të kurrikulës në gjuhën boshnjake.

Megjithatë, një numër i nxënësve boshnjakë vijojnë kurrikulën në gjuhën shqipe për shkak të perceptimit për arsim më cilësor, si dhe mundësive shtesë për arsimim dhe karrierë. Përveç kësaj, nxënësit boshnjakë janë të regjistruar në shkollat me kurrikulë të Serbisë në komunat e Leposaviqit, Mitrovicës Veriore, Zveçanit, Obiliqit dhe Graçanicës.

Gjatë vitit shkollor 2023–2024, 2703²⁸ pjesëtarë të komunitetit boshnjak janë regjistruar në arsimin parauniversitar. Në Prizren, gjatë vitit shkollor 2022/2023 ishin 1703 nxënës boshnjakë të Kosovës që arsimoheshin në gjuhën boshnjake sipas sistemit të kurrikulës së Kosovës.²⁹ Ndërsa në Dragash, 330 pjesëtarë të komunitetit kanë vijuar mësimet në gjuhën boshnjake.³⁰

Në rajonin e Pejës, shumica e fëmijëve boshnjakë vijojnë arsimin në gjuhën boshnjake sipas kurrikulës së Kosovës. Në vitin shkollor 2023-2024, në komunën e Pejës mësimin e vijojnë 425 nxënës boshnjakë, 298 në nivelin fillor dhe 127 në nivelin e mesëm. Në komunën e Istogut, 132 nxënës boshnjakë janë të regjistruar në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët. Në komunën e Gjakovës, nuk ka më asnjë pjesëtar të komunitetit të moshës shkollore që vijon mësimin në gjuhën boshnjake, i cili më parë ofrohej deri në klasën e pestë, derisa 18 nxënës boshnjakë vijojnë mësimin në gjuhën shqipe. Në Deçan, dy nxënës boshnjakë vijojnë arsimin fillor në gjuhën boshnjake sipas sistemit të Kosovës, ndërsa tre nxënës të shkollave të mesme në komunë vijojnë arsimin në gjuhën boshnjake në Pejë.

27 Deçan, Dragash, Gjakovë, Istog, Mitrovicë Jugore, Pejë, Prishtinë dhe Prizren.

28 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Shënime Statistike 2023/2024. (shikuar së fundi në dhjetor 2023).

29 Parashkollor 12 nxënës, parafillor: 79, fillorë dhe e mesme e ulët: 1,314, e mesme e lartë: 298.

30 Parafillorë: tetë; fillorë dhe e mesme e ulët: 283; e mesme e lartë: 39.

Në rajonin e Mitrovicës, nxënësit boshnjakë kryesisht regjistrohen në shkollat me kurrikulë serbe, kryesisht për shkak të numrit të madh të pjesëtarëve të komunitetit që jetojnë në pjesën veriore të rajonit. Përveç afërsisë, ekziston edhe perceptimi për arsim më cilësor në shkollat me kurrikulë serbe. Mosnjohja e diplomave të shkollave me kurrikulë të Kosovës nga institucionet e arsimit të lartë me kurrikulë serbe gjithashtu mund të jetë një faktor. Një nxitje shtesë për disa pjesëtarë të komunitetit për t'u regjistruar në sistemin arsimor serb është përfitimi i asistencës sociale i ofruar nga institucionet serbe. Në Mitrovicën e Jugut, ekziston vetëm një shkollë fillore dhe një shkollë e mesme me një numër të vogël nxënësish që ofron arsim në gjuhën boshnjake sipas kurrikulës së Kosovës. Numri i nxënësve vazhdon të zvogëlohet çdo vit, kryesisht për shkak të mundësive të kufizuara për të vazhduar arsimin në gjuhën boshnjake sipas këtij sistemi në nivelet e mesme dhe universitare.

Në rajonin e Prishtinës, fëmijët boshnjakë vijojnë mësimin në gjuhën boshnjake në shkolla me kurrikulë të Kosovës; disa nxënës boshnjakë nga Graçanica udhëtojnë deri te shkollat e Prishtinës. Disa nxënës boshnjakë vijojnë mësimin në shkollat me kurrikulë serbe në komunat e Graçanicës dhe Obiliqit. Në rajonin e Gjilanit, fëmijët boshnjakë ndjekin mësimin në gjuhën shqipe sipas sistemit arsimor të Kosovës.

Në të gjitha rajonet, sfida kryesore e komunitetit për qasje në arsimin parauniversitar në gjuhën boshnjake mbetet mungesa e teksteve shkollore në gjuhën boshnjake. Shumë nxënës përdorin fotokopje, pasi jo të gjitha tekstet janë në dispozicion, veçanërisht për arsimin e mesëm të lartë. Tekstet shkollore të importuara nga Bosnja dhe Hercegovina shpesh nuk përshtaten me kontekstin lokal. Përkthimet e teksteve nga shqipja në gjuhën boshnjake janë të cilësisë së dobët. Krahas pasojave të tjera, mungesa e teksteve ndikon negativisht në rezultatet e studentëve në provimin përfundimtar të maturës, duke ndikuar kështu në mundësitë e tyre për t'u regjistruar në universitetet publike. Në vitin 2023, tekstet shkollore janë shpërndarë nga deputetja boshnjake Duda Balje për të gjithë nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta në komunat e Istogut dhe Pejës. Në vitin 2023, në Deçan, tekstet shkollore në gjuhën boshnjake janë siguruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MESTI). Në fillim të vitit akademik 2023-2024, nxënësit që vijojnë kurrikulën në gjuhën boshnjake në rajonin e Prizrenit janë përballur me sfida të mëdha. Çështja kryesore ishte mungesa e librave shkollorë për t'u blerë në libraritë lokale. MESTI njoftoi më vonë se po kalonin nga shpërndarja e teksteve shkollore në shkolla në mbështetje direkte financiare për prindërit përmes një platforme online.³¹ Kjo, kombinuar me mungesën e njohurive lidhur me platformën e-Kosova dhe qasjen e kufizuar në pajisjet online dhe shërbimet bankare ka krijuar paqartësi shtesë për shumë familje dhe shkolla. Në shtator të vitit 2023, deputetja Duda Balje njoftoi përmes rrjeteve sociale për një marrëveshje me shtëpinë botuese "Dukagjini" për të ofruar tekste falas në gjuhën boshnjake për klasat 1-5 në mbarë Kosovën.

Qëndrueshmëria e arsimit në gjuhën boshnjake është luhatur nga mungesa e personelit të kualifikuar mësimdhënës. Shumë mësues kanë studiuar në Bosnje dhe Hercegovinë ose në Serbinë qendrore, por kualifikimet e tyre nuk njihen nga institucionet e Kosovës. Në Prizren ekziston një program universitar për trajnimin e

³¹ MESTI e ka hapur platformën për aplikime më 25 gusht 2023, ka njoftuar faqja e internetit të MESTI-t, <https://masht.rks-gov.net/aplikimin-per-subvencionimin-e-teksteve-shkollore-dhe-materialeve-mesimore/>.

mësuesve në gjuhën boshnjake në Kosovë. Megjithatë, programi e ka humbur akreditimin në disa raste në të kaluarën për shkak të numrit të pamjaftueshëm të personelit akademik që plotësonin kërkesat që rregullojnë akreditimin e programeve të arsimit të lartë.³² Në shkurt të vitit 2024, jashtë periudhës raportuese, Agjencia Kosovare e Akreditimit e ka refuzuar riakreditimin e programit në bazë të të njëjtave arsye.

Ekzistojnë gjithashtu një mori problemesh në lidhje me zbatimin e kurrikulës së re të Kosovës, duke përfshirë mungesën e manualeve të përkthyer, teksteve të reja, apo materialeve ndihmëse arsimore të nevojshme për zbatimin me sukses të kurrikulës së re në gjuhën boshnjake, krahas mungesës së trajnimit të mësimeve.

Brenda komunitetit boshnjak, nuk janë vërejtur probleme të mëdha në lidhje me qasjen fizike në shkolla dhe transport, me pak përjashtime. Për shembull, në komunën e Prizrenit, nxënësit e shkollave të mesme boshnjake që jetojnë në zona të thella, kryesisht në fshatrat Novosellë dhe Gërncar, përballen me vështirësi pasi që në këto dy fshatra nuk ka asnjë linjë të rregullt të transportit.

Në disa zona rurale, veçanërisht në komunën e Dragashit, disa vajza boshnjake nuk e vazhdojnë arsimin e mesëm të lartë dhe/ose universitar. Mungesa e transportit në zonat e thella dhe gjendja e vështirë ekonomike e familjeve në këto zona luajnë rol të madh në pengimin e vajzave për të vijuar shkollën e mesme, duke e paraqitur kështu nevojën për mbështetje proaktive komunale dhe të shkollave për të garantuar të drejtën e barabartë në arsim për këta nxënës dhe qasjen e integruar gjinore për të kapërcyer boshllëqet gjinore në arsim.

Rastet e braktisjes së shkollës në mesin e nxënësve [boshnjakë të Kosovës](#) janë të rralla. Në rast të braktisjes, shkak kryesor është migrimi. Në disa zona rurale, vajzat preken nga problemi i martesave të hershme. Organet përkatëse komunale dhe shkollore rregullisht i monitorojnë dhe trajtojnë rastet e braktisjes së shkollës në baza individuale. Përveç kësaj, në Mitrovicën e Veriut, një numër i konsiderueshëm i studentëve [boshnjakë të Kosovës](#) e kanë braktisur sistemin arsimor të Kosovës për t'u regjistruar në sistemin serb, për shkak të mundësive më të mëdha për arsim të mesëm të lartë dhe studime universitare në gjuhën serbe.

Sa i përket arsimit universitar, pjesëtarët e komunitetit boshnjak zgjedhin arsimin në gjuhën boshnjake, shqipe (në një nga shtatë universitetet publike me programe në gjuhën shqipe) ose në gjuhën serbe (në universitetin në gjuhën serbe në Mitrovicën e Veriut).³³ Programet e studimit në gjuhën boshnjake janë në dispozicion në universitetet publike në Prizren, Pejë dhe Prishtinë (shih më lartë komentin lidhur me akreditimin). Disa studentë boshnjakë studiojnë jashtë Kosovës, më së shpeshti në Bosnje dhe Hercegovinë, Serbi qendrore dhe Turqi.

Regjistrimi i studentëve boshnjakë për të studiuar në gjuhën shqipe sigurohet përmes Udhëzimit Administrativ për zbatimin e masave afirmative dhe kuotave për regjistrimin e kandidatëve nga komunitetet joshumicë në institucionet publike të

³² Ligji nr. 08/L-110 për Agjencinë e Akreditimit të Kosovës.

³³ Universitetet publike gjenden në Ferizaj, Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë e Jugut, Pejë, Prishtinë dhe Prizren.

arsimit të lartë.³⁴ Masat afirmative përfshijnë kuotën prej 12 për qind për regjistrimin e studentëve të komuniteteve joshumicë në të gjitha programet e arsimit të lartë, si dhe 12 për qind për vendosje në konvikte dhe mensat e studentëve.

Numri i përgjithshëm i studentëve boshnjakë që studiojnë në gjuhën boshnjake në Universitetin e Prizrenit ishte 152 studentë në vitin akademik 2023/2024. Bursat janë në dispozicion për studentët e nivelit universitar nga të gjitha komunitetet.

Në vitin akademik 2023–2024 në Universitetin e Pejës janë regjistruar 74 studentë boshnjakë në studimet themelore (baçellor) në programet në gjuhën boshnjake, ndërsa 24 studentë boshnjakë janë regjistruar në studimet Master.

Studentët boshnjakë nga rajoni i Mitrovicës kryesisht regjistrohen në Universitetin në gjuhën serbe në Mitrovicën e Veriut si dhe në Universitetin publik në Prizren. Në vitin 2022-2023, katër studentë boshnjakë janë regjistruar në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicën e Jugut, në programet e studimit në gjuhën shqipe.

Ndërveprimi ndërmjet nxënësve të shkollave të përziera që ndjekin kurrikulën e Kosovës në Prizren dhe Dragash është kryesisht pozitiv. Për shembull, nxënësit në këto shkolla të përziera përdorin të njëjtën derë hyrëse të shkollës, oborrin e shkollës dhe objektet e tjera shkollore dhe marrin pjesë në aktivitete të përbashkëta sportive dhe kulturore. Personeli mësimor në këto shkolla shfrytëzon të njëjtën sallë të arsimtarëve, gjë që ofron mundësi shtesë për komunikim dhe bashkëpunim. Një situatë e ngjashme është vërejtur në shkollat ndëretnike sipas sistemit të Kosovës në Deçan, Istog dhe Pejë. Ndryshe nga shembujt e mësipërm, edhe pse shkollat që funksionojnë në komunën e Dragashit sipas kurrikulës së Kosovës dhe të Serbisë, respektivisht, i shfrytëzojnë bashkërisht mjediset shkollore dhe këndet e lojërave apo objektet sportive, ndërveprimi ndërmjet fëmijëve nga komunitete të ndryshme është minimal, dhe mungojnë aktivitetet dhe iniciativat nga menaxhmenti i shkollës për t'i bashkuar ata.

Në Prishtinë, niveli i ndërveprimit ndërmjet studentëve boshnjakë dhe komuniteteve serbisht-folëse (siç janë serbët e Kosovës dhe romët e Kosovës) është përgjithësisht më i lartë se ai me komunitetet shqipfolëse. Në shkollat me kurrikula të ndara, niveli i ndërveprimit ndërmjet komuniteteve të ndryshme është më i ulët sepse procesi arsimor është i organizuar në ndërrime të ndryshme sipas kurrikulave të drejtuara nga Beogradi dhe Kosova.

Në Mitrovicën Jugore, nxënësit që mësojnë në gjuhën boshnjake në nivelet fillore dhe të mesme nuk janë fizikisht të ndarë nga bashkëmoshatarët e tyre që ndjekin mësimin në gjuhën shqipe. Kjo ka çuar në një nivel relativisht më të lartë të ndërveprimit mes nxënësve. Ndërveprimi mes nxënësve boshnjakë dhe serbë në shkollat me kurrikulë serbe në Leposaviq dhe Mitrovicë Veriore është i mirë dhe të gjithë nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, pa asnjë incident të raportuar.

³⁴ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë *Udhëzimi Administrativ 09/2016*; 2016.

7. Qasja në drejtësi

Numri i pjesëtarëve të komunitetit boshnjak të Kosovës të punësuar në institucionet jo-gjyqësore: Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV), Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) dhe Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) është shumë i ulët.

Një pjesëtare grua e komunitetit boshnjak është e punësuar në zyrën rajonale të ANJF-së në Mitrovicën Jugore. Nuk ka asnjë boshnjak të Kosovës të punësuar në IAP. Dy nga 33 të punësuar në ZMNV janë boshnjakë, të dyja gra (në zyrat rajonale në Prizren dhe Pejë). Për më tepër, nga 1,383 avokatë të licencuar që janë anëtarë të Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK), nëntë individë, duke përfshirë dy gra, janë boshnjakë.

Monitorimi i OSBE-së tregon se pjesëtarët e komunitetit boshnjak janë të vetëdijshëm në masë të caktuar për shërbimet që ofrohen nga ANJF, IAK dhe ZMNV. Megjithatë, niveli i vetëdijesimit në mesin e komunave ndryshon.

IAK (ndryshe nga ZMNV apo ANJF) zhvillon vizita të rregullta mujore dhe ad-hoc në terren³⁵ në komuna të ndryshme (edhe pse jo në rajonin e Prishtinës), duke i dhënë prani më të mirë se dy ofruesit e tjerë të shërbimeve ligjore.

Çdo tetor, ZMNV-ja, nën patronatin e Zyrës së Kryeprokurorit dhe me mbështetjen e Ambasadës së SHBA-ve, organizon çdo vit "Javën e të Drejtave të Viktimave të Krimit". Përkundër disa fushatave informuese të zhvilluara nga institucione të ndryshme, duke përfshirë ZMNV-në, Ministrinë e Drejtësisë dhe OAK-në, dhe informacionin e ndarë me viktimat kur kërkojnë shërbime, të kuptuarit e programit të kompensimit të viktimave të krimit (KVK) është i kufizuar ose nuk ekziston fare.

Përveç zyrave të saj rajonale, njëra nga zyrat mobile të ANJF-së mbulon komunën e Dragashit, në rajonin e Prizrenit. Në vitin 2023, me mbështetjen e USAID-it, ANJF-ja ka shpërndarë fletushka dhe posterë në gjuhët angleze, shqipe, serbe dhe turke, si dhe në alfabetin e Brajlit. Në mënyrë të ngjashme, video klipet dhe postimet në rrjetet sociale gjatë Javës së Ndhmës Juridike Falas, me moton "Mbroni të drejtat tuaja", janë shpërndarë në gjuhët zyrtare shqipe dhe serbe.

Në vitet e kaluara, Avokati i Popullit ka organizuar disa aktivitete të përgjithshme informuese për promovimin e të drejtave të komuniteteve në përgjithësi, ku ishin ftuar pjesëtarë të komunitetit boshnjak të Kosovës.

³⁵ Ditët e hapura organizohen çdo muaj me qëllim të komunikimit të drejtpërdrejtë me pjesëtarët e komunitetit për sfida të ndryshme të drejtave të njeriut.

Megjithatë, kohët e fundit nuk ka pasur aktivitete informuese që synojnë drejtpërdrejt komunitetin.

Në rajonin e Prizrenit, secili nga këto tre institucione ka punonjës që flasin shumë gjuhë që mund të komunikojnë dhe ofrojnë shërbime në të gjitha gjuhët zyrtare, përkatësisht në gjuhën shqipe, serbe/boshnjake dhe turke. Megjithatë, jo të gjitha dokumentet e prodhuara nga këto institucione janë të disponueshme në gjuhët e komuniteteve ose përkthimi i tyre është vonuar. Një situatë e ngjashme vërehet në rajonin e Pejës, ku tre nga katër zyrtarë të Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave mund të komunikojnë në të dy gjuhët vendase, duke përfshirë edhe njërin që boshnjakishtën e ka gjuhë amtare. Sa herë që është e nevojshme, shërbimet e përkthimit dhe interpretimit janë në dispozicion ose për shkak të stafit shumëgjuhësh ose për shkak të përdorimit të shërbimeve të përkthimit të ofruara nga prokuroria themelore përkatëse në rastin e ZMNV-së.

Në lidhje me përfituesit e shërbimeve³⁶, në vitin 2023, ANJF-ja ka ofruar shërbime për 6,070 persona (përfshirë 2,883 gra), nga të cilët 73 ishin pjesëtarë të komunitetit boshnjak. Në vitin 2023, IAP-i ka pranuar gjithsej 1660 ankesa (1162 burra dhe 498 gra).³⁷ që përfshinin 4296 persona. Nga numri i përgjithshëm i ankesave, 23 sish janë paraqitur nga pjesëtarë të komunitetit boshnjak. ZMNV-ja ka trajtuar 2883 raste në vitin 2023, nga të cilat 97 viktima ishin boshnjakë, shumica gra.

Pjesëtarët e komunitetit janë të lirë të zgjedhin përfaqësuesit e tyre ligjorë. Mirëpo, në rastet e përfaqësimit sipas detyrës zyrtare në lëndët penale, OAK-u cakton avokatë sipas radhës së avokatëve të shënuar në evidencën e tyre, të cilët flasin rrjedhshëm gjuhën e komunitetit që përfaqësojnë apo pjesëtarëve të komunitetit përkatës.

Në vitin 2023, një gjyqtare boshnjake (grua) ka filluar punën si gjyqtare penale në Gjykatën Themelore të Pejës.

Të gjithë bashkëbiseduesit e intervistuar kanë deklaruar se pjesëtarët e komunitetit të tyre nuk përballen me diskriminim kur i qasen sistemit gjyqësor. Megjithatë, disa deklaruan se boshnjakët që nuk flasin shqip mund të përballen me pengesa në shfrytëzimin e sistemit ligjor. Disa thanë se tarifat gjyqësore dhe shpenzimet ligjore janë barrë e konsiderueshme financiare për disa pjesëtarë të komunitetit.³⁸ Sipas burimeve të shumta në rajonin e Pejës, shumica e zyrtarëve janë në gjendje të komunikojnë në të dy gjuhët vendore, ndërsa në rastet kur klientët kanë probleme gjuhësore, institucionet përkatëse (gjykata, prokuroria, ZMNV) kanë në dispozicion përkthyes/interpretë.

36 Intervistat dhe shkëmbimi me email me ZMNV, ANJF, IAP dhe OAK në dhjetor 2023 dhe janar 2024.

37 Raporti Vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit 2023.

38 Intervistat e realizuara me përfaqësues të komunitetit boshnjak në mbarë Kosovën, duke përfshirë pjesëtarët e komunitetit boshnjak që punojnë në nivelin komunal.

8. Përdorimi i gjuhës dhe mediat

Gjuha boshnjake është gjuhë zyrtare në komunat e Prizrenit dhe Dragashit, ndërsa është gjuhë në përdorim zyrtar në komunat e Istogut, Pejës dhe Mitrovicës së Veriut. Sigurimi i përkthimit dhe interpretimit, si dhe ofrimi i shërbimeve dhe dokumenteve komunale në gjuhën boshnjake janë të detyrueshme për ato komuna ku është gjuhë zyrtare, si dhe sipas kërkesës në komunat ku është gjuhë në përdorim zyrtar.

Në komunat ku komuniteti banon në numër të madh, boshnjakët përgjithësisht ndjehen të lirë të përdorin gjuhën e tyre në jetën publike dhe private. Në komunat ku banojnë në numra më të vegjël, si në Prishtinë, Gjakovë, ose në rajonin e Gjilanit, boshnjakët zgjedhin ta përdorin kryesisht gjuhën shqipe për ndërveprime në publik. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve më të moshuar të komunitetit nuk e flasin rrjedhshëm gjuhën shqipe, gjë që herë pas here e pengon komunikimin me institucionet dhe komunitetin shumicë. Megjithatë, në vitet e fundit, numri i pjesëtarëve të rinj të komunitetit boshnjak që flasin gjuhën shqipe është rritur, pjesërisht për shkak të rritjes së numrit të pjesëtarëve të komunitetit që janë regjistruar në universitetet publike në gjuhën shqipe.

Disponueshmëria e dokumenteve të shkruara dhe shërbimeve në të gjitha gjuhët zyrtare ndryshon nga rajoni në rajon. Raportimi i OSBE-së tregon se komunat e Prizrenit dhe Dragashit janë pjesërisht në përputhshmëri sa i përket përkthimit të dokumenteve zyrtare në gjuhën boshnjake, me rreth 70 për qind të përputhshmërisë së vendimeve dhe rregulloreve komunale. Në Pejë, përkthimi në serbisht bëhet vazhdimisht dhe përkthimi në gjuhën boshnjake bëhet sipas kërkesës. Komunat tjera ku banon komuniteti u gjet se ishin në përputhshmëri (mbi 80 për qind) me kërkesat për përkthim, kryesisht për shkak të dokumenteve dhe shërbimeve në dispozicion në gjuhën serbe. Megjithatë, në rajonin e Gjilanit, komuniteti më së shumti merr informacione publike në gjuhën shqipe dhe sipas kërkesës edhe në serbisht.

Lidhur me përmbajtjen në dispozicion në gjuhën boshnjake në faqet e internetit të komunave, gjendja nuk është në nivel të kënaqshëm, veçanërisht sa i takon lajmeve ditore komunale. Në Prizren, për shembull, mes majit dhe dhjetorit 2023, nga 611 artikuj lajmesh që janë ngarkuar në gjuhën shqipe në faqen e internetit të komunës, vetëm 91 janë përkthyer në gjuhën serbe dhe atë boshnjake. Përveç kësaj, në Prizren, përkthimi në gjuhën boshnjake gjatë takimeve zyrtare të kuvendit komunal ka qenë një problem i vazhdueshëm për shkak të mosfunksionimit të pajisjeve të përkthimit dhe/ose mungesës së përkthyesve.

Pavarësisht ankesave të vazhdueshme nga komuniteti turk dhe ai boshnjak, problemi mbetet i pazgjidhur. Për shkak të vonësive në marrjen e dokumenteve dhe shërbimeve në gjuhën boshnjake ose serbe, pjesëtarët e komunitetit nganjëherë përdorin gjuhën shqipe në komunikimin e tyre me administratën lokale për të shmangur procedurat më të gjata.

Në lidhje me informimin publik dhe shërbimet publike, komuniteti boshnjak i merr faturat e shërbimeve komunale, taksat e ndryshme dhe faturat për shërbimet publike në gjuhën serbe.

Shumica e shenjave të rrugëve janë të vendosura në gjuhën boshnjake në komunat e Prizrenit, Dragashit dhe Pejës. Megjithatë, vazhdojnë problemet me shenjat e dëmtuara, një problem ky që duhet të adresohet nga institucionet përkatëse komunale dhe qeveritare. Në Prizren, ku banon pjesa më e madhe e komunitetit boshnjak, informacioni është gjerësisht i disponueshëm në gjuhët serbe/boshnjake në spital dhe qendrat shëndetësore lokale, duke përfshirë atë që jepet nga personeli mjekësor dhe administrativ. E njëjta gjë vlen edhe për shërbimet dhe zyrat e tjera publike të komunës.

Pjesëtarët e komunitetit boshnjak kanë qasje në lajme në gjuhën boshnjake përmes mediave elektronike dhe të shkruara. Shërbimi i Transmetuesit Publik të Kosovës (RTK 1 dhe RTK 2) transmeton programe speciale të komuniteteve për komunitetet joshumicë, duke përfshirë edhe atë në gjuhën boshnjake. "Bošnjački Vidici" është një emision javor një orësh i komunitetit boshnjak i transmetuar të hënën në RTK 2, duke shfaqur dokumentarë, programe informative dhe intervista me pjesëtarë të komunitetit. Radio Kosova transmeton edhe një program në gjuhën boshnjake.

Mediat private funksionojnë edhe në nivelin komunal. Në rajonin e Prizrenit, për shembull, komuniteti ka qasje në tri radio stacione: "Radio Omega" dhe "Radio Astra" në Prizren, dhe "Radio Gora" në Dragash (transmeton si për komunitetin [boshnjak të Kosovës](#) ashtu edhe për atë goranë të Kosovës). Përveç kësaj, komuniteti ka qasje në portalet e internetit në gjuhën boshnjake "Info KS", "Balkan-Plus" nga Prizreni dhe "Gora Press" nga Dragashi, të cilat janë të qasshme për pjesëtarët e komunitetit në mbarë Kosovën.³⁹ Në vitin 2020, portali "Kosova.info" e ka hapur një rubrikë me informacione në gjuhën boshnjake dhe serbe. Në rajonin e Pejës, "Radio Peja" transmeton lajme ditore dhe një emision javor në gjuhën boshnjake. Përveç kësaj, pjesëtarët e komunitetit boshnjak i përdorin mediat në gjuhën serbe në Kosovë, si dhe mediat elektronike nga rajoni, si nga Serbia qendrore dhe Bosnja e Hercegovina.

Gjatë pandemisë COVID-19, komuniteti boshnjak ka marrë informacion kryesisht përmes RTK 1 dhe RTK 2 si dhe nga komuna. Në fillim të pandemisë, pjesëtarët e komunitetit nga Prizreni janë ankuar për mungesën e informacionit në dispozicion për COVID-19 në gjuhën boshnjake dhe serbe nga institucionet përkatëse, pas së cilës gjendja ishte përmirësuar. Komuna e Prizrenit kishte krijuar një faqe të internetit specifike për COVID-19, duke ofruar informacione bazë për simptomat, rekomandimet dhe shërbimet shëndetësore, e cila ishte e disponueshme edhe në gjuhën boshnjake.

³⁹ "Info KS" <https://www.info-ks.net/>; "Ballkan Plus" <https://www.balkanplus.net/>; "Gora Press" <http://www.gorapress.net/> (shikuar së fundi në dhjetor 2023).

9. Trashëgimia kulturore dhe fetare, liritë fetare

Komuniteti boshnjak është kryesisht myslimanë sunitë, dhe objektet fetare dhe kulturore janë të përbashkëta me komunitetet shqiptare dhe joshqiptare.

Pjesëtarët e komunitetit boshnjak marrin pjesë në ceremonitë fetare në xhamitë sunitë, pavarësisht se cili komunitet i menaxhon xhamitë apo gjuhës së imamëve. Për shembull, në fshatin Vitomiricë në Pejë, xhamia udhëhiqet nga një imam boshnjak. Të paktën dy xhami në qytetin e Prizrenit kanë imamë që flasin gjuhën boshnjake (njëra në një lagje me shumicë boshnjake, tjetra në një zonë etnikisht të përzier). Të gjitha xhamitë në fshatrat e rajonit të Gorës udhëhiqen nga imamë që flasin gjuhën boshnjake. Qyteti i Dragashit ka dy xhami, njëra me imam që flet boshnjakisht dhe tjetra me imam që flet shqip. Komuniteti feston 28 shtatorin e njohur zyrtarisht si Dita e Boshnjakëve, si dhe festat fetare myslimane. Komuniteti boshnjak në përgjithësi është i lirë të shprehë identitetin e tij kulturor, besimet fetare dhe zakonet.

10. Të drejtat pronësore

Në rajonin e Prizrenit, ka pasur probleme me qasjen në pronat në pronësi të pjesëtarëve të komunitetit boshnjak të Kosovës.

Nga viti 2006 e deri të paktën në vitin 2020, në fshatin Gornjasellë brenda zonës së mbrojtur të Prevallës në rajonin e Prizrenit, pjesëtarët e komunitetit boshnjak janë penguar që t'iu qasen livadheve të tyre tradicionale për shkak të urbanizimit ndërhyrës. Kështu, ata nuk kanë qenë në gjendje të vazhdojnë me punët e tyre bujqësore.

Në vitin 2022, dy boshnjakë në rajonin e Prizrenit kanë marrë vendime të legalizimit për pronat e tyre, duke zyrtarizuar në këtë mënyrë titujt e tyre të pronësisë në regjistrin kadastral.

11. Kthimi dhe riintegrimi

Mungesa e përgjithshme e mundësive ekonomike dhe vështirësitë e hasura për punësim janë pengesat kryesore për kthimin dhe riintegrimin e personave të zhvendosur boshnjakë. Një numër i panjohur i boshnjakëve janë detyruar të emigrojnë gjatë dhe pas konfliktit për shkak të shqetësimeve të sigurisë, mungesës së mundësive ekonomike dhe vështirësive për t'iu qasur punësimit. Kthimet kanë qenë të ulëta.

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë vlerëson se që nga viti 2011, 238 pjesëtarë të zhvendosur të komunitetit boshnjak janë kthyer vullnetarisht në shtëpitë e tyre të para konfliktit. Raporti i UNHCR-së gjithashtu tregon se nuk ka më boshnjakë të Kosovës të zhvendosur brenda vendit.⁴⁰

Të kthyerit boshnjakë kanë qenë në gjendje të rikthejnë posedimin e pronave pa vështirësi të mëdha, megjithëse janë raportuar incidente sigurie të lidhura me kontestet pronësore.⁴¹

Programi i financuar nga Bashkimi Evropian (BE) për Kthimin dhe Riintegrimin në Kosovë ka raportuar se rreth 28 njësi banimi nga gjithsej 665 që ishin ndërtuar ose rindërtuar, ishin planifikuar për të kthyerit boshnjakë dhe 24 persona (nga 528) janë përkrahur me projekte për gjenerimin e të ardhurave në kuadër të riintegritit dhe promovimit të të drejtave të komuniteteve.⁴² Në kuadër të programit, komuna e Prizrenit ka mbështetur kthimin e asistuar të individëve. Si rezultat, në vitin 2019 dhe 2021, në komunë janë miratuar disa kërkesa për ndërtim të shtëpive, ndërtimi i të cilave kishte nisur. Në vitin 2021, në komunën e Prizrenit janë zbatuar dy projekte në kuadër të Projektit për Kthim dhe Riintegrim në Kosovë dhe Stabilizim të Komunitetit të Këshillit Danez për Refugjatë. Këto iniciativa janë financuar nga Byroja e Shteteve të Bashkuara për Popullsinë, Refugjatët dhe Migracionin dhe janë mbështetur nga MKK-ja. Projektet përfshinin aktivitete që lidhen me riparime të vogla të shtëpive, grante për gjenerimin e të ardhurave - kryesisht në bujqësi, duke përfshirë bletarinë - krahas sigurimit të pajisjeve të distilimit dhe trajnimit për institucionet e përfshira në përpjekjet e kthimit. Megjithatë, numri i kërkesave nga pjesëtarët e komunitetit boshnjak është i ulët në krahasim me përfituesit serbë të Kosovës.

40 UNHCR, Zyra e Shefit të Misionit në Prishtinë, *Vështrim statistikor* (dhjetor 2023). Në vitin 2015, numri i të kthyerve në 18 komuna: Pejë nëntë, Istog pesë, Prizren tre dhe Mitrovicë Jugore një. Në vitin 2016, numri i të kthyerve ishte 11, Pejë tetë, Prizren dy dhe Mitrovicë Jugore një. Në vitin 2017, numri i të kthyerve ishte dy, të dy në Mitrovicën Jugore. Në vitin 2018, numri i të kthyerve ishte dhjetë, Istog gjashtë dhe Mitrovicë katër. Nga viti 2019 deri në vitin 2023, UNHCR ka regjistruar katër kthime, tre në Pejë dhe një në Mitrovicë nga komuniteti boshnjak i Kosovës.

41 UNHCR, Zyra e Shefit të Misionit në Prishtinë, *Vështrim statistikor* (dhjetor 2019), pjesa 10, "Të drejtat pronësore".

42 Të dhënat e siguruar nga Zyra e IOM-it në Kosovë, Projekti i BE-së për Kthimin dhe Riintegrimin në Kosovë; numri i njësisve banesore të ndërtuara apo të rindërtuara në Prizren ishte 18, Novobërdë tre, Pejë tre, Obiliq dy dhe nga një njësi banesore në komunat e Shtërpçës dhe Istogut. Numri i projekteve për gjenerim të të ardhurave në Prizren ishte 13, Novobërdë tre, Obiliq dy, Pejë dy, dhe nga një në komunat e Shtërpçës dhe Istogut.

Në komunën e Dragashit ka pasur mungesë të fondeve institucionale për asistencë në kthim për vite me radhë, përkundër kërkesave të shumta. Edhe pse 28 persona janë kthyer në Dragash ndërmjet viteve 2015 dhe 2019, të dhënat nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) tregojnë se asnjë nga individët e kthyer nuk ka përfituar nga pakoja e ndihmës.⁴³ Ndonëse mund të ndodhë që jo të gjithë të kthyerit të kenë nevojë për ndërtim ose rindërtim të shtëpive, shumica e të kthyerve përballen me vështirësi ekonomike dhe do të kishin përfituar nga ndihma për gjenerimin e të ardhurave. Dragashi nuk është përfshirë asnjëherë në ndonjë projekt për kthimin dhe riintegrimin në Kosovë, duke i bërë shumë pjesëtarë nga radhët e komunitetit boshnjak të pretendojnë se MKK-ja dhe BE-ja u kanë dhënë prioritet të kthyerve serbë dhe i kanë përjashtuar komunitetet më të vogla nga përfitimi nga ndihma për kthim në kuadër të këtyre projekteve. Autoritetet komunale kanë treguar se pengesa kryesore për kthimin e qëndrueshëm në komunën e Dragashit është mungesa e mundësive të punësimit.

Megjithatë, në vitin 2023, MKK-ja ka ndërmarrë një hap të rëndësishëm duke lëshuar një thirrje për të ofruar ndihmë esenciale për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë.⁴⁴ Nisma synonte të adresonte nevoja të ndryshme, duke përfshirë sigurimin e artikujve ushqimorë dhe jo ushqimorë, si dhe mbështetjen për ndërtimin dhe rindërtimin e shtëpive. Për më tepër, Ministria e ka zgjeruar shtrirjen e saj për të forcuar sektorin e bujqësisë, duke ofruar subvencione për të lehtësuar praktikat e qëndrueshme bujqësore. Njëkohësisht, ka pasur një përpjekje të posaçme për t'i mbështetur bizneset e vogla brenda këtyre komuniteteve. Ndikimi i këtyre përpjekjeve ka qenë i prekshëm, pasi Ministria ka mbështetur me sukses 27 familje boshnjake, duke u ofruar atyre artikuj të rëndësishëm, përfshirë materiale të ndërtimit. Vlen të theksohet që iniciativa ka rezultuar me ndërtimin e dy shtëpive, një në Istog dhe një në Prizren. Gjithashtu, iniciativat me ndikim të Ministrisë janë shtrirë në ofrimin e mbështetjes substanciale për 20 familje, në shumën prej 222,830 euro. Kjo ndihmë financiare është dhënë në drejtim të promovimit të zhvillimit në sektorin e bujqësisë ose mbështetjen e bizneseve të vogla. Konkretisht, nga kjo iniciativë kanë përfituar 19 familje të vendosura në Prizren dhe një në Istog.⁴⁵

Përveç komunave të Prizrenit dhe Dragashit, nuk janë vërejtur sfida apo zhvillime të mëdha lidhur me kthimin dhe riintegrimin e boshnjakëve në komunat tjera.

43 Të dhënat janë siguruar nga Zyra e IOM-it në Kosovë, projekti i BE-së për Kthimin dhe Riintegrimin në Kosovë.

44 Vendimi për krijimin e procedurave për ofrimin e ndihmës nga Ministria për Komunitete dhe Kthim për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, i nxjerrë më 2 shkurt 2023: [Vendim i procedurave për ofrimin e ndihmës- Odluka o proceduri pruženja pomoci compressed compressed-compressed \(1\).pdf \(rks-gov.net\)](#), (shikuar së fundi në dhjetor 2023).

45 Të dhënat janë ndarë me Misionin e OSBE-së në Kosovë nga Ministria për Komunitete dhe Kthim më 6 shkurt 2024.



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Photo Credit: Yllka Fetahaj

Profili i komunitetit

kroat të Kosovës

osbe

Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Profili i komunitetit kroat të Kosovës

Ndonëse Kushtetuta e Kosovës nuk i klasifikon kroatët e Kosovës si komunitet i veçantë, ata konsiderohen si një nga komunitetet e përfaqësuar në Kosovë sipas Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve.¹

Popullsia e kroatëve të Kosovës është zvogëluar jashtëzakonisht shumë gjatë 30 viteve të fundit. Sipas regjistrimit të popullsisë në Jugosllavi në vitin 1981, asokohe në Kosovë jetonin 8718 kroatë (0.6 përqind). Nga ajo kohë, ky numër ka rënë ndjeshëm. Ky komunitet nuk ishte përfshirë në regjistrimin e vitit 2011.² Sipas raportimit të OSBE-së, numri i kroatëve të Kosovës që banojnë në Kosovë është afërsisht 260 (0.01 për qind), duke e bërë atë komunitetin më të vogël në Kosovë.³ Sidoqoftë, Zyra kroate për kroatët jashtë vendit kishte përlllogaritur më 2013 që ishin 350 kroatë të Kosovës që jetonin në Kosovë.⁴

Komuniteti kroat i Kosovës nuk është shumicë në asnjë vend të Kosovës. Shumica e popullatës kroate të Kosovës banon në komunën e Lipjanit në rajonin e Prishtinës, si dhe në komunën e Vitisë në rajonin e Gjilanit. Sipas raportit të OSBE-së, rreth 21 kroatë të Kosovës banojnë në komunën e Vitisë, konkretisht në fshatrat Letnicë (17), Vërnakollë (dy), dhe Vërnez (një), si dhe në qytetin e Vitisë (një). Ky komunitet përbëhet kryesisht nga persona mbi moshën 40 vjeç, ndërsa nëntë janë të moshës 65 vjeç apo më shumë.⁵

Në komunën e Lipjanit, 0.37 për qind e popullsisë në komunë janë kroatë të Kosovës, të cilët banojnë kryesisht në fshatin Janjevë.⁶ Afërsisht 50 për qind e pjesëtarëve të komunitetit janë larguar nga fshati për në Kroaci, ndërsa afërsisht 150 kroatë të Kosovës jetojnë aktualisht në Janjevë.

¹ Ligji Nr. 04/L-020 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë, i cili i përkufizon komunitetet si grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore ose fetare, tradicionalisht të pranishme në Kosovë, e që nuk janë shumicë.

² Gëzim Visoka dhe Elvin Gjevori, "Politika e regjistrimeve dhe etnitë në Ballkanin Perëndimor," *Politika e Evropës Lindore*, 29 (4), 2013, fq. 479–498.

³ OSBE, *Profillet komunale 2018*.

⁴ Zyra për kroatët jashtë vendit, "Statusi i pakicave kroate jashtë vendit" (2013). (Shikuar për herë të fundit në dhjetor 2023.)

⁵ Nga viti 2018 – 2019, rreth 40 pjesëtarë të këtij komuniteti kanë banuar në komunën e Vitisë, konkretisht në fshatrat Letnicë, Shashar, Vërnakollë dhe Vërnez. Megjithatë, gjatë viteve 2019 – 2023, përafërsisht 20 të moshuar kroatë të Kosovës kanë ndërruar jetë për shkak të pleqërisë dhe/ose sëmundjeve. Tani, vetëm 21 burra dhe gra kroate të Kosovës jetojnë në komunën e Vitisë.

⁶ OSBE, *Profillet komunale 2018*.

Faktet dhe çështjet kryesore

- Vjedhjet në shtëpi të pabanuara janë incidentet më të shpeshta të sigurisë që shqetësojnë këtë komunitet.
- Komuniteti [kroat i Kosovës](#) nuk ka ulëse të rezervuara në Kuvendin e Kosovës.
- Problemet e mëdha me kushtet e banimit, furnizimin me ujë të pijshëm, sistemet e kanalizimit dhe menaxhimin e mbeturinave prekin fshatrat e banuara nga [kroatët e Kosovës](#).
- Një pjesë e konsiderueshme e komunitetit [kroat të Kosovës](#) janë të moshuar dhe varen nga pensionet dhe/ose asistenca sociale e ofruar nga Prishtina, Beogradi dhe/ose Zagrebi.⁷
- [Kroatët e Kosovës](#) ndjekin planprogramin serb, pasi arsimi në gjuhën kroate nuk është i disponueshëm në Kosovë. Lëndët specifike të komunitetit përmes së cilave [Kroatët e Kosovës](#) do të mësonin për identitetin dhe kulturën e tyre gjithashtu nuk janë të disponueshme.
- Komuniteti [kroat i Kosovës](#) ka përjetuar valë të mëdha migrimi gjatë 30 viteve të fundit.

⁷ Zyra për kroatët jashtë vendit, *Statusi i pakicave kroate*.

1. Siguria dhe rendi

Përgjithësisht, gjendja e sigurisë e kroatëve të Kosovës është e qëndrueshme, me incidente të herëpashershme të vjedhjeve dhe plaçkitjeve të viktimave të gjinisë femërore në Janjevë dhe Letnicë.^{8,9}

Së paku nga viti 2016, një seri incidentesh të sigurisë janë raportuar në fshatin Janjevë (Komuna e Lipjanit).¹⁰ Në shkurt 2019, pas një numri të shtuar të incidenteve të pazgjidhura, Avokati i Popullit filloi hetimin sipas detyrës zyrtare në lidhje me sigurinë e kroatëve të Kosovës dhe pronës së tyre në fshatin Janjevë. Paralelisht, komuniteti kroat i Kosovës nga fshati i dërgoi një letër të hapur Avokatit të Popullit për të tërhequr vëmendjen rreth situatës së sigurisë. Letra, e nënshkruar nga 115 pjesëtarë të komunitetit kroat të Kosovës, pretendonte se Policia e Kosovës ishte joefektive dhe e paaftë për të zgjidhur çështjen e lartpërmendur.

Në shtator 2019, pas hetimit të ngjarjeve dhe mbledhjes së informacioneve në terren, Institucioni i Avokatit të Popullit iu drejtua me një letër Policisë së Kosovës, duke i rekomanduar që të rriste numrin e policëve në Janjevë për të reaguar përshtatshëm ndaj incidenteve dhe për parandalimin e tyre.¹¹ Më pas, në tetor 2019, u raportua për një zjarr në tri shtëpi të pabanuara që u përkisnin pjesëtarëve të komunitetit kroat të Kosovës.¹² Në nëntor 2019, një përfaqësues i Janjevës informoi Institucionin e Avokatit të Popullit se patrullimet ishin shtuar dhe gjendja e sigurisë atje ishte përmirësuar. Megjithatë, në shkurt të vitit 2020 dhe në dhjetor të vitit 2021, në fshat u raportuan sërish zjarre në një shtëpi të pabanuar të një kroati të Kosovës.¹³

8 Sipas monitorimit të brendshëm të OSBE-së, ka pasur tre incidente në vitin 2013, dy në 2014, asnjë në 2015, dy në 2016, asnjë në 2017, gjashtë në 2018, gjashtë në 2019, tetë në 2020, gjashtë në 2021, tre në 2022 dhe dy në vitin 2023.

9 Në maj 2020, gra kroate të Kosovës ishin viktime të vjedhjeve dhe plaçkitjeve në dy incidente: në fshatin Janjevë, dikush hyri në shtëpinë e një nëne beqare kroate të Kosovës dhe vodhi shumë sende me vlerë, ndërsa në qershor 2021, një grua kroate e Kosovës ishte viktimë e abuzimit verbal dhe sulmit fizik nga një fqinj, shqiptar nga Maqedonia e Veriut, në fshatin Letnicë. Në dhjetor 2022, e njëjta grua ishte kërcënuar dhe fyer nga i njëjti fqinj.

10 Në janar të vitit 2016, Policia e Kosovës raportoi se dy mjete ndezëse ishin hedhur në oborrin e shtëpisë së një kroati të Kosovës. Në maj të vitit 2018, një kryq 2.5 metra i lartë u hoq nga shtylla, ndërsa një statujë e Shën-Mërisë ishte dëmtuar. Është raportuar gjithashtu se një grup prej 10 deri në 15 motoçiklistësh vinin nga Prishtina çdo fundjavë dhe vozitnin në mënyrë të pakujdesshme në rrugët e Janjevës, duke ngacmuar verbalisht njerëzit në gjuhën shqipe. Në tetor të vitit 2020, një çift i moshuar kroat i Kosovës u largua nga fshati për në Kroaci pas një sulmi të rëndë fizik gjatë një grabitjeje.

11 Që nga 16 korriku 2020, në nënstacionin e Janjevës punonin 11 policë të Policisë së Kosovës, përfshirë komandantin. Për shkak të pandemisë COVID-19, Policia e Kosovës ka tërhequr përkohësisht personelin plotësues që zakonisht patrullonte në këtë fshat, pasi siç pohonte policia, ishin të zënë me kontrollin e masave shëndetësore dhe disa pjesëtarë të policisë ishin të infektuar me COVID-19.

12 Në shkurt të vitit 2016, në të njëjtin fshat ishte djegur një shtëpi e pabanuar e një kroati të Kosovës, që nuk jetonte në Kosovë. Në qershor 2018, një tjetër shtëpi e pabanuar e një kroati të Kosovës u përfshi në zjarr, ndërsa rasti është klasifikuar si zjarrvënie. Gjithashtu, në shkurt të vitit 2020 në Janjevë, një shtëpi e pabanuar në pronësi të një kroati të Kosovës mori flakë për arsye të panjohura.

13 Bazuar në monitorimin e Misionit të OSBE-së. Jashtë periudhës raportuese, në mars të vitit 2024, kamerat vëzhguese u instaluan në Janjevë, me mbështetjen e Misionit, si përgjigje ndaj një kërkesë të kahershme nga komuniteti kroat i Kosovës atje.

Deri në vitin 2019 ishin tre pjesëtarë të komunitetit [kroat të Kosovës](#) të punësuar në Policinë e Kosovës. Më pas, ky numër u zvogëluar dhe aktualisht është vetëm një zyrtarë e Policisë së Kosovës, e cila shërben në nënstacionin e Policisë së Kosovës në Janjevë, në komunën e Lipjanit.

Një grua [kroate e Kosovës](#) është anëtare e Komitetit Lokal për Siguri Publike (KLSP) në Janjevë.¹⁴

Pjesëtarët e komunitetit [kroat të Kosovës](#) në Janjevë përfaqësohen nga Don Mate Paliq, famullitar i kishës katolike Shën Nikolla që nga viti 1997, dhe prift në të njëjtin fshat që nga viti 1990.¹⁵ Përveç kryerjes së detyrave fetare për famullinë e tij, Don Mate Paliq organizon edhe ngjarje kulturore. Ai përfaqëson komunitetin katolik në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) të Lipjanit.

14 Që nga nëntori 2023.

15 Historia gojore e Kosovës, [Don Matej Paliq](#) (Gusht 2019). (Shikuar për herë të fundit në dhjetor 2023.)

2. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi

Si në qeverinë e formuar në 2021, ashtu edhe në ato të mëparshmet nuk ka pasur ministra e as zëvendësministra nga komuniteti kroat i Kosovës. Komuniteti nuk ka ulëse të rezervuara në Kuvend, por nuk ka as pjesëtarë të komunitetit kroat të Kosovës në Kuvend.

Komuniteti kroat i Kosovës ka dy ulëse të rezervuara në Këshillin Konsultativ për Komunitete. Ulëset aktualisht mbahen nga dy anëtarë që përfaqësojnë organizatën joqeveritare (OJQ) Hrvatska Udruga Sveti Nikola (Shoqata Kroate Shën Nikolla), një burrë dhe një grua.

Që nga viti 2017, pjesëtarët e komunitetit përbënin 0.06 për qind të shërbimit civil në nivel qeveritar.¹⁶

Komuniteti përfaqësohet në komitetet për komunitete (KK) në dy komunat ku banojnë shumica e kroatëve të Kosovës : Lipjan dhe Viti.¹⁷ Nga ky komunitet nuk ka nënkryetar për komunitete, e as nënkryetarë të kuvendit komunal për komunitete. Kroatët e Kosovës nuk janë të përfaqësuar as në Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK).

Në KKSB ka dy pjesëtarë të komunitetit kroat të Kosovës: një burrë në komunën e Vitisë dhe një tjetër në atë të Lipjanit.

¹⁶ OSBE, *Përfaqësimi i komuniteteve në shërbimin civil në Kosovë* (2017) 2016. Përfaqësimi në shërbimin civil në nivel komunal nuk mund të përlogaritet për komunitetin kroat të Kosovës, pasi nuk ishte përfshirë si komunitet i veçantë në Regjistrimin e vitit 2011.

¹⁷ Të dy pjesëtarët kroatë të Kosovës në Komitet për Komunitete janë gra. Vlen të përmendet se anëtari i Komitetit që është kroat i Kosovës në Lipjan emigroi në Kroaci në mesin e vitit 2023. Deri në dhjetor të vitit 2023, nominimi i anëtarit të ri nuk ishte miratuar zyrtarisht nga MAPL-ja.

3. Punësimi dhe gjendja socio-ekonomike

Komuniteti kroat i Kosovës në përgjithësi ndan të njëjtat shqetësime socio-ekonomike me komunitetet e tjera në Kosovë. Megjithatë, gjendja e komunitetit rëndohet më shumë nga barrierat gjuhësore, por edhe nga fuqia punëtore shumë e kufizuar në rradhët e tyre për shkak të moshës së shtyrë të pjesëtarëve të komunitetit kroat të Kosovës. Shumë kroatë të Kosovës jetojnë në kushte jashtëzakonisht të këqija, me banim dhe infrastrukturë të papërshtatshme.

Nuk ka të dhëna të besueshme për shkallën e papunësisë në mesin e komunitetit kroat të Kosovës. Në vitin 2018, vetëm 0.1 për qind e kroatëve të Kosovës ishin të regjistruar si të papunë. Për këtë komunitet nuk janë realizuar as ndërmjetësime për punësim e as trajnime profesionale.¹⁸ Meqë shumica e pjesëtarëve të komunitetit ishin të moshuar dhe vetëm 10 për qind nga rradhët e tyre ishin në gjendje të punonin, gjenerimi i të ardhurave për komunitetin kroat të Kosovës në komunën e Vitisë ishte i vogël. Shumica janë të angazhuar në biznese të vogla familjare dhe në aktivitete bujqësore për mbijetesë.¹⁹

Kroatët e Kosovës kanë përfaqësim të barabartë gjinor në shërbimin civil dhe mbajnë pozita përgjithësisht të nivelit profesional; megjithatë, përfaqësimi i tyre në numër është shumë i ulët.

Në rajonin e Prishtinës, tetë kroatë të Kosovës janë të punësuar në sektorin publik, kryesisht në arsim në komunën e Lipjanit. Në shkollën fillore Vladimir Nazor në Janjevë, zëvendësudrejtori, katër arsimtarë dhe një punëtor ndihmës janë kroatë të Kosovës.²⁰ Një kroate e Kosovës punon si infermiere në klinikën shëndetësore të një fshati, ndërsa një tjetër kroate e Kosovës punon si nëpunëse shkolle në komunën e Vitisë.

Në të dy rajonet, Gjilan dhe Prishtinë, Kroatët e Kosovës në përgjithësi janë në moshë të shtyrë dhe varen nga të ardhurat nga pensionet. Nuk ka ndonjë të dhënë se ky komunitet angazhohet në ekonomi informale. Në Viti, Kroatët e Kosovës varen gjithashtu nga shujtat ditore pa pagesë që financohen nga Ambasada Kroate në Prishtinë, të përgatitura nga qendra komunitare dhe restoranti "Dubrovnik" dhe Kisha Katolike.²¹ Restoranti në fjalë është pronë e një familjeje kroate të Kosovës, që siguron vetëpunësim për tre anëtarë të familjes. Restoranti në Letnicë është i vetmi biznes i regjistruar privatisht, ku anëtarët e një familjeje kroate të Kosovës janë të vetëpunësuar.

18 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Puna dhe Punësimi në Kosovë, *Raporti Vjetor 2018*, fq. 19, 34 dhe 41. Nuk disponohet në anglisht.

19 OSBE, *Kroatët e Kosovës të Komunës së Vitisë: Një komunitet i cenueshëm* (2011), fq. 4.

20 Kjo shkollë fillore ofron arsim që ndjek si kurrikulën në gjuhën serbe, ashtu edhe kurrikulën e Kosovës.

21 Katër kroatë të Kosovës shfrytëzojnë kuzhinën e Kishës Katolike.

Komuniteti **kroat i Kosovës** ka përjetuar disa valë migrimi gjatë 30 viteve të fundit. Sipas përfaqësuesve të komunitetit në Janjevë, shumë pjesëtarë të komunitetit **kroat të Kosovës** janë shpërngulur në Kroaci gjatë viteve 1980 dhe 1990, duke e ulur numrin e qytetarëve të këtij komuniteti në mënyrë të ndjeshme. Vala më e konsiderueshme e migrimit ndodhi gjatë dhe pas konfliktit të vitit 1999. Ata që qëndruan në komunat Viti dhe Lipjan kanë vënë rrënjë të forta në Kosovë dhe nuk kanë ndërmend të zhvendosen në Kroaci. Vlen të përmendet se shumica përfitojnë nga skemat kroate të ndihmës sociale.

Ekziston një trend në mesin e të rinjve **kroatë të Kosovës** që të udhëtojnë çdo vit për në Kroaci për punë sezonale. Ashtu siç raportohet, disa mijëra pjesëtarë të komunitetit **kroat të Kosovës** kanë emigruar gjatë viteve 1999 – 2002 nga Kosova, kryesisht në Kroaci. Megjithatë, disa pjesëtarë të komunitetit zgjedhën të qëndronin, edhe pse fëmijët dhe nipërit e tyre ishin larguar. Që atëherë, shumë nga këta pjesëtarë të moshuar të komunitetit janë ftuar nga familjet e tyre të gjera të emigrojnë në Kroaci dhe vendet e Bashkimit Evropian, por ata nuk janë të interesuar që të largohen nga shtëpitë e tyre në Kosovë.²²

22 ZKKK

4. Qasja në infrastrukturë dhe shërbime publike

Pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës kryesisht banojnë në zonat rurale të komunës së Vitisë dhe të Lipjanit. Pjesëtarët e këtij komuniteti kanë gjendjen më të rënduar në mesin e komuniteteve sa i përket qasjes së tyre të kufizuar në infrastrukturë dhe shërbime publike, që është faktor kontribues në situatën e tyre përgjithësisht të varfër socio-ekonomike dhe të zonave të thella në të cilat jetojnë shumë prej tyre.

Kushtet e papërshtatshme të banimit dhe mungesa e një sistemi funksional të furnizimit me ujë të pijshëm mbeten ndër çështjet më urgjente. Përveç kësaj, grumbullimi i mbeturinave dhe mungesa e sistemeve të rregullta të kanalizimit janë gjithashtu ndër çështjet e ngritura nga [Kroatët e Kosovës](#) në komunat e Vitisë dhe Lipjanit.

Në rajonin e Gjilanit, në fshatin Letnicë, uji ka kohë që nuk është i pijshëm. Ujësjellësi është ndërtuar gati katër dekada më parë dhe është mirëmbajtur dobët, kështu që ujësjellësit i mungon shtypja dhe kapaciteti i mjaftueshëm. Sipas një vlerësimi të bërë në vitin 2007 nga ndërmarrja rajonale e shërbimeve publike "Hidromorava", sistemi i ujësjellësit do të duhej ndërruar plotësisht. Së voni, komuna ka ndërmarrë hapa për përmirësimin e kësaj gjendjeje. Një projekt për përmirësimin e sistemit të ujësjellësit, bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Qeveria e Kosovës dhe Komuna e Vitisë, filloi në fund të vitit 2019 dhe u finalizua në nëntor të vitit 2020.²³ Fatkeqësisht, në gusht të vitit 2023, një pjesëtar i komunitetit [kroat të Kosovës](#) raportoi se prurja e ujit nga rrjeti i ri i ujësjellësit ishte e ndotur për shkak të reshjeve të mëdha dhe rrjedhës së ujërave nëntokësore dhe për këtë arsye uji nuk ishte i pijshëm. Ndërmarrja publike e ujësjellësit "Hidromorava" deklaroi se problemi nuk mund të rregullohej me që rrjeti i ujësjellësit nuk ishte i pajisur me filtër për pastrimin e menjëhershëm të ujit të ndotur.

Grumbullimi i mbeturinave dhe mungesa e një sistemi të rregullt të kanalizimit janë gjithashtu ndër çështjet e ngritura nga [Kroatët e Kosovës](#) në komunat e Vitisë dhe Lipjanit. Në gusht të vitit 2020, pas avokimit nga OSBE, u arrit një marrëveshje për përfshirjen e fshatit Letnicë në sistemin e grumbullimit të mbeturinave komunale. Komuna ka instaluar katër kontejnerë për grumbullimin e mbeturinave në fshat dhe tani mbeturinat grumbullohen në baza javore. Përfaqësuesit e fshatit ranë dakord të paguanin tarifën e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, ndërsa restoranti "Dubrovnik" dhe prifti i kishës katolike u angazhuan të paguajnë për ato familje që nuk mund të përballonin tarifën.

23 OSBE, Raporti i brendshëm ditor i komunës: Komuna e Vitisë (9 gusht 2019).

Qindra prona të pambikëqyrura janë lënë pas nga [kroatët e Kosovës](#), të cilët kanë jetuar në rajonin e Gjilanit deri në vitin 1999. Shumë banorë të moshuar jetojnë në shtëpi në gjendje të mjeruar, shpesh pa kuzhina e banjo. Një numër i konsiderueshëm i shtëpive përdoren si hapësira magazinimi, madje disa janë marrë nga shqiptarët që kanë migruar nga Maqedonia e Veriut. Parcelat e tokës janë braktisur e lënë pas dore, shpesh mbuluar me bimësi.²⁴ Furnizimi me energji elektrike thuhet se është gjithashtu i dobët, me reduktime të zgjatura të energjisë, edhe në Qendrën shëndetësore në Letnicë. Ndërprerjet e energjisë elektrike regjistrohen shpesh, veçanërisht gjatë dimrit. Në prill të vitit 2023, një ndërprerje e tillë në Letnicë zgjati tri ditë, para se Shërbimi i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike të Kosovës (KEDS) të fillonte riparimin e shtyllës së rrëzuar elektrike. Ndriçimi rrugor është i disponueshëm vetëm në zonat kryesore të fshatit Letnicë, duke e bërë të rrezikshëm udhëtimin në rrugët rurale. Ndriçimi ekzistues rrugor i është nënshtruar dëmtimeve dhe periudhave të mosfunksionimit. Pjesëtarët e komunitetit [kroat të Kosovës](#) po ashtu përballen me vështirësi në qasjen në varrezat e tyre, për shkak të gjendjes së keqe ose mungesës së rrugëve ndërlidhëse dhe trotuareve.²⁵

Në rajonin e Prishtinës, ofrimi i shërbimeve publike, duke përfshirë ujësjellësin, sistemin e kanalizimit dhe menaxhimin e mbeturinave, është i dobët për të gjitha komunitetet që banojnë në zonë. Rrjedhjet e shpeshta dhe vërshimet si pasojë e tyre ndodhin sidomos në dimër, por për këtë ende nuk është gjetur ndonjë zgjidhje e përhershme. [Kroatët e Kosovës](#) dhe komunitetet tjera që jetojnë në fshatin Janjevë i kanë bërë thirrje komunës së Lipjanit, disa herë, që ta zgjidhë këtë çështje. Edhe pse komuna ka ndihmuar në përmirësimin e infrastrukturës së fshatit dhe mirëmbajtja e pompave të ujit është përmirësuar, reduktimet e gjata të ujit vazhdojnë të jetë problem. Gjithashtu në Janjevë, faturat e papaguara të energjisë elektrike kanë çuar në ndërprerje të zgjatura të furnizimit me energji elektrike; megjithatë, situata është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme që nga viti 2018. Ndriçimi rrugor është i disponueshëm në shumicën e pjesëve të fshatit, ndërsa mungesa e trotuareve mbetet problem për sigurinë e këmbësorëve. Sipas përfaqësuesit të komunitetit [kroat të Kosovës](#), furnizimi me ujë është përmirësuar dukshëm kohëve të fundit, ndërsa mungesa e linjës direkte për dhe nga Prishtina paraqet sfidë për pjesëtarët e të gjitha komuniteteve.

24 OSBE, *Kroatët e Kosovës të Komunës së Vitisë: Një komunitet i cenueshëm* (2011), fq. 4.

25 Varrezat që përdoren nga kroatët e Kosovës gjenden në Letnicë, Shashar dhe Vërnakollë.

5. Qasja në shërbime sociale, duke përfshirë shërbimet e kujdesit shëndetsor

Një pjesë e konsiderueshme e komunitetit kroat të Kosovës janë të moshuar dhe varen nga ndihma sociale që ofrohet nga Prishtina, Beogradi dhe/ose Zagrebi.²⁶ Sipas Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në vitin 2018, 16 familje kroate të Kosovës (41 individë) ishin kualifikuar për ndihmë sociale.²⁷

Që nga dhjetori 2023, sipas drejtorit komunal të Qendrës komunale për Punë Sociale në Viti, tre kroatë të Kosovës marrin ndihmë mujore sociale, nëntë marrin pensione mujore (që do të thotë të gjithë Kroatët e Kosovës të moshës 65 e lart që jetojnë në rajonin e Gjilanit), ndërsa gjashtë pjesëtarët e mbetur të komunitetit kroat të Kosovës të cilët janë nën moshën 65 vjeç zakonisht marrin mbështetje financiare nga familjet që jetojnë jashtë vendit.²⁸

Për shkak se shumë kroatë të Kosovës janë të moshuar dhe jetojnë në zona të izoluara dhe rurale, shpenzimet për qasje në shërbime mjekësore dhe terapi përbëjnë pengesë të konsiderueshme për komunitetin, pasi atyre do t'u duhej të udhëtonin në distanca të gjata deri në objektin më të afërt shëndetësor, ndërsa transporti publik nuk është i disponueshëm (siç është raportuar ngjashëm në raportin e OSBE-së të vitit 2011).²⁹ Mungesa e qasjes në shërbime shëndetësore përkeqësohet më tej nga pamundësia e shumë pjesëtarëve të komunitetit për të paguar transportin privat dhe koston e barnave. Ndihma sociale nuk mjafton për të mbuluar këto shpenzime. Në rajonin e Gjilanit, OSBE-ja ka vërejtur se komuniteti vazhdon të përballet me probleme në qasjen në shërbimet e kujdesit shëndetësor, por ka shënuar përmirësime që nga viti 2019.³⁰

Qendra e kujdesit shëndetësor në fshatin Letnicë ka personel të rregullt gjatë ditëve të javës, me një infermiere nga Kisha Katolike që paguhet nga komuna e Vitisë. Një herë në javë, një mjek nga spitali i Vitisë e viziton klinikën. Këto shërbime ishin ndërprerë për shkak të mungesës së përgjithshme të personelit mjekësor në vitet 2020 – 2021, gjatë pandemisë COVID-19, por që atëherë kanë rifilluar.

Në vitin 2023, komuna ndau 30 vaksina të gripit sezonal për të moshuarit kroatë të Kosovës në Letnicë.³¹

26 Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave në Kosovë, "Profili i komunitetit: Komuniteti Kroat" (2013). (Shikuar për herë të fundit në dhjetor 2023.)

27 Shih Institucionin e Avokatit të Popullit, *Raporti Vjetor 2018*, f. 100.

28 Qendra për Punë Sociale. Të dhënat e ndara për komunitete, që do të shfaqnin numrin e kroatëve të Kosovës që marrin pension dhe/ose pagesa për aftësi të kufizuara, nuk janë të disponueshme.

29 OSBE, *Kroatët e Kosovës të Komunës së Vitisë*, fq. 5.

30 Po aty.

31 Qendra shëndetësore e Vitisë, më 16 dhjetor 2023.

Meqenëse të moshuarit kishin vështirësi të siguronin transportin për në qendrën e kujdesit shëndetësor në Viti, një murgeshë nga Kisha Katolike e Letnicës doli vullnetare për të ndihmuar me vaksinimin e tyre. Si rezultat, në Letnicë u vaksinuan 18 të moshuar kroatë të Kosovës. Qendra e kujdesit shëndetësor theksoi se do të siguronin më shumë vaksina, sipas nevojës. Çështja e vaksinimit të të moshuarve [kroatë të Kosovës](#) fillimisht u ngrit nga OSBE-ja së bashku me zyrtarin komunal për barazi gjinore, ndërsa më vonë u mor përsipër nga autoritetet lokale shëndetësore.

Në rajonin e Prishtinës, qendra shëndetësore e fshatit Janjevë është funksionale dhe nuk ka pasur ankesa të mëdha për qasje në shërbimet mjekësore. Megjithatë, barnatorja e fshatit shpesh nuk është e pajisur mjaftueshëm dhe nuk mund të sigurojë të gjitha ilaçet e nevojshme, kështu që [Kroatët e Kosovës](#) duhet të udhëtojnë në qytetin e Lipjanit ose në Graçanicë për të marrë barnat.

Në përgjithësi, [Kroatët e Kosovës](#) nuk kanë vështirësi në marrjen e dokumenteve të regjistrimit civil. Sipas Zyrës Komonale për Komunitete dhe Kthim në Viti, qytetarët [kroatë të Kosovës](#) janë të pajisur me dokumente personale.

Në Lipjan – Janjevë, një përfaqësues i komunitetit [kroat të Kosovës](#) raportoi se një segment i rëndësishëm i komunitetit mbështetet në pensione, si nga institucionet e Kosovës ashtu edhe nga Beogradi. Qasja në kujdesin shëndetësor është adekuate, por shqetësimi i vetëm ishte se rrallëherë ka mjekë dygjuhësor (ku infermieres [kroate të Kosovës](#) shpesh i duhet të përkthejë).

6. Qasja në arsim

Kroatët e Kosovës arsimohen në gjuhën serbe, pasi arsimimi në gjuhën kroate nuk ofrohet në Kosovë. Në fshatin Janjevë, kroatët e Kosovës ndjekin mësimet në shkollën fillore "Vladimir Nazor" me kurrikulë të Serbisë, ku i ndajnë hapësirat me shkollën "Shtjefën Gjeçovi" me kurrikulë të Kosovës. Arsimi i mesëm në gjuhën serbe ofrohet në Graçanicë.

Institucionet kanë filluar që nga viti 2019 të ofrojnë transport për **Kroatët e Kosovës** që udhëtojnë nga fshati Janjevë në Graçanicë për të vazhduar arsimin e mesëm. Para kësaj, qasja në arsim ishte sfidues për nxënësit në fjalë. Problemi u adresua më 28 gusht 2019, kur komuna e Graçanicës dhe Asociacioni i Kroatëve që jetojnë në Kosovë siguruan fonde për riparimin e një furgoni që kishte shërbyer si autobus shkollor. Prindërit kontribuan me shpenzimet e karburantit, mirëmbajtjen dhe kompensimin e shoferit.³²

Nuk ka **kroatë të Kosovës** në moshë shkollore në fshatrat e Letnicës, Shashar, Vërnakollë dhe Vërnez, në komunën e Vitisë.

Sipas Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, 22 **kroatë të Kosovës** janë regjistruar në arsimin parauniversitar gjatë vitit akademik 2019-2020³³ ndërsa në vitin shkollor 2023-2024 janë regjistruar vetëm 12 nxënës.³⁴

Nuk ka lëndë specifike për komunitetin ku nxënësit **kroatë të Kosovës** do të mësonin për identitetin dhe kulturën e tyre.

Kroatët e Kosovës ndjekin arsimin e lartë ose në Universitetin në gjuhën serbe në Mitrovicën e Veriut ose në universitetet në Kroaci.

Fëmijët **kroatë të Kosovës** që ndjekin kurrikulën në gjuhën serbe vendosen në klasa dhe kënde lojërash të ndryshme nga fëmijët që ndjekin kurrikulën në gjuhën shqipe, në të njëjtën shkollë me kurrikulë të kombinuar. Ata piren të shoqërohen më ngushtë me fëmijët serbë dhe romë të Kosovës.

Të dhënat dhe statistikat zyrtare janë të vështira të sigurohen për shkollat me kurrikulë të Serbisë. Një zyrtar i arsimit në Graçanicë informoi ekipin e OSBE-së në terren se nuk është regjistruar asnjë rast i braktisjes së shkollës nga komuniteti kroat i Kosovës.

32 Bazuar në monitorimin e Misionit të OSBE-së, gusht 2019.

33 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, *Shënime Statistike 2019/2020 (2020)*.

34 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, *Shënime Statistike 2023/2024*. (Shikuar për herë të fundit në dhjetor 2023).

7. Qasja në drejtësi

Nuk ka përfaqësues të komunitetit kroat të Kosovës të punësuar në asnjë nga institucionet jo-gjyqësore: Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF), Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) dhe Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV). Për më tepër, nuk ka avokatë kroatë të Kosovës të licencuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK).

Monitoruesit e OSBE-së në terren theksojnë që pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës në përgjithësi nuk janë të informuar për shërbimet që ofrohen nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) dhe Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMMV). Për shembull, shumica e bashkëbiseduesve të cilëve u janë drejtuar ekipet fushore të OSBE-së në komunën e Lipjanit nuk ishin në gjendje të jepnin ndonjë informacion në emër të komunitetit kroat të Kosovës, pasi që ata vetë nuk ishin në dijeni për shërbimet e ofruara nga këto institucione. Përveç kësaj, shumica e pjesëtarëve të komunitetit kroat të Kosovës në Viti janë persona të moshuar, të cilët në përgjithësi kanë komunikim dhe ndërveprim të drejtpërdrejtë shumë të rrallë me institucionet. Fëmijët e pjesëtarëve të komunitetit që jetojnë jashtë Kosovës thuhet se i ndihmojnë anëtarët e familjeve të tyre në Kosovë me këto çështje institucionale. Anëtarët e familjes zakonisht punësojnë avokatë privatë ose marrin shërbime nga zyra noteriale ose institucione të tjera në vend që t'u drejtohen institucioneve jo-gjyqësore të lartpërmendura.

Komuniteti kroat i Kosovës në komunën e Vitisë raportohet se ballafaqohet me sfida në përpjekje për qasje në shërbimet e ofruara nga ANJF-ja, IAP-ja dhe ZMMV-ja. Një përfaqësues nga zyra rajonale e IAP-së në Gjilan viziton komunën një herë në muaj. Vizita e planifikuar publikohet ose në faqen e IAP-së ose në hyrje të komunës. Megjithatë, Kroatët e Kosovës që jetojnë në zona të largëta, duke përfshirë personat e moshuar, nuk kanë qasje në internet dhe për këtë arsye nuk janë në gjendje të marrin informacione për orarin. Përveç kësaj, transporti publik është i padisponueshëm dhe shumica e pjesëtarëve të komunitetit përdorin shërbime private për nevoja thelbësore, si kontrollet shëndetësore ose tërheqja e fondeve të pensionit. Në komunën e Lipjanit nuk është raportuar për çështje që kanë të bëjnë me qasjen.

Zyra rajonale e IAP-së në Graçanicë vuri në dukje se pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë herë pas here kanë hasur në pengesa gjuhësore kur iu është kërkuar të përgatisin dokumente në gjuhën shqipe, para se të vazhdohet me veprime të mëtejshme.³⁵ IAP-ja ka pranuar ankesa edhe për punonjësit e gjykatës, të cilët mund të komunikojnë vetëm në gjuhën shqipe.

³⁵ Sipas raportimit të Misionit të OSBE-së nga terreni.

Në përgjithësi, pjesëtarët e komunitetit **kroat të Kosovës** nuk kanë njohuri për programin e Kompensimit të Viktimave të Krimit (KVK), pavarësisht se IAP, ZNMV, ANJF dhe OAK i informojnë pjesëtarët e komunitetit për të drejtat, mjetet juridike dhe dobitë e tyre, duke përfshirë qasjen në programin KVK gjatë ndërveprimit të tyre me rastet.

Në tetor 2023, Avokati i Popullit, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, në përputhje me mandatin dhe përgjegjësitë e tij, vizituan fshatin Janjevë për të parë situatën nga afër dhe për të diskutuar problemet e përditshme me të cilat ballafaqohet komuniteti **kroat i Kosovës** atje.

Çdo tetor, ZNMV-ja, nën kujdesin e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe me mbështetjen e Ambasadës Amerikane organizon "Javën e të Drejtave të Viktimave të Krimit". Megjithatë, është mendim i përgjithshëm i palëve të interesit që janë intervistuar që fushata informuese duhet të organizohen gjatë gjithë vitit.

Në vitin 2023, ANJF-ja ofroi shërbime për 6,070 persona (përfshirë 2,883 gra), nga të cilët asnjë nuk ishte pjesëtar i komunitetit **kroat të Kosovës**. Në vitin 2023, IAP ka marrë gjithsej 1,660 ankesa (1,162 burra dhe 498 gra)³⁶, duke përfshirë 4296 persona. Nga numri i përgjithshëm i ankesave, asnjëra prej tyre nuk vinte nga komuniteti kroat i Kosovës. ZNMV nuk ka regjistruar asnjë viktimë **kroate të Kosovës**.

Sipas raportimit të OSBE-së nga terreni, **kroatëve të Kosovës** u mungon besimi në institucionet publike, në përgjithësi. Shumë janë ankuar se institucionet publike janë apatike në ofrimin e shërbimeve, sidomos në lidhje me mosmarrëveshjet lidhur me pronën, ku përfshihen pjesëtarë të komunitetit **kroat të Kosovës**.³⁷ Faktorët socio-ekonomikë ndikojnë edhe në qasjen e komunitetit në drejtësi, pasi tkurrin mundësitë për të paguar shpenzimet gjyqësore, tatimet komunale dhe shpenzimet e transportit.

³⁶ Shih, Raporti Vjetor i IAP 2023, i qasshëm në <https://oik-rks.org/2024/03/29/>

³⁷ Sipas raportimit të Misionit të OSBE-së nga terreni.

8. Përdorimi i gjuhës dhe media

Gjuha amtare e komunitetit kroat të Kosovës është gjuha kroate.³⁸

Nuk ka pengesa domethënëse për këtë komunitet që të përdorë gjuhën e tij në hapësira publike, institucione qeveritare dhe dyqane, si dhe për të qasur shërbimet komunale dhe publike.

Për shkak të ngjashmërive ndërmjet gjuhës serbe dhe kroate, komuniteti përdor gjuhën serbe kur ndërvepron me autoritetet lokale. Nganjëherë pjesëtarët e komunitetit përjetojnë vështirësi në lidhje me mungesën e përkthimit dhe interpretimit adekuat e me kohë në gjuhën serbe në dy komunat ku banon shumica e këtij komuniteti.

Komuniteti **kroat i Kosovës** nuk ka qasje në mediat e shkruara dhe elektronike në gjuhën kroate me seli në Kosovë. Komuniteti ndjek mediat në gjuhën serbe.

Gjuha shqipe dhe ajo serbe janë gjuhë zyrtare në komunat e Vitisë dhe Lipjanit. Faqet e internetit të komunave dhe llogaritë zyrtare të mediave sociale përdoren gjithnjë e më shumë për të përcjellë informacion tek publiku, si njoftimet për shtyp, datat e organizimeve dhe konkurset për punësim. Ekipet e OSBE-së në terren kanë vërejtur vonesa të konsiderueshme në përditësimin e faqeve komunale dhe llogarive të mediave sociale në të dyja gjuhët zyrtare, deri në një muaj në disa raste, për shkak të ngarkesës së madhe me punë të përkthyesve komunalë. Megjithatë, informacioni që ka rëndësi për komunitetet dhe përfshirjen në çështje sociale, si punësimi dhe vendet e lira të punës, janë përgjithësisht të disponueshme dhe përditësohen menjëherë në të dyja gjuhët. Shenjat komunale janë pjesërisht të vendosura në të dyja gjuhët zyrtare.

Ka më shumë gjasë që gjenerata më e vjetër i flet dy gjuhët; megjithatë, me shumë gjasë, të rinjtë flasin vetëm një nga gjuhët zyrtare. Përdorimi i një gjuhe të vetme nga pjesëtarët e komunitetit është sfidë, sidomos pasi nëpunësit civilë nuk janë gjithmonë në gjendje të ofrojnë shërbime në gjuhën serbe. Ky kufizim gjuhësor mund të ndikojë në mundësitë e punësimit të pjesëtarëve të komunitetit tani dhe në të ardhmen. Gjeneratat e reja gjithnjë e më shumë priren të mësojnë gjuhën shqipe si pasojë e ndërveprimeve me bashkëmoshatarët shqiptarë të Kosovës në shkollat me hapësira të përbashkëta.

³⁸ Pas shpërbërjes së Jugosllavisë, katër gjuhë lindën nga gjuha e mëparshme zyrtare e njohur si serbo-kroate ose kroato-serbe: boshnjake, kroate, malazeze, dhe serbe.

9. Trashëgimia kulturore dhe fetare, liritë fetare

Kroatët e Kosovës janë sllavë katolikë për të cilët thuhet se kanë mbërritur në Kosovë gjatë shekullit të 14-të. Feja është komponent qenësor i identitetit kulturor të këtij komuniteti.

Komuniteti kroat i Kosovës është i angazhuar në mënyrë aktive në ruajtjen e traditave të tij kulturore, të cilat janë ruajtur ndër shekuj. Për shembull, teknikat tradicionale të përdorura nga kroatët e Kosovës, të bartura në gjenerata, ende përdoren për të prodhuar mallra në një numër punishtesh në Janjevë.

Objektet e trashëgimisë kulturore me rëndësi për komunitetin kroat të Kosovës janë Kisha Katolike Romake e Zojës së Madhe në Letnicë dhe Kisha e Shën Nikollës, e shekullit të 15-të, në Janjevë. Kisha në Letnicë nderohet për trashëgiminë e Nënë Terezës së Kalkutës, e cila pranoi thirrjen e saj fetare atje. Një tipar dallues i kishës është statuja 300-vjeçare e Shën Mërisë, e bërë nga druri i nxirë, që i jep kishës edhe emrin e saj. Çdo 14 dhe 15 gusht, në festën e "Të ngjiturit e Zojës së Bekuar në Qiell", zhvillohet një meshë për nder të Zojës së Madhe. Mijëra njerëz marrin pjesë në këtë pelegrinazh, i cili përfshin Kroatët e Kosovës të kthyer nga vende të tjera, por edhe ata që jetojnë në Kosovë, katolikët shqiptarë të Kosovës, besimtarët e krishterë ortodoksë dhe myslimanët. Kjo festë është një shembull i rrallë i një feste fetare ndërkomunitare. Gjatë dy ditëve mbahen mesha në gjuhën kroate dhe shqipe.

Trashëgimia popullore e fshatit Letnicë ka një rëndësi të konsiderueshme. Në shënimin e rëndësisë kulturore të fshatit, OSBE organizoi atje seminare me studentë në 2018 dhe 2019 për të mësuar rreth konservimit kulturor, për mbrojtjen e arkitekturës lokale, si dhe për të hartuar një plan zhvillimi.³⁹

Në rajonin e Prishtinës, Kisha e Shën Nikollës, e shekullit të 15-të, në Janjevë, është po ashtu objekt i rëndësishëm kulturor dhe fetar për kroatët e Kosovës. Këtu komuniteti mbledhet për të shënuar kremten fetare të "Festës Verore të Shën Nikollës" çdo vit më 9 maj.

³⁹ OSBE, *Laboratori i Trashëgimisë, Rizbulimi i trashëgimisë së Letnicës: Raporti i Punëtorisë së Zhvillimit* (2020).

Sipas vëzhguesve të OSBE-së në terren, **Kroatët e Kosovës** janë të lirë të shprehin besimet e tyre fetare, me qasje të hapur në objektet e trashëgimisë kulturore dhe fetare. Ekipet e OSBE-së në terren kanë raportuar vetëm dy incidente më të dukshme të sigurisë gjatë periudhës së konsideruar kohore. Më 4 shkurt 2018, persona të panjohur kishin hapur me dhunë derën e kishës katolike romake në fshatin Letnicë dhe kishin vjedhur afërsisht 1000 euro nga dy kuti të bamirësisë në altarin e kishës. Po ashtu, në maj të vitit 2018, ishte rrëzuar kryqi 2.5 metrash i vendosur në kodrat e Janjevës. Sipas raportimit, kjo ngjarje ishte një aksident i shkaktuar nga një banor që punonte me traktorin e tij. Komuniteti katolik romak e ringriti kryqin brenda një muaji.

10. Të drejtat pronësore

Ashtu si me komunitetet e tjera në Kosovë, kroatët e Kosovës përballen me sfida për të drejtat e tyre pronësore, siç janë uzurpimi i paligjshëm dhe mungesa e titujve të regjistruar pronësorë të pronës për shkak të transaksioneve të mëparshme joformale.

Për komunitetin kryesisht të moshuar kroat të Kosovës, ndërmarrja e procedurave komplekse ligjore dhe administrative për ndryshimin e titujve të pronës në të dhënat kadastrale mund të jetë tejet e vështirë.

Në rajonin e Prishtinës, shqetësimi kryesor i komunitetit kroat të Kosovës është pronësia e paqartë për shkak të transaksioneve të vjetra joformale në të cilat transferimet e pronës nuk ishin regjistruar zyrtarisht. Ky problem lidhet sidomos me ata që kanë anëtarë të familjes ose të afërm të tjerë që janë shpërngulur në Kroaci, pasi titujt pronësorë në regjistra kadastralë paraqesin pronarët e mëparshëm formalë, ndërsa konfuzioni shpesh vonon ose pengon procedurat e trashëgimisë.

OSBE-ja ka mbështetur pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës në komunat e Lipjanit dhe Vitisë për të diskutuar sfidat në lidhje me procedurat e trashëgimisë dhe regjistrimin e pronës.

11. Kthimi dhe riintegrimi

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) raporton se ndërmjet viteve 2010 dhe 2023, katër individë nga komuniteti kroat i Kosovës janë kthyer në Kosovë.⁴⁰

40 Të dhënat e siguruara nga Zyra e Shefit të Misionit të UNHCR-së në Prishtinë, në dhjetor 2023.



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Foto: Yllka Fetahaj

Profili i komunitetit

egjiptian të Kosovës

osbe

Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Profili i komunitetit Egjiptian të Kosovës

Komuniteti egjiptian i Kosovës¹ është komuniteti i katërt më i vogël në Kosovë², që përfaqëson 0.66 për qind të popullsisë.³

Egjiptianët e Kosovës kryesisht jetojnë në perëndim të Kosovës. Komuna e Gjakovës, ku komuniteti përfaqëson rreth 5.4 për qind të popullsisë komunale,⁴ ka numrin më të madh të banorëve egjiptianë të Kosovës. Egjiptianët e Kosovës banojnë edhe në komunën e Pejës (afro 2.8 për qind e popullsisë në komunë),⁵ Istog (afro 3.8 për qind),⁶ Klinë (afro 2.4 për qind),⁷ Deçan (rreth 390 banorë), Rahovec (rreth 300), si dhe Suharekë (dhjetë).⁸ Gjetiu në Kosovë, pjesëtarët e komunitetit egjiptian të Kosovës banojnë në komunat e Fushë Kosovës (afro 1,500), Obiliqit (afërsisht 35 deri në 40), Mitrovicës së Jugut (dy familje me 12 anëtarë në lagjen Adem Voca, si dhe një familje me pesë anëtarë në lagjen 2 Korriku), Podujevë (dy familje me 11 anëtarë), si dhe Ferizajt (22).⁹

1 Romët, ashkalitë dhe egjiptianët e Kosovës identifikohen si persona që u përkasin tri komuniteteve të veçanta, e si të tillë njihen nga korniza legjislative e Kosovës, institucionet e Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare. Misioni i OSBE-së e njeh plotësisht ekzistencën e tre komuniteteve të dallueshme, si dhe në këtë publikim është përpjekur të nxjerrë në pah karakteristikat dhe përvojat e tyre të veçanta. Megjithatë, për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme të ndara për komunitetet në disa komuna, pjesë të këtij profili ofrojnë shifra që përfaqësojnë romët, ashkalitë dhe egjiptianët e Kosovës në tërësi.

2 Vetëm komuniteti goran, malazez dhe ai kroat i Kosovës janë më të vogla.

3 OSBE, *Pasqyrë e komuniteteve ashkali, rom dhe egjiptian në Kosovë* (janar 2020), f. 4.

4 Rreth 5120 pjesëtarë të komunitetit.

5 Rreth 2700 pjesëtarë të komunitetit.

6 Rreth 1545 pjesëtarë të komunitetit.

7 Rreth 1189 pjesëtarë të komunitetit.

8 OSBE, *Profillet e Komunave 2018* (janar 2019).

9 Zyrtari Komunal për Komunitete dhe Kthim.

Fakte dhe çështjet kryesore:

- Incidentet kundër pjesëtarëve të komunitetit egjiptian të Kosovës përfshijnë ngacmimin dhe diskriminimin; shumica e rasteve përfshijnë sulme fizike.
- Komuniteti egjiptian i Kosovës në Qeverinë e formuar në vitin 2021 përfaqësohet me një ministër. Një nga 120 deputetët e Kuvendit është egjiptian i Kosovës.
- Komuniteti egjiptian i Kosovës është dobët i përfaqësuar në shërbimin civil në të gjitha nivelet qeveritare.
- Komuniteti ballafaqohet me një situatë përgjithësisht të dobët socio-ekonomike dhe shkallë të lartë të papunësisë.
- Pjesëtarët e komunitetit egjiptian të Kosovës në Gjakovë janë të ekspozuar ndaj ndotjes, duke pasur parasysh mungesën e sistemit të kanalizimit dhe afërsinë e tyre me deponinë komunale.
- Komuniteti ka cenueshmëri më të lartë ndaj përjashtimit nga skemat e asistencës sociale.
- Gjuha amtare e komunitetit egjiptian të Kosovës është gjuha shqipe. Pjesëtarët e komunitetit përdorin shqipen si në mjedise publike ashtu edhe në ato private.
- Nxënësit egjiptianë të Kosovës në përgjithësi ndjekin shkollat me kurrikulë të Kosovës.
- Nivelet e ulëta të të ardhurave dhe mundësitë e kufizuara të punësimit janë çështjet kryesore me të cilat ballafaqohen të kthyerit egjiptianë të Kosovës pas kthimit në Kosovë.

1. Siguria dhe rendi

Gjendja e sigurisë te komuniteti egjiptian të Kosovës është përmirësuar gradualisht me kalimin e kohës. Megjithatë, më 2019 është vërejtur një rritje e numrit të incidenteve që prekin këtë komunitet.¹⁰

Në total, numri i incidenteve që përfshijnë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës është i dyti më i madhi, pas incidenteve ndaj komunitetit serb të Kosovës.

Komuniteti egjiptian i Kosovës është i prekur nga një numër i lartë i thyerjeve/vjedhjeve¹¹ dhe incidenteve tjera të rënda, ku shpesh ka edhe sulme fizike ndaj pjesëtarëve të komunitetit.¹² Incidente të tjera janë edhe rastet e zjarrvënies,¹³ ngacmimit dhe përdhunimit.¹⁴ Të kthyerit egjiptianë të Kosovës kanë qenë gjithashtu viktimë në incidentet e sigurisë.¹⁵

Më 2023, dhjetë pjesëtarë të komunitetit egjiptian të Kosovës (bashkë me një grua) ishin punësuar në Policinë e Kosovës, me shërbim në Mitrovicë të Jugut, Mitrovicë të Veriut, Pejë, Istog, Klinë, Gjakovë, Rahovec dhe Suharekë.

Nuk ka pjesëtarë të komunitetit egjiptian të Kosovës në Komitetet Lokale të Sigurisë Publike (KLSP).

10 Sipas monitorimit të brendshëm të OSBE-së, ka pasur 25 incidente në vitin 2013, 26 më 2014, 21 më 2015, 15 në vitin 2016, shtatë më 2017, tetë më 2018, 28 në vitin 2019, 13 në vitin 2020, 12 më 2021, tetë më 2022 dhe gjashtë në vitin 2023.

11 Në prill të vitit 2020, një egjiptian nga Kosova raportoi për vjedhjen e bagëtive nga stalla e tij. Në shtator të vitit 2020, një/disa persona të panjohur vodhën bagëtinë nga stalla e një egjiptiani të Kosovës. Policia kishte nisur hetimet për të dyja rastet. Në prill të vitit 2021, një person i panjohur kishte hyrë me forcë në shtëpinë e një gruaje të moshuar egjiptiane kosovare, duke vjedhur disa bizhuteri dhe duke sulmuar e lënë gruan me lëndime të lehta.

12 Në maj të vitit 2019, në fshatin Treboviq në Pejë, një shqiptar i Kosovës kishte qëllloi mbi një grua dhe një burrë egjiptianë të Kosovës, duke i plagosur të dy. Në gusht të vitit 2019 në qytetin e Pejës, dy të dyshuar meshkuj shqiptarë të Kosovës ishin arrestuar pasi kishin sulmuar fizikisht një viktimë mashkull egjiptian nga Kosova. Në gusht 2019, një shqiptar i Kosovës kishte sulmuar fizikisht një vajzë shtatëvjeçare egjiptiane nga Kosova në një treg në fshatin Gurakoc. Viktimë pësoi lëndime trupore dhe u dërgua në spital për trajtim mjekësor. Në nëntor të vitit 2019, në fshatin Gorazhdec të Pejës, një shqiptar i Kosovës u arrestua pasi kishte goditur qëllimisht me veturën e tij një egjiptian të Kosovës. Në mars të vitit 2022 në Gjakovë, tre të dyshuar meshkuj shqiptarë të Kosovës (babai dhe dy djem të mitur) u arrestuan pasi kishin sulmuar fizikisht një viktimë mashkull egjiptian nga Kosova.

13 Incidente zjarri që prekin pronat e egjiptianëve të Kosovës ishin raportuar në dhjetor të vitit 2015 në fshatin Zallq, komuna Istog; në janar 2019 në fshatin Dobrushë, Istog; në maj 2019 në qytetin e Pejës; si dhe në mars dhe dhjetor 2019, edhe mars 2020, në vendbanimin Ali Ibra në qytetin e Gjakovës. Në tetor 2020, në fshatin Banjë, komuna Istog, një egjiptian i Kosovës kishte raportuar se automjeti i tij ishte përfshirë në flakë, rast të cilin Policia e Kosovës e kishte klasifikuar si zjarrvënie.

14 Në maj të vitit 2017, një grua egjiptiane e Kosovës që punonte në brigadën e zjarrfikësve në qytetin e Gjakovës kishte raportuar se ishte ngacmuar verbalisht në vendin e saj të punës nga një grua shqiptare e Kosovës. E dyshuara ishte arrestuar nën dyshimin se e kishte ofenduar vazhdimisht viktimën në baza racore dhe etnike, si dhe ishte shkarkuar nga puna. Më 5 qershor 2019, të pandehurit arritën marrëveshje dhe aktakuza u hodh poshtë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë. Në gusht të vitit 2018, në Gjakovë, një polic egjiptian i Kosovës raportoi se një shqiptar i Kosovës kishte postuar komente të papërshtatshme në Facebook për komunitetin, ndërsa rasti ishte klasifikuar si "nxitje e urrejtjes kombëtare, racore, fetare ose etnike, përcarje ose mosdurim". Në nëntor të vitit 2021, në Gorazhdec, komuna e Pejës, një grua egjiptiane nga Kosova ishte ngacmuar nga një shqiptar i Kosovës në prani të Policisë së Kosovës. Në shtator të vitit 2022, një mashkull shqiptar nga Kosova ishte arrestuar nën dyshimin për dhunë fizike dhe tentativë përdhunimi të një të mituri egjiptian nga Kosova. Në gusht të vitit 2023, në Gjakovë, gjatë vozitjes së veturës së tij, një i dyshuar shqiptar i Kosovës kishte ngacmuar disa herë një grua egjiptiane të Kosovës në rrugë.

15 Në janar, mars dhe maj 2015, tek vendbanimi i të kthyerve në Qungur, në fshatin Nakëll, komuna e Pejës, persona të panjohur kishin gjuajtur disa herë me gurë disa shtëpi që i përkisnin familjeve të kthyerit egjiptianë të Kosovës, të cilët ishin kthyer në nëntor 2014. Në mars të vitit 2023, autori(ët) e panjohur kishin thyer pesë shtëpi të pabanuara që u përkisnin familjeve të kthyerit egjiptianë në fshatin Klinafç, komuna e Klinës.

2. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi

Komuniteti egjiptian i Kosovës përfaqësohet nga një ministër në Qeverinë e formuar në vitin 2021: Elbert Krasniqi (Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK) është Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal. Fridon Lala (IRDK) aktualisht përfaqëson komunitetin në Kuvend. Në mandatin e kaluar, komuniteti përfaqësohej nga Veton Berisha nga Partia Liberale Egjiptiane (PLE) dhe Elbert Krasniqi.¹⁶

Një grua dhe një burrë aktualisht mbajnë dy ulëset e rezervuara për këtë komunitet në Këshillin Konsultativ për Komunitete. Përveç këtyre, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka një anëtar nga radhët e komunitetit egjiptian të Kosovës.

Që nga viti 2017, pjesëtarët e komunitetit egjiptian të Kosovës kanë përfaqësim të ulët në shërbimin civil në nivelin qeveritar, me vetëm 0.03 për qind. Komuniteti ishte dobët i përfaqësuar edhe në shërbimin civil komunal në të shtatë komunat ku banonin shumica e pjesëtarëve të komunitetit, sipas regjistrimit të vitit 2011: Fushë Kosovë, Pejë, Klinë, Gjakovë, Istog, Deçan dhe Rahovec.¹⁷

Nëntë burra dhe gjashtë gra përfaqësojnë komunitetin egjiptian të Kosovës në 13 komitete të komuniteteve (KiK) në mbarë Kosovën.¹⁸ Komuniteti nuk është i përfaqësuar në KiK-të e tetë komunave ku pjesëtarët e komunitetit banojnë në numër më të vogël, sipas regjistrimit të vitit 2011.¹⁹ Përveç këtyre, komuniteti egjiptian i Kosovës mban pozitën e kryesuesit të KiK-së në katër komuna: Deçan, Gjakovë, Mitrovicë e Jugut, si dhe Pejë (grua).

¹⁶ Komuniteti ka dy deputetë në Kuvend në bazë të dispozitës Kushtetuese që garanton ulësen e katërt për partinë që merr numrin e katërt më të madh të votave në mesin e partive që përfaqësojnë komunitetet ashkali, rom dhe egjiptian të Kosovës. Disa herë më parë, një përfaqësues i komunitetit ashkali të Kosovës ka mbajtur ulësen e katërt.

¹⁷ OSBE, *Përfaqësimi i komuniteteve në shërbimin civil në Kosovë* (2017) 2016.

¹⁸ Në Deçan, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Istog, Klinë, Lipjan, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prizren, Rahovec, Shtime, Suharekë.

¹⁹ Në Dragash, Gjiilan, Gllgoc, Graçanicë, Lipjan, Prishtinë, Skënderaj dhe Vushtrri.

Burra egjiptianë të Kosovës mbajnë pozitat e nënkryetarit për komunitete (NKK) në komunat Fushë Kosovë dhe Istog.²⁰ Zëvendëskryesuesi i Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë është një burrë nga komuniteti egjiptian.

Në komunat Gjakovë dhe Rahovec, udhëheqësit e Zyrave Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) janë nga komuniteti egjiptian i Kosovës (të dy burra). Egjiptianët e Kosovës përfaqësohen në ZKKK-të e komunave Gjakovë, Istog, Klinë, Pejë dhe Rahovec.²¹

Janë tetë pjesëtarë të komunitetit egjiptian të Kosovës në Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi (KKSB): nga një grua në komunat Podujevë, Klinë dhe Pejë, si dhe nga një burrë në komunat Gjakovë, Istog, Fushë Kosovë, Rahovec dhe Suharekë.

Disa prej organizatave joqeveritare (OJQ) të shquara që udhëhiqen nga egjiptianë të Kosovës, si dhe/ose punojnë me çështjet që prekin komunitetin janë: "Roma Versitas Kosovo"; "Voice of Roma, Ashkali and Egyptians - VoRAE"; "Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashklike dhe Egjiptiane" (RROGRAEK); "Nevo Koncepti"; "Sakuntala"; "Iniciativa 6"; "Durmish Aslano"; "Rromani Baxt"; "Përparimi i Komuniteteve"; "Vizioni 02"; "Prosperiteti"; "Syri i Vizionit"; "Nisma për Paqe dhe Unitet (NPU)"; "Era në Dukagjin"; "Arena"; "Iniciativa për Veprim"; "Roma in Action"; dhe "Ec Vetë"; por edhe organizatat "Ideas Partnership", "Advancing Together", "Balkan Sunflowers", si dhe "Bethany Christian Services". Në Mitrovicë të jugut dhe Podujevë, OJQ-ja "Përparimi Rinor i Ashkalinjëve të Mitrovicës" (PRAM), "Zëri i Rinisë Rome dhe Ashkali të Mitrovicës" (ZRRAM), si dhe OJQ "Qëndrimi" përfaqësojnë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës.

20 Sipas regjistrimit të vitit 2011, ashkallitë e Kosovës përfaqësojnë komunitetin më të madh joshumicë në komunën e Fushë Kosovës, si dhe në bazë të kornizës përkatëse ligjore në fuqi në momentin e emërimit, ky komunitet duhet të mbajë postin e nënkryetarit për komunitete. Megjithatë, në vitin 2022, Kuvendi Komunal i Fushë Kosovës votoi për emërimin e Suhat Ademit, egjiptian i Kosovës (Koalicioni i Inicativës Egjiptiane-Ashklike për Fushë Kosovë, IFKEA), si NKK. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) e kundërshtoi, duke parashtruar padi kundër Kuvendit Komunal. Gjykata më vonë hodhi poshtë kundërshtimin e MAPL-së. Vlen të përmendet se Udhëzimi i ri Administrativ për procedurën e emërimit të NKK-ve në komuna, i miratuar në dhjetor të vitit 2023 (UA nr. 03/2023) kishte hequr detyrimin që nënkryetari të jetë nga komuniteti më i madh joshumicë me banim në komunë.

21 Shtatë anëtarë, nga të cilët një grua (në Gjakovë).

3. Punësimi dhe gjendja socio-ekonomike

Gjendja e dobët socio-ekonomike e komunitetit egjiptian të Kosovës, si për komunitetin rom edhe ashkali të Kosovës, është për shkak të papunësisë së lartë dhe shkallës së ulët të të ardhurave.

Për shkak të shkollimit dhe/ose trajnimit profesional të kufizuar, pjesëtarëve të komunitetit egjiptian të Kosovës shpesh u mungojnë kualifikimet dhe shkathësitë e caktuara, gjë që kufizon qasjen në mundësitë e punësimit dhe rrit përjashtimin socio-ekonomik.

Në vitin 2018, ishin rreth 95,890 persona të regjistruar si të papunë në Kosovë, ku nga ata 0.9 për qind i përkisnin komunitetit egjiptian të Kosovës.²² Gjithashtu, gati 250 egjiptianë të Kosovës janë regjistruar si punëkërkues aktivë në fund të vitit 2018. Një numër i madh i egjiptianëve të Kosovës ndërmjet moshës 18 dhe 24 vjeç janë kualifikuar si "jo në shkollim, punësim apo trajnim (NEET)" në vitin 2018. Egjiptianët, romët dhe ashkalitë e Kosovës së bashku përbënin 78 për qind të të rinjve të konsideruar NEET, ku gratë e reja nga të tre komunitetet përfaqësoheshin në mënyrë disproporcionale (afërsisht 88 për qind konsideroheshin NEET). Shkalla e punësimit të grave të reja ishte vetëm katër për qind. Ndoshta si pasqyrim i pjeshëm i statusit të dobët ekonomik, vetëm 37 për qind e grave nga të tri komunitetet kishin perceptim pozitiv për jetën e tyre, krahasuar me 51 për qind të grave nga komunitetet tjera në Kosovë.²³

Komuniteti , e sidomos gratë, janë të përfaqësuara dobët në shërbimin civil, si në nivel qeveritar ashtu edhe në atë komunal.²⁴ Shumica e pjesëtarëve të komunitetit që punojnë në sektorin publik janë të punësuar në komunat e Gjakovës, Istogut, Pejës dhe Klinës. Komunat e Rahovecit, Deçanit dhe Prizrenit punësojnë vetëm nga një pjesëtar të komunitetit në shërbimin komunal. Një pjesëtar i komunitetit që punon në sektorin publik në Mitrovicën e Jugut në pozitën e sigurimit/mirëmbajtësit, ndërsa njëri është drejtor komunal për komunitete në komunën e Mitrovicës së Veriut. Pozitat më të shpeshta që mbahen nga Egjiptianët e Kosovës janë në administratën komunale, shëndetësi dhe arsim. Më pak punojnë në mirëmbajtje dhe disa janë pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Policisë së Kosovës.

²² Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Puna dhe Punësimi në Kosovë, *Raporti Vjetor 2018*, (2019), f. 19.

²³ Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), *Perspektiva e të rinjve romë, ashkali dhe egjiptianë mbi mundësitë dhe sfidat e denjë për punë në Kosovë* (2018), f. 21.

²⁴ OSBE, *Përfaqësimi i komuniteteve në shërbimin civil në Kosovë: Raporti përcjellës* (2017), f. 21.

Në sektorin privat, Egjiptianët e Kosovës përgjithësisht angazhohen në punë manuale të përkohshme me kualifikim të ulët, siç janë puna sezonale në ndërtim apo bujqësi, prerje drush e mbledhje të hekurishteve dhe materialeve të riciklueshme.²⁵ Disa pjesëtarë të komunitetit kanë biznese të vogla private ose familjare në zanatet tradicionale, si farkëtarë, marangozë, metalpunues, bravandreqës, saldatorë, rrobaqepës, këpucarë, parukierë e hidraulikë. Të tjerët punojnë në servise makinash e dyqane të ndryshme tregtare, ose bëjnë muzikë tradicionale.

Shumë egjiptianë të Kosovës në rajonin e Pejës raportohen të jenë të varur nga asistencë sociale, pasi shkalla e papunësisë është shumë e lartë. Në komunën e Gjakovës, hapja e fabrikës "Comodita" ka ndihmuar në punësimin e një numri të pjesëtarëve të komunitetit.

Në komunën e Prizrenit, sipas përfaqësuesit të KiK-së, shkalla e papunësisë për komunitetin egjiptian të Kosovës është 95 për qind, duke prekur si meshkujt ashtu edhe femrat e të gjitha moshave. Janë pesë punëkërkuar aktivë të regjistruar në Prizren, duke përfshirë një grua. Sipas përfaqësuesit të KiK-së, ka shumë pjesëtarë të komunitetit egjiptian të Kosovës që kanë diploma universitare, por që janë të papunë. Situata është e ngjashme në komunën e Rahovecit. Shumica e gati 300 pjesëtarëve të komunitetit varen nga ndihma sociale, tre janë të regjistruar si punëkërkuar aktivë dhe vetëm një është i punësuar në komunë.

Puna e fëmijëve është veçanërisht e përhapur në mesin e fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës (rreth 17 për qind krahasuar me 11 për qind në mbarë Kosovën).²⁶ Të dhëna të sakta, të ndara në komunitete, nuk gjende në dispozicion. Kjo praktikë lidhet ngushtë me varfërinë familjare, zotërimin e dobët në shkollim, si dhe mungesën e kujdesit dhe mbikëqyrjes prindërore.²⁷ Ka mospërputhje gjinore, pasi që më shumë djem angazhohen në punë të fëmijëve.²⁸ Fëmijët mbledhin kanaqe nga koshat e mbeturinave, pastrojnë dritare makinash, shesin artikuj në rrugë dhe kafene, apo lypin para.

Trembëdhjetë për qind e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës – krahasuar me fëmijët në mbarë Kosovën (shtatë për qind) - punojnë në kushte të rrezikshme, duke përfshirë punën fizike në fusha, prerjen e druve, operimin e makinerive bujqësore, spërkatjen me pesticide, punën në korrije, shirje ose punën në thertore; si dhe në miniera (në hapësira nëntokësore, pa ajrim adekuat).²⁹ Në përgjithësi, puna e fëmijëve cenon edhe qasjen në arsim dhe ka ndikim negativ në cilësinë e tij, duke rezultuar në mundësi të pakta dhe duke kontribuar në një zinxhir të vazhdueshëm përjashtimi social.

²⁵ Po aty.

²⁶ Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), *Perspektiva e të rinjve romë, ashkali dhe egjiptianë mbi mundësitë dhe sfidat e denjë për punë në Kosovë* (2018), f. 24.

²⁷ Zyra e Qeverisjes së Mirë, *Hartëzimi dhe vlerësimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve* (2012), fq. 25; UNICEF, *Analiza e gjendjes së fëmijëve dhe grave në Kosovë* (2017), f. 89.

²⁸ Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), *Perspektiva e të rinjve romë, ashkali dhe egjiptianë mbi mundësitë dhe sfidat e denjë për punë në Kosovë* (2018), f. 23- 23.

²⁹ Shih UNICEF-in, *Analiza e situatës*, fq. 91; Organizata Ndërkombëtare e Punës, *Perspektiva e Romëve*, fq. 24; Banka Botërore, *Anketë me grupime, me tregues të shumëfishtë 2013-14*, fq. 128.

Nuk ekzistojnë projekte për gjenerim të të ardhurave që targetojnë posaçërisht komunitetin egjiptian të Kosovës. Megjithatë, disa pjesëtarë të komunitetit përfitojnë nga programet e gjenerimit të të ardhurave që financohen nga donatorë ndërkombëtarë, për komunitete jo-shumicë. Për shembull, Programi i BE-së për Stabilizimin e Komuniteteve targeton si bizneset fillestare ashtu edhe ato ekzistuese.³⁰ Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) ka mbështetur familjet e kthyer egjiptiane të Kosovës me një sërë projektsh. OJQ-ja gjermane HELP i ka ofruar komunitetit mjete dhe pajisje për bizneset e vogla.

Egjiptianët e Kosovës, bashkë me romët dhe ashkalitë e Kosovës, besohet të jenë numri i dytë më i madh i azilkërkuesve nga Kosova në vendet e Bashkimit Evropian. Shumë egjiptianë të Kosovës identifikojnë varfërinë, mungesën e mirëqenies sociale dhe mbulimit shëndetësor, si dhe mungesën e mundësive të punësimit si arsye kryesore për migrim.³¹ Ka edhe migrim sezonal për të kërkuar punë si në BE ashtu edhe në vendet fqinje, si Shqipëria, Maqedonia e Veriut ose Mali i Zi.

Në vitin 2022, Qeveria e Kosovës krijoi një platformë kundër diskriminimit të pjesëtarëve të tri komuniteteve, ku ata ose të tjerët mund të raportojnë incidente të diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike. Në vitin 2023, Qeveria krijoi një ekip ndërinstitucional për promovimin e punësimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për të rritur punësimin e tre komuniteteve në shërbimin civil dhe mundësitë e tjera të punësimit.

³⁰ Bashkimi Europian, "BE – Programi i Stabilizimit të Komunitetit" (6 maj 2020). (Qasur në dhjetor 2023). Ky ka mbështetur rreth 900 mikro-ndërmarrje të reja dhe ekzistuese, si dhe kontribuon në zbatimin e projekteve të zhvillimit individual dhe komunitar. Programi, i cili tani është në fazën e tij të katërt, menaxhohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, në partneritet me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, si dhe zbatohet nga IOM.

³¹ OSBE, *Raporti i Vlerësimit të të Drejtave të Komuniteteve* (2015), fq. 26.

4. Qasja në infrastrukturë dhe shërbime publike

Komuniteti egjiptian i Kosovës në përgjithësi ka qasje të paqëndrueshme në shërbime publike. Shumë pjesëtarë të komunitetit me të ardhura të ulëta nuk janë të kyçur në sistemet komunale të kanalizimit, ndërsa grumbullimi i mbeturinave është problematik.

Një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të komunitetit në rajonin e Pejës jetojnë në vendbanime të këthyerve me banesa të papërshtatshme, shpesh të improvizuara dhe infrastrukturë të vjetruar e të mbingarkuar përtej kapaciteteve. Nivelet e larta të ndotjes, por edhe menaxhimi i dobët i mbeturinave, si dhe sistemet e dobëta të kanalizimit, janë çështje që shpesh prekin këtë komunitet. Në disa zona raportohen ndërprerje sporadike të furnizimit me ujë dhe energji elektrike, veçanërisht në periudha të caktuara të vitit.

Në komunën e Gjakovës, gjendja e përgjithshme e infrastrukturës në komunë vlerësohet si “e mirë”,³² megjithatë, shumica e zonave të banuara nga Egjiptianët e Kosovës nuk kanë ndriçim funksional rrugor dhe sisteme të kanalizimit. Kjo ka qenë një çështje e kahershme sidomos në lagjen Ali Ibra në periferi të qytetit të Gjakovës, ku jetojnë 170 familje (165 egjiptianë të Kosovës dhe pesë romë të Kosovës). Gjendja u përmirësua në vitin 2022, kur u asfaltuan rrugët kryesore, u ndërtua kanalizimi i ujërave të zeza dhe u pastrua deponia e afërt. Një transfer-stacion i financuar nga BE përmirësoi ndjeshëm kushtet e jetesës së komunitetit. Rrugët përcjellëse në lagje janë asfaltuar në vitin 2023. Përgjatë vitit 2022 dhe 2023, janë bërë përmirësime të infrastrukturës edhe në zonat tjera në komunën e Gjakovës ku banon komuniteti. Shtëpitë janë rinovuar ose ndërtuar dhe rrugët janë shtruar në fshatin Skivjan, në Piskotë, si dhe në lagjet Brekoc, Mahalla e Sefes dhe Mehmet Hyseni.³³

Në komunën e Pejës, komuniteti egjiptian i Kosovës gëzon qasje të plotë në infrastrukturë dhe shërbime publike. Ndërmjet viteve 2021 dhe 2023, komuna përmirësoi sistemin e kanalizimeve dhe ujësjellësit në lagjen 7 Shtatori të qytetit, shtroi rrugët kryesore dhe dytësore dhe instaloi ndriçimin publik. Po ashtu, në fshatin Qungur në komunën e Pejës, problemet e kahershme me gropat septike janë zgjidhur në vitin 2023 dhe që atëherë nuk ka pasur probleme të raportuara.

³² OSBE, *Profili komunale 2018: Gjakovë* (2018).

³³ Për t'u theksuar, nuk ka të dhëna të zbërthyer për këta përfitues, kështu që nuk ka informacion përfundimtar nëse i përkasin komunitetit ashkali, rom apo egjiptian të Kosovës.

Në komunën e Istogut, ndërmjet viteve 2015 dhe 2020, ZKKK-ja ka mbështetur shtrimin e rrugëve në disa fshatra të banuara nga komuniteti: Zallq, Kosh, Veriq, Gjurakoc dhe Dragolevc. Ndërmjet viteve 2021 dhe 2023, rrugët janë shtruar me zhavorr në Serbobran dhe shtruar në Llukafc të Thatë, Banjë, Gurakoc, Zallq and Drejë. Sisteme kanalizimi janë ndërtuar në Dragolevc më 2021, si dhe në Dubravë, Istog të Poshtëm, si dhe Banjë më 2023.

Në Klinë, komuna aktualisht është duke mbështetur përmirësimin e infrastrukturës në zonat e banuara me egjiptianë të Kosovës, veçanërisht në ndërtimin e rrugëve dhe shërbimet publike. Megjithatë, nevoja për ndërtimin e rrugëve mbetet në pjesë të fshatrave Klinafc dhe Dresnik³⁴. Rreth dhjetë familje egjiptiane të Kosovës kanë nevojë urgjente për strehim në disa fshatra, si dhe afro 40 familje kanë nevojë për ndihmë me riparimin dhe rindërtimin e shtëpive.

Në Deçan, sfida kryesore është mungesa e qasjes së komunitetit në sistemin e kanalizimit. Në shtator të vitit 2020, kryetari i komunës dhe zëvendësministri i Infrastrukturës njoftuan ndërtimin e një sistemi të kanalizimit dhe asfaltimin e rrugës në lagjen Pemishtë në fshatin Baballoq dhe në fshatin Gramaçel, të cilët janë të banuar kryesisht nga pjesëtarë të komunitetit egjiptian dhe rom të Kosovës. Ky projekt përfundoi më 2023.

Në Fushë Kosovë, rajoni i Prishtinës, katër shtëpi janë ndërtuar për familjet egjiptiane të Kosovës që nga viti 2018, si pjesë e projektit të BE-së për Kthimin dhe Riintegrimin në Kosovë. Në Lipjan, shumica e shtëpive në lagjet e urbanizuara nuk kanë leje ndërtimi dhe parcelat nuk janë në pronësi të banorëve të atyre shtëpive.

³⁴ Ndërtimi i rrugës ka filluar në dhjetor 2023.

5. Qasja në shërbime sociale, duke përfshirë edhe kujdesin shëndetësor

Shumica e komunitetit egjiptian të Kosovës përfiton nga ndihma sociale e ofruar nga Qeveria, ndërsa disa pjesëtarë marrin edhe ndihmë sociale nga institucionet e drejtuara nga Beogradi³⁵. Në Mitrovicën e Jugut, disa pjesëtarë të komunitetit deklaruan se përfitojnë nga të dy sistemet.

Komuniteti nuk përballet me probleme të konsiderueshme në qasjen në skema të asistencës sociale, përveç disa pengesave legislative. Legjislacioni aktual i mirëqenies sociale në Kosovë përkufizon ngushtë “familjet që jetojnë në një bashkësi familjare”. Kjo ka ndikuar negativisht tek familjet egjiptiane të Kosovës me shumë gjenerata, të cilat janë hequr nga lista e përfituesve. Informatat për asistencën sociale specifike për komunitetin egjiptian të Kosovës janë të kufizuara, pasi disa komuna grupojnë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës së bashku. Të dhënat e ndara për komunitete, që do të shfaqnin numrin e egjiptianëve të Kosovës që marrin pension dhe/ose pagesa për aftësi të kufizuara, nuk janë të disponueshme.

Komuniteti egjiptian i Kosovës shfrytëzon institucionet e kujdesit shëndetësor të Kosovës dhe ndan shqetësime të ngjashme me komunitetin rom dhe ashkali të Kosovës. Shëndeti i komunitetit ndikohet ndjeshëm nga kushtet e këqija të jetesës dhe mungesa e kanalizimeve, higjienës bazë dhe imunizimit, si dhe përdorimi i kufizuar i shërbimeve të kujdesit shëndetësor parandalues.³⁶ Për më tepër, shkalla e vdekshmërisë foshnjore në mesin e këtyre tre komuniteteve është tre herë më e lartë se mesatarja e Kosovës.³⁷

Megjithëse shërbimet e kujdesit shëndetësor janë përgjithësisht të disponueshme për këtë komunitet, duke përfshirë shëndetin riprodhues në shumicën e komunave,³⁸ shfrytëzimi i tyre pengohet nga disa faktorë, si mungesa e edukimit, vështirësitë ekonomike dhe largësia nga institucionet mjekësore dhe farmacitë.³⁹

35 OSBE, *Pasqyrë e komuniteteve ashkali, rom dhe egjiptian në Kosovë* (9 janar 2020), ff. 4-5.

36 Mbrojtësit e të Drejtave Civile, *Muri i anti-gjipsizmit: Romët, Ashkalitë dhe Egjiptianët në Kosovë* (2018), f. 21.; Zyra e Qeverisjes së Mirë, *Strategjia për Përfshirjen e Komunitetit Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017–2021*, fq. 26.

37 Zyra e Qeverisjes së Mirë, *Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë e Kosovës 2017– 2021* (April 2017), f. 27.

38 Shërbimet e kujdesit shëndetësor riprodhues ofrohen falas për gratë në komunat vijuese: Deçan, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gjilan, Istog, Klinë, Lipjan, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec dhe Suharekë.

39 Rrjeti i Grave të Kosovës, *Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë* (2016), fq. 51; KOSANA, *Sigurimi i ri kombëtar do të shpëtojë jetë: Jetëgjatësia dhe shëndeti në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës* (2016): f. 45.; KOSANA, *Dokument politikash 4: Qasja dhe përdorimi i shërbimeve shëndetësore nga romët, ashkalitë dhe egjiptianët e Kosovës* (nëntor 2015), f. 3.

Përveç kësaj, pjesëtarët e komunitetit egjiptian të Kosovës janë më të cenueshëm ndaj diskriminimit në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me shëndetin riprodhues të grave.⁴⁰

Në Ferizaj, gjendja e përgjithshme shëndetësore e egjiptianëve të Kosovës është përmirësuar dukshëm. Nga viti 2021 deri në vitin 2023, janë organizuar disa fushata informuese shëndetësore në vendbanimet e banuara kryesisht nga komuniteti egjiptian i Kosovës, për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e imunizimit në parandalimin e sëmundjeve, duke përfshirë atë nga OJQ "Balkan Sunflowers", përkrahur nga UNICEF-i⁴¹. Shërbimet e vaksinimit ofrohen rregullisht nga ekipi i imunizimit, pesë ditë në javë, në qendrat shëndetësore të vendosura në vendbanimet e banuara me komunitetin egjiptian të Kosovës⁴². Në Ferizaj, për shembull, shkalla e fëmijëve të vaksinuar është pothuajse e njëjtë me atë të komunitetit shumicë.

Pengesat ndaj shfrytëzimit dhe qasjes në shërbimet e kujdesit shëndetësor në Ferizaj janë të ulëta, pasi që qendrat shëndetësore lokale janë të vendosura në vendbanimet e banuara nga komuniteti egjiptian i Kosovës, e të cilat ofrojnë shërbime pa pagesë, pa diskriminim. Sipas zyrtarëve shëndetësorë, shkalla e vdekshmërisë foshnjore në komunitetin egjiptian të Kosovës në Ferizaj është ulur gjatë gjithë periudhës raportuese.

Në vitin 2022, OSBE-ja ndërmori një fushatë për të inkurajuar gratë nga komunitetet joshumicë që t'i bëjnë kontrollet mamografike në komunat e Ferizajt dhe Gjilanit, por edhe në qytetin e Gjakovës dhe atë të Pejës. Në vitin 2023, OSBE-ja vazhdoi me prezantime të ngjashme për pjesëtarët e komunitetit në komunën e Istogut. Përveç kësaj, OJQ-të dhe qendrat lokale të kujdesit shëndetësor kanë ndërmarrë disa fushata ndërgjegjësimi për shëndetin.⁴³ Mes viteve 2020-2022, shoqëria civile dhe Ministria e Shëndetësisë kanë mbajtur një numër sesionesh informuese në lagjet e komunitetit në Gjakovë për diabetin, hipertensionin, vaksinimin dhe kujdesin shëndetësor për gratë shtatzëna dhe fëmijët. Mamografi falas për zbulimin e hershëm dhe parandalimin e kancerit të gjirit janë organizuar edhe në rajonin e Prizrenit në zonat e banuara nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës.

Sipas raporteve në dy vitet e fundit, në Fushë Kosovë, vlerësohet se 50 e anëtarëve të komunitetit jetojnë me ndihmë sociale, me qasje përgjithësisht të mirë në shërbimet shëndetësore.

Mungesa e dokumentacionit personal mbetet sfidë për pjesëtarët e komunitetit egjiptian të Kosovës. Informimi i dobët brenda komunitetit mbi procedurat e regjistrimit civil tkurr edhe regjistrimin e lindjeve.⁴⁴

40 KOSANA, *Sigurimi i ri kombëtar do të shpëtojë jetë: Jetëgjatësia dhe shëndeti në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës* (2016), fq. 46.

41 OJQ BRAN.

42 Shefi i Njësisë së Imunizimit, Ferizaj.

43 OJQ BRAN.

44 Banka Botërore, *Anketa e grupimeve me tregues të shumëfishtë 2013–2014* (janar 2016), f. 126–127.

Institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë disa masa për rritjen e regjistrimit civil tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, duke përfshirë ofrimin e ditëve të regjistrimit falas.⁴⁵ Në total, 93 për qind e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës nën moshën pesë vjeçare janë të regjistruar. Nuk disponohen të dhëna të sakta të ndara në komunitet për numrin e pjesëtarëve të komunitetit që nuk janë të regjistruar. Komuna e Ferizajt, për shembull, ofron regjistrim falas për pjesëtarët e komunitetit egjiptian të Kosovës si dhe zbaton rregullisht masa për rritjen e regjistrimit civil të komunitetit, pa kosto.⁴⁶ Të gjitha lindjet e foshnjave egjiptiane të Kosovës janë të regjistruara, si dhe të gjithë fëmijët nën moshën pesë vjeçare nga komuniteti.⁴⁷

45 OSBE, *Raporti i Vlerësimit të të Drejtave të Komuniteteve, Edicioni i Katërt* (2015), fq. 25–26; Këshilli i Evropës, Komiteti Këshillues për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, *Opinion i katërt për Kosovën* (2017), §78, f. 30.

46 ZKKK

47 ZKKK

6. Qasja në arsim

Studentët egjiptianë të Kosovës arsimohen në gjuhën shqipe sipas kurrikulës së Kosovës. Përjashtim përbëjnë Mitrovica Jugore, ku disa prindër i regjistrojnë fëmijët e tyre në shkollat me plan-program serb, si dhe në Mitrovicën e Veriut dhe Prizren, ku disa prindër i regjistrojnë fëmijët e tyre për të mësuar në gjuhën turke ose boshnjake sipas kurrikulës së Kosovës.

Ndër sfidat më komplekse me të cilat përballen nxënësit egjiptianë të Kosovës me qasjen në arsim është statusi përgjithësisht i dobët socio-ekonomik i familjeve të tyre. Shumë familje egjiptiane rrallë mund të blejnë libra shkollorë bazë dhe materiale, gjë që kontribuon në rritjen e rasteve të braktisjes, si dhe vendimin e shpeshtë për të çuar vetëm djemtë në shkollë.

Duke pasur parasysh mundësitë e tyre të kufizuara, nxënësit egjiptianë të Kosovës shpesh varen shumë nga mbështetja dhe ndihma e qendrave mësimore gjatë gjithë shkollimit të tyre. Qendrat mësimore ofrojnë orë plotësuese për fëmijët e marginalizuar që vuajnë nga pasojat e përjashtimit socio-ekonomik. Qendrat kanë qenë kryesisht të varura nga mbështetja e donatorëve. Megjithatë, një udhëzim i ri administrativ i vitit 2018 që synon rregullimin e qendrave parashikon edhe financim nga buxheti qendror dhe lokal. Megjithatë, vonesat në përbushjen e detyrimeve nga institucionet qeveritare dhe komunale, së bashku me mungesën e qartësisë mbi shtrirjen e këtyre detyrimeve të financimit, i kanë lënë qendrat mësimore me mungesë fondesh dhe shumë janë detyruar të mbyllen.⁴⁸

Të dhënat e sakta statistikore të ndara sipas përkatësisë etnike, moshës, apo edhe gjinisë për nxënësit e komunitetit egjiptian të Kosovës nuk janë gjithmonë të disponueshme në nivel komunal. Në shumicën e rasteve, të dhënat e destinuar për monitorim, planifikim të politikave dhe ndërhyrje grumbullohen e prezantohen bashkërisht për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës. Prandaj, hulumtimi substancial në veçanti për komunitetin egjiptian të Kosovës është problematik. Ndonëse ka ngjashmëri midis tre komuniteteve, secili ka specifikat dhe sfidat e veta, që kërkojnë qasje dhe zgjidhje të ndryshme në politika.

Një sfidë tjetër në disa komuna ka të bëjë me transportin e nxënësve në shkolla. Në lagjen Ali Ibra në Gjakovë, prindërit kërkojnë transport për nxënësit për shkak të sigurisë në komunikacion.

⁴⁸ Për më shumë mbi Qendrat Mësimore, shih Raporti i OSBE-së Pasqyrë e Qendrave Mësimore në Kosovë dhe Zbatimi i Udhëzimit Administrativ 19/201, (2023).

Pasi fillimisht refuzoi kërkesën, duke qenë që nxënësit banonin brenda largësisë së përcaktuar me ligj, duke i përjashtuar ata nga mbulimi me transportit, komuna hapi tender për kompani transporti, por pa sukses⁴⁹. Në fshatin Serbobran, në Istog, edhe pse nxënësit jetonin më pak se katër kilometra larg shkollës, komuna pranoi të ofrojë ndihmë me transport për të inkurajuar frekuentimin e rregullt dhe për të parandaluar braktisjen e shkollës.

Në Mitrovicën e Jugut, nxënësit egjiptianë të Kosovës që ndjekin shkollat me plan-program serb në Mitrovicën e Veriut përballen me sfida në qasjen fizike në shkolla, pasi ura këmbësore mbi lumin Ibër që lidh dy komunat nuk ekziston më, ndërsa kalimi në urën kryesore perceptohet nga komuniteti si rrezik potencial sigurie për fëmijët.

Gjatë pandemisë COVID-19, studentët egjiptianë, romë dhe ashkali të Kosovës u ballafaquan me dukshëm më shumë probleme sesa komunitetet e tjera në qasjen në procesin e mësimin në internet, për shkak të mungesës së pajisjeve të TI-së dhe lidhjes në internet.

Edhe pse shkalla e braktisjes së shkollës është ulur dukshëm në vitet e fundit, është ende çështje e përsëritur në mesin e nxënësve egjiptianë të Kosovës. Në përgjithësi, numri i nxënësve egjiptianë të Kosovës në shkollat e mesme është dukshëm më i vogël se në shkollën fillore, madje edhe më i vogël në nivel universitar. Vajzat egjiptiane të Kosovës ndikohen në masë disproporcionale: për shembull, numri i vajzave egjiptiane të Kosovës në shkollat e mesme të larta është shumë më i vogël se numri i djemve. Shkalla e ulët e vijueshmërisë së shkollës është rezultat i gjendjes së dobët socio-ekonomike të shumicës së familjeve egjiptiane të Kosovës, si dhe migrimit.

Vajzat dhe gratë nga komuniteti egjiptian, rom dhe ashkali i Kosovës përballen me sfida plotësuese në aspektin e qasjes në arsim, për shkak të lindjes së fëmijëve, martesave të detyruara dhe roleve tradicionale gjinore në këto komunitete.⁵⁰ Në përgjithësi, 13.7 për qind e vajzave në këto komunitete nuk vazhdojnë arsimin e mesëm të lartë, krahasuar me 11.3 për qind të djemve nga këto komunitete. Gjithashtu, katër për qind e vajzave nuk vazhdojnë nga shkolla fillore në atë të mesme të ulët, krahasuar me 6.1 për qind të djemve nga i njëjti komunitet.⁵¹ Martesa e fëmijëve është një nga faktorët që ndikon që vajzat të braktisin shkollën.⁵² Megjithatë, është e vështirë të përcaktohet lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet martesës së fëmijëve dhe niveleve më të ulëta të arsimit në mesin e vajzave nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës.

49 Për shkak të mungesës së fitimit.

50 *Martesa e fëmijëve dhe martesave të detyruara* janë terma që përdoren alternativisht. Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë, "fëmijë" konsiderohet "çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare". Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e fëmijëve, neni 3. Ligjërish, "martesa e fëmijëve" dhe "martesa e hershme" konsiderohen të njëjta: martesë e një fëmije nën moshën 18 vjeç. *Martesa e detyruar* është martesë në të cilën njëri ose të dy bashkëshortët, pavarësisht moshës, nuk japin pëlqimin. Në Ligjin për Familjen në Kosovë, "Personi i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeçare nuk mund të lidhë martesë" (neni 16), përveç për shkaqe të arsyeshme (neni 16b). Neni 18 thotë se "Martesa nuk do të jetë e plotfuqishme, nëse pëlqimi është arritur përmes shtrëngimit, kërcënimit ose lajthimit, apo të ndonjë mungese tjetër të vullnetit të lirë nga ana e bashkëshortëve të ardhshëm". Ligji Nr. 2004/32 për Familjen (2006) dhe Ligji Nr. 06/L-077 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Familjen Nr. 2004/32.

51 UNICEF, *Analiza e gjendjes së fëmijëve dhe grave në Kosovë* (2017), Tabela 16: Analiza e rrugëtimit në shkollim për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian sipas gjinisë; fq. 79.

52 UNFPA, *Martesa e fëmijëve në Kosovë (Përmbledhje)*, (2014).

Mungesa e të dhënave të sakta dhe të krahasueshme, të ndara në komunitete, për numrin e fëmijëve të martuar para moshës 18 vjeç përbën sfidë të konsiderueshme në matjen e efektit negativ të martesave të fëmijëve në arsimimin e vajzave, për të gjitha komunitetet.

Në fund të vitit 2023, Qeveria themeloi grupin punues ndërinstitucional për parandalimin dhe raportimin e martesave të hershme në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës.

Kurrikula e Kosovës nuk ofron ndonjë lëndë specifike për komunitetin që nxënësit egjiptianë të Kosovës të mësojnë për identitetin dhe kulturën e tyre.

Për të mbështetur nxënësit nga komuniteti për vazhdimin e studimeve të tyre, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), me ndihmën e donatorëve, ofron çdo vit 500 bursa për nxënësit romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës për arsimin e mesëm.⁵³ Sipas statistikave të MASHTI-t, në arsimin parauniversitar për vitin akademik 2023–2024 janë regjistruar 1279 egjiptianë të Kosovës.⁵⁴

Në gusht të vitit 2023, MASHTI njoftoi se prindërit do të obligoheshin të blinin tekstat shkollorë për klasat 1 deri në 5, e më pas të rimburoheshin, me anë të aplikacionit elektronik. Vendimi shkaktoi disa shqetësime, veçanërisht për komunitetet dhe familjet më të cenueshme në kushte të vështira ekonomike. Familjet duhej të mbështeteshin në mbështetjen e OJQ-ve për të pasur qasje në subvencione, pasi disa pjesëtarë të komunitetit nuk kishin llogari bankare ose shkathtësi të dobëta kompjuterike.

Egjiptianët e Kosovës zgjedhin shkollimin universitar në gjuhën shqipe në universitete publike në Prishtinë, Pejë dhe Prizren.⁵⁵ Universitetet publike kanë vende të rezervuara për studentët jo-shqiptarë të Kosovës, duke përfshirë Egjiptianët e Kosovës.

Studentët universitarë nga komuniteti egjiptian i Kosovës (si dhe komuniteti rom dhe ashkali i Kosovës) mbështeten me financim nga komuniteti i donatorëve ndërkombëtarë, në veçanti nga OJQ-të "Roma Versitas", "VORAE" dhe Fondi për Arsimin e Romëve. Disa bursa për studentët universitarë ofrohen edhe nga MASHTI. Në përgjithësi, komunat nuk ofrojnë apo financojnë bursa që synojnë posaçërisht studentët universitarë egjiptianë të Kosovës, megjithatë disa komuna ofrojnë bursa për studentë nga komunitete të caktuara, duke përfshirë Egjiptianët e Kosovës. Megjithatë, nuk ka të dhëna në dispozicion për numrin e përfituesve të bursave nga komuniteti egjiptian i Kosovës. Sipas ZKKK-së në komunën e Gjakovës, asnjë student egjiptian i Kosovës nuk kishte marrë bursë apo masa të tjera afirmative në vitet e fundit. Thuhet se studentët nga komuniteti në përgjithësi nuk aplikojnë për bursa ose nuk përmbushin kriteret, gjë që çon në refuzim.

⁵³ Ministria e Arsimit e Përkushtuar në Mbështetjen e Studentëve të Komuniteteve Rom, Egjiptian, Ashkali – MASHTI (rks-gov.net).

⁵⁴ Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Shënime Statistike 2023/24: Të dhëna për Arsimin Parauniversitar,

⁵⁵ Ekzistojnë shtatë universitete publike në Kosovë, me programe studimi në gjuhën shqipe: në Ferizaj, Gjakovë, Gjiçan, Mitrovicë e Jugut, Pejë, Prishtinë dhe Prizren.

Edhe pse në të kaluarën janë raportuar raste të ngacmimit dhe diskriminimit ndaj studentëve egjiptianë të Kosovës, kohët e fundit nuk është vërejtur ndonjë problem. Nxënësit egjiptianë të Kosovës në përgjithësi ndërveprojnë më shpesh me nxënësit shqipfolës sesa nxënësit serbishtfolës, kryesisht për shkak të gjuhës së përbashkët.

7. Qasja në drejtësi

Është një përfaqësues (burrë) i komunitetit egjiptian të Kosovës i punësuar në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP), por jo në ndonjë institucion tjetër jo-gjyqësor: Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) dhe Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV). Për më tepër, nuk ka avokatë egjiptianë të Kosovës të licencuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK).

Komuniteti egjiptian i Kosovës në përgjithësi gëzon qasje formale në sistemin e drejtësisë. Megjithatë, ekziston një mungesë e përgjithshme e njohurive në komunitet për të drejtat si dhe procedurat ligjore, por edhe mundësinë e ndihmës juridike falas. Varfëria është pengesa kryesore për qasjen në sistemin ligjor, pasi tarifat gjyqësore, shpenzimet ligjore, e madje edhe transporti, mund të përbëjnë barrë të konsiderueshme financiare.

Monitorimi në terren i OSBE-së raporton se pjesëtarët e komunitetit egjiptian të Kosovës në përgjithësi, e në veçanti ato familje që jetojnë në zona rurale, janë deri diku të vetëdijshëm për shërbimet e ofruara nga ANJF, IAP dhe ZMNV. Pjesëtarët e komunitetit më të vetëdijshëm për këto shërbime janë ata që punojnë ose angazhohen me institucionet komunale, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat, si dhe studentët. Fushatat e vetëdijesimit që mbulojnë komunitetin e gjerë, sidomos familjet që jetojnë në zona rurale, mund të jenë efektive; shembull janë përpjekjet për të rritur dukshmërinë e ANJF-së.

Në vitin 2023, me mbështetjen e USAID-it, ANJF-ja shpërndau fletëpalosje dhe posterë në gjuhët angleze, shqipe, serbe dhe turke dhe në alfabetin Braille. Ngjashëm, video spote e postime të krijuara në rrjetet sociale gjatë Javës së Ndhmës Juridike Falas me moton "Mbroni të drejtat tuaja", u shpërndanë në gjuhët zyrtare shqip dhe serbisht. Për më tepër, përfaqësues të këtyre institucioneve marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të ndërgjegjësimit të organizuara nga palë të ndryshme.

Që nga tetori i vitit 2021, IAP ka udhëhequr Forumin për Dialog në mes të Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC), që bën bashkë OSHC të ndryshme, duke përfshirë edhe ato që përfaqësojnë komunitetin egjiptian të Kosovës.⁵⁶ Në mars të vitit 2023, së bashku me OJQ-në "ROMTEGRA", Avokati i Popullit vizitoi disa familje egjiptiane të Kosovës në Mitrovicë me qëllim të informimit dhe diskutimit të sfidave dhe shqetësimeve të tyre.

⁵⁶ Qëllimi i Forumit është krijimi i një platforme të përbashkët bashkëpunimi ndërmjet IAP-së dhe OSHC-ve, për avancimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, identifikimin e sfidave dhe shkeljeve të të drejtave dhe lirive themelore, si dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta për promovimin dhe mbrojtjen e tyre.

Në bashkëpunim me Qendrën e Avokimit për Kulturë Demokratike (ACDC) nga Mitrovica Veriore, Avokati i Popullit u takua me OSHC-të në Mitrovicë dhe Pejë dhe mbajti tryeza (të organizuara nga ACDC) për brengat e komuniteteve që lidheshin me respektimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre.⁵⁷

Në vitin 2023, IAP-ja publikoi raportin, sipas detyrës zyrtare, lidhur me mungesën e kushteve të përshtatshme të jetesës për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës të kthyer në Obiliq nga Maqedonia e Veriut.⁵⁸

Çdo tetor, ZMNV, nën ombrellën e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe me mbështetjen e Ambasadës Amerikane, organizon "Javën e të Drejtave të Viktimave të Krimin". Megjithatë, është mendim i përgjithshëm i palëve të interesit që janë intervistuar që fushata informuese duhet të organizohen gjatë gjithë vitit. Përkundër disa fushatave informuese të ndërmarra nga institucione të ndryshme, duke përfshirë ZMNV-në, Ministrinë e Drejtësisë, OAK-në, si dhe informatat që ndahen me viktimat kur kërkojnë shërbime, ka pak ose aspak njohuri lidhur me kompensimin e viktimave të krimin (KVK).

Në vitin 2023, ANJF-ja ofroi shërbime për 6,070 persona (përfshirë 2,883 gra), prej të cilëve 156 ishin pjesëtarë të komunitetit egjiptian të Kosovës. Në vitin 2023, IAP pranoi gjithsej 1,660 ankesa (1,162 burra dhe 498 gra),⁵⁹ që përfshinin 4296 persona. Nga numri i përgjithshëm i ankesave, shtatë ishin nga pjesëtarët e komunitetit egjiptian të Kosovës. ZMNV-ja ka trajtuar 2,883 raste në vitin 2023, nga të cilat 80 kanë të bëjnë me pjesëtarët e komunitetit egjiptian të Kosovës dhe 53 të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës (pasi jo çdo rajon i ndan ato në komunitete individuale). Shumica e viktimave ishin gra.

Në kuadër të komunitetit egjiptian të Kosovës, gjuha nuk perceptohet si pengesë për qasje në institucionet ligjore, pasi që ata flasin rrjedhshëm gjuhën shqipe, ndërsa shumë prej tyre flasin rrjedhshëm edhe gjuhën turke dhe/ose serbe (kryesisht ata që jetojnë në komunën e Prizrenit, sidomos gjeneratat e vjetra).

57 Për më shumë informacion ju lutemi shikoni: <https://oik-rks.org/en/2023/12/05/the-ombudsperson-met-representatives-of-civil-society-organizations-from-the-region-of-peja/> (Qasur në dhjetor 2023).

58 Institucioni i Ombudspersonit, *Mungesa e kushteve të përshtatshme të jetesës për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të kthyer në Obiliq, nga Republika e Maqedonisë së Veriut* (2018).

59 Shih, *Institucioni i Avokatis të Popullit, Raporti Vjetor 2023*.

8. Përdorimi i gjuhës dhe media

Komuniteti egjiptian në Kosovë përdor shqipen si gjuhë amtare. Ky komunitet nuk ka pengesa madhore në përdorimin e gjuhës në hapësira publike apo institucione qeveritare, si dhe në qasje të shërbimeve komunale dhe publike.

Komuniteti egjiptian i Kosovës pranon shërbime publike dhe informacione në gjuhën shqipe. Pjesëtarët e komunitetit kanë qasje në median e shkruar dhe elektronike në shqip. Për më tepër, ekziston një program i shkurtër në gjuhën shqipe e që i kushtohet komunitetit egjiptian të Kosovës që transmetohet në transmetuesin publik RTK1. Komuniteti egjiptian i Kosovës gjithashtu ka qasje në OJQ Radio Prosperiteti, me seli në Gjakovë.⁶⁰

60 Informatat mund të qasen në vegëzën e tyre në media sociale: <https://www.facebook.com/Radio.Prosperteti/> (Qasur në dhjetor 2023).

9. Trashëgimia kulturore dhe fetare, liritë fetare

Komuniteti egjiptian i Kosovës në përgjithësi është i lirë të shprehë identitetin e tij kulturor, besimet fetare dhe zakonet. Ky komunitet kryesisht i përket besimit mysliman suni, edhe pse në komunat e Gjakovës dhe Pejës ka edhe të tillë që janë pasues të islamit sufi, si dhe disa protestantë.

Egjiptianët e Kosovës shpeshherë marrin pjesë në ceremoni fetare në xhamitë sunite, si dhe kishat protestante ungjillore të menaxhuara edhe nga komunitetet e tjera.

Komuniteti egjiptian i Kosovës feston "Ditën Ndërkombëtare të Egjiptianëve të Ballkanit" më 24 qershor, në kujtim të kuvendit të parë të egjiptianëve ballkanikë të mbajtur në Ohër, Maqedoni të Veriut, në vitin 1970. Myslimanët egjiptianë të Kosovës festojnë festat fetare të Fitër Bajramit, Kurban Bajramit, Nevruzit dhe Ashures, ndërsa ata me përkatësi ungjillore protestante festojnë Krishtlindjet, Pashkët dhe Ditën e Reformimit. Midis 6 dhe 15 majit, komuniteti egjiptian i Kosovës feston festën e Shën Gjergjit, që kombinohet me dy festa të tjera tradicionale që shënojnë fundin e dimrit dhe fillimin zyrtar të verës.

Objektet fetare dhe kulturore ndahen me komunitetet e tjera. Në komunën e Gjakovës, për shembull, një *teqe* sufi dhe Xhamia Sunite menaxhohen nga prijës fetarë të komunitetit egjiptian të Kosovës, por marrin pjesë edhe pjesëtarë të komuniteteve të tjera. Në vitin 2019, një xhami është ngritur në lagjen Pemishtë të fshatit Baballoq në Deçan, me financim nga Bashkësia Islame e Kosovës. Për më tepër, komuniteti udhëheq objektin fetar joformal të njohur si *Tyrbja e Baba Hajdarit*, që gjendet në lagjen e egjiptianëve të Kosovës në fshatin Veriq, komuna e Istogut. Vlen të theksohet se në vitin 2023, persona të panjohur i vunë zjarrin Tyrbes së lartpërmendur.

Në korrik të vitit 2019, OSBE-ja mori pjesë në një inspektim në terren në fshatin Dresnik në Klinë, organizuar nga Instituti Arkeologjik i Kosovës dhe Ministria e Infrastrukturës, për të diskutuar ndërtimin e rrugës Prishtinë-Pejë. Përfaqësuesi lokal ortodoks serb dhe përfaqësuesit e ZKKK-së gjithashtu morën pjesë dhe shprehën brengën se ndërtimi mund të ndikojë negativisht në disa varreza; Ata kërkuan që Ministria e Infrastrukturës të shqyrtojë ndryshimin e projektit për të anashkaluar varrezat. Në nëntor 2020, ZKKK në Klinë informoi ekipin në terren të OSBE-së se rruga e re nuk do të ndikojë në pjesën egjiptiane të varrezave.

10. Të drejtat pronësore

Komuniteti egjiptian i Kosovës përballet me sfida të ngjashme me ato të komuniteteve të tjera joshumicë në Kosovë, siç është qasja e kufizuar në banim dhe regjistrimi i titujve pronësorë në regjistrat kadastralë, veçanërisht në rajonin e Gjilanit dhe Prishtinës.

Në rajonin e Prishtinës, pronat e shumë egjiptianëve të Kosovës nuk janë të regjistruara ligjërisht në zyrat kadastrale komunale. Për shkak se shumica e anëtarëve të këtij komuniteti kanë jetuar në vendbanime në të cilat toka është bartur në mënyrë joformale, pa regjistrim zyrtar, këta pjesëtarë të komunitetit nuk kanë të drejta formale pronësie mbi pronën dhe shtëpitë e tyre. Prandaj dhe nuk ka siguri të titujve pronësorë të këtyre familjeve.

Në rajonin e Gjilanit gjatë vitit 2019, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka nisur ndërtimin e tri shtëpive për pjesëtarët e komunitetit egjiptian të Kosovës që jetojnë në fshatin Dubravë të komunës së Ferizajt. Projekti synonte të përmirësonte kushtet e jetesës së komunitetit.

11. Kthimi dhe riintegrimi

Shumë egjiptianë të Kosovës janë kthyer në Kosovë gjatë 20 viteve të fundit. Të kthyerit egjiptianë të Kosovës shpeshherë hasin vështirësi pas kthimit, me nivel të ulët të të ardhurave dhe mundësi të kufizuara të banimit e punësimit.

Sipas Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), rreth 7,800 ashkali dhe egjiptianë të Kosovës janë kthyer vullnetarisht në Kosovë, nga viti 2000 e deri në maj të vitit 2023.⁶¹ Shumica e të kthyerve egjiptianë të Kosovës janë nga rajoni i Pejës. Prej tyre, sipas ZKKK-së, nga viti 1999 në komunën e Gjakovës janë kthyer 167 pjesëtarë të komunitetit egjiptian të Kosovës (76 gra dhe 91 burra). Nga viti 2015 deri në dhjetor 2023, vlerësohet se janë kthyer 494 individë në komunat e Gjakovës (202 individë), Pejës (161), Istogut (104) dhe Klinës (21), ndërsa në Prizren dhe Ferizaj më pak se pesë individë ishin kthyer, sipas UNHCR-së.

Mbështetja në projekte të financuara nga donatorët, të cilat krijojnë zgjidhje banimi për të kthyerit, krijon sfidat e veta në kuptimin që pak komuna marrin pjesë në projekte, e të kthyerit potencialë nga komunat e tjera duhet të mbështeten në ndihmën sporadike nga Ministria për Komunitete e Kthim (MKK). Projekti i financuar nga BE-ja Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë raporton se 67 njësi banimi janë ndërtuar për të kthyerit dhe 57 individë kanë marrë pako për gjenerimin e të ardhurave, kryesisht në komunat e Pejës dhe Gjakovës. Projekti menaxhohet nga Zyra e BE-së në Kosovë në partneritet me MKK-në dhe zbatohet nga IOM.⁶²

Ka pasur edhe nisma të tjera që kanë targetuar komunitetet e marginalizuara, duke përfshirë Egjiptianët e Kosovës, nën ombrellën e BE-së, institucioneve të Kosovës dhe organizatave donatore, siç janë Këshilli Danez për Refugjatët dhe Arbeiter-Samariter-Bund.

Në vitin 2023, MKK-ja ndërmori një hap të rëndësishëm duke nxjerrë thirrje për ofrimin e ndihmës materiale për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë.⁶³ Kjo nismë kishte për qëllim adresimin e nevojave të ndryshme, duke përfshirë sigurimin e artikujve ushqimorë dhe joushqimorë, si dhe mbështetjen për ndërtimin dhe rindërtimin e shtëpive.

61 UNHCR, 77 (2023). Aktualisht, nuk ka të dhëna të ndara për sa i përket kthimit vullnetar të komunitetit egjiptian të Kosovës.

62 Numri i njërive banesore të ndërtuara apo rindërtuara përfshinë 25 njësi në Pejë, 17 në Gjakovë, 12 në Istog, tetë në Klinë, si dhe pesë në Fushë Kosovë. Të dhënat janë ofruar nga zyra e Misionit të IOM-së në Kosovë.

63 Vendimi për përcaktimin e procedurave për ofrimin e ndihmës nga Ministria për komunitete dhe kthim për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, i nxjerrë më 2 shkurt 2023: [Vendim i procedurave për ofrimin e ndihmës-Odluka o proceduri pruzenja pomoci compressed compressed-compressed \(1\).pdf \(rks-gov.net\)](#). (Qasur në dhjetor 2023).

Për më tepër, Ministria zgjeroi kontaktet e saj për të përforcuar sektorin e bujqësisë, duke ofruar subvencione për të lehtësuar praktikat e qëndrueshme bujqësore. Njëkohësisht, pati përpjekje të përkushtuar për të mbështetur bizneset e vogla brenda këtyre komuniteteve. Ndikimi i këtyre përpjekjeve ishte i prekshëm, pasi Ministria mbështeti me sukses 150 familje egjiptiane të Kosovës, duke u ofruar atyre artikuj të rëndësishëm, përfshirë materiale ndërtimore. Vlen të theksohet se kjo nismë ka rezultuar me ndërtimin e një shtëpie që ndodhet në Fushë Kosovë. Përveç këtyre, nisma të tjera të Ministrisë u shtrinë në ofrimin e mbështetjes materiale për 18 familje, në shumën prej 167,014 euro. Kjo ndihmë financiare u orientua drejt nxitjes së zhvillimit në sektorin e bujqësisë ose mbështetjes së bizneseve të vogla. Konkretisht, dhjetë familje që gjenden në Istog, pesë në Gjakovë dhe tri në Ferizaj kanë përfituar nga kjo iniciativë.⁶⁴

64 Të dhënat u ndanë me Misionin e OSBE-së në Kosovë nga Ministria për Komunitete dhe Kthim më 6 shkurt 2024.



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Foto: Yllka Fetahaj

Profili i komunitetit

goran të Kosovës

osbe

Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Profili i komunitetit goran të Kosovës

Komuniteti goran i Kosovës është nga komunitetet më të vogla në Kosovë. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, në Kosovë jetojnë përafërsisht 10,300 pjesëtarë të komunitetit goran të Kosovës, që përbëjnë afërsisht 0.55 për qind të popullsisë së Kosovës.¹

Përqendrimi më i madh i komunitetit goran të Kosovës është në komunën e Dragashit në rajonin e Prizrenit, ku ata përbëjnë rreth 26 për qind të popullsisë (8,000-10,000). Në Dragash, goranët e Kosovës përfaqësojnë komunitetin e dytë më të madh në komunë dhe komunitetin shumicë në qytetin e Dragashit (rreth 51-52 për qind të popullsisë së qytetit).² Grupe më të vogla të komunitetit goran të Kosovës janë të pranishme në komunat e Mitrovicës Veriore (gati dy për qind e popullsisë komunale), Prizrenit (më pak se një për qind), Pejës (më pak se një për qind) dhe Prishtinës (më pak se një për qind), por edhe gjetkë nëpër Kosovë. Në Graçanicë, janë rreth 60 pjesëtarë të komunitetit (dhjetë familje).

1 Agjencia e Statistikave të Kosovës. https://askdata.rks.gov.net/pxweb/en/ASKdata/ASKdata_Census%20population_Census%202011__3%20By%20Municipalities/tab%205%204.px/table/tableViewLayout1/. Vetëm komuniteti kroat dhe ai malazez i Kosovës kanë më pak pjesëtarë në Kosovë. (Qasur në dhjetor 2023).

2 Agjencia e Statistikave të Kosovës. Shifrat për Regjistrimin e Popullatës në Kosovë të vitit 2011 https://askdata.rks.gov.net/pxweb/en/ASKdata/ASKdata_Regjistrimi_i_popullsisë_Census_2011__3_Nga_Komunat/tab_5_4.px/table/tableViewLayout1/. Komuniteti më i madh në komunën e Dragashit është ai shqiptar i Kosovës; boshnjakët e Kosovës janë të tretët për nga numri. (Qasur në dhjetor 2023).

Faktet dhe çështjet kryesore

- Siguria e përgjithshme e komunitetit goran të Kosovës aktualisht është relativisht stabile.
- Një pjesëtar i komunitetit goran të Kosovës është deputet në Kuvend.
- Komuniteti është i nënpërfaqësuar në nivelet e administratës publike dhe komunale.
- Komuniteti goran i Kosovës përballet me shkallë të lartë të papunësisë.
- Perspektivat e kufizuara ekonomike nxisin migrimin e pjesëtarëve të komunitetit.
- Goranët e Kosovës në përgjithësi kanë qasje të qëndrueshme në infrastrukturën adekuate, përveç në zonat malore rurale të komunës së Dragashit, ku komuniteti përballet me sfida me rrjetet e shpërndarjes së ujit dhe energjisë elektrike. Vërehen probleme të herëpashershme me qasjen në dokumentet e gjendjes civile.
- Shumica e komunitetit goran të Kosovës ndjekin mësimin sipas planprogramit të Serbisë në gjuhën serbe, ndërsa një numër më i vogël i ndjekin shkollat me planprogram të Kosovës në gjuhën boshnjake, shqipe ose turke.
- Nxënësit goranë të Kosovës në komunën e Dragashit përballen me infrastrukturë të dobët shkollore dhe sfida me qasjen fizike në arsim.
- Duhet bërë më shumë për të shëruar ndarjet ndërmjet komuniteteve në komunën e Dragashit, duke ndihmuar kështu në rritjen e pjesëmarrjes së goranëve të Kosovës në jetën publike dhe lehtësimin e qasjes në arsim.

1. Siguria dhe rendi

Siguria e komunitetit goran të Kosovës është përmirësuar gjatë dekadës së fundit dhe aktualisht është stabilizuar; numri relativisht i ulët i incidenteve zakonisht përfshin vjedhjet dhe grabitjet.³ Deri në vitin 2015, komuniteti goran i Kosovës përjetoj numrin e tretë më të madh të incidenteve (pas komunitetit serb dhe boshnjak të Kosovës), por tashmë këto shifrat janë ulur ndjeshëm.

Komuniteti goran i Kosovës dhe ai malazez i Kosovës përjetojnë numrin më të ulët të incidenteve të sigurisë.

Shqetësimet kryesore të përsëritura të sigurisë së komunitetit goran të Kosovës janë vjedhjet e bagëtimeve dhe vjedhjet e shtëpive të pabanuara nga të dyshuarit që besohet se janë nga Shqipëria. Rritja e parë e regjistruar në vjedhje të tilla ndodhi në korrik të vitit 2014 dhe që atëherë kanë ndodhur disa incidente të ngjashme, duke përfshirë, mes tjerash, grabitjet me armë, vjedhjet e bagëtimeve dhe mallrave bujqësore, frikësimi dhe dëmtimi i pronës.⁴ Janë regjistruar disa incidente të klasifikuara si sulme fizike ndaj komunitetit goran të Kosovës.⁵

Në vitin 2016 dhe 2017, janë instaluar kamerat e sigurisë në tetë lokacione në komunën e Dragashit, duke përfshirë edhe në fshatin Orçushë.⁶

Shqetësimet për sigurinë e komunitetit si dhe mundësitë e kufizuara ekonomike konsiderohen si faktorët më të rëndësishëm kontribuues në rritjen e migrimit të goranëve dhe boshnjakëve të Kosovës nga komuna e Dragashit në vendet e Evropës Perëndimore.

Për t'i zbutur shqetësimet e sigurisë janë bërë përpjekje për të rritur përfaqësimin dhe pjesëmarrjen kuptimplotë dhe efektive të komunitetit goran të Kosovës në forumet lokale të sigurisë dhe në Policinë e Kosovës. Përfaqësuesit goranë të Kosovës kanë kërkuar vazhdimisht shtimin e numrit të policëve të Kosovës nga ky komunitet, veçanërisht në nënstacionin me mungesë të personelit policor në fshatin Krushevë në Dragash, për të rritur sigurinë e komuniteteve joshumicë në zonë.

3 Sipas monitorimit të brendshëm të OSBE-së ka, pasur tetë incidente në vitin 2013, 30 incidente në vitin 2014, 25 incidente në 2015, 16 në 2016, 15 në 2017, dy në 2018, gjashtë në 2019, katër në 2020, katër në 2021 një në vitin 2022, dhe pesë në vitin 2023.

4 Në nëntor të vitit 2016, janë raportuar thyerje në 15 shtëpi ndërsa në nëntor të vitit 2021 në dy shtëpi të familjeve gorane të Kosovës në fshatin Restelicë të komunës së Dragashit. Në shkurt të vitit 2021, një goran i Kosovës raportoi në Policinë e Kosovës se një grup i të dyshuarve të panjohur e sulmuan fizikisht derisa ai po kalonte nga Mitrovica e Jugut për në Mitrovicën e Veriut.

5 Në qershor të vitit 2023, një goran i Kosovës raportoi në Policinë e Kosovës se një shqiptar i Kosovës e kërcënoi dhe e sulmoi fizikisht në dyqanin e tij në Mitrovicën e Veriut. Në gusht të vitit 2023, në Dragash, pas një mosmarrëveshjeje, një i dyshuar shqiptar i Kosovës e sulmoi fizikisht një viktimë të përkatësisë gorane, i cili mori tretman mjekësor.

6 Kamerat janë instaluar në fshatrat Zaplluzhe, Brodosan, Bellobrade, Brezne, Orçushë, Gllloboçicë dhe Restelicë, si dhe në qytetin e Dragashit.

Në vitin 2023, 39 pjesëtarë të komunitetit **goran të Kosovës** (dy gra) kanë qenë të punësuar në Policinë e Kosovës. Që të gjithë shërbejnë në Policinë e Kosovës në Prizren dhe në Dragash, duke përfshirë në nënstacionin e Krushevës.

Janë pesë pjesëtarë **goranë të Kosovës** në Komitetet Lokale të Sigurisë Publike (KLSP).⁷

⁷ Që nga nëntori i vitit 2023.

2. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi

Komuniteti goran i Kosovës u përfaqësua në Qeverinë e formuar në vitin 2021 nga Enes Goran nga Partia e Bashkuar Gorane (JGP), i cili më parë ka mbajtur postin e zëvendësministrit të tregtisë dhe industrisë. Ajo përfaqësohet edhe nga Edison Beqiri, i cili u emërua këshilltar i Kryeministrit në Qeverinë e formuar në vitin 2021.

Më parë, zëvendësministri i infrastrukturës dhe mjedisit ishte përfaqësuesi i vetëm i JGP-së në Qeverinë 2020-2021.

Ulësja e garantuar për komunitetin në Kuvend aktualisht mbahet nga lideri i Partisë së Bashkuar Gorane, Adem Hoxha. Këtë mandat ai e kishte fituar edhe në zgjedhjet e mëparshme. Parti të tjera që përfaqësojnë komunitetin që morën pjesë në zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kuvend të vitit 2019 dhe 2020 ishin Lëvizja për Gorën (PZG) dhe Nisma Qytetare Gora (GIG).

Dy vendet e rezervuara për komunitetin në Këshillin Konsultativ për Komunitete (KKK) aktualisht mbahen nga një grua dhe një burrë.⁸

Që nga viti 2017⁹, pak pjesëtarë të komunitetit goran të Kosovës ishin pjesë e shërbimit civil në nivel qeveritar (0.17 për qind), dhe si të tillë ishin të nënpërfaqësuar. Komuniteti ishte gjithashtu i nënpërfaqësuar në mënyrë të konsiderueshme në shërbimin civil në komunën e Dragashit (ku banojnë shumica e anëtarëve të komunitetit), Prizrenit dhe komunat tjera ku jeton numër më i vogël i komunitetit.¹⁰

Komuniteti është i përfaqësuar në gjashtë komitete të komuniteteve (KK) në mbarë Kosovën, ku përfshihen pesë gra dhe dy burra.¹¹ Pozitën e kryesuesit të KK-së në Mitrovicën e Veriut e mban një goran i Kosovës. Megjithatë, sipas regjistrimit të vitit 2011 dhe vlerësimeve të monitorimit të OSBE-së, komuniteti nuk është i përfaqësuar në KK në 12 komuna ku banojnë persona që i përkasin komunitetit.¹²

Pozitën e nënkryetarit për komunitete në komunën e Dragashit e mban një goran i Kosovës.¹³

8 Amira Mustafa përfaqësoi OJQ-në Klubi i Futbollit Dragash Sport dhe Fehim Sali përfaqësoi OJQ-në Neven.

9 Nuk ka të dhëna më të reja në dispozicion.

10 OSBE, *Përfaqësimi i komuniteteve në Shërbimin Civil në Kosovë* (maj 2017).

11 Për shkak të mungesës së stërzgjatit të përfaqësuesit të komunitetit goran të Kosovës, në dhjetor 2023, kryesuesi i KK-së së Prizrenit e ka iniciuar procesin për zëvendësimin e anëtarit të KK-së dhe ka mbajtur takime konsultative me përfaqësuesit e tjerë të komunitetit goran të Kosovës për të identifikuar ndonjë kandidat.

12 Shtatë KK-të me përfaqësues të goranëve të Kosovës janë Dragashi, Ferizaj, Graçanica, Mitrovica e Veriut, Prishtina, dhe Prizreni.

12 KK-të pa përfaqësim të goranëve të Kosovës janë Deçani, Fushë Kosova, Gjakova, Gjilani, Kamenica, Lipjani, Mitrovica e Jugut, Obiliqi, Peja, Shtimja, Vitia, dhe Vushtrria. Vlerësimet e banorëve për komunat Leposaviq, Mitrovicë e Veriut Zubin Potok dhe Zveçan bazohen në të dhënat e OSBE-së nga *Profilet komunale 2018* për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare të regjistrimit të popullatës.

13 Nënkyetari i komunës për komunitete në Dragash është burrë (Partia e Bashkuar gorane, JGP).

Megjithatë, asnjë pjesëtar i komunitetit nuk e mban pozitën e zëvendëskryesuesit të kuvendit komunal për komunitete në ndonjë komunë. Ka anëtarë nga radhët e **goranëve të Kosovës** në tri zyra komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK), dhe një grua gorane e Kosovës mban pozitën e kryetares së ZKKK-së në Graçanicë.¹⁴

Në këshillat komunalë të sigurisë në bashkësi (KKSB) janë katër anëtarë **goranë të Kosovës**: nga një grua në secilën nga komunat e mëposhtme: Graçanicë, Prishtinë dhe Dragash; si dhe një burrë në Prizren.

Sektori i shoqërisë civile brenda komunitetit **goran të Kosovës** nuk është shumë i zhvilluar dhe karakterizohet me numër të vogël të organizatave joqeveritare (OJQ) të drejtuara nga donatorët. Në të vërtetë, varësia e këtyre OJQ-ve nga financimi i donatorëve shpeshherë nënkupton se u mungojnë fonde për funksionim të mirëfilltë. Në shkurt të vitit 2023 një grua **gorane e Kosovës** e themeloi OJQ-në "Sensa", e para dhe e vetmja OJQ e grave në komunën e Dragashit, e cila angazhohet për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të vajzave dhe grave gorane dhe boshnjake të Kosovës që banojnë në këtë komunë.

Vendimi i autoriteteve komunale për të vendosur një monument përkujtimor të Adem Jasharit në qendër të qytetit të Dragashit pa u konsultuar me komunitetin **goran të Kosovës** çoi në pasoja politike, duke përfshirë bojkotin e përfaqësuesve goranë dhe boshnjakë të Kosovës në mbledhjet e KK-së në komunën e Dragashit. 2016-2017.¹⁵ Pjesëtarët e komunitetit vunë në pikëpyetje aftësinë e institucioneve dhe legjislacionit të Kosovës për të siguruar mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve joshumicë. Meqë përfaqësuesit e KK-së refuzuan të marrin pjesë në takime, duke zvogëluar pjesëmarrjen e tyre, komuniteti goran bëri thirrje për ndryshime në Ligjin për vetëqeverisje lokale për të siguruar mbrojtje më të madhe të të drejtave të komuniteteve. Emërimi i nënkryetarit të komunës për komunitete nga radhët e komunitetit **goran të Kosovës**, pas zgjedhjeve komunale në fund të vitit 2021, e forcoi përfaqësimin e komunitetit në komunë.

Përfaqësuesit e komunitetit kanë kërkuar themelimin e Gorës, komunë kjo që ka ekzistuar nga viti 1990 deri në 1999 ku **goranët e Kosovës** do ta kishin shumicën, me qytetin e Dragashit si qendër administrative dhe fshatrat me goranë dhe boshnjakë të Kosovës të rajonit të Gorës brenda kufijve administrativë të saj. Në shtator të vitit 2015, përfaqësuesit e të gjitha partive politike gorane dhe boshnjake të Kosovës nga Dragashi, si dhe OJQ-të dhe pjesëtarët e diasporës i paraqitën kërkesë Qeverisë dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për fillimin e konsultimeve për krijimin e komunës së Gorës. Megjithatë, institucionet e Kosovës asnjëherë nuk i janë përgjigjur kësaj kërkesë. Shumë persona në komunitetin **goran të Kosovës** besojnë se në komunën e Gorës, të drejtat dhe interesat e komuniteteve joshumicë do të mbroheshin dhe respektoheshin më mirë, ndërsa e drejta e tyre për vetëqeverisje lokale dhe decentralizim do të mund të ushtrohej më mirë.

¹⁴ Tre ZKKK me pjesëtarë goranë të Kosovës janë ato në Dragash, Ferizaj, dhe Graçanicë.

¹⁵ Adem Jashari ishte komandant shqiptar i Kosovës në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, i cili u vra në vitin 1998.

3. Punësimi dhe gjendja socio-ekonomike

Komuniteti goran i Kosovës përballlet me mundësi të kufizuara punësimi dhe ekonomike. Shkalla e papunësisë në mesin e komunitetit goran të Kosovës është 30 për qind, duke prekur veçanërisht gratë.

Bazuar në statistikat e Zyrës së Agjencisë Kosovare të Punësimi në Dragash janë 66 punëkërkues aktivë (33 gra) të regjistruar nga komuniteti goran i Kosovës.

Shumica e goranëve të Kosovës në sektorin privat janë të vetëpunësuar dhe fitojnë të ardhura. Goranët e Kosovës më së shpeshti angazhohen në biznese të vogla familjare dhe tradicionalisht janë të angazhuar në sektorin e hotelerisë, si në dyqanet e ëmbëlsirave, blerjen dhe shitjen e ëmbëlsirave dhe në furrat e bukës, skarat e ushqimit të shpejtë, kafenetë dhe restorantet që përgatisin ushqim lokal. Një numër i vogël i tyre punojnë në sektorin e ndërtimitarisë.

Në sektorin publik, komuniteti goran i Kosovës është i nënpërfaqësuar në pozitat në nivel qeveritar dhe atë lokal. Shumica e nëpunësve civilë goranë të Kosovës mbajnë pozita të nivelit profesional në nivel qeveritar, ndërsa në nivel komunal kryejnë detyra teknike dhe administrative.¹⁶ Ndonëse të nën-përfaqësuar në institucionet e Kosovës në të dy nivelet, një numër i konsiderueshëm i goranëve të Kosovës ishin të punësuar në institucione të ndryshme të drejtuara nga Beogradi në nivel lokal, veçanërisht në komunën e Dragashit, duke përfshirë në sektorin e shëndetësisë dhe arsimit. Në vitin 2021, vetëm 27 goranë të Kosovës ishin të punësuar në sektorin publik të Kosovës në Dragash, ndërsa më shumë se 200 ishin të punësuar në institucione të ndryshme të drejtuara nga Beogradi në të njëjtën komunë.¹⁷ Mosnjohja e diplomave të lëshuara në bazë të planprogramit të Serbisë nga institucionet e Kosovës është pengesë e madhe për komunitetin, veçanërisht në Dragash.

Në Prishtinë një grua gorane e Kosovës punon në Drejtorinë Komunale të Financave dhe një burrë në ndërmarrjen publike, *Termokos*.

Në Graçanicë ka 20-25 anëtarë të komunitetit të punësuar në sektorin privat, kryesisht burra, 30-60 vjeçar, në fushën e zejtarisë. Shkalla e papunësisë është rreth 30 për qind.

¹⁶ OSBE, *Përfaqësimi i komuniteteve në shërbimin civil në Kosovë* (2017, fq. 13, 17 dhe 24

¹⁷ Gjashtëmbëdhjetë goranë të Kosovës kanë qenë të punësuar në Këshillin e Përkohshëm të Komunës së Gorës, 16 ishin në listën e pagave të qeverisë së Serbisë në sektorin e shëndetësisë, ndërsa përafërsisht 180 deri në 200 ishin të punësuar në gjashtë shkollat fillore dhe një të mesme me planprogram të Serbisë në komunën e Dragashit.

Pensionet dhe ndihmat sociale nga institucionet e Prishtinës dhe ato të Beogradit gjithashtu ofrojnë të ardhura për komunitetin goran të Kosovës. Pjesëtarët e komunitetit të papunësuar, përgjithësisht të moshuar dhe gra, shpesh pranojnë fonde nga të afërmit që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit.

Pjesëtarë të shumtë të komunitetit goran të Kosovës pranojnë mbështetje financiare nga institucionet e drejtuara nga Beogradi, duke përfshirë pensionet, asistencën sociale, pagën minimale të garantuar nga qeveria serbe dhe shtesat për fëmijë për të gjithë nxënësit që ndjekin shkollat me planprogram të Serbisë.¹⁸ Kjo mbështetje është shumë e nevojshme për komunitetin, duke pasur parasysh shkallën e lartë të papunësisë dhe situatën sfiduese socio-ekonomike, veçanërisht në komunën e Dragashit.

Situata shumë e rëndë ekonomike e komunitetit goran të Kosovës ka tërhequr disa projekte të gjenerimit të të ardhurave, siç janë ato të sponsorizuara nga Programi i Stabilizimit të Komunitetit i financuar nga BE-ja që ofrojnë ndihmë për fermerët nga komuniteti të cilët merren me produktet e qumështit. Karitasi zviceran dhe komuna e Dragashit kanë financuar bashkërisht projekte për gjenerimin e të ardhurave që fokusohen kryesisht në prodhimin bujqësor në komunat e Prizrenit dhe Dragashit (duke përfshirë manaferrat dhe bimët medicinale).

Në mesin e komunitetit goran të Kosovës, nuk është vërejtur asnjë rast i punës së fëmijëve, përveç rasteve të rralla kur fëmijët ndihmojnë prindërit e tyre në biznese të vogla familjare gjatë muajve të verës. Ekonomia joformale gjithashtu nuk është shumë e përhapur brenda komunitetit.

Anëtarët e komunitetit goran të Kosovës kanë migruar në numër të madh që nga viti 1999 në kërkim të mundësive ekonomike. Anëtarët e komunitetit vendosen kryesisht brenda rajonit, por një numër i konsiderueshëm kanë emigruar në vendet e Evropës Perëndimore si Itali, Francë, Gjermani, Belgjikë, Austri, Zvicër dhe Suedi. Vitet e fundit, të rinjtë goranë të Kosovës kanë emigruar për qëllime arsimore, kryesisht në Turqi dhe Bullgari.

¹⁸ Pas miratimit të një rregulloreje nga Banka Qendrore e Kosovës në dhjetor 2023, e cila e vendos euron si monedhën e vetme të lejuar për transaksione me para të gatshme në Kosovë, e cila hyri në fuqi më 1 shkurt 2024, ekipet në terren të Misionit të OSBE-së në Kosovë pranuan raportime se ky ndryshim e ka prekur komunitetin i cili pranon mbështetje financiare nga qeveria e Serbisë.

4. Qasja në infrastrukturë dhe shërbime publike

Në komunat e Gjilanit, Pejës, Graçanicës dhe Prishtinës, pjesëtarët e komunitetit goran të Kosovës jetojnë në zonat urbane në lagje të përziera, duke gëzuar qasje të plotë dhe të barabartë në ujë të pijshëm, sisteme të kanalizimit, shërbime të grumbullimit të mbeturinave, energji elektrike të besueshme, dhe rrugë të asfaltuara, ashtu si të gjithë banorët e tjerë.

Shumica e pjesëtarëve të komunitetit goran të Kosovës banojnë në zonat malore të komunës së Dragashit, ku qasja në shërbimet publike rëndohet nga terreni i vështirë, rrjetet e vjetruara të furnizimit me energji elektrike dhe ujë, dhe mungesa e sistemeve të kanalizimit në një numër fshatrash. Për shembull, ndonëse shumica e anëtarëve të komunitetit goran të Kosovës kanë qasje në ujë të pijshëm, banorët në fshatrat Rapqë e Epërme dhe Rapqë e Poshtme ende përballen me mungesë uji për shkak të rrjetit të vjetruar të furnizimit me ujë.¹⁹ Personat që jetojnë në shtëpitë e vjetra që nuk janë të lidhur me sistemin e kanalizimit përdorin gropa septike ose kanale të hapura. Për të përmirësuar infrastrukturën, buxheti i kuvendit komunal të Dragashit për vitin 2024 ka ndarë afërsisht 4.5 milionë euro për projektet e investimeve kapitale, shumica e të cilave do të shpenzohen për zbatimin e një projekti për furnizim me ujë për 15 fshatra në rajonin e Gorës dhe Opojës dhe qytetin e Dragashit, duke përfshirë ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujit në fshatin Radesh.

Në Graçanicë, infrastruktura (rruga, rryma, kanalizimi, uji) është e dobët dhe numri i ankesave zyrtare kohëve të fundit është rritur.

Sistemet e vjetra dhe të dobëta të transmisionit shkaktojnë ndërprerje sporadike të shërbimit elektrik në fshatrat e zonës së Gorës, veçanërisht gjatë dimrit. Ndonëse katër hidrocentrale që janë në funksion prodhojnë energji elektrike në rajonin e Gorës, investimi minimal në rrjetin e shpërndarjes në rajon për më shumë se 30 vjet – pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të komunitetit – ka çuar në ndërprerje të vazhdueshme, veçanërisht në fshatrat Restelicë, Zllipotok, Krushevë dhe Globoçicë. Komuniteti goran i Kosovës dhe të tjerët janë tërësisht të varur nga Kompania e Distribucionit të Energjisë Elektrike e Kosovës (KEDS) për energji elektrike. Në dhjetor të vitit 2020, filloi instalimi i një linje të re kryesore elektrike nga qyteti i Dragashit në drejtim të fshatit Restelicë të banuar nga boshnjakët dhe goranët e Kosovës. Ajo pritej të lidhte të gjithë fshatrat e zonës dhe të përmirësonte cilësinë e shërbimit.

¹⁹ Përveç kësaj, mosmarrëveshjet me fshatin fqinj Kërstec penguan qasjen e fshatrave Rapqë e Epërme dhe Rapqë e Poshtme në burimet natyrore në zonën e tyre kadastrale. Në vitin 2019, komuna e Dragashit u përpoq të ndërmjetësonte në këtë çështje, por pa sukses.

Megjithatë, kjo ndërhyrje u zbatua vetëm pjesërisht dhe nuk adresoi plotësisht problemet që lidhen me infrastrukturën e rrjetit në zonën e Gorës. Në fund të vitit 2023, KEDS prezantoi planin strategjik për periudhën 2024-2026, duke ofruar një udhërrëfyes për instalimin e rrjetit të ri energjetik në fshatrat e zonës së Gorës.

Përveç kësaj, problemet e menaxhimit të mbeturinave në rajonin e Gorës vazhdojnë. Komuna e Dragashit, në bashkëpunim me Agjencinë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA), ka bërë përpjekje për të mbuluar të gjithë territorin e saj në planin komunal të menaxhimit të mbeturinave; megjithatë, ka fshatra që ende nuk janë mbuluar. Ky është rasti me fshatin Leshtan, Kërstec, Baçkë, Orqushë, Dikancë, Kukjan,²⁰ dhe Restelicë, ku OJQ-ja lokale *Eko Restelica* po trajton çështjet e menaxhimit të mbeturinave me fonde të pranuar nga kontributet vullnetare të banorëve dhe bizneseve.

Nga aspekti tjetër pozitiv, ndriçimi i rrugëve është përmirësuar ndjeshëm vitet e fundit në shumicën e zonave rurale të komunës së Dragashit, duke përmirësuar kështu kushtet e sigurisë së përgjithshme dhe personale të komunitetit. Trotualet janë të pranishme në të gjitha fshatrat kryesore.

Cilësia e infrastrukturës rrugore në zonat e banuara nga **goranët e Kosovës** në komunën e Dragashit është përmirësuar dukshëm gjatë dekadës së fundit. Rrugët për në të gjitha fshatrat e rajonit të Gorës janë të asfaltuara. Rruga kryesore rajonale nga Prizreni në Dragash është zgjeruar në disa pjesë, dhe pjesa e mbetur e rrugës është rindërtuar, ndërsa rruga nga qyteti i Dragashit deri në fshatin Brod është zgjeruar dhe rindërtuar.

Mirëpo, terreni malor në zonën e Gorës paraqet sfida shtesë për komunitetin. Rënia e shkëmbinjve, rrëshqitjet e dheut dhe ortekët paraqesin kërcënim për sigurinë dhe shkaktojnë bllokime të herëpashershme të rrugëve lokale që lidhin fshatrat e banuara nga **goranët e Kosovës**, veçanërisht gjatë stinës së dimrit.

Në përgjithësi, komuniteti **goran i Kosovës** nuk përballet me probleme të banimit, pasi shumica e pjesëtarëve të komunitetit janë pronarë të shtëpive të tyre, ndërsa disa posedojnë edhe banesa. Përveç kësaj, pjesëtarët e komunitetit **goran të Kosovës** në përgjithësi nuk kanë fatura të mëdha dhe të akumuluar komonale.

Komuniteti **goran i Kosovës** ka qasje të papenguar në varrezat e preferuara të tyre në të gjitha komunat ku ata banojnë, dhe në përgjithësi i përdorin varrezat islame së bashku me komunitetet tjera.

²⁰ Në zonën e Opojës, fshatrat Xërxë dhe Pllajnik, të banuara kryesisht nga shqiptarët e Kosovës, përballen me të njëjtën situatë. Në rastin e kësaj të fundit, një zyrtar komunal ka raportuar se kompania e menaxhimit të mbeturinave *Eko Regjioni* nuk është e gatshme që të ofroj shërbimet e saj për shkak të vendndodhjes së largët të fshatit dhe kostove shtesë që do t'i shkaktonte kompanisë.

5. Qasja në shërbime sociale, duke përfshirë edhe kujdesin shëndetësor

Komuniteti goran i Kosovës ka qasje në shërbimet sociale dhe shëndetësore përmes institucioneve të Kosovës dhe Beogradit, varësisht nga disponueshmëria e shërbimeve lokale. Për shembull, në Dragash, Gjilan dhe Kamenicë, komuniteti i përdor shërbimet sociale, kujdesin shëndetësor dhe sistemet e mirëqenies.

Në Prishtinë, Pejë dhe Ferizaj, komuniteti goran i Kosovës mbështetet në institucionet e Kosovës për qasje në shërbime, ndërsa në Graçanicë komuniteti kryesisht shfrytëzon e kujdesit shëndetësor të menaxhuara nga Beogradi, pasi ato siç raportohet se janë më të lira.

Në vitin 2018, 168 familje gorane të Kosovës, me 463 individë, kishin të drejtë për ndihmë sociale.²¹ Nuk ka në dispozicion të dhëna që tregojnë numrin e goranëve të Kosovës që pranojnë pension dhe/ose pagesë për aftësinë e kufizuar.

Viteve të fundit, qasja fizike dhe përballueshmëria e kujdesit shëndetësor, si dhe disponueshmëria e shërbimeve emergjente, janë përmirësuar, veçanërisht në fshatrat e banuara me goranë të Kosovës në zonën e Gorës.²² Megjithatë, për shkak të vendndodhjes së largët të zonës, ky komunitet është grupi me pozitën më të pafavorshme gjeografike në Kosovë. Shumica përdorin shërbime të taksisë ose ecin në këmbë për të marrë kujdesin e nevojshëm shëndetësor. Prandaj, pengesat e qasjes fizike mund t'i rrisin kostot financiare.

Disa mjekë goranë të Kosovës drejtojnë ordianca private dhe ofrojnë shërbime për banorët lokal. Për më tepër, pjesëtarët e komunitetit që posedojnë letërnjoftime të Serbisë dhe kartela të sigurimit shëndetësor kanë gjithashtu qasje në ofruesit e kujdesit shëndetësor të drejtuar nga Beogradi në Graçanicë dhe Mitrovicë Veriore, ndërsa për çështje më serioze shëndetësore komuniteti përdor edhe qendrat shëndetësore dhe klinikat në Beograd.

Megjithatë, goranët e Kosovës kanë më pak gjasa për të kryer kontrole të përgjithshme shëndetësore si pjesë e kujdesit parandalues në krahasim me komunitetet tjera joshumicë. Ky ngurrim është për shkak të barrierave kulturore, mungesës së fushatave në lidhje me shëndetin dhe mungesës së vetëdijes së përgjithshme për të drejtat e lidhura me shëndetin në radhët e komunitetit.²³

21 Institucioni i Avokatit të Popullit, *Raporti Vjetor 2018* (2019), f. 100.

22 Rrjeti i Grave të Kosovës, *Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë* (2016), fq. 54. (Qasur në dhjetor 2023).

23 Po aty, 52, 54.

Komuniteti goran i Kosovës ka shprehur shqetësime lidhur me qasjen në dokumentet e regjistrimit civil për personat e lindur jashtë Kosovës. Në vitin 2017 janë zbatuar procedura të reja për të thjeshtuar procesin e marrjes së dokumenteve zyrtare të Kosovës. Mirëpo, zyra e gjendjes civile në Dragash vazhdon të kërkojë nga anëtarët e komunitetit që të ndjekin procedurën e mëparshme, dhe kështu shumë goranë të Kosovës nuk kanë mundur të marrin dokumentet e regjistrimit. Keqinterpretime të tilla të dispozitave ligjore ekzistuese shkaktojnë vështirësi dhe pasiguri juridike për pjesëtarët e komunitetit goran të Kosovës dhe pengojnë të drejtat e tyre për të marrë dokumente personale.

6. Qasja në arsim

Nxënësit goranë të Kosovës janë të regjistruar si në shkollat me planprogram të Kosovës ashtu edhe në ato me planprogram të Serbisë.

Ata kryesisht vijojnë mësimin në shkollat me planprogram të Serbisë në gjuhën serbe në komunën e Dragashit, Graçanicës, Mitrovicës Veriore, dhe Kamenicës.

Nxënësit nga radhët e goranëve të Kosovës vijojnë shkollat me planprogram të Kosovës, kryesisht në gjuhën boshnjake por me raste edhe në gjuhën shqipe dhe turke në Mitrovicën Jugore, Prishtinë, Pejë, dhe Prizren. Arsimi në dialektin goran nuk është në dispozicion.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në vitin shkollor 2023/24 në arsimin parauniversitar janë regjistruar 314 nxënës goranë të Kosovës.²⁴

Në komunën e Prishtinës, nxënësit apo studentët goranë të Kosovës vijojnë shkollimin ose mësimin në gjuhën shqipe ose turke. Në komunën e Graçanicës rreth 30-40 nxënës goranë të Kosovës ndjekin shkollat me planprogram të Serbisë.

Në komunën e Dragashit, ku jetojnë shumica e goranëve të Kosovës, 590 nxënës janë regjistruar në shkollat me planprogram të Serbisë për arsimin fillor dhe të mesëm për vitin shkollor 2023/24. Një numër më i vogël i pjesëtarëve të komunitetit ndjekin mësimet në gjuhën boshnjake sipas planprogramit të Kosovës.

Në komunën e Dragashit, shkollat që ndjekin të dyja kurrikulat kryesisht u shërbejnë nxënësve goranë dhe boshnjakë të Kosovës, respektivisht. Mbi gjysma e nxënësve goranë të Kosovës në Dragash kanë vijuar katër shkolla me planprograme të përbashkëta në fshatrat Restelicë, Brod, Rapçë dhe Vranishtë. Në të kaluarën, edukatorët goranë dhe boshnjakë të Kosovës garonin për burimet e kufizuara, duke përfshirë hapësirën në klasa të përbashkëta, kabinete, madje edhe drutë e zjarrit, duke çuar në konkurrencë dhe mungesë të përgjithshme të besimit dhe bashkëpunimit ndërmjet mësuesve, si dhe në krijimin e tensioneve ndërmjet dy komuniteteve. Mirëpo, të dy sistemet tani duket se kanë burime më të kënaqshme. Që nga viti 2017, personeli nga shkollat që kanë objekte të përbashkëta në Brod dhe Restelicë, të cilat ballafaqoheshin me më së shumti probleme, përmirësoi bashkëpunimin e tyre për këto çështje dhe ia dolën të ulin tensionet dhe të rrisin qasjen e goranëve të Kosovës në arsim.

24 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Shënime Statistike 2023/2024. (Qasur në dhjetor 2023).

Mirëpo, situata e përgjithshme në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet shkollave që ndjekin dy planprogramet e ndryshme në këtë komunë mbetet e brishtë.

Viteve të fundit shkollat fillore dhe të mesme në qytetin e Dragashit, ku ishin të përqendruar shumë goranë të Kosovës, u zhvendosën në Lubovishtë dhe Mlikë dhe tani janë modernizuar.

Duke pasur parasysh terrenin malor të rajonit të Gorës, sfidat që kanë të bëjnë me transportin e nxënësve kanë krijuar probleme me qasjen në shkolla, veçanërisht gjatë stinës së dimrit. Komuna ka angazhuar një kontraktues për të siguruar transportin e nxënësve goranë të Kosovës të cilët vijnë shkollat sipas planprogramit të Kosovës. Transporti për nxënësit që ndjekin shkollat sipas planprogramit të Serbisë është mbështetur nga institucionet e drejtuara nga Beogradi, nëpërmjet një kompanie të jashtme. Në disa raste, veçanërisht gjatë muajve të dimrit, prindërit bënin organizimin e udhëtimit për fëmijët e tyre.

Rastet e braktisjes janë të rralla në mesin e nxënësve goranë të Kosovës dhe më së shpeshti vijnë nga migrimi i familjeve. Braktisjet zakonisht monitorohen nga shkollat dhe, kur është e nevojshme, adresohen rast pas rasti.

Për shkollat që ndjekin planprogramin e Serbisë, Ministria e Arsimit e Serbisë i siguron tekstet shkollore. Nxënësit goranë të Kosovës që vijnë në mësim sipas planprogramit të Kosovës, veçanërisht në gjuhën turke dhe boshnjake, përballen me sfida që lidhen me mungesën e manualeve dhe teksteve shkollore në gjuhën boshnjake dhe turke, mungesën e trajnimit të mësuesve dhe mbështetjen në tekstet e vjetra që nuk ndjekin planprogramin e ri.

Arsimi universitar në serbisht ofrohet në Universitetin e Mitrovicës Veriore, ku regjistrohen shumë studentë goranë të Kosovës. Një numër më i vogël zgjedh të ndjekë planprogramin e Kosovës, kryesisht në gjuhën boshnjake, por edhe në gjuhën shqipe dhe turke, në universitetet në Prizren, Pejë dhe Prishtinë. Në vitet 2019–2020, 303 goranë të Kosovës janë regjistruar në universitete.²⁵

Sa i përket arsimit të lartë, studentët goranë të Kosovës përballen me shumë sfida në qasjen në arsimin universitar sipas planprogramit të Kosovës, duke filluar nga barrierat gjuhësore, mos disponueshmëria e testeve pranuese në gjuhën e preferuar, apo mungesa e vendeve të rezervuara për anëtarët e komunitetit në universitete, të cilat në teori garantojnë nga legjislacioni ekzistues.²⁶ Përveç kësaj, diplomat parauniversitare sipas planprogramit të Serbisë të pranuar në Kosovë shpesh nuk njihen, duke e penguar më tej qasjen në arsimin universitar sipas planprogramit të Kosovës. Prandaj, shumë studentë goranë të Kosovës preferojnë të studiojnë jashtë Kosovës në universitetet serbe, por edhe në Maqedoni të Veriut, Turqi dhe Bullgari.

²⁵ Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Shënime Statistike 2019/2020.

²⁶ Studentëve të universiteteve jo-shumicë u garantojnë 12 për qind e vendeve në programet e arsimit të lartë, si dhe në konviktet dhe mensat e studentëve. Për më tepër, ligji i lejon anëtarët e komunitetit që t'i nënshtrohen provimeve pranuese në universitet në gjuhën e tyre amtare dhe e rregullon shpërndarjen e bursave dhe ndihmës sociale për këta studentë.

Nuk ekzistojnë pengesa strukturore për qasje të barabartë në arsimin e detyrueshëm për djemtë dhe vajzat **gorane të Kosovës**. Megjithatë, në arsimin e mesëm dhe universitar janë të regjistruara shumë më pak femra sesa meshkuj, veçanërisht në komunën e Dragashit.

Ndërveprimi ndërmjet studentëve **goranë të Kosovës** dhe studentëve të komuniteteve të ndryshme është i kënaqshëm, pa ndonjë incident apo problem të fundit të sigurisë. Megjithatë, menaxherët e shkollave dhe universiteteve në përgjithësi nuk promovojnë iniciativa për të bashkuar studentët nga komunitete të ndryshme.

7. Qasja në drejtësi

Nuk ka përfaqësues të komunitetit goran të Kosovës të punësuar në asnjë nga institucionet jogjyqësore: Agjencia për Ndhimë Juridike Falas (ANFJL), Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) dhe Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave (ZMNV). Për më tepër, dy avokatë goranë të Kosovës, të dy burra, janë të licencuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK).

Monitorimi i OSBE-së tregon se pjesëtarët e komunitetit goran të Kosovës janë në një farë mase të vetëdijshëm për shërbimet e ofruara nga ANJF, IAP, dhe ZMNV. Megjithatë, niveli i ndërgjegjësimit ndryshon nga njëra komunë te tjetra. Veçanërisht, pjesëtarët e komunitetit goran të Kosovës në komunën e Prizrenit dhe të Dragashit kanë njohuri të kufizuara për shërbimet e ofruara nga ANJF, IAP dhe ZMNV, ndonëse këto institucione kanë shtrirje në rajone, për shkak të mungesës së aktiviteteve për vetëdijësim dhe mungesës së përpjekjeve të kontaktimit nga këto institucione me synim komunitetin goran të Kosovës në këto komuna. Në vitin 2023, ANJF punësoi një zyrtar për të mbuluar komunat e Suharekës dhe Dragashit me qëllim që të ofrojë këshilla juridike falas për zonat rurale për komunitetet me të ardhura të ulëta.

IAP (ndryshe nga ZMNV dhe ANJF) është institucioni i vetëm që kryen vizita të rregullta mujore dhe të atypëratyshme në komuna të ndryshme dhe për këtë arsye ka dukshmëri më të mirë se dy ofruesit e tjerë të shërbimeve juridike. Megjithatë, është raportuar se IAP nuk kryen më vizita mujore në komunat në rajonin e Prishtinës; në vend të kësaj ato kryhen bazuar në nevojat dhe interesimin e qytetarëve.

Çdo tetor, ZMNV në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit dhe me mbështetjen e Ambasadës Amerikane organizon "Javën e të drejtave të viktimave të krimit". Megjithatë, është mendimi i përgjithshëm i palëve të interesit të intervistuar se fushata informuese duhet të organizohen gjatë gjithë vitit.

Përkundër disa fushatave informative të kryera nga institucione të ndryshme, duke përfshirë ZMNV-në, Ministrinë e Drejtësisë, OAK-në, dhe informacionit të ndarë me viktimat kur kërkojnë shërbime, ka shumë pak ose aspak njohuri rreth programit të kompensimit të viktimave të krimit (KVK).

Në vitin 2023, ANJF ofroi shërbime për 6,070 persona (përfshirë 2,883 gra), prej të cilëve 54 ishin pjesëtarë të komunitetit goran të Kosovës. Raportohet se në Prizren, anëtarët goranë të Kosovës rrallë i shfrytëzojnë shërbimet e IAP-së.²⁷

²⁷ Sipas bashkëbiseduesve nga Prizreni.

Në vitin 2023, IAP ka pranuar gjithsej 1,660 ankesa (1,162 burra dhe 498 gra)²⁸, që kanë përfshirë 4296 persona. Nga numri i përgjithshëm i ankesave, dy vinit nga komuniteti **goran i Kosovës**. ZMNV ka trajtuar 1009 raste në vitin 2023, nga to dy viktima ishin nga radhët e komunitetit **goran të Kosovës**.

Pjesëtarët e komunitetit janë të lirë të zgjedhin përfaqësuesit e tyre ligjorë. Mirëpo, në rastet e përfaqësimit sipas detyrës zyrtare në lëndët penale, OAK cakton avokatë sipas radhës së avokatëve të shënuar në listë, të cilët flasin rrjedhshëm gjuhën e komunitetit që përfaqësojnë apo atë të pjesëtarëve të komunitetit përkatës.

Komuniteti **goran i Kosovës** nuk përballlet me sfida në qasjen në gjykata dhe shërbime juridike. Veçanërisht, të tria institucionet i ofrojnë shërbimet e tyre pa pagesë dhe kanë staf shumëgjuhësor/shumetnik i cili mund të komunikojë dhe të ofrojë shërbime në të gjitha gjuhët zyrtare, siç kërkohet në rajonin e Prizrenit, përkatësisht në gjuhën shqipe, serbe/boshnjake dhe turke. Gjuha në përgjithësi nuk është pengesë për t'iu qasur shërbime ve ligjore.

Veçanërisht, Gjykata Themelore e Prizrenit ka tre përkthyes gjyqësor të punësuar në mënyrë të përhershme për gjuhën boshnjake/serbe, e cila përgjithësisht flitet në mesin e komunitetit **goran të Kosovës**. Prokuroria Themelore e Prizrenit ka të punësuar një përkthyes të përhershëm për gjuhën serbe/boshnjake. Megjithatë, tarifatat gjyqësore dhe ligjore, si dhe shpenzimet e udhëtimit mund të krijojnë pengesa për familjet në nevojë që nuk kanë të ardhura të rregullta dhe mund të pengojnë qasjen në gjykata për të zgjidhur çështjet civile.

28 Raporti Vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit 2023.

8. Përdorimi i gjuhës dhe mediat

Në jetën e tyre të përditshme dhe në ndërveprimet private, komuniteti goran i Kosovës flet gjuhën gorane, që është dialekt i sllavishtes. Komuniteti goran i Kosovës ndihet mjaft i lirë në përdorimin e dialektit në ndërveprimet e përditshme, ndërsa shumica e përdorin gjuhën serbe dhe shqipe në komunikimin formal me institucionet.

Gjeneratat e reja, veçanërisht në Prishtinë, janë më me gjasë ta mësojnë shqipen.

Dialekti goran tradicionalisht është përdorur kryesisht në rajonin e Gorës në komunën e Dragashit. Dialekti nuk njihet si gjuhë zyrtare apo gjuhë në përdorim zyrtar në asnjë komunë të Kosovës dhe komuniteti asnjëherë nuk e ka ndjekur një qëllim të tillë. Për shkak se format e shkruara të dialektit nuk janë në përdorim të gjerë, ajo ruhet kryesisht përmes të folurit të përditshëm dhe këngëve popullore folklorike.

Shumë goranë të Kosovës në zonën e Gorës të komunës së Dragashit dhe rajoneve të tjera – veçanërisht femrat – nuk flasin apo kuptojnë shqip, gjë që kufizon aftësinë e tyre për të komunikuar me komunitetin shumicë, si dhe me institucionet lokale dhe qeveritare. Për shembull, në Prishtinë situata është veçanërisht e vështirë për gratë gorane të Kosovës të cilat nuk e flasin gjuhën shqipe dhe kanë shkallë të lartë të papunësisë, shpesh përkundër faktit që kanë diploma universitare. Për këtë arsye, anëtarët e komunitetit goran të Kosovës kanë shprehur interesim për të mësuar gjuhën shqipe për të përmirësuar ndërveprimet publike, veçanërisht me mësuesit dhe nëpunësit civilë.

Në komunën e Dragashit, të gjitha tabelat topografike dhe të rrugëve përdorin gjuhën shqipe dhe serbe/boshnjake. Për më tepër, disa emra rrugësh dhe vendbanimesh në fshatra janë shkruar në dialektin goran, duke përfshirë edhe disa emra tradicionale vendorë. Banorët e secilit fshat në zonën e Gorës u konsultuan përpara se komuna të miratonte dhe të vendoste tabelat e reja të rrugëve.

Për ata që shohin faqet e internetit të komunave, komuniteti goran i Kosovës mbështetet në informacionet e publikuara në serbisht dhe/ose boshnjakisht, të cilat përgjithësisht janë të përhapura në faqet e internetit të komunave.

Komuniteti goran i Kosovës përdor gjuhën serbe për të pranuar informacione dhe shërbime publike, duke përfshirë faturat e shërbimeve, taksat e ndryshme dhe faturat tjera. Në këtë drejtim, komuniteti ka pasur qasje relativisht të mirë në dokumente publike, veçanërisht në komunën e Dragashit.

Komuniteti **goran i Kosovës** ka qasje në disa media lokale në gjuhën e tyre amtare. Këto përfshijnë "Radio Gora" (e cila transmeton në serbisht/boshnjakisht dhe dialektin goran) dhe ueb-portali lokal "Gora Press", i cili ndjek kryesisht zhvillimet lokale.²⁹ Televizioni publik i RTK-së transmeton program të veçantë për komunitetin në dialektin goran, "Svetlo Gore" (Drita e Gorës), i cili transmetohet të shtunën e fundit të çdo muaji. Programi është kryesisht lajme ose dokumentarë me titra që janë shfaqur në RTK2 dhe RTK3. Përveç kësaj, pjesëtarët e komunitetit **goran të Kosovës** kanë qasje të plotë në mediat në gjuhën serbe dhe boshnjake në Kosovë dhe në rajon.

²⁹ Ueb portali "[Gora Press](#)" luajti rol të rëndësishëm në transmetimin dhe përkthimin e lajmeve gjatë pandemisë COVID-19, kur informacioni në gjuhët e komunitetit nuk ishte lehtësisht i disponueshëm.

9. Trashëgimia kulturore dhe fetare, liritë fetare

Goranët e Kosovës janë komunitet mysliman që ndan objektet fetare me komunitetin shqiptar të Kosovës. Në përgjithësi, komuniteti është i lirë për të shprehur bindjet e tij fetare dhe kulturore. Kohëve të fundit nuk është raportuar për ndonjë incident të sigurisë.

Një monument i rëndësishëm fetar për goranët e Kosovës është xhamia e shekullit të 19-të në fshatin Mlikë në Dragash, e cila është në listën e objekteve të trashëgimisë kulturore nën mbrojtjen e përkohshme të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Është një nga xhamitë më të vjetra në rajon.

Përveç festave tradicionale myslimane, komuniteti goran i Kosovës feston fillimin e pranverës, ditën e Shën Gjergjit, më 5 deri më 6 maj, festë zyrtare në Kosovë. Për këtë rast organizohen ngjarje kulturore, kryesisht në rajonin e Prizrenit. Muzika tradicionale gorane është gjithashtu komponent i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore të komunitetit dhe vallja e famshme "kolo" (Rrethi) e shoqëruar me muzikë instrumentale praktikohet gjerësisht në Kosovë.

10. Të drejtat pronësore

Komuniteti goran i Kosovës përballet me sfida të ndërlydhura me pronën, të ngjashme me ato të komuniteteve tjera joshumicë në Kosovë, veçanërisht në rajonin e Gjilanit dhe Prizrenit, siç është pasiguria e shkaktuar nga rrënimi i mundshëm i objekteve afariste, privatizimi i tokës në pronësi publike dhe shpronësimi i tokave në pronësi private, gjëra këto që ndikojnë ndjeshëm në statusin ekonomik të pjesëtarëve të komunitetit.

Në dhjetor të vitit 2019, autoritetet komunale në Kamenicë informuan një familje **gorane të Kosovës** se biznesi i tyre, një dyqan ëmbëlsirash i ndërtuar në vitin 1970 në tokën komunale, do të rrënohej për t'i hapur rrugë projekteve të investimeve kapitale. Me kërkesë të nënkryetarit për komunitete, kryetari i komunës e pezulloi urdhrin për rrënim; megjithatë, në prill to vitit 2020, dyqani i ëmbëlsirave dhe disa dyqane në pronësi të shqiptarëve të Kosovës u rrënuan për të krijuar sheshin kryesor publik të komunës së Kamenicës dhe për të niveluar shtratin e lumit.

Në shkurt të vitit 2012, institucionet shpronësuan pronë private për ndërtimin e gjashtë hidrocentraleve në komunën e Dragashit. Shpronësimi u kontestua nga komuniteti **goran i Kosovës**, siç raportohet për mungesë konsultimi me popullatën vendase dhe për shpronësim të paligjshëm. Përfaqësuesit e pronarëve të pronave kanë paraqitur disa padi kundër komunës së Dragashit në Gjykatën Themelore në Prizren; megjithatë, më vonë ata tërhoqën paditë e tyre në këmbim të kompensimit.

Autoritetet komunale në Dragash kanë penguar qasjen në kullosa të pjesëtarëve të komunitetit **goran të Kosovës** për shkak të përpjekjeve për privatizimin e tyre që nga viti 2006. Toka ka qenë në pronësi të një ndërmarrjeje shoqërore. Rasti është ende i pazgjidhur, në pritje të një vendimi të Gjykatës Supreme të Kosovës që nga viti 2010. Privatizimi i kullosave rrezikon kullotjen e bagëtive, burim ky i rëndësishëm i të ardhurave për komunitetin **goran të Kosovës**.³⁰

30 Rasti është në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që kanë të bëjnë me Agjencinë e Privatizimit.

11. Kthimi dhe riintegrimi

Pas konfliktit të vitit 1999, shumë goranë të Kosovës u larguan nga Kosova për arsye sigurie si dhe për kërkim të mundësive afatgjata për përmirësim të gjendjes sociale dhe ekonomike.

Shumica migruan në Beograd dhe pjesë të tjera të rajonit, dhe shumë të tjerë shkuan në Evropën Perëndimore. Nuk ka të dhëna të sakta për numrin e personave të zhvendosur të komunitetit goranë të Kosovës.

Qasja e kufizuar në punësim dhe jetesë më e mirë, si dhe sfidat në lidhje me zgjedhjen e sistemit arsimor, janë pengesat kryesore për kthimin dhe riintegrimin e qëndrueshëm të personave të zhvendosur nga radhët e komunitetit goranë të Kosovës. Sipas UNHCR-së, që nga viti 1999, 1,464 goranë të Kosovës janë kthyer në Kosovë. Megjithatë, ndërmjet viteve 2015 dhe 2023, vetëm 29 individë janë kthyer, kryesisht në komunën e Dragashit.³¹

Përkundër kërkesave të përsëritura përgjatë shumë viteve, Qeveria dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk kanë arritur që të sigurojnë ndonjë fond për të ndihmuar kthimin në komunën e Dragashit, ku tradicionalisht kanë jetuar shumica e goranëve të Kosovës. Andaj, vizitat "Shko-shih" apo "Shko-informohu" nuk janë organizuar për këtë komunitet në komunë.³² Për më tepër, aktualisht nuk ekzistojnë projekte aktive të kthimit që për synim e kanë komunitetin goranë të Kosovës, dhe projektet e BE-së për kthim dhe riintegrim nuk e kanë përfshirë asnjëherë komunën e Dragashit. Mungesa e mbështetjes institucionale për lehtësimin e kthimit të goranëve të Kosovës ka bërë që shumë përfaqësues të komunitetit të pohojnë se serbët e Kosovës, komuniteti më i madh jo-shumicë në Kosovë, pranojnë pjesën më të madhe të ndihmës për kthim për shkak të manovrave politike, ndërsa personat e zhvendosur dhe të kthyerit nga komunitetet më të vogla janë lënë pas dore. Në vitin 2023, megjithatë, Ministria për Komunitete dhe Kthim ndërmori hap të rëndësishëm duke shpallur thirrje për të ofruar ndihmë thelbësore për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë.³³

31 Në vitin 2015 dhe 2018, 28 individë janë kthyer në komunën e Dragashit, dhe në vitin 2017 një individ është kthyer në komunën e Prizrenit. UNHCR Zyra e shefit të misionit, në Prishtinë, Vështrim statistikor (dhjetor 2023).

32 Vizitat shko dhe shih u ofrojnë personave të zhvendosur mundësinë për të mbledhur informacion të dorës së parë për kushtet në vendin e tyre të origjinës dhe për të bashkëvepruar dhe angazhuar drejtpërdrejt me komunitetin pritës për të marrë vendim të informuar për kthimin ose për të bërë zgjidhje të tjera të qëndrueshme.

33 Vendimi për vendosjen e procedurave për ofrimin e ndihmës nga Ministria për komunitete dhe kthim për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, i lëshuar më 2 shkurt 2023: [Vendim i procedurave për ofrimin e ndihmës-Odruka o proceduri pruzenja pomoci_compressed_compressed-compressed \(1\).pdf \(rks-gov.net\)](#), (Qasur në dhjetor 2023).

Nisma kishte për qëllim adresimin e nevojave të ndryshme, duke përfshirë ofrimin e artikujve ushqimorë dhe jo ushqimorë, si dhe mbështetje për ndërtimin dhe rindërtimin e shtëpive. Për më tepër, Ministria zgjeroi shtrirjen e saj për të forcuar sektorin e bujqësisë, duke ofruar subvencione për të lehtësuar praktikën e qëndrueshme bujqësore. Njëkohësisht, pati përpjekje të përkushtuar për të mbështetur bizneset e vogla brenda këtyre komuniteteve. Si rezultat i thirrjes, Ministria ka mbështetur një familje **gorane të Kosovës** në Dragash duke ofruar mbështetje për biznes të vogël në vlerë prej 13,200 euro.³⁴

Krahas pengesave institucionale, të kthyerit **goranë të Kosovës** përballen me papunësi dhe paqëndrueshmëri ekonomike. Këto sfida ekonomike janë veçanërisht të përhapura tek të rinjtë, të cilët kanë vështirësi me qasjen në programet arsimore në gjuhën e tyre të preferuar.

34 Të dhënat nga Ministria për Komunitete dhe Kthim u ndanë me Misionin e OSBE-së në Kosovë më 6 shkurt 2024.



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Foto: Christophe Quirion

Profili i komunitetit

malazez të Kosovës

osbe

Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Profili i komunitetit malazez të Kosovës

Komuniteti malazez i Kosovës është nga komunitetet më të vogla në Kosovë. Mijëra pjesëtarë të këtij komunitetit kanë emigruar gjatë 30 viteve të fundit, veçanërisht pas konfliktit të vitit 1999 dhe vetëm një numër i vogël i tyre është kthyer.

Ndonëse Kushtetuta e Kosovës nuk i klasifikon malazezët e Kosovës si komunitet në vete, sipas Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve ata konsiderohen si një nga komunitetet në Kosovë.¹

Nuk ekzistojnë shifra zyrtare të popullsisë për komunitetin malazez të Kosovës, meqë ky komunitet nuk ishte përfshirë si grup i veçantë në regjistrimin e popullsisë së vitit 2011.² Në regjistrimin e vitit 1981 në Jugosllavi, vlerësimi i fundit zyrtar në të cilin ishte përfshirë komuniteti malazez i Kosovës, 27,028 persona nga numri total i banorëve të Kosovës (ose 1.7 për qind) ishin deklaruar si malazezë. Vlerësimet aktuale tregojnë se komuniteti malazez i Kosovës në Kosovë numëron afërsisht 265 persona (0.01 për qind e popullsisë), duke bërë që malazezët e Kosovës të jenë komuniteti i dytë më i vogël në Kosovë.³

Komuniteti malazez i Kosovës nuk është shumicë në asnjë vendbanim në Kosovë. Pjesëtarët e tij janë kryesisht të përqendruar në rajonin perëndimor të Pejës, ku përfaqësojnë 0.2 për qind të banorëve në komunën e Istogut,⁴ 0.03 për qind në Pejë, 0.007 për qind në Deçan dhe 0.005 për qind në Klinë. Në komunën e Fushë Kosovës, 0.28 për qind e popullatës janë malazezë të Kosovës. Në Lipjan, komuniteti malazez i Kosovës kryesisht banon në qytet dhe në fshatin Grackë e Vjetër. Numri i përgjithshëm i tyre është 45, duke përfshirë gjashtë nxënës të shkollës fillore dhe 13 nxënës të ciklit të ulët/të mesëm.

1 Neni 1.4 i Ligjit Nr. 04/L-020 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë, i përkufizon komunitetet si grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare, tradicionalisht të pranishme në Kosovë që nuk janë shumicë.

2 Regjistrimi i popullatës i vitit 2011 ishte i pari që u mbajt që nga viti 1981 dhe u krye përmes kuadrit ligjor të përcaktuar me Ligjin e regjistrimit të popullatës të vitit 2010. Gëzim Visoka dhe Elvin Gjevori, "Politika e regjistrimit të popullatës dhe përkatësia etnike në Ballkanin Perëndimor," *Politika e Evropës Lindore*, 29 (4), 2013, faqet 479–498.

3 OSBE, *Profilet Komunale 2018*. Vlerësimi bazohet në të dhënat e OSBE-së dhe vlerësimet e përfaqësuesve të komunitetit. Vetëm komuniteti kroat i Kosovës në Kosovë është më i vogël.

4 Katërmbëdhjetë pjesëtarë të komunitetit.

Faktet dhe çështjet kryesore

- Për shkak të numrit të tij të vogël, komuniteti **malazez i Kosovës** nuk ka vende të garantuara në Kuvend.
- Shumica e incidenteve të raportuara të sigurisë kundër pjesëtarëve të komunitetit **malazez të Kosovës** përfshijnë uzurpimin e paligjshëm të pronës, të gjitha nga të cilat janë raportuar në rajonin e Pejës nga të kthyerit dhe personat e zhvendosur.
- **Malazetët e Kosovës** ndjekin mësimin sipas planprogramit në gjuhën serbe. Si të tillë, folësit e gjuhës malazeze kanë përvoja të ngjashme për sa i përket të drejtave gjuhësore me ato të folësve të gjuhës serbe.
- Komuniteti malazez, i cili kryesisht jeton në zona rurale të Kosovës, përballet me shkallë të lartë të papunësisë dhe barriera gjuhësore që kanë të bëjnë me mësimin e shqipes si një nga dy gjuhët zyrtare.

1. Siguria dhe rendi

Në përgjithësi, komuniteti malazez i Kosovës ndan të njëjtat shqetësime për sigurinë si komuniteti serb i Kosovës.⁵

Shumica e incidenteve të sigurisë që përfshijnë këtë komunitet kanë të bëjnë me pronat e malazezëve të zhvendosur të Kosovës që janë të uzurpuara nga komunitetet shumicë. Për shembull, në dhjetor 2016 ndodhi një incident i rëndë gjatë një "vizite shko dhe shih"⁶ në pronat e katër malazezëve të moshuar të Kosovës dhe katër personave të zhvendosur serbë të Kosovës (tri ishin gra), që kulmoi me evakuimin e tetë personave nga komuna e Deçanit pas ngritjes së tensioneve.⁷

Malazezët e Kosovës kanë qenë të përfaqësuar në Policinë e Kosovës me dy punonjës në Mitrovicë Veriore dhe një në Pejë deri në vitin 2019. Në vitin 2023, vetëm një pjesëtar i këtij komuniteti shërbente në Policinë e Kosovës në Gjilan.

Nuk ka pjesëtarë të komunitetit malazez të Kosovës në Komitetet Lokale të Sigurisë Publike (KLSP).⁸

5 Sipas monitorimit të brendshëm të OSBE-së ka pasur një incident në vitin 2013, tre në vitin 2014, katër në 2015, dy në 2016, tre në 2017, një në 2018, dy në 2019, asnjë në 2020, një në 2021 dhe asnjë në vitin 2022 dhe 2023.

Uzurpim i tokës në pronësi të komunitetit malazez të Kosovës është raportuar në qershor të vitit 2015, në Vitomiricë, në shtator 2015, në Pejë, në qershor 2016, në fshatin Serbobran, në Istog, në maj 2018 dhe në mars 2019 në Pejë, dhe në vitin 2021 në Klinë.

6 Vizitat shko dhe shiko u ofrojnë personave të zhvendosur mundësinë për të mbledhur informacion të dorës së parë për kushtet në vendin e tyre të origjinës dhe për të bashkëvepruar dhe angazhuar drejtpërdrejt me komunitetin pritës për të marrë vendim të informuar për kthimin ose për të bërë zgjidhje të tjera të qëndrueshme.

7 Pronat në fjalë janë në Dashinoc, Pozhar dhe Lumbardh. Gjatë takimit, një punonjës i komunës, shqiptar i Kosovës deklaroi se vizita u pa si "provokim i drejtpërdrejtë" ndaj atyre, familjarët e të cilëve ishin vrarë ose zhdukur si pasojë e konfliktit të viteve 1998-1999. Që nga ai takim, nuk ka pasur të kthyer tjerë në komunën e Deçanit.

Në shtator 2017, një grua e kthyer malazeze e Kosovës i raportoi një zyrtari në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në Deçan se derisa po dilte nga banesa e saj, ishte ngacmuar disa ditë me radhë nga një i ri shqiptar i Kosovës.

8 Që nga nëntori 2023.

2. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi

Në qeverinë e formuar më 2021 nuk ishte asnjë ministër nga komuniteti malazez i Kosovës. Një zëvendësministër vjen nga ky komunitet.⁹

Komuniteti malazez nuk ka ulëse të garantuara në Kuvend dhe nuk ka deputetë nga radhët e këtij komuniteti. Megjithatë, komuniteti malazez i Kosovës nuk ka munguar plotësisht në strukturat qeveritare; për shembull, një grua malazeze e Kosovës ishte këshilltare e ministrit për komunitete dhe kthim nga viti 2008 deri në vitin 2020.

Komuniteti malazez i Kosovës ka pasur dy ulëse të rezervuara në Këshillin Konsultativ për Komunitete (KKK) që nga themelimi i tij. Në mandatin më të fundit dyvjeçar të KKK-së, nga shtatori 2022, pozitat mbaheshin nga një grua dhe një burrë.¹⁰

Që nga viti 2017, pjesëtarët e komunitetit përbënin 0.03 për qind të nëpunësve publikë të nivelit qeveritar.¹¹

Komuniteti përfaqësohet në komitetet e komuniteteve në tre komuna: Deçan, Fushë Kosovë dhe Lipjan.¹² Për më tepër, tre malazezë të Kosovës (një burrë dhe dy gra) janë anëtarë të ZKKK-ve në Istog, Pejë dhe Rahovec. Nuk ka nënkryetarë të komunave për komunitete apo zëvendëskryesues të kuvendit komunal për komunitete nga ky komunitet.

Dy malazezë të Kosovës përfaqësohen në Këshillin Komunal të Sigurisë në Bashkësi (KKSB): një grua në Obiliq dhe një burrë në Fushë Kosovë.

Në Kosovë veprojnë disa organizata të shoqërisë civile të malazezëve të Kosovës, duke përfshirë Shoqatën e Malazezëve të Kosovës, organizatën kulturore Shoqata e Malazezëve të Kosovës MATICA, Shoqatën e Grave me Prejardhje nga Mali i Zi dhe Shoqatën e Malazezëve Lovqen.

9 Z. Llazar Radulloviq u emërua zëvendësministër i Bujqësisë nga Kryeministri Kurti në janar 2023, pasi më parë kishte shërbyer si këshilltar i Ministrit për Komunitete dhe Kthim.

10 Gruaja përfaqësonte organizatën joqeveritare Shoqata e Grave me prejardhje nga Mali i Zi, dhe burri përfaqësonte OJQ-në Shoqata e Malazezëve të Kosovës.

11 OSBE, *Përfaqësimi i komuniteteve në Shërbimin Civil në Kosovë* (maj 2017).

12 Nga tre anëtarët e komiteteve për komunitete, dy janë gra.

3. Punësimi dhe gjendja socio-ekonomike

Komuniteti malazez i Kosovës është përballur me nivele të larta të papunësisë dhe barriera gjuhësore në arsimin formal.¹³ Pjesëmarrja e pjesëtarëve të komunitetit në tregun aktiv të punës është mjaft e kufizuar. Malazezët e Kosovës përgjithësisht jetojnë në zona rurale dhe merren me bujqësi. Nuk ka të dhëna të besueshme në dispozicion për shkallën e papunësisë për këtë komunitet.

Në vitin 2018, vetëm nëntë persona që i përkisnin komunitetit malazez të Kosovës ishin regjistruar si të papunë (tetë gra dhe një burrë). Asnjë pjesëtar i komunitetit malazez të Kosovës nuk është përfshirë në ndërmjetësim të punësimit dhe/ose trajnim profesional të organizuar nga institucionet e Kosovës.¹⁴

Shumë pak pjesëtarë të komunitetit malazez të Kosovës janë të punësuar në sektorin e shërbimeve publike. Që nga viti 2017, të punësuarit nga ky komunitet mbanin poste të nivelit administrativ ose teknik.¹⁵

Që nga dhjetori 2015, në rajonin e Prishtinës, një grua malazeze e Kosovës ishte zyrtare për të drejtat e njeriut në komunën e Obiliqit. Në Lipjan, dhjetë malazezë të Kosovës punonin në sektorin e arsimit, dhe dhjetë ishin të punësuar në sektorin e shëndetësisë (12 gra dhe tetë burra).

Në rajonin e Pejës, tre malazezë të Kosovës janë të punësuar në sektorin publik. Dy gra malazeze të Kosovës kanë punuar në zyrat komunale për komunitete dhe kthim në komunat e Pejës dhe Istogut. Një malazez i Kosovës ka punuar si komandant i policisë së Kosovës në fshatin Gorazhdec në komunën e Pejës.

Pjesëtarët e komunitetit, veçanërisht të kthyerit, janë përfitues të projekteve të gjenerimit të të ardhurave që realizohen nga organizata donatore, si Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM). Këto projekte kryesisht konsistojnë në financimin e makinerive bujqësore dhe mjeteve të tjera të punës. Për shembull, komandanti malazez i Kosovës i stacionit policor në Gorazhdec ka përfituar nga një skemë e tillë, por edhe nga projekti i rindërtimit të shtëpive Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë i financuar nga Zyra e Komisionit Evropian dhe i zbatuar nga IOM-i. Një tjetër malazez i Kosovës nga komuna e Obiliqit ka përfituar nga një projekt për gjenerimin e të ardhurave që synon përmirësimin e riintegrit të të kthyerve.

Për këtë komunitet nuk është raportuar asnjë rast i punës së fëmijëve apo përfshirjes në ekonominë informale.

13 OSBE, *Qasja e komuniteteve në arsimin parauniversitar në Kosovë* (dhjetor 2018).

14 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Punës dhe Punësimit, *Raporti Vjetor 2018*, fq. 19, 34 dhe 41. E padisponueshme në gjuhën angleze.

15 OSBE, *Përfaqësimi i komuniteteve në Shërbimin Civil në Kosovë* (2017, fq. 14, 17 dhe 23).

4. Qasja në infrastrukturë dhe shërbimet publike

Malazezët e Kosovës në përgjithësi kanë qasje në infrastrukturë dhe shërbime publike, megjithëse ka sfida, duke përfshirë të tilla si menaxhimi i papërshtatshëm i mbeturinave dhe sistemet e kanalizimit.

Në rajonin e Pejës, pjesëtarët e komunitetit malazez të Kosovës jetojnë në numër të vogël në fshatrat rurale të komunës së Istogut, kryesisht në Serbobran, Shalinovicë, Osojan, Dragolevc dhe Zallq. Të gjitha rrugët kryesore që çojnë nga qendra urbane e komunës në këto fshatra janë të asfaltuara. Furnizimi me energji elektrike është përmirësuar, por ka ndërprerje të kohëpaskohshme gjatë motit. Vërehen probleme të herëpashershme lidhur me mungesën e sistemeve të përbashkëta të kanalizimit në zonat rurale. Ndonëse qyteti i Istogut dhe pothuajse të gjitha fshatrat janë të kyçura në rrjetin e ujësjellësit, asnjë nga fshatrat në Istog nuk ka qasje në sistem të kanalizimit¹⁶ me përjashtim të Dragolevcit, ku sistemi i kanalizimit është ndërtuar në vitin 2021. Në vitin 2020, ZKKK-ja mbështeti asfaltimin e rrugëve në Dragolevc dhe të rrugës ndërmjet Osojanit dhe Koshit. Dritat e rrugëve janë instaluar në fshatrat Dragolevc dhe Osojan. Në vitin 2020, ato u rregulluan dhe u zgjeruan nga IOM/ZKKK. Dritat e rrugëve u instaluan gjithashtu në Serbobran në vitin 2022. Në Osojan, shtyllat e energjisë elektrike janë zëvendësuar nga KEDS-i në vitin 2022.

Në komunën e Pejës, në qytetin e Deçanit dhe në fshatin Gorazhdec, problemet më të shpeshta e të përsëritura që prekin komunitetin janë menaxhimi joadekuat i mbeturinave dhe mungesa e një sistemi funksional të kanalizimit.

Në rajonin e Prishtinës, disa pjesëtarë të komunitetit malazez të Kosovës banojnë në zonat rurale në komunat si Graçanicë, Fushë Kosovë (Lagja Parku i Makinerisë dhe në fshatrat Bresje e Kuzmin), dhe Lipjan (në Lagjen e Re dhe në fshatin Grackë e Vjetër).

Në të dyja komunat ka infrastrukturë rrugore. Furnizimi me energji elektrike është stabilizuar viteve të fundit, megjithëse mbeten probleme serioze me menaxhimin e mbeturinave dhe sistemin e kanalizimit.

¹⁶ OSBE, *Profilet Komunale 2018: Istog* f. 6.

5. Qasja në shërbime sociale, duke përfshirë edhe shërbimet e kujdesit shëndetësor

Malazetët e Kosovës kanë qasje në asistencë sociale, kujdes shëndetësor dhe pensione si nga institucionet e udhëhequra nga Beogradi ashtu edhe nga institucionet e Kosovës.¹⁷

Në vitin 2018, katër familje malazeze të Kosovës (nëntë individë) e kishin fituar të drejtën për ndihmë sociale, sipas Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.¹⁸ Nuk disponohet me të dhëna të kategorizuara sipas komunitetit që tregojnë numrin e malazetëve të Kosovës që pranojnë pension dhe/ose kompensim për aftësinë e kufizuar.

Malazetët e Kosovës nuk përballen me vështirësi të konsiderueshme për t'u qasur në objektet dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor. Objektet shëndetësore janë në dispozicion në komunat dhe fshatrat ku ata banojnë. Malazetët e Kosovës në përgjithësi nuk kanë vështirësi financiare që pengojnë qasjen në kujdesin shëndetësor dhe, meqë rasti është i tillë, nuk ka pasur ndonjë fushatë ndërgjegjësimit për shëndetin publik enkas për këtë komunitet.

Në përgjithësi, malazetët e Kosovës nuk përballen me ndonjë problem me regjistrimin civil.

¹⁷ Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave në Kosovë, "Profili Komuniteti malazez" (dhjetor 2013), f. 59. (Shikuar për herë të fundit në dhjetor 2023.)

OSBE, "malazetët e Kosovës," *Profilet e Komuniteteve të Kosovës 2010* (2011), fq. 6.

¹⁸ Institucioni i Avokatit të Popullit, *Raporti Vjetor 2018* (2019), f. 100.

6. Qasja në arsim

Malazezët e Kosovës arsimohen në gjuhën serbe. Vlerësohet se fëmijët malazezë të Kosovës nuk përballen me pengesa të konsiderueshme për qasje në arsim bazuar në përkatësinë e komunitetit, gjininë ose moshën. Nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e saktë të rinjve malazezë të Kosovës të regjistruar në sistemin arsimor.

Nxënësit malazezë të Kosovës në Lipjan dhe Fushë Kosovë vijojnë mësimin sipas planprogramit të Serbisë (në shkollën Aca Maroviq, që ndanë objektin me shkollën Daut Bogujevci e cila funksionon sipas planprogramit të Kosovës në Fushë Kosovë). Megjithatë, shkollimin e mesëm nxënësit e vijojnë në Graçanicë. Komuna dhe prindërit kontribuojnë në mbulimin e kostos së transportit të nxënësve. Fëmijët malazezë të Kosovës që vijojnë mësimin sipas planprogramit të Serbisë grupohen me fëmijët serbë të Kosovës në klasa dhe kënde lojërash të ndara nga nxënësit që ndjekin mësimin sipas planprogramit të Kosovës në të njëjtën ndërtesë. Nxënësit malazezë të Kosovës priren të socializohen më shumë me nxënësit serbë dhe romë të Kosovës për shkak të gjuhës dhe arsye të tjera.

Në rajonin e Pejës, Malazezët e Kosovës ndjekin shkollat me planprogram të Serbisë pa asnjë pengesë të vërejtur në aspektin e arsimit. Shkolla në komunën e Istogut ofron transport për nxënësit. Përveç kësaj, qeveria e Serbisë rimbursos individualisht kostot e karburantit për prindërit, ngjashëm me praktikën që e ka me nxënësit serbë të Kosovës. Në komunën e Pejës shkolla është në Gorazhdec, ku banojnë nxënësit malazezë të Kosovës dhe për këtë arsye nuk ka nevojë për transport.

Në përgjithësi, braktisja e shkollës nuk konsiderohet problem për komunitetin malazez të Kosovës. Megjithatë, është e vështirë të sigurohen të dhënat dhe statistikatat për shkollat që punojnë me planprogram të Serbisë, veçanërisht në komunat e Fushë Kosovës dhe Lipjanit. Zyrtari komunal për arsim i Graçanicës raportoi se ka monitoruar vijueshmërinë e nxënësve malazezë të Kosovës dhe ka treguar se nuk ka braktisje nga ky komunitet. Drejtorja komunale e arsimit në Pejë nuk posedon të dhëna për nxënësit që ndjekin shkollat sipas planprogramit të Serbisë. Komuna e Istogut e ka numrin e përgjithshëm të nxënësve që ndjekin arsimin sipas planprogramit të Serbisë, por nuk ka të dhëna të kategorizuara sipas komunitetit. Megjithatë, drejtori i shkollës thekson se aty e vijojnë mësimin edhe nxënës malazezë të Kosovës.

Nuk ka lëndë specifike për komunitetin ku nxënësit malazezë të Kosovës do të mësonin për identitetin dhe kulturën e tyre.

Nxënësit malazezë të Kosovës ndjekin arsimin e lartë kryesisht në Universitetin e Mitrovicës së Veriut dhe në Serbi.

7. Qasja në drejtësi

Nuk ka përfaqësues të komunitetit malazez të Kosovës të punësuar në asnjë nga institucionet jogjyqësore: Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF), Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) dhe Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV). Për më tepër, nuk ka avokatë malazezë të Kosovës të licencuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK).

Pjesëtarët e komunitetit malazez të Kosovës në përgjithësi kanë qasje të gjerë në zyrat dhe institucionet ligjore. Sipas raportimeve, ata gëzojnë qasje të pakufizuar në shërbimet e autorizuar të ndihmës juridike falas. Megjithatë, pjesëtarët e komunitetit malazez të Kosovës raportohet se përgjithësisht nuk kanë njohuri për ANJF, IAP dhe ZMNV. Qasja në këto shërbime dhe institucione të tjera ligjore mund të paraqesë vështirësi për malazezët e Kosovës që jetojnë në zona të largëta, të cilët mund të jenë më të cenueshëm në aspektin social dhe/ose nuk mund ta përballojnë transportin.

Raportet nga terreni e theksojnë nevojën për fushata ndërgjegjësimi për këto shërbime të ndihmës juridike. Në rajonin e Pejës, ndërgjegjësimi i malazezëve të Kosovës përshkruhet si "mesatar", pasi që pjesëtarët e komunitetit vërehen duke përdorur shërbime të ngjashme alternative të disponueshme në komunat veriore.¹⁹ Gjithashtu, një përfaqësues i komunitetit malazez të Kosovës nga Lipjani vuri në dukje se ka pak gjasa që pjesëtarët e komunitetit të kenë njohuri të duhura për këto institucione dhe shërbimet që ato ofrojnë.

Në përgjithësi, pjesëtarët e komunitetit malazez të Kosovës nuk janë të vetëdijshëm për programin e kompensimit të viktimave të krimit (PKV), pavarësisht se IAP, ZMNV, ANJF dhe OAK i informojnë pjesëtarët e komunitetit për të drejtat, mjetet juridike dhe benefitet e tyre, duke përfshirë qasjen në programin e PKV-së, gjatë ndërveprimit të tyre me raste. Kështu, informacioni i pamjaftueshëm në lidhje me programin PVK tregon se vërtetë ka nevojë për seanca informative për të edukuar individët rreth të drejtave të viktimave, siç dëshmohet nga mungesa e aplikimeve për kompensim.

IAP është institucioni i vetëm që kryen vizita të rregullta mujore dhe ad-hoc në komuna të ndryshme dhe për këtë arsye ka dukshmëri më të mirë se dy ofruesit e tjerë të shërbimeve juridike. Megjithatë, është raportuar se IAP-ja nuk kryen më vizita mujore në komunat në rajonin e Prishtinës; tashmë, ato zhvillohen sipas nevojës dhe interesimit të qytetarëve.

¹⁹ Raporti Vjetor IAP 2023, <https://oik-rks.org/2024/03/29/> (Shikuar për herë të fundit në dhjetor 2023). Komuniteti malazez dhe përfaqësuesit e ZKKK-së në rajonin e Pejës.

Në Pejë dhe Istog, Klinë, ANJF kishte zhvilluar fushata ndërgjegjësuese, me synim të gjitha komunitetet joshumicë, duke shpërndarë fletëpalosje që shpjegojnë shërbimet e tyre, të disponueshme në gjuhën shqipe dhe serbe.

Çdo tetor, ZMNV, nën kujdesin e Zyrës së Kryeprokurorit dhe me mbështetjen e Ambasadës Amerikane, organizon "Javën e të drejtave të viktimave të krimit". Megjithatë, është mendimi i përgjithshëm i palëve të interesuara të intervistuar se fushata informuese duhet të organizohen gjatë gjithë vitit.

Në vitin 2023, ANJF ofroi shërbime për 6,070 persona (përfshirë 2,883 gra), asnjëra prej të cilëve nuk ishte pjesëtarë i komunitetit malazez të Kosovës. Në vitin 2023, IAP ka pranuar gjithsej 1,660 ankesa (1,162 burra dhe 498 gra)²⁰, ku përfshiheshin 4,296 persona, asnjëri prej të cilave nuk ishte nga komuniteti malazez i Kosovës (bazuar në numrin e rasteve në të cilat është deklaruar komuniteti; ka pasur 13 raste në të cilat komuniteti nuk është deklaruar). ZMNV nuk ka regjistruar asnjë viktimë nga radhët e malazezëve të Kosovës.

Siç raportohet, malazezët e Kosovës nuk kanë pengesa gjuhësore kur e përdorin sistemin ligjor. Kur është e nevojshme, atyre u ofrohen shërbime përkthimi në gjykata ose institucione të tjera gjyqësore ose jogjyqësore siç është IAP. Disa kanë vështirësi për t'i paguar tarifatat gjyqësore, por ligji e parasheh lirin nga pagesa duke pasur si bazë vështirësinë ekonomike.²¹

²⁰ Raporti Vjetor i IAP-së 2023, <https://oik-rks.org/2024/03/29/> (Shikuar për herë të fundit në dhjetor 2023).

²¹ Shih nenet 449–466 (shpenzimet procedurale), Ligji nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore, 20 shtator 2008 dhe Ligji nr. 04/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore, 16 tetor 2012.

8. Përdorimi i gjuhës dhe mediat

Gjuhë amtare e malazezeve të Kosovës është gjuha malazeze.²² Nuk ka pengesa domethënëse për këtë komunitet në aspektin e përdorimit të gjuhës së tyre në hapësira publike, institucione qeveritare dhe dyqane, si dhe për t'iu qasur shërbimeve komunale dhe publike. Duke qenë se gjuha malazeze është mjaft e ngjashme me gjuhën serbe, pjesëtarët e komunitetit përdorin gjuhën malazeze për ndërveprim me autoritetet publike.

Komuniteti malazez i Kosovës ka njëfarë qasje në media në gjuhën malazeze me burim nga Kosova. "Crnogorski mozaik" transmetohet çdo të premte në orën 18:00 në Transmetuesin Publik të Kosovës (RTK 2). Gjithashtu, për shkak të ngjashmërisë së gjuhëve malazeze dhe serbe, sipas përfaqësuesve të komunitetit, komuniteti malazez i Kosovës ka qasje në mediat në gjuhën serbe në Kosovë.

Në rajonin e Prishtinës përdoren faqet e internetit të komunave dhe llogaritë e mediave sociale për të përcjellë informacion tek publiku, duke përfshirë njoftimet për shtyp, ngjarjet dhe njoftimet për punë. OSBE-ja ka vërejtur vonesa të konsiderueshme në përditësimin e faqeve të internetit në komuna dhe llogarive të mediave sociale në të dyja gjuhët zyrtare, për shkak të kapacitetit të vogël të përkthimit në administratat komunale, veçanërisht në komunat e Lipjanit, Fushë Kosovës dhe Prishtinës. Megjithatë, informacioni që ka të bëjë me komunitetet dhe përfshirjen e tyre në çështjet sociale, siç janë punësimi dhe vendet e lira të punës, është përgjithësisht i disponueshëm dhe i përditësuar në të dyja gjuhët zyrtare. Shenjat komunale janë pjesërisht të vendosura në të dyja gjuhët zyrtare.

Ka shumë gjasë që gjenerata më e vjetër i flet dy gjuhët; megjithatë, të rinjtë më me gjasë flasin vetëm njërin nga gjuhët zyrtare. Pjesëtarëve të komuniteteve gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare mund t'iu duhet që të mësojnë njërin nga gjuhët zyrtare varësisht nga komuna.

²² Pas shpërbërjes së Jugosllavisë, katër gjuhë dolën nga gjuha e mëparshme zyrtare e njohur si gjuha serbo-kroate ose kroate-serbe: Gjuha boshnjake, kroate, malazeze, dhe serbe.

9. Trashëgimia kulturore dhe fetare, liritë fetare

Malazezët e Kosovës janë kryesisht të krishterë ortodoksë të cilët ndajnë pjesën më të madhe të trashëgimisë së tyre fetare dhe kulturore me serbët e Kosovës, duke përfshirë objektet fetare të Kishës Ortodokse Serbe dhe varrezat ortodokse.

Në përgjithësi, malazezët e Kosovës gëzojnë lirinë e fesë dhe u bashkohen serbëve të Kosovës në kremtimin e festave ortodokse në vendet e kultit. Incidentet që përfshijnë Kishën Ortodokse Serbe dhe varrezat ortodokse prekin edhe komunitetin malazez të Kosovës.²³

23 Informacione të mëtejshme janë dhënë në profilin e komunitetit serb të Kosovës.

10. Të drejtat pronësore

Pavarësisht përmirësimeve në politikën dhe kornizën legjislative për të drejtat pronësore në Kosovë, ende ka probleme.

Sikurse të gjitha komunitetet tjera, malazezët e Kosovës përballen me sfida në ushtrimin e të drejtave të tyre pronësore. Ndonëse disa komunitete janë më të prekura nga institucionet që shkelin ose dështojnë të mbrojnë të drejtat e tyre pronësore, siç është kompensimi joadekuat për pronën e shpronësuar ose rrënimi i shtëpive, malazezët e Kosovës më së shumti preken nga uzurpimi i pronës dhe qasja e pamjaftueshme në banim social.

Praktika e vazhdueshme e uzurpimit të pronës së komuniteteve të cenueshme kërkon veprim nga institucionet kosovare të zbatimit të ligjit.²⁴

Në vitin 2019, në qytetin e Pejës, një malazez i Kosovës raportoi në Policinë e Kosovës uzurpimin e ngastrës së tij tokësore.

Në vitin 2019, qeveria miratoi një kërkesë nga komuna e Deçanit për financimin e rindërtimit të një objekti në qytet për tetë familje, përfshirë këtu një familje malazeze të Kosovës.²⁵

24 Në vitin 2018, një person i zhvendosur malazez i Kosovës raportoi një rast uzurpimi të pronës në qytetin e Pejës. Policia e Kosovës e ka arrestuar të dyshuarin, i cili ka pohuar se ka qenë i vetëdijshëm se shtëpia nuk i takonte atij, por ai ishte futur në të pasi nuk kishte vend tjetër për të jetuar. Prokurori është njoftuar për rastin dhe ka urdhëruar lirimin e të dyshuarit në procedurë të rregullt. Çështja u zgjidh disa vite më vonë kur pronari e shiti pronën.

25 Këtë informacion e ka dhënë zyrtari komunal për komunitete dhe kthim në komunën e Deçanit.

11. Kthimi dhe riintegrimi

Mijëra malazezë migruan gjatë 20 viteve të fundit dhe relativisht pak janë kthyer.

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) raporton se 21 individë nga komuniteti malazez i Kosovës janë kthyer në Kosovë mes viteve 2010 dhe 2023.²⁶

²⁶ UNHCR, Zyra e shefit të misionit në Prishtinë, *Vështrim statistikor* (dhjetor 2023). Pesë persona janë kthyer në Pejë, dy në Istog, dhe një në Klinë.



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Foto: Yllka Fetahaj

Profili i komunitetit

rom të Kosovës

osbe

Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Profili i komunitetit rom të Kosovës

Komuniteti rom i Kosovës¹ është i gjashti për nga madhësia në Kosovë.² Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, në Kosovë jetojnë 8,824 romë të Kosovës, që përbëjnë 0.51 për qind të popullsisë së përgjithshme.³

Komuna e Prizrenit ka numrin më të madh të banorëve romë të Kosovës, ku ata përbëjnë rreth 1.63 për qind të popullsisë së përgjithshme, pasuar nga komunat perëndimore të rajonit të Pejës (rreth një për qind⁴) dhe Gjakovës (rreth 0.8 për qind⁵), dhe komunat tjera si Graçanica (gati shtatë për qind⁶), Obiliqi (tre për qind⁷), Fushë Kosova (300-400 banorë), Lipjani⁸, Klina (116), Rahoveci (84), Mamusha (70), Mitrovica Jugore (më pak se një për qind - 112 familje me 400 anëtarë në lagjen "Adem Voca") dhe Vushtrria (38 familje me 224 anëtarë në Prelluzhë).

Në pjesë tjera të vendit jetojnë numër më i vogël i romëve të Kosovës: Shtime (20-25 banorë), Malishevë (28), Suharekë (20), Istog (39) dhe Deçan (33).⁹ Në komunën e Leposaviqit jetojnë pesë familje me 23 anëtarë në qytezë dhe 14 familje me 68 anëtarë në fshatin Kamen. Dhjetë familje me 45 anëtarë jetojnë në Mitrovicën Veriore, ndërkaq nëntë familje me 67 anëtarë jetojnë në Podujevë.

1 Romët, ashkalitë dhe egjiptianët e identifikojnë veten si persona që u përkasin tri komuniteteve të ndryshme, dhe njihen si të tillë nga korniza ligjore e Kosovës, institucionet e Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare. Misioni i OSBE-së në Kosovë e nje plotësisht ekzistencën e tri komuniteteve të ndryshme dhe në këtë publikim është përpjekur të nxjerrë në pah karakteristikat dhe veçoritë e tyre dalluese. Megjithatë, për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme të zbërthyer për këto tri komunitete në disa komuna, pjesë të këtij profili përmbajnë shifra që i përfaqësojnë romët, ashkalitë dhe egjiptianët së bashku.

2 Agjencia e Statistikave të Kosovës, *Ndryshimet demografike të popullsisë së Kosovës 1948-2006* (2008).

3 Megjithatë, regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 është bojkotuar pjesërisht nga komuniteti rom i Kosovës.

4 Rreth 1300 pjesëtarë të komunitetit.

5 Rreth 740 pjesëtarë të komunitetit.

6 Rreth 2500 - 3000. Ata kryesisht jetojnë në qytezën e Graçanicës, Llapllasellë, Preoc, Çagllavicë, Lepi, Radevë, Skullan, Suhadoll, Gushtericë.

7 Rreth 1,000 pjesëtarë të komunitetit - kryesisht në Plemetin, Carravodicë dhe në qytet.

8 Përafërsisht 45 familje / 230 individë, që jetojnë në fshatin me komunitet të përzier të Janjevës, dhe rreth dhjetë familje në qytetin e Lipjanit.

9 OSBE, *Profilet e komunave 2018* (2019).

Përafërsisht 407 (263 burra dhe 144 gra) romë të Kosovës jetojnë në qytetin e Gjilanit,¹⁰ 357 në komunën e Kamenicës (nuk ka të dhëna të kategorizuara sipas gjinisë),¹¹ 256 (130 burra dhe 126 gra) në komunën e Ferizajt,¹² 50 (23 gra dhe 27 burra) në komunën e Novobërdës,¹³ dhe nëntë familje me 44 anëtarë (23 burra dhe 21 gra) në komunën e Shtërpçës.¹⁴

10 Punonjësi rom i Kosovës në ZKKK.

11 Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK).

12 ZKKK dhe përfaqësuesi i komunitetit rom të Kosovës.

13 Anëtar i rom i Kosovës i Komitetit për Komunitete (KK).

14 ZKKK dhe përfaqësuesi i komunitetit.

Faktet dhe çështjet kryesore

- Numri i incidenteve të sigurisë që prekin komunitetin rom të Kosovës ka shënuar në përgjithësi rënie, pavarësisht luhatjeve.
- Në Qeverinë e formuar në vitin 2021 është një zëvendësministër nga komuniteti rom i Kosovës, Sylejman Elshani, i cili shërben si zëvendësministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- Nga 120 anëtarë të Kuvendit, dy janë romë të Kosovës.
- Komuniteti rom i Kosovës ka përgjithësisht qasje të papenguar në infrastrukturë dhe shërbime publike. Shumica e problemeve infrastrukturore që e prekin këtë komunitet kanë të bëjnë me kapacitetet e pamjaftueshme dhe sistemet e mbingarkuara në vendbanimet joformale në mbarë vendin.
- Pjesëtarët e komunitetit rom të Kosovës janë më të cenueshëm ndaj përjashtimit nga skemat e ndihmës sociale sesa komunitetet tjera.
- Ekzistojnë pengesa financiare dhe gjeografike në qasjen në shërbime shëndetësore, si dhe mungesë të vetëdijes për rëndësinë e kujdesit shëndetësor preventiv.
- Nxënësit romë të Kosovës vijojnë mësimin qoftë në shkolla që punojnë sipas planprogramit të Kosovës ose ato që punojnë sipas planprogramit serb.
- Statusi i ulët socio-ekonomik i familjeve romë të Kosovës ndikon në qasjen e fëmijëve në arsim.
- Romët e Kosovës më së shpeshti e flasin gjuhën rome në mjedise private, ndërsa gjuhën shqipe ose serbe e përdorin për të komunikuar me pjesëtarët e komuniteteve tjera dhe për të kërkuar shërbime publike.

1. Siguria dhe rendi

Me kalimin e kohës është shënuar rënie e përgjithshme e numrit të incidenteve që shënjestrojnë komunitetin rom të Kosovës, me përjashtim të vitit 2019 kur numri i incidenteve u rrit ndjeshëm krahasuar me vitin paraprak, për t'iu rikthyer më pas trendit në rënie.¹⁵

Krahas numrit të lartë të vjedhjeve dhe rasteve të zjarrit apo zjarrvënive, janë shënuar edhe incidente të tjera të rënda,¹⁶ përfshirë këtu incidente të tilla si ngacmim seksual, dhunim dhe trafikim me njerëz,¹⁷ ku viktima janë shpeshherë fëmijët romë të Kosovës.¹⁸

Në disa incidente të regjistruara që përfshinin sulme fizike ndaj pjesëtarëve të komunitetit rom të Kosovës, kryerësit ishin të mitur.¹⁹ Cak i incidenteve kanë qenë edhe të kthyerit romë të Kosovës.

Në vitin 2023, 16 pjesëtarë të komunitetit rom të Kosovës (katër gra) janë punësuar nga Policia e Kosovës për të shërbyer në stacionet e Policisë së Kosovës në Mitrovicë Jugore, Mitrovicë Veriore, Ferizaj, Shtime, Gjilan, Kamenicë, Novobërdë, Pejë, Istog, Klinë, Gjakovë, Rahovec, Malishevë, Prizren, Suharekë dhe në nënstacionin në fshatin Prelluzhë të komunës së Vushtrrisë. Në zonat e banuara nga Romët e Kosovës, si në Janjevë (Lipjan), Prelluzhë (Vushtri) dhe Vitomiricë (Pejë), ndodhen nënstacione të Policisë së Kosovës.

Në Komitetet Lokale të Sigurisë Publike (KLSP) janë 14 anëtarë të komunitetit rom të Kosovës.²⁰

15 Sipas monitorimit të brendshëm të OSBE-së, janë regjistruar 30 incidente në 2013, 27 në 2014, 22 në 2015, 15 në 2016, 16 në 2017, 11 në 2018, 21 në 2019, 11 në 2020, 9 në 2021, 14 në 2022 dhe 3 në 2023.

16 Në incidente të ndara që kanë ndodhur në prill 2015 dhe mars 2017 në qytetin e Prizrenit, sulmuesit kishin therur me thikë pjesëtarë të komunitetit rom të Kosovës. Në rastin e dytë, viktima ishte një i mitur rom i Kosovës. Policia e Kosovës i identifikoi dhe arrestoi tre të mitur shqiptarë të Kosovës. Në mars të vitit 2021, një djalë 12-vjeçar rom i Kosovës u rrah në Mitrovicën Jugore. Në qershor të vitit 2021, një rom i Kosovës u plagos me armë zjarri në fshatin Lisicë të Mitrovicës Jugore. Në nëntor të vitit 2021, një i ri rom i Kosovës u sulmua fizikisht dhe u ofendua verbalisht nga personeli i sigurisë së një qendre tregtare në Prizren, kinse për arsye të mosmbajtjes së maskës mbrojtëse nga Covid-19. Incidenti u dënua nga OSHC-të rome të Kosovës dhe u raportua nga mediat lokale. Në tetor 2022, një rom i Kosovës raportoi në Policinë e Kosovës se një shqiptar i Kosovës e kishte rrahur atë në fshatin Pestovë, komuna e Vushtrrisë, ku sipas raportimeve viktima punonte si punëtor krahu në arën e të dyshuarit.

17 Në gusht të vitit 2017, një grua rome e Kosovës u dhunua në Prizren nga një shtetas i Shqipërisë. Policia e Kosovës arrestoi një të dyshuar.

18. Në korrik të vitit 2017, në qytetin e Rahovecit, ku banojnë serbë të Kosovës dhe romë të Kosovës, ndodhi një përleshje mes disa të rinjve shqiptarë të Kosovës dhe romë të Kosovës, me ç' rast u arrestuan dy të mitur shqiptarë të Kosovës për shkak të lëndimeve trupore. Në korrik të vitit 2019, një djalë nëntëvjeçar nga Fushë Kosova u dhunuar dhe u vra. Nëna e djalit e kishte raportuar në polici dhunimin e tij nga i dyshuari, por i dyshuari u lirua pas marrjes në pyetje. Gjashtë muaj më vonë, fëmija u gjet i vdekur. I dyshuari u arrestua më pas për dhunim dhe vrasje të rëndë. Ndaj dy prokurorëve të përfshirë në këtë rast u iniciuan hetime disiplinore me dyshimin se nuk kanë arritur t'i trajtojnë pretendimet për abuzim me kohë dhe në mënyrë efikase. Këshilli Prokurorial i shqiptoi masë disiplinore njërit prej prokurorëve. Një avokat i të drejtave të njeriut e mori përsipër rastin në fjalë dhe kërkoi që zyrtarët të mbaheshin përgjegjës për mosveprim (shih Raportin për të drejtat e njeriut në Kosovë 2020 të Departamentit të Shtetit të SHBA-së). Në shtator të vitit 2019, tre të mitur serbë të Kosovës i sulmuan dy të mitur romë të Kosovës në një shkollë në Graçanicë, ku një rom i Kosovës pësoi lëndime të lehta dhe një nga të rinjtë serbë të Kosovës i dyshuar për sulmin u ndalua nga policia. Në gusht të vitit 2021, në Prizren, një vajzë e mitur rome e Kosovës u keqtrajtua fizikisht dhe u dhunuar për tri ditë radhazi nga tre të dyshuar shqiptarë të Kosovës, të cilët e kishin rrëmbyer viktimen nga rruga dhe e kishin çuar në një shtëpi të pabanuar.

19 Në mars të vitit 2017, në fshatin Zahaq të komunës së Pejës, një pjesëtar i komunitetit rom të Kosovës u sulmua fizikisht nga një i mitur shqiptar i Kosovës dhe pësoi lëndime të lehta. Në maj dhe qershor të vitit 2019, një grua rome e Kosovës u sulmua fizikisht dy herë nga kryerës të mitur, në Lipjan dhe Ferizaj. Pas incidentit të dytë, viktima u dërgua për trajtim mjekësor dhe një i mitur shqiptar i Kosovës u arrestua. OSBE, Avokati i Popullit në Kosovë dhe Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve i dënuan incidentet. Në janar të vitit 2021, në fshatin Janjevë të komunës së Lipjanit, një rom i Kosovës raportoi se kishte qenë cak i një sulmi me armë të rrezikshme nga dy të mitur shqiptarë të Kosovës.

20 Deri në nëntor të vitit 2023.

2. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi

Komuniteti rom i Kosovës përfaqësohet nga një zëvendësministër në Qeverinë e formuar në vitin 2021, Sylejman Elshani, i cili është zëvendësministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Në Qeverinë e krijuar para marsit 2021, Erxhan Galushi nga radhët e Partisë së Bashkuar Rome të Kosovës (PREBK) ka shërbyer si zëvendësministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Gazmen Salijeвиќ ka qenë zëvendësministër për Komunitete dhe Kthim. Salijeвиќ e ka vazhduar këtë rol edhe në Qeverinë e formuar në vitin 2021, deri në maj të vitit 2023.

Aktualisht, komunitetin rom në Kuvend e përfaqësojnë Erxhan Galushi dhe Fadil Gashi nga Iniciativa Rome (IR). Në mandatin e kaluar, komunitetin e ka përfaqësuar lideri i PREBK-së, Albert Kinolli, që njëherësh ka shërbyer edhe si shef i Grupit Parlamentar 6+. ²¹ Një parti tjetër rome e Kosovës që mori pjesë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2019 ishte Partia e Re e Romëve të Kosovës (PRRK).

Dy vendet e rezervuara për komunitetin rom të Kosovës në Këshillin Konsultativ për Komunitete i mbajnë një grua dhe një burrë.

Në vitin 2017, pjesëtarët e komunitetit rom të Kosovës përbënin 0.14 për qind të shërbimit civil në nivel qeveritar. ²² Komuniteti nuk ishte i përfaqësuar në shkallë të mjaftueshme në shërbimin civil komunal në tetë nga dhjetë komuna ku është dashur të ketë të paktën një pozitë sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 (Pejë, Graçanicë, Mitrovicë Jugore, Gjakovë, Obiliq, Prizren, Gjilan dhe Kamenicë). ²³

Komuniteti rom i Kosovës përfaqësohet në komitetet për komunitete (KK) në 24 komuna, me gjithsej 18 burra dhe gjashtë gra, ndërkaq nuk ka përfaqësues në KK në gjashtë komuna ku banon ky komunitet sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011. ²⁴ Asnjë pjesëtar i komunitetit rom të Kosovës nuk është emëruar si kryesues i KK-së, nënkryetar për komunitete i komunës apo zëvendëskryesues për komunitete i kuvendit komunal. ²⁵

21 Grupi Parlamentar 6+ përbëhet nga deputetë nga radhët e komuniteteve joshumicë joserbe të Kosovës.

22 Të dhënat më të fundit nuk janë në dispozicion.

23 OSBE, *Përfaqësimi i komuniteteve në shërbimin civil të Kosovës: Vazhdim i raportit të mëparshëm* (maj 2017).

24 KK-të në komunat Dragash, Istog, Kaçanik, Leposaviq, Mitrovicë Veriore dhe Viti. Për shkak të mungesës së të dhënave nga regjistrimi i popullsisë, vlerësimet e popullsisë për katër komunat veriore bazohen në *Profilet e komunave të vitit 2018* të Misionit të OSBE-së në Kosovë. Përfaqësimi i grave rome të Kosovës në kuadër të KK-ve mbetet veçanërisht sfidues (23 për qind).

25 Ndonëse romët janë komuniteti më i madh joshumicë (bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011) në Obiliq, nënkryetar për komunitete i kësaj komune është një serb i Kosovës. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk e ka kundërshtuar emërimin, meqë mekanizmi në fjalë nuk është i detyrueshëm në këtë komunë (shih po ashtu Profilet e komuniteteve ashkali dhe egjiptianë të Kosovës).

Komuniteti rom i Kosovës përfaqësohet në tetë zyra komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK) nga tetë burra.²⁶

21 pjesëtarë të komunitetit rom të Kosovës janë anëtarë të Këshillave Komunalë për Siguri në Bashkësi (KKSB)²⁷ në komunat në vijim: nga një grua në Ferizaj, Pejë e Mamushë, dhe nga një burrë në Gjilan, Shtërpçë, Vushtrri, Podujevë, Deçan, Gjakovë, Istog, Klinë, Fushë Kosovë, Graçanicë, Lipjan, Obiliq, Shtime, Prishtinë, Malishevë, Prizren, Rahovec e Suharekë.

Organizatave të shquara joqeveritare (OJQ) të udhëhequra nga romë të Kosovës dhe/ose që punojnë në çështje që prekin komunitetin rom të Kosovës përfshijnë "Roma Versitas Kosova", "Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve" (ZRAE), "Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane të Kosovës" (RROGRAEK), "Përparojmë së bashku", "Qendra e Dokumentimit Rom e Ashkali" dhe "Balkan Sunflowers". Ndër OJQ-të tjera aktive janë edhe "Ideas Partnership" në rajonin e Prishtinës; "Roma in Action", "Syri i Vizionit", "JETA"²⁸, "Vizioni 02", "Bethany Christian Services" dhe "Prosperiteti" në rajonin e Pejës; "Zëri i Rinisë Rome dhe Ashkali të Mitrovicës" (ZRRAM), "Shukarno Talenti" (Talentet e Bukura), "Gjuvljano Mangipe" (Dituritë e Gjera), "Roma Road", "Romano Anglunipe" dhe "Qëndrimi" në rajonin e Mitrovicës; dhe "Nevo Koncepti" (Koncepti i Ri), "Durmish Asllano", "Sakuntala", "Rromani Baxt" (Fati Rom), "Iniciativa 6" dhe "Concordia Tranzit Centre" në Prizren. Në vitin 2023, OSBE i ka mbështetur të rinjtë romë të Kosovës nga Kamenica për ta themeluar OJQ-në "Luludi".

26 Në Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjilan, Kamenicë, Mamushë, Obiliq, Pejë, Prizren. Vlen të ceket se në Fushë Kosovë, zyrtari rom i Kosovës nuk është në listën e pagave, por aktualisht paguhet përmes një projekti të financuar nga donatorët.

27 Qëllimi i KKSB-ve është institucionalizimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve komunale, komuniteteve dhe Policisë së Kosovës. Secili komunitet që banon në komunë duhet ta ketë nga një përfaqësues në KKSB, pavarësisht nga madhësia apo ndjenja e përkatësisë etnike të popullsisë. Për komunitetet me popullsi shumë të vogël në nivel komunal, ky përfaqësim mund të jetë i vështirë për t'u arritur. KKSB-të janë themeluar me Udhëzimin administrativ nr. 27/2012 të MPB-së (neni 4), ndërsa përbërja e tyre rregullohet me Udhëzimin administrativ nr. 03/2012 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

28 E udhëhequr nga një grua shqiptare e Kosovës, kjo OJQ ofron trajnime profesionale dhe artizanale dhe aktivitete të tjera për komunitetet joshumicë, përfshirë këtu dhe për romët e Kosovës.

3. Punësimi dhe gjendja socio-ekonomike

Gjendja socio-ekonomike e komunitetit rom të Kosovës përbën shqetësim serioz. Krahasuar me komunitetet tjera në Kosovë, shkalla e varfërisë në mesin e pjesëtarëve të këtij komuniteti vazhdon të jetë dukshëm më e lartë.

Mundësitë e pabarabarta që rrjedhin nga diskriminimi strukturor i rrënjosur thellë, shkalla e lartë e papunësisë dhe infrastruktura shpeshherë e dobët dhe e pasigurt e bëjnë këtë komunitet jashtëzakonisht të cenueshëm. Si rrjedhojë e nivelit të kufizuar të shkollimit dhe aftësimin profesional, shumë pjesëtarëve të komunitetit rom të Kosovës u mungojnë kualifikimet dhe aftësitë që do t'u krijonin mundësi ekonomike, duke rritur kështu përjashtimin socio-ekonomik.

Shkalla e papunësisë në mesin e komunitetit rom të Kosovës është mbi 90 për qind.²⁹ Zyrtarisht, në vitin 2018, 1.8 për qind e komunitetit rom të Kosovës ka qenë të regjistruar si të papunë nga gjithsej 95,890 persona të papunësuar, ndërsa 1,269 romë të Kosovës kanë qenë të regjistruar si punëkërkuës aktivë. Sidoqoftë, statistikat zyrtare të papunësisë përkitazi me këtë komunitet janë të kufizuara dhe nuk e pasqyrojnë gjendjen reale.³⁰ Qasja e komunitetit në shërbimet e punësimit dhe aftësimin profesional të ofruara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe organizata tjera është e kufizuar për shkak të qasjes të dobët në informata mbi mundësitë e punësimit.³¹ Disa komuna, veçanërisht ato të rajonit të Pejës dhe Gjilanit, ofrojnë programe të gjenerimit të të ardhurave për pjesëtarët e komunitetit, ashtu siç ofron edhe Bashkimi Evropian (BE) përmes Programit për stabilizim të komuniteteve dhe disa OJQ.

Një numër i madh i romëve të Kosovës të moshës 18-24 vjeç janë cilësuar si "jo në arsim, punësim apo trajnim (JAPT)" në vitin 2018. Romët, ashkalitë dhe egjiptianët e Kosovës përbënin 78 për qind të të rinjve që konsideroheshin si JAPT.³²

Gratë rome të Kosovës përballen me papunësi akoma më të lartë. Megjithëse gratë në Kosovë përballen përgjithësisht me diskriminim pavarësisht nga përkatësia etnike, gratë rome të Kosovës janë në pozitë veçanërisht të cenueshme për shkak të

29 Komisioni Evropian, Dokument pune, *Raport për Kosovën 2023* (2023), f. 100.

30 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Kosovës, *Raport vjetor 2018* (2019), f. 19.

31 Komisioni Evropian, Dokument pune, *Raport për Kosovën 2020* (2020), f. 38.

32 Organizata Ndërkombëtare e Punës, *Perspektiva e të rinjve romë, ashkali dhe egjiptianë mbi mundësitë dhe sfidat për punë të denjë në Kosovë* (2018), f. 21.

diskriminimit të shumëfishtë dhe nocioneve të rrënjësura të roleve gjinore.³³ Gratë e reja ishin të përfaqësuara në mënyrë joproportionale në mesin e atyre të cilësuar si JAPT, ku deri në 88 për qind të grave të reja rome, ashkali dhe egjiptiane të Kosovës konsideroheshin JAPT në vitin 2018. Për më tepër, shkalla e punësimit të grave të reja ishte tejet e ulët: vetëm katër për qind. Mbase si një ilustrim i pjesshëm i gjendjes së dobët ekonomike, vetëm 37 për qind e grave nga të tria komunitetet kishin një perceptim pozitiv të jetës së tyre, krahasuar me 51 për qind të grave nga radhët e komuniteteve tjera në Kosovë.³⁴

Sigurimi i një vendi të punës në sektorin privat është sfidë për komunitetin rom të Kosovës. Pjesëtarët e komunitetit në përgjithësi punojnë në sektorin joformal në punë të pasigurta, pa kualifikime dhe me status të ulët, të tilla si ndërtimtaria dhe punët bujqësore sezonale, prerja e drunjve dhe mbledhja e hekurishteve e materialeve të riciklueshme.³⁵ Prania e romëve të Kosovës në tregun joformal të punës në Kosovë është më e lartë krahasuar me vendet e tjera në rajon.³⁶ Disa pjesëtarë të komunitetit zotërojnë biznese të vogla, të tilla si riparime të veturave, tekstile dhe dyqane artizanale.

Komuniteti rom i Kosovës ka shkallë të ulët përfaqësimi në shërbimin civil, veçanërisht në nivelin qeveritar. Shumica e pjesëtarëve të komunitetit rom të Kosovës të punësuar në shërbimin civil kryejnë punë teknike ose administrative, ku në këtë kategori numri i grave është më i madh se ai i burrave.³⁷ Përveç këtyre pak pozitave në shërbimin civil, më pak se 100 pjesëtarë të komunitetit rom të Kosovës janë të punësuar në sektorin publik, përfshirë këtu në sektorin e shëndetësisë, arsimit, në ndërmarrje të shërbimeve komunale dhe të mbeturinave, si dhe në Doganën e Kosovës, Policinë e Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës.³⁸ Romët e Kosovës punojnë gjithashtu dhe në qendrat mësimore me bazë në komunitet që ofrojnë shërbime arsimore për nxënësit nga radhët e komunitetit, si dhe në OJQ të shumta lokale e rajonale.

Në komunën e Gjilanit, vetëm 18 nga rreth 407 romë të Kosovës janë të regjistruar zyrtarisht si të punësuar, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Në fund të vitit 2023, tridhjetekatër romë të Kosovës ishin të regjistruar si punëkërkuar aktivë dhe 37 familje merrnin ndihmë sociale. Në komunën e Kamenicës, vetëm shtatë nga 357 romë të Kosovës janë të regjistruar zyrtarisht si të punësuar në sektorin publik dhe privat. Dyzetepesë pjesëtarë të komunitetit rom të Kosovës janë punëkërkuar aktivë, ndërsa 50 familje përfitojnë ndihmë sociale.

33 Po aty. f. 42.

Qendra Kosovare për Studime Gjinore, *Pozita e grave rome, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë* (2018), f. 4 dhe 15
Rrjeti Kosovar për Arsim dhe Punësim, *Drejt një politike të re: Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë 2016–2020* (2020), f. 15.

34 Organizata Ndërkombëtare e Punës, *Perspektiva e të rinjve romë, ashkali dhe egjiptianë mbi mundësitë dhe sfidat për punë të denjë në Kosovë* (2018), f. 21.

35 Komisioni Evropian, Dokument pune, *Raport për Kosovën 2020* (2020), f. 79.

OSBE, Pasqyrë e përgjithshme e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës (2020).

36 Komisioni Evropian, Dokument pune, *Raport për Kosovën 2019*, f. 31.

37 OSBE, *Përfaqësimi i komuniteteve në shërbimin civil të Kosovës: Vazhdim i raportit të mëparshëm* (2017), f. 17 dhe 23.

38 OSBE, *Pasqyrë e përgjithshme e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë* (2020)

Në komunën e **Ferizajt**, vetëm dy pjesëtarë të komunitetit rom të Kosovës, një grua dhe një burrë, janë të regjistruar si punëkërkues aktivë. Tetë familje (30 persona) marrin ndihmë sociale. Vetëm gjashtë persona janë të punësuar në sektorin publik. Sipas ZKKK-së dhe përfaqësuesit të komunitetit rom të Kosovës, 20 romë të Kosovës janë të punësuar në sektorin privat si farkëtarë, 10-15 burra punojnë si prodhues litarësh ose në ndërtimtari. Nga 44 romë të Kosovës që banojnë në komunën e Shtërpcës, 18 janë fëmijë. Një pjesëtar i komunitetit rom të Kosovës është i punësuar në ndërmarrjen e shërbimeve komunale, tri familje rome të Kosovës kanë biznese private (një dyqan dhe dy punëtori saldimi), e 11 persona marrin ndihmë sociale. Një familje e zhvendosur rome e Kosovës ka përfitur nga ndërtimi i një shtëpie në kuadër të një projekti të BE-së.

Në **Prizren**, grupmoshat më të prekura nga shkalla tejet e lartë e papunësisë janë grupmoshat 20-30 dhe ato mbi 50 vjeç, si burra ashtu edhe gra. Sipas statistikave të zyrës së Agjencisë së Punësimit në Prizren, aktualisht janë 238 punëkërkues aktivë nga radhët e komunitetit rom, përfshirë këtu 100 gra. Dy romë të Kosovës punojnë në komunën e Prizrenit, dy në qendrat e mjekësisë familjare dhe disa në spitalin e Prizrenit, kryesisht si infermierë dhe personel administrativ/mbështetës. Disa pjesëtarë të komunitetit janë të punësuar në projekte nga OJQ-të, ku ca sosh udhëhiqen nga aktivistë romë.

Në komunën e **Mamushës**, tri gra rome të Kosovës janë të angazhuara në pastrimin dhe mirëmbajtjen e objekteve komunale përmes një kompanie private. Pjesëtarët e komunitetit rom të Kosovës që punojnë në sektorin privat janë të punësuar kryesisht në supermarkete dhe dyqane. Disa punojnë në OJQ të ndryshme si personel i projekteve, vullnetarë ose bashkëpunëtorë.

Në komunën e **Rahovecit**, shumica e 84 banorëve romë të Kosovës janë përfitues të ndihmës sociale, me vetëm një të regjistruar si punëkërkues aktiv. Përkundër disponueshmërisë së projekteve nga MKK, pjesëtarët e komunitetit rom të Kosovës nuk i plotësojnë kushtet për të përfitur nga to pasi që janë përfitues të ndihmës sociale.

Gjendja e përgjithshme ekonomike mbetet kryesisht e pandryshuar në mbarë rajonin e Pejës, me papunësi jashtëzakonisht të lartë, kurse edhe ata që punojnë, kanë punë me të ardhura të ulëta. Shumë pjesëtarë të komunitetit marrin ndihmë sociale.

Në komunën e **Graçanicës**, 20 romë të Kosovës (tri gra dhe 17 burra) janë të punësuar në sektorin publik, dhe atë kryesisht në shëndetësi, arsim e administratë, ndërsa rreth 30 - 40 burra punojnë në kompaninë e shërbimeve publike për grumbullimin e mbeturinave. Sipas përfaqësuesit të komunitetit rom të Kosovës, numri i banorëve që marrin ndihmë sociale është shumë i ulët. Ka pasur shumë ankesa nga pjesëtarët e komunitetit për rastet e refuzuara nga qendra për punë sociale. Në komunën e **Lipjanit**, shumica e pjesëtarëve të komunitetit janë të papunë dhe marrin ndihmë sociale si nga institucionet e Kosovës ashtu edhe ato të Beogradit. Në komunën e **Novobërdës**, nëntë nga 58 romë të Kosovës janë të punësuar në sektorin publik dhe asnjë në sektorin privat, shtatë janë të regjistruar si punëkërkues aktiv, rritje kjo nga vetëm një sa ishte në vitin 2020, dhe gjashtë familje rome të Kosovës marrin ndihmë sociale.

Në **Obiliq**, një rom i Kosovës punon në komunë dhe tre tjerë në sektorin e arsimit (sipas kurrikulës serbe) dhe në organizatat e shoqërisë civile (OSHC). Pjesëtarët e komunitetit rom të Kosovës kanë raportuar se kohëve të fundit nuk kanë përfituar nga projektet për lehtësim të punësimit të tyre. Në komunën e Shtimes dhe atë të Fushë Kosovës, asnjë pjesëtar i këtij komuniteti nuk është i punësuar në sektorin publik. Në këtë të fundit, thuhet gjysma e komunitetit merret me grumbullim të mbeturinave për qëllime të riciklimit. Sipas një përfaqësuesi të komunitetit rom të Kosovës, rreth 80 për qind e familjeve romë të Kosovës marrin ndihmë sociale nga të dy sistemet, krahas subvencioneve arsimore për fëmijët.

Në rajonin e **Mitrovicës**, njësoj si në rajonet tjera, shumica e pjesëtarëve të komunitetit në moshë pune janë të papunë ose të angazhuar në biznese private si ndërtimtari, bujqësi dhe grumbullim të materialeve plastike të riciklueshme. Në fshatin Prelluzhë të komunës së Vushtrrisë, katër burra romë të Kosovës janë të punësuar në institucionet arsimore të drejtuara nga Beogradi. Në lagjen "Adem Voca" në komunën e Mitrovicës Jugore janë disa kompani aktive në një inkubator të biznesit të themeluar disa vite më parë nga OJQ "Këshilli Danez për Refugjatë". Disa pjesëtarë të komunitetit rom të Kosovës kanë biznese të vogla të tilla si berberë, dyqane të shërbimeve elektronike, grumbullim të materialeve të riciklueshme dhe kafene të vogla.

Dukuria e punës së fëmijëve është e përhapur posaçërisht në mesin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës. Ndonëse mungojnë të dhëna të sakta, të kategorizuara sipas komuniteteve, vlerësohet se 17 për qind³⁹ e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës punojnë. Fëmijët mbledhin kanaçe nga koshat e mbeturinave, pastrojnë dritaret e makinave, shesin gjësende në rrugë dhe kafene, ose kërkojnë lëmshë. Puna e fëmijëve është e lidhur ngushtë me nivelet e varfërisë familjare, arritshmërinë e ulët në arsim, si dhe mungesën e kujdesit dhe mbikëqyrjes prindërore.⁴⁰ Kjo dukuri karakterizohet me një mospërputhje gjinore, pasi që më shumë djem janë të angazhuar në punën e fëmijëve sesa vajza.⁴¹

Trembëdhjetë për qind e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës punojnë në kushte të rrezikshme, përfshirë kryerjen e punëve fizike në ara, prerjen e drunjve, operimin me makineri bujqësore, punën në miniera nëntokësore, spërkatjen e pesticideve, kërkimin e gjësendeve në kosha të mbeturinave apo punën në thertore. Në disa raste, fëmijët punojnë për t'u ndihmuar financiarisht familjeve të tyre. Grupet e organizuara kriminale përfitojnë nga këta fëmijë, veçanërisht në lëmshë-kërkimin e detyruar.⁴² Sipas raporteve të OSBE-së, besohet gjerësisht se shumë fëmijë të angazhuar në lëmshë-kërkim dhe punën e fëmijëve vijnë nga Republika e Shqipërisë apo vende të tjera përbrenda Kosovës.

39 Shih Organizata Ndërkombëtare të Punës, *Perspektiva e të rinjve romë, ashkali dhe egjiptianë mbi mundësitë dhe sfidat për punë të denjë në Kosovë* (2018), f. 24.

40 Zyra për Qeverisje të Mirë, *Hartëzimi dhe vlerësimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve* (2012), f. 25; UNICEF, *Analizë e gjendjes së fëmijëve dhe grave në Kosovë* (2017), f. 89

41 Shih Organizata Ndërkombëtare të Punës, *Perspektiva e të rinjve romë, ashkali dhe egjiptianë mbi mundësitë dhe sfidat për punë të denjë në Kosovë* (2018) f. 23-24.

42 UNICEF, *Analizë e gjendjes së fëmijëve dhe grave në Kosovë* (tetor 2017), f. 92.

Në përgjithësi, puna e fëmijëve pengon qasjen në arsim dhe ndikon negativisht në cilësinë e tij. Kjo praktikë shpie në numër të konsiderueshëm të rasteve të braktisjes së shkollimit, gjë që kufizon mundësitë në të ardhmen dhe, për rrjedhojë, kontribuon në një cikël të vazhdueshëm të përjashtimit social. Megjithatë, për shembull, në rajonin e Gjilanit, pas fushatave ndërgjegjësuese të drejtuara nga qendra për punë sociale, puna e fëmijëve nuk është aq e përhapur sa në të kaluarën.

Romët e Kosovës, së bashku me komunitetet ashkali të Kosovës dhe egjiptian të Kosovës, përbëjnë grupin e dytë më të madh nga Kosova që kërkojnë azil në shtetet anëtare të BE-së.⁴³ Shumë romë të Kosovës e përmendin varfërinë, mungesën e mirëqenies sociale dhe të kujdesit shëndetësor, si edhe papunësinë, si arsye kryesore për emigrim.⁴⁴ Ka edhe migrim sezonal për të kërkuar punë si në BE ashtu edhe në vendet fqinje si Shqipëria, Maqedonia e Veriut ose Mali i Zi.

Në vitin 2022, qeveria e Kosovës krijoi një platformë kundër diskriminimit ndaj pjesëtarëve të këtyre tri komuniteteve për t'u mundësuar atyre që t'i raportojnë incidentet e diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike. Në vitin 2023 Qeveria krijoi një ekip ndërinstitucional për promovimin e punësimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për të rritur punësimin e tri komuniteteve në shërbimin civil dhe mundësitë e tjera të punësimit.

43 Bashkimi Evropian, Zyra Evropiane për Mbështetje të Azilit, *Azilkërkuesit nga Ballkani Perëndimor: Analizë krahasuese e tendencave, faktorëve shtytës-tërheqës dhe përgjigjeve – Përditësim* (maj 2015), f. 10; Zyra Evropiane për Mbështetje të Azilit, *Azilkërkuesit nga Ballkani Perëndimor: Analizë krahasuese e tendencave, faktorëve shtytës-tërheqës dhe përgjigjeve* (2013), f. 23.

44 OSBE, *Raport i për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve* (2015), f. 26.

4. Qasja në infrastrukturë dhe shërbime publike

The Gjendja socio-ekonomike përgjithësisht e dobët e romëve të Kosovës ua pengon qasjen në infrastrukturë dhe shërbime publike. Komuniteti përballet me një mori problemesh serioze të tilla si grumbullimi i parregullt i mbeturinave, mungesa e infrastrukturës bazë në vendbanimet joformale, kushtet e dobëta të banimit dhe faturat e grumbulluara të energjisë elektrike.

Numri më i madh i romëve të Kosovës ndodhet në rajonin e **Prizrenit**, ku thuhet se që të gjithë jetojnë në lagje me komunitete të përziera, me qasje në sisteme të qëndrueshme të energjisë elektrike, ujit dhe kanalizimit. Megjithatë, shumë shtëpi kanë nevojë për riparim, e disa sosh në gjendje nën-standarde. Në vitin 2017, komuna e Prizrenit ka ndarë 20,000 euro për riparimin e shtëpive dhe, në bashkëpunim me OJQ-në "VoRAE", ka financuar edhe 24 rinovime të shtëpive. Në vitin 2019, Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale e Komunës së Prizrenit ka financuar ndërtimin ose rehabilitimin e pjesëshëm të 15 shtëpive të familjeve rome të Kosovës në nevojë dhe, përmes një projekti të bashkëfinancuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ka ndërtuar 15 shtëpi për familjet rome të Kosovës. Në vitet 2020 dhe 2021, zyra komunale për komunitete dhe kthim ka rinovuar dhjetë shtëpi. Në lagjen "Jeta e Re", OJQ-të rome të Kosovës "Nevi Koncepti" dhe "Durmish Asllano" kanë avokuar për përmirësimin e sistemit të kanalizimit, çështje kjo që raportohet të jetë zgjidhur nga komuna.⁴⁵

Në rajonin e **Pejës**, qasja e komunitetit në infrastrukturë dhe shërbime publike përcillet me ndryshueshmëri. Për ata që jetojnë në fshatrat e Vitomiricës dhe Brestovikut, ku infrastruktura në përgjithësi është e kënaqshme, shqetësim kryesor është gjendja e keqe e disa shtëpive, ashtu si edhe në komunat e Gjakovës, Istogut dhe Deçanit. Përmes një projekti ROMACTED, me mbështetjen e ZKKK-së, në shtator të vitit 2020 është finalizuar ndërtimi i një sistemi të ri të kanalizimit në fshatin Serbobran të komunës së Istogut të banuar nga Romët e Kosovës.

Në vitin 2022, në lagjen "Ali Ibra" në qytetin e Gjakovës janë asfaltuar rrugët kryesore, është ndërtuar sistemi i kanalizimit dhe është pastruar deponia në afërsi të kësaj lagjeje. Një stacion i bartjes së mbeturinave i financuar nga BE-ja ka përmirësuar ndjeshëm kushtet e jetesës së komunitetit. Asfaltimi i rrugëve ka vazhduar në vitin 2023. Gjatë viteve 2022 dhe 2023 janë bërë përmirësime të infrastrukturës edhe në zona të tjera në komunën e Gjakovës ku banon komuniteti. Në fshatin Skivjan janë ndërtuar katër shtëpi dhe janë asfaltuar disa rrugë.

45 OSBE, *Paqyrrë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë* (2020), f. 78-79.

Në Piskotë është ndërtuar një shtëpi dhe janë rinovuar tri të tjera, si edhe janë ndërtuar apo asfaltuar disa rrugë. Në lagjen "Brekoc" janë ndërtuar dy shtëpi dhe janë rinovuar tri të tjera. Në lagjen "Mëhalla e Sefës" është rinovuar një shtëpi, si edhe janë asfaltuar ose ndërtuar disa rrugë në atë lagje si dhe në lagjen "Mehmet Hyseni".⁴⁶

Për Romët e Kosovës në komunën e Klinës, problematike mbetet qasja në ujë të pijshëm, ku atyre u duhet të mbështeten në pusët private për furnizim, me përjashtim të fshatit Klinafc të kësaj komune.

Në periudhën 2021-2023, në komunën e Pejës, janë asfaltuar disa nga rrugët në lagjen "7 Shtatori" në qytetin e Pejës dhe në fshatin Vitomiricë, e problemi i kahershëm me gropat septike në fshatin Qungur është zgjidhur.

Në rajonin e **Prishtinës**, pjesëtarët e komunitetit kryesisht banojnë në vendbanime gjysmë formale në banesa të përhershme individuale, me qasje përgjithësisht të kënaqshme në energji elektrike, ujë, ndriçim rrugor dhe sisteme të kanalizimit. Nga ana tjetër, sistemet e ujërave të zeza të ndërtuara dobët në zonat e banuara nga Romët e Kosovës në Janjevë dhe Lipjan paraqesin rrezik për shëndetin e komunitetit. Në Fushë Kosovë, komuna ka bërë përpjekje që të gjitha familjet romë të Kosovës në dy lagjet ku banojnë Romët e Kosovës (28 dhe 29) të kyçen në sistemin e ujësjellësit.

Në komunën e Graçanicës, sistemi i furnizimit me ujë është shumë i vjetër, gjendja e rrugëve është e keqe, e sistemi i kanalizimit nuk funksionon siç duhet. Në komunën e Obiliqit, në vitin 2018, Misioni i OSBE-së dhe Ambasada e Luksemburgut kanë investuar në riparimin e një objekti të banuar nga Romët e Kosovës në fshatin Plemetin çatia e të cilit ishte shkatërruar nga erërat e forta. Pjesëtarët e komunitetit rom të Kosovës kanë raportuar se nuk kanë përfituar nga asnjë mbështetje për rinovim nga komuna.

Në komunën e Kamenicës, rajoni i Gjilanit, furnizimi me ujë të pijshëm dhe kushtet e këqija të banimit vazhdojnë të përbëjnë problem që prek komunitetin rom të Kosovës. Në vitin 2018, kompania rajonale e ujësjellësit në këtë komunë i ka kyçur në rrjet të gjitha familjet në fshatin Berivojcë, përfshirë këtu edhe shtatë familje të kthyer romë. Sidoqoftë, deri në dhjetor të vitit 2023, uji i ujësjellësit nuk ishte i pijshëm për shkak të kontaminimit të puseve të ujit në vitin 2020.⁴⁷ Banorëve të Berivojcës u duhet të mbështeten në pusët private të ujit, gjersa banorët në qytetin e Kamenicës blejnë ujë të ambalazhuar. Komuna e Gjilanit ka punuar po ashtu për ta pastruar një deponi të paligjshme të mbeturinave në lagjen "Abdullah Presheva".⁴⁸

Në Mitrovicën Veriore dhe Mitrovicën Jugore, komuniteti rom i Kosovës banon në objekte të dedikuara për të kthyerit me qasje në ujë të pijshëm, energji elektrike, rrjete të kanalizimit dhe kushte adekuate banimi. Në lagjen "Adem Voca" në Mitrovicën Jugore, komuna ka siguruar tokë për banim dhe, së bashku me organizatat ndërkombëtare, ka siguruar mjete për ndërtimin e shtëpive për pjesëtarët e komunitetit. Banesat e tyre janë në pronësi të komunës dhe u janë dhënë në

46 Vlen të ceket se nuk ka të dhëna të kategorizuara për këta përfitues, kështu që nuk ka informacion përfundimtar nëse ata i përkasin komunitetit shkallë të Kosovës, rom të Kosovës apo egjiptian të Kosovës.

47 ZKKK.

48 Po aty, f. 24.

shfrytëzim pa pagesë pjesëtarëve të komunitetit deri në 20 vjet. Në Mitrovicën Veriore, komuna dhe donatorët ndërkombëtarë kanë ndërtuar një kompleks banesor pesëkatësh, në pronësi të komunës, por të kontraktuar me pjesëtarët e komunitetit rom të Kosovës për t'i shfrytëzuar pa pagesë.

Në komunën e Vushtrrisë, shumica e romëve të Kosovës banojnë në vendbanimin joformal në fshatin me shumicë serbe Prelluzhë. Shtëpitë janë të ndërtuara në tokë komunale, dhe ca sosh janë në gjendje të keqe. Rrugët në Mëhallën e Romëve në këtë fshat akoma nuk janë asfaltuar dhe nuk kanë ndriçim. Në komunën e Leposaviqit, Romët e Kosovës banojnë në ish-objektin e Kryqit të Kuq të Serbisë në qytezën e Leposaviqit dhe në fshatin Kamen, ku shtëpitë dhe rrugët janë në gjendje të keqe. Në disa rrugë mungon ndriçimi rrugor. Në vitin 2019 në fshat është ndërtuar sistemi i kanalizimit dhe një pus. Në qytetin e Podujevës, komuniteti rom i Kosovës banon në dy vendbanime të cilat kanë nevojë për riparim të sistemit të kanalizimit.

5. Qasja në shërbime sociale, përfshirë këtu edhe kujdesin shëndetësor

Komuniteti rom i Kosovës merr ndihmë sociale qoftë nga Prishtina ose Beogradi⁴⁹, ose të dyja.

Në përgjithësi, legjislacioni në fuqi për mirëqenien sociale ka vendosur kriteret më të rrepta për familjet që të kualifikohen për të përfituar ndihmë sociale. Përkufizimi i ngushtë i "familjeve që jetojnë në një bashkësi të vetme" ka ndikuar negativisht te familjet me shumë breza të komunitetit rom të Kosovës. Në komunën e Lipjanit dhe atë të Fushë Kosovës, sipas përfaqësuesve të komunitetit, shumica e pjesëtarëve të komunitetit marrin ndihmë sociale si nga sistemi i Kosovës ashtu edhe institucionet e drejtuara nga Beogradi, krahas subvencioneve për arsim për fëmijët. Në Graçanicë, numri i romëve të Kosovës që marrin ndihmë sociale raportohet të jetë shumë i ulët. Pjesëtarët e komunitetit janë ankuar për rastet që u janë refuzuar nga qendra për punë sociale. Në Obiliq, pjesëtarët e komunitetit kanë raportuar se ndryshimi i kriterëve për përfitime sociale ka bërë që shumë familje në nevojë të mbeten jashtë skemës së ndihmës sociale.

Në mars të vitit 2019, 2000 romë të Kosovës kishin të drejtë të pranonin ndihmë sociale nga Prishtina (813 burra dhe 1187 gra), gjersa për ndihmat sociale të dhëna nga Beogradi nuk ka të dhëna të besueshme.⁵⁰

Sipas kreut të ZKKK-së në komunën e Podujevës, në këtë komunë ndihmë sociale marrin pesë familje romë të Kosovës me 37 anëtarë. Në komunat e tjera të rajonit të Mitrovicës raportohet se shumica e pjesëtarëve të komunitetit rom të Kosovës marrin ndihmë sociale.

Kujdesi shëndetësor është në dispozicion, por nuk shfrytëzohet sa duhet në rastin e komunitetit rom të Kosovës. Dy pengesa që pamundësojnë qasjen janë varfëria dhe largësia nga institucionet mjekësore.⁵¹ Veç vështirësive financiare, qasja në kujdes shëndetësor përkeqësohet edhe si rrjedhojë e mungesës së mbulimit universal shëndetësor dhe varfërisë.⁵²

49 Pas miratimit të një rregulloreje nga Banka Qendrore e Kosovës në dhjetor të vitit 2023, duke e përcaktuar euron si monedhën e vetme që lejohet për transaksione me para në Kosovë, e cila hyri në fuqi më 1 shkurt të vitit 2024, ekipet në terren të Misionit të OSBE-së në Kosovë pranuan raporte se ky ndryshim ka prekur komunitetin që mbështetet në mbështetjen financiare nga qeveria e Serbisë.

50 OSBE, *Pasqyrë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë* (2020), f. 4–5.

51 KOSANA, *Sigurimi i ri kombëtar do të shpëtojë jetë: Jetëgjatësia dhe shëndeti në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës* (2016), f. 46.

52 Komisioni Evropian, Dokument pune, *Raporti për Kosovën 2019*, f. 31.

Për më tepër, komuniteti rom i Kosovës është shpeshherë subjekt i diskriminimi që mund të shprehet në formën e cilësisë së dobët të shërbimeve shëndetësore të ofruara.⁵³

Shëndeti i dobët i pjesëtarëve të komunitetit rom të Kosovës në krahasim me popullsinë e përgjithshme është kryesisht rezultat i kushteve jo të shëndetshme të jetesës, mungesës së kushteve sanitare e higjienës elementare dhe imunizimit, si dhe përdorimit të kufizuar të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parandalues.⁵⁴ Hendekun ndërmjet romëve të Kosovës dhe komunitetit më të madh e ilustron më së miri një statistikë e vetme e zyrtë: ndonëse shërbimet e kujdesit për shëndetin riprodhues ofrohen falas për gratë në shumicën e komunave,⁵⁵ shkalla e vdekshmërisë së foshnjave në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës është tre herë më e lartë se mesatarja e Kosovës, e pjesëtarët e komunitetit nuk janë të informuar mjaftueshëm se shërbime të tilla shëndetësore ekzistojnë.⁵⁶

Në Ferizaj, komuniteti rom i Kosovës i shfrytëzon dhe ka qasje të mirë në institucionet e kujdesit shëndetësor të Kosovës të cilat ndodhen në afërsi të vendbanimeve të tyre.⁵⁷ Nga viti 2021 deri në vitin 2023 janë organizuar disa fushata ndërgjegjësimi shëndetësor në vendbanimet e banuara kryesisht nga komuniteti rom i Kosovës, për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e imunizimit në parandalimin e sëmundjeve. Këto fushata kanë shërbyer për t'i informuar pjesëtarët e komunitetit për kalendarin e ri të vaksinimit për fëmijët deri në moshën 18 vjeçare. OJQ "Balkan Sunflowers", me mbështetje nga UNICEF-i, ka organizuar gjithashtu disa fushata ndërgjegjësimi lidhur me vaksinimin dhe imunizimin.⁵⁸ Së bashku me qendrën mjekësore në komunë, ata organizuan ditë shtesë të imunizimit të dedikuara enkas për pjesëtarët e komunitetit rom të Kosovës. Në kuadër të kësaj fushate janë krijuar dy ekipe mobile që organizojnë fushata derë më derë. Shërbimet e vaksinimit ofrohen rregullisht nga ekipi i imunizimit, pesë ditë në javë, në qendrat mjekësore që gjenden në vendbanimet e banuara me pjesëtarë të komunitetit rom të Kosovës.⁵⁹ Sipas zyrtarëve shëndetësorë, shkalla e vdekshmërisë së foshnjave në komunitetin rom të Kosovës në Ferizaj ka pësuar rënie gjatë periudhës për të cilën raportohet.

Shkalla e vaksinimit të fëmijëve romë të Kosovës në rajonin e Gjilanit ka shënuar përmirësim të madh: tani është gati e njëjtë me komunitetin shumicë.

Në vitin 2022, OSBE realizoi një fushatë që kishte si qëllim t'i nxiste gratë nga radhët e komuniteteve joshumicë në komunat e Ferizajt dhe Gjilanit që t'u nënshtrohen kontrolleve të mamografisë, si edhe mbajti prezantime për shëndetin riprodhues dhe ofroi mamografi falas për pjesëtarët e komunitetit në qytetin e Gjakovës dhe atë të Pejës.

53 KOSANA, *Sigurimi i ri kombëtar do të shpëtojë jetë: Jetëgjatësia dhe shëndeti në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës* (2016), f. 46.

54 Mbrojtësit e të Drejtave Civile, *Muri i anti-gjipzimit: romët, ashkalitë dhe egjiptianët në Kosovë* (2018), f. 21; Zyra për Qeverisje të Mirë, *Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017–2021* (2017), f. 26.

55 Kujdesi falas për shëndetin riprodhues ofrohet për të gjitha komunitetet në këto komuna: Deçan, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gjilan, Istog, Klinë, Lipjan, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec dhe Suharekë.

56 Zyra për Qeverisje të Mirë, *Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017–2021* (Prill 2017), f. 27.

57 Shefi i Njësisë së Imunizimit, Ferizaj.

58 OJQ "BRAN".

59 Shefi i Njësisë së Imunizimit, Ferizaj.

Më tej, OSBE realizoi një fushatë për vetëdijesimin dhe testimin për kancer të gjirit të dedikuar enkas për gratë **rome të Kosovës** nga fshati Prelluzhë në komunën e Vushtrrisë dhe lagjen “Adem Voca” në Mitrovicën Jugore. Në vitin 2023, OSBE realizoi fushata të vetëdijesimit shëndetësor të dedikuara për komunitetet joshumicë në Gjilan për kancerin e gjirit, në Istog për shëndetin riprodhues, dhe në Kamenicë për sëmundjet ngjitëse, ushqimin e shëndetshëm dhe sëmundjet kronike.

Qendrat mjekësore që ndodhen në vendbanimet e banuara nga komuniteti **rom i Kosovës** organizojnë seanca të rregullta informuese për t’i ndërgjegjësuar burrat, gratë dhe të rinjtë për një sërë temash shëndetësore. OJQ-të realizojnë gjithashtu disa fushata ndërgjegjësimi për shëndetin, përfshirë mes tjerash për HIV/AIDS, përdorimin e narkotikëve, vaksinimin, shëndetin riprodhues, parandalimin e kancerit të gjirit dhe helmimin nga plumbi, në Gjakovë, Pejë, Mitrovicë Jugore dhe Rahovec.⁶⁰ Në periudhën 2020-2022, shoqëria civile dhe Ministria e Shëndetësisë kanë realizuar disa seanca informuese në lagjet e banuara nga komuniteti në Gjakovë për tema të tilla si diabeti, hipertensioni, vaksinimi, dhe kujdesi shëndetësor për gratë shtatzëna dhe fëmijët.

Mungesa e dokumentacionit personal mbetet problem i vazhdueshëm për komunitetin **rom të Kosovës**. Është raportuar se 93 për qind e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës nën moshën pesëvjeçare janë të regjistruar. Pengesë për regjistrimin e lindjes është mosndërgjegjësimi për procedurat e regjistrimit civil.⁶¹ Institucionet e Kosovës kanë zbatuar disa masa që synojnë rritjen e shkallës së regjistrimit civil në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës, përfshirë promovimin e ditëve të regjistrimit falas për ta lehtësuar regjistrimin civil.⁶² Për shembull, komuna e Ferizajt ofron regjistrim falas për pjesëtarët e komunitetit **rom të Kosovës** dhe zbaton rregullisht masa për rritjen e regjistrimit civil të komunitetit **rom të Kosovës**, pa asnjë kosto.⁶³ Në tërë rajonin e Gjilanit janë regjistruar të gjitha lindjet e foshnjave **rome të Kosovës**.⁶⁴

60 OJQ BRAN.

61 Agjencia e Statistikave të Kosovës, *2013–2014 Komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë* Anketa e grupeve me tregues të shumëfishtë* (2014), f. 126–127. Të dhënat e sakta për komunitetin për numrin e personave të paregjistruar nuk janë në dispozicion.

62 OSBE, *Raport për vlerësimin e të drejtave të komuniteteve* (2015), f. 25–26; Këshilli i Evropës, Komiteti Këshillëdhënës për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, *Opinion i katërt për Kosovën* (2017), f. 30.

63 ZKKK

64 ZKKK

6. Qasja në arsim

Nxënësit romë të Kosovës i vijnë mësimet qoftë në gjuhën shqipe sipas planprogramit të Kosovës ose në atë serbe në shkolla që punojnë sipas planprogramit të Serbisë. Në përgjithësi, prindërit romë të Kosovës priren që t'i zgjedhin shkollat me planprogram të Serbisë për fëmijët e tyre, kur ato janë në dispozicion dhe lehtësisht të qasshme.

Një nga sfidat që vështirëson vlerësimin e ofrimit të arsimit për komunitetin rom të Kosovës është se ata shpesh vendosen në të njëjtin grup me ashkalitë e Kosovës dhe egjiptianët e Kosovës për qëllime të monitorimit, planifikimit të politikave dhe ndërhyrjeve.

Deri në vitin 2019, nxënësit romë të Kosovës në fshatin Strezoc të komunës së Kamenicës i kanë vijuar mësimet në një shkollë me planprogram të Kosovës e cila u mbyll pas reformave arsimore të ndërmarra nga komuna. Si rrjedhim, ata u zhvendosën në një shkollë me planprogram serb dhe, që nga dhjetori i vitit 2023, në komunën e Kamenicës nuk ka asnjë nxënës romë të Kosovës në shkollat me planprogram të Kosovës.

Që nga viti 2011, planprogrami i Kosovës ofron një modul të lëndës zgjedhore në gjuhën rome që përmban elemente të historisë dhe kulturës për nxënësit e shkollave që zgjedhin ta ofrojnë këtë lëndë. Tani për tani, lënda në gjuhën rome ofrohet në Prizren dhe Lipjan, ndërsa shkollat me planprogram serb sigurojnë mësim në gjuhën rome për nxënësit romë të Kosovës në komunat e Kamenicës dhe Gjilanit.

Shumë nxënës romë të Kosovës varen në masë të madhe nga mbështetja dhe ndihma që marrin në qendrat mësimore përgjatë vazhdës së shkollimit të tyre. Qendrat mësimore ofrojnë arsim plotësues për fëmijët që vuajnë pasojat e përjashtimit socio-ekonomik. Këto qendra kanë qenë kryesisht të varura nga mbështetja e donatorëve, megjithëse një udhëzim administrativ i vitit 2018 që synonte rregullimin e qendrave parasheh edhe financim nga buxhetet qendrore dhe komunale. Megjithatë, vonesat e qeverisë dhe institucioneve komunale në sigurimin e mjeteve, së bashku me paqartësitë rreth shumës së mjeteve që duhet të ndahen, i kanë lënë qendrat mësimore pa financim dhe, si rrjedhim, shumë sosh është dashur të mbyllen.⁶⁵

Në gusht të vitit 2023, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) njoftoi se prindërit duhej t'i blinin vet tekstet shkollore për klasat 1-5 dhe se do të kompensoheshin pas aplikimit në internet.

⁶⁵ Për më shumë rreth qendrave mësimore, shih Raportin e OSBE-së "Vështrim i përgjithshëm mbi qendrat mësimore në Kosovë dhe zbatimin e Udhëzimit administrativ nr. 19/2018 (2023).

Vendimi shkaktoi disa shqetësime, veçanërisht për komunitetet më të cenueshme dhe familjet në kushte të vështira ekonomike, të cilat duhej të mbështeteshin në përkrahjen e OJQ-ve për të pasur qasje në subvencionet, meqë disa pjesëtarë të komunitetit nuk kishin llogari bankare ose nuk dinin të përdornin kompjuterin.

Për t'i inkurajuar nxënësit që të qëndrojnë të regjistruar në shkollë përtej viteve të para të arsimit të detyrueshëm, MASHTI ofron çdo vit 500 bursa për nxënësit e shkollave të mesme nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës të cilët i vijnë shkollat me planprogram të Kosovës. Financimi mbështetet nga donatorët, përfshirë Komisionin Evropian dhe Fondin për Arsimin e Romëve.

Nxënësit romë të Kosovës të cilët i vijnë shkollat me planprogram të Kosovës kanë më shumë të ngjarë që t'i vazhdojnë studimet universitare sesa ata që vijnë shkollat me planprogram serb. Universitetet publike kanë vende të rezervuara për studentët joshqiptarë, përfshirë për Romët e Kosovës. Për më tepër, OJQ-të Roma Versitas, VoRAE dhe Fondi për Arsimin e Romëve i mbështesin studentët e universitetit nga radhët e komunitetit rom të Kosovës, si edhe studentët ashkali dhe egjiptianë të Kosovës.

Sipas MASHTI-t, 1157 nxënës romë të Kosovës janë regjistruar në arsimin parauniversitar gjatë vitit shkollor 2023–2024. Megjithatë, informatat specifike në fushën e arsimit për komunitetin rom të Kosovës janë jashtëzakonisht të kufizuara. Veç kësaj, ofrimi i arsimit për Romët e Kosovës nga shkollat me planprogram serb në Kosovë nuk monitorohet në mënyrë sistematike.⁶⁶

Ndër sfidat më të ndërlikuara me të cilat përballen nxënësit romë të Kosovës është marginalizimi i familjeve të tyre dhe mundësitë financiare përgjithësisht shumë të kufizuara, që kanë shpeshherë si pasojë punën e fëmijëve dhe mungesën në shkollë. Për shembull, me fillimin e mësimin në distancë gjatë pandemisë COVID-19, nxënësit romë të Kosovës u përballën me shumë më tepër sfida sesa komunitetet e tjera në kuptim të qasjes në procesin e mësimin në internet, për shkak të mungesës ose papërshtatshmërisë së pajisjeve të TI-së dhe lidhjes në internet. Megjithatë, shkalla e braktisjes së shkollimit në mesin e fëmijëve romë të Kosovës është duke pësuar rënie.

Shkak i disa rasteve të braktisjes së shkollimit në këtë komunitet ka qenë transporti i çrregullt i nxënësve. Për shembull, në fshatin Janjevë të komunës së Lipjanit, nxënësit romë të Kosovës të cilët udhëtojnë në Graçanicë për t'i vijuar shkollat e mesme me planprogram serb kanë raportuar për probleme me transportin. Në Mitrovicën Jugore, nxënësit romë të Kosovës të cilët i vijnë shkollat me planprogram serb në Mitrovicën Veriore përballen me sfida në kuptimin e qasjes fizike në shkolla, pasi ura për këmbësorë mbi lumin Ibër që lidh dy komunat nuk ekziston më, e kalimi i përditshëm i urës kryesore perceptohet nga komuniteti si rrezik potencial sigurie për fëmijët.

⁶⁶ Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, *Statistikat e arsimit 2023/2024* (2023). Në shumicën e rasteve, të dhënat që përdoren për monitorimin, planifikimin e politikave dhe ndërhyrjet mbledhen dhe prezantohen bashkërisht për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës. Mungesa e përgjithshme e të dhënave të hollësishme për secilin komunitet veç e veç është posaçërisht problematike kur shqyrtohet arsimi dhe vijimi i shkollës.

Megjithatë, disa komuna u janë përgjigjur ankesave të prindërve nga komuniteti. Në fshatin Serbobran të komunës së Istogut, fëmijët ishin detyruar që të ecnin në trafik të rënduar përgjatë rrugëve pa trotuare për të shkuar në shkollë në Gjurakoc dhe në Llukafc të Thatë, kështu që institucionet komunale në Istog iu përgjigjën shqetësimeve të prindërve duke siguruar transport për nxënësit.

Vajzat dhe gratë nga radhët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës përballen me sfida shtesë në qasjen në arsim për shkak të martesave të fëmijëve dhe/ose të hershme⁶⁷ si dhe roleve tradicionale gjinore në këto komunitete. Gjithsej 13.7 për qind e vajzave romë, ashkali dhe egjiptiane të Kosovës nuk e vazhdojnë arsimin e mesëm të lartë pas përfundimit të shkollës së mesme të ulët, krahasuar me 11.3 për qind të djemve nga komunitetet e tyre.⁶⁸ Për më tepër, katër për qind e vajzave romë, ashkali dhe egjiptiane të Kosovës nuk kalojnë nga arsimi fillor në atë të mesëm të ulët, krahasuar me 6.1 për qind të djemve nga i njëjti komunitet.⁶⁹ Martesat e fëmijëve janë një prej faktorëve për ndërprerjen e shkollimit,⁷⁰ por është e vështirë të përcaktohet një korrelacion i drejtpërdrejtë ndërmjet martesave të fëmijëve dhe arritshmërisë akademike më të ulët të vajzave nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës. Mungesa e të dhënave të sakta dhe të krahasueshme të zbërthyer sipas komunitetit për numrin e fëmijëve që martohen para se të mbushin moshën 18-vjeçare i vështirëson përpjekjet për ta matur ndikimin negativ të martesave të fëmijëve në shkollimin e vajzave, jo vetëm për këto tri komunitete por për gjitha komunitetet e tjera.

Në fund të vitit 2023, Qeveria themeloi një grup punues ndërinstitucional për parandalimin dhe raportimin e martesave të hershme në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Nxënësit romë të Kosovës në përgjithësi ndërveprojnë me nxënës të komuniteteve tjera pa incidente. Megjithatë, në disa shkolla me planprogram serb, veçanërisht në ato të Mitrovicës Veriore, nxënësit romë dhe serbë të Kosovës mësojnë ndaras dhe, kështu, praktikisht pamundësohet çfarëdolloj ndërveprimi ndërmjet komuniteteve. Kjo ndarje ka rezultuar në ankesa nga prindërit dhe përfaqësuesit e komunitetit rom të Kosovës, të cilët kanë pretenduar se cilësia e arsimimit që u ofrohet nxënësve romë është më e dobët se e komunitetit shumicë. Në komuna të tilla si Novobërdë, Gjilan, Kamenicë dhe Shtërpcë është raportuar për ndërveprime pozitive mes nxënësve romë të Kosovës dhe bashkëmohatarëve të tyre të serbë të Kosovës.

67 *Martesa e fëmijëve dhe martesa e hershme* janë shprehje që përdoren në mënyrë të ndërkëmbyeshme. Sipas Ligjit për mbrojtjen e fëmijës në Kosovë, "fëmijë" konsiderohet "çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare". [Ligji nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës, neni 3](#). Në kuptimin ligjor, "martesa e fëmijëve" dhe "martesa e hershme" konsiderohen si të njëjta: martesë e një fëmije nën moshën 18 vjeçare. *Martesa e detyruar* është një martesë në të cilën njëri ose të dy bashkëshortët, pavarësisht moshës, nuk e kanë dhënë pëlqimin. Në Ligjin për familjen të Kosovës, "Personi i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetëvjeçare nuk mund të lidhë martesë" (neni 16), përveç për arsye të justifikueshme (neni 16b). Neni 18 përcakton se "Martesa nuk do të jetë e plotfuqishme, nëse pëlqimi është arritur përmes shtrëngimit, kërcënimit ose lajthimit, apo të ndonjë mungese tjetër të vullnetit të lirë nga ana e bashkëshortëve të ardhshëm". Ligji nr. 2004/32 Ligji për Familjen (2006) dhe [Ligji nr. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Familjen nr. 2004/32](#).

68 UNICEF, *Analizë e gjendjes së fëmijëve dhe grave në Kosovë* (2017), Tabela 16: Analiza e rrugëtimit në arsim për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian sipas gjinisë; f. 79.

69 Po aty.

70 UNFPA, *Martesa e fëmijëve në Kosovë (Pasqyrë)*, (2014).

7. Qasja në drejtësi

Nuk ka përfaqësues të komunitetit rom të Kosovës të punësuar në asnjë nga institucionet jogjyqësore: Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF), Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) dhe Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV). Për më tepër, nuk ka avokatë romë të Kosovës të licencuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK).

Monitorimi në terren i OSBE-së ka shpalosur se pjesëtarët e komunitetit rom të Kosovës në përgjithësi gëzojnë qasje formale në sistemin e drejtësisë. Megjithatë, ky komunitet ka mungesë të përgjithshme të njohurive për të drejtat e tyre, si dhe për procedurat ligjore dhe mundësinë e ndihmës juridike falas. Pengesë kryesore për qasjen në sistemin ligjor është varfëria, ngaqë tarifatat gjyqësore, kostot ligjore, madje edhe transporti, mund të jenë barrë e madhe financiare.

Në përgjithësi, pjesëtarët e komunitetit rom të Kosovës nuk janë në dijeni për shërbimet që ofrohen nga ANJF, IAP dhe ZMNV. Pjesëtarët e komunitetit të cilët kanë më së shumti njohuri për këto shërbime janë ata që punojnë në ose komunikojnë me institucionet komunale, organizatat e shoqërisë civile, mediat, si dhe studentët. Fushatat e ndërgjegjësimit që synojnë komunitetin e gjerë, veçanërisht familjet që jetojnë në zonat rurale, mund të jenë efektive, e një shembull të këtillë përbëjnë përpjekjet për të rritur dukshmërinë e ZNJF.

Në përgjithësi, komuniteti rom i Kosovës nuk përballet me sfida në qasjen në shërbime juridike falas. Megjithatë, familjet që banojnë në zona të largëta e kanë të vështirë t'i përballojnë shpenzimet e transportit dhe kostot tjera të lidhura me qasjen në to. Përfaqësuesit e komunitetit rom dhe egjiptian të Kosovës në rajonin e Pejës deklaruan se niveli i njohurive për shërbimet e IAP, ZNJF dhe ZMNV është mjaft i ulët, pavarësisht se janë realizuar disa aktivitete nga këto institucione përkatëse dhe përfaqësuesit e tyre kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme ndërgjegjësimi të organizuara nga akterë të ndryshëm. Në përgjithësi, Romët e Kosovës që jetojnë në komunat me shumicë serbe të Kosovës e perceptojnë qasjen e tyre në mekanizmat ligjorë si më pak të penguar sesa Romët e Kosovës që banojnë në komunat me shumicë shqiptare të Kosovës. Sidoqoftë, kufizimet financiare mbeten shqetësim për tërë komunitetin.

Në vitin 2023, me mbështetjen e USAID-it, ZNJF shpërndau fletëpalosje dhe afishe në gjuhët angleze, shqipe, serbe dhe turke si dhe në alfabetin e brajlit.

Në mënyrë të ngjashme, gjatë Javës së Ndihmës Juridike Falas me moton "Mbroni të drejtat tuaja" janë postuar videoklipe dhe postime në rrjetet sociale në gjuhët zyrtare. ZNJF në Prizren, Gjilan dhe Prishtinë, me vetiniciativë zbaton procedura të shpejta për shërbimet për kategoritë e cenueshme, dhe të tjera sipas nevojës, për t'ua lehtësuar qasjen dhe barrën e shpenzimeve të udhëtimit.

Që nga tetori i vitit 2021, IAP është duke udhëhequr me "Forumit për Dialog" ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe OSHC-ve, i cili mbledh OSHC të ndryshme, përfshirë ato që përfaqësojnë **Romët e Kosovës**.⁷¹ Në mars të vitit 2023, së bashku me OJQ-në "ROMTEGRA", Institucioni i Avokatit të Popullit vizitoi disa familje **rome të Kosovës** në Mitrovicë me qëllim të ofrimit të informacionit dhe diskutimit të sfidave dhe shqetësimeve të tyre. Në bashkëpunim me Qendrën Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC) nga Mitrovica Veriore, Institucioni i Avokatit të Popullit është takuar gjithashtu dhe me OSHC-të në Mitrovicë dhe Pejë dhe ka realizuar tryeza diskutimi, të organizuara nga ACDC, rreth shqetësimeve të komuniteteve që lidhen me respektimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre.⁷²

Në vitin 2023, IAP publikoi një raport sipas detyrës zyrtare lidhur me mungesën e kushteve të përshtatshme të jetesës për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës të kthyer në Obiliq nga Maqedonia e Veriut.⁷³

ZMNV, nën patronazhin e Zyrës së Kryeprokurorit dhe me mbështetjen e Ambasadës Amerikane, organizon çdo tetor "Javën e të Drejtave të Viktimave të Krimin". Megjithatë, është mendim i përgjithshëm i palëve të interesit të cilat janë intervistuar se fushata të tilla informuese duhet të organizohen gjatë tërë vitit.

Përkundër fushatave të shumta informuese të realizuara nga institucione të ndryshme, përfshirë nga ZMNV, Ministria e Drejtësisë, OAK, dhe informatat që u ofrohen viktimave kur kërkojnë shërbime, ka pak në mos fare hiq njohuri rreth programit të kompensimit të viktimave të krimin (KVK).

Veç kësaj, pjesëtarët e komunitetit **rom të Kosovës** nga Mitrovica Jugore kohët e fundit kanë pretenduar se ka pasur trajtim diskriminues nga IAP. Pjesëtarët e komunitetit kanë deklaruar se kur pagesat e ndihmës financiare u ndaluan gjatë pandemisë COVID-19, ata kishin paraqitur një ankesë, por nuk morën kurrë përgjigje.

Në vitin 2023, ANJF ka ofruar shërbime për 6070 persona (përfshirë këtu 2883 gra), prej të cilëve 506 ishin pjesëtarë të komunitetit **rom të Kosovës**. Në vitin 2023, IAP ka pranuar gjithsej 1,660 ankesa (1,162 burra dhe 498 gra),⁷⁴ që përfshin 4296 persona. Nga numri total i ankesave, 19 janë paraqitur nga komuniteti rom i Kosovës.

71 Qëllimi i Forumit është krijimi i një platforme të përbashkët për bashkëpunim ndërmjet IAP dhe OSHC-ve, për avancimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, për identifikimin e sfidave dhe shkeljeve të të drejtave dhe lirive themelore dhe zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta për promovimin dhe mbrojtjen e tyre.

72 Për më shumë informacion, shih: <https://oik-rks.org/en/2023/12/05/the-ombudsperson-met-representatives-of-civil-society-organizations-from-the-region-of-peja/> (qasur në dhjetor të vitit 2023).

73 Institucioni i Avokatit të Popullit, *Mungesa e kushteve të përshtatshme të jetesës për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të kthyer në Obiliq nga Republika e Maqedonisë së Veriut* (2018).

74 *Shih* Institucioni i Avokatit të Popullit, *Raporti vjetor për vitin 2023*.

ZMNV i ka trajtuar 2883 raste në vitin 2023, 26 viktima ishin romë të Kosovës dhe 53 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës (jo çdo rajon ofron zbërthim të dhënave sipas komuniteteve). Shumica e viktimave ishin gra.

Komuniteti rom i Kosovës nuk e percepton gjuhën si pengesë për qasje në institucionet ligjore, meqë shumica dërrmuese e pjesëtarëve të komunitetit e flasin rrjedhshëm ose gjuhën shqipe ose atë serbe.

8. Përdorimi i gjuhës dhe mediat

Komuniteti rom i Kosovës e flet gjuhën rome. Në Kosovë fliten disa dialekte rome. Romët e Kosovës ndjehen të lirë që ta përdorin gjuhën e tyre amtare në mjedise private, e për komunikim publik ose zyrtar mbështeten në gjuhën shqipe ose atë serbe.

Shumica e romëve flasin shumë gjuhë, ndër to shpesh edhe serbishten ose shqipen, ose të dyja gjuhët. Përdorimi i gjuhës rome duket se është në rënie tek të rinjtë, shumë prej të cilëve parapëlqejnë që edhe në mjedise private ta flasin ose gjuhën shqipe, ose serbe.

Gjuha rome është folur tradicionalisht në komunën e Prizrenit, që vazhdon njëherësh të jetë një nga qendrat më të rëndësishme kulturore për komunitetin rom. Në përgjithësi, komuniteti rom i Kosovës në rajonin e Prizrenit e përdorë gjuhën rome vetëm në sferën private, ndërkaq shumica e përdorin gjuhën shqipe në jetën publike. Megjithatë, komuniteti rom i Kosovës në zonat me shumicë serbe të Rahovecit të epërm dhe Hoçës së Madhe në përgjithësi e përdorin gjuhën serbe në mjedise publike.

Në vitin 2022, në Prizren u krijua "Koalicioni për gjuhën rome" nga OJQ-ja lokale "Nevo Koncepti" me mbështetjen e Këshillit të Evropës. Qëllimi kryesor i koalicionit ishte promovimi i njohjes së gjuhës rome nga Komuna e Prizrenit. Më 31 tetor të vitit 2022, gjuha rome u njoh si gjuhë në përdorim zyrtar në Prizren. Koalicioni ka vazhduar punën e tij për ta avancuar përdorimin e gjuhës rome. Në vitin 2024, me mbështetjen financiare të IOM-it, komuna e Prizrenit ka angazhuar një përkthyes të përkohshëm për gjuhën rome për gjashtë muaj. Më 8 shkurt të vitit 2024, pra jashtë periudhës për të cilën raportohet, me mbështetjen e Zyrës së Komisionarit për Gjuhët, disa OJQ rome të Kosovës nga Prizreni organizuan një ngjarje promovuese që shënoi të parën herë ku gjuha rome u dëgjua dhe flitej edhe në komunën e Prizrenit, si dhe u përkthye në gjuhë të tjera zyrtare. Komuna e Graçanicës e kishte përcaktuar gjuhën rome si gjuhë në përdorim zyrtar në nivel komunal me ndryshimin e statutit të saj në dhjetor të vitit 2014, megjithatë, në praktikë, mungesa e përkthyesve ka ndikim negativ në qasjen e pjesëtarëve të komunitetit në shërbimet në gjuhën rome.

Në Gjakovë, pjesëtarët e komunitetit rom të Kosovës kanë shprehur interesim që gjuha rome të njihet si gjuhë në përdorim zyrtar, por asnjë kërkesë zyrtare nuk i është drejtuar komunës. Romët e atyshëm e përdorin në përgjithësi gjuhën rome kur komunikojnë me njëri-tjetrin jashtë sferës publike, e gjuhën shqipe kur ndërveprojnë me institucionet.

Në pjesën tjetër të rajonit të Pejës, komuniteti e përdor kryesisht gjuhën shqipe si në jetën private ashtu edhe atë publike, me përjashtim të të moshuarve.

Në komunat e Shtërpçës, Gjilanit dhe Kamenicës, Romët e Kosovës parapëlqejnë që ta përdorin gjuhën serbe në komunikimin e tyre me institucionet, me disa përjashtime. Në rajonin e Mitrovicës, romët të cilët banojnë në zonat me shumicë serbe e përdorin gjuhën serbe. Në rajonin e Prishtinës, pjesëtarët e komunitetit rom të Kosovës në përgjithësi e flasin rrjedhshëm gjuhën shqipe dhe komunikojnë me institucionet vendore pa ndonjë problem të madh, ndërkohë që gjuhën e tyre amtare e përdorin në mjedise private.

Që nga viti 2003, televizioni shtetëror RTK ka transmetuar programe të veçanta për komunitetet joshumicë, përfshirë këtu dhe në gjuhën rome. RTK transmeton një buletin lajmesh në kohëzgjatje prej 15 minutash në gjuhën rome çdo ditë pune. "Yekhiphe" është emision informativ i përjavshëm që transmetohet në RTK 2 e që përmban një debat të gjatë informativ dhe që shpeshherë ritransmetohet.

Stacionet televizive komerciale dhe mediat në nivel komunal ofrojnë gjithashtu programe në gjuhën rome. Në Prizren, radiostacioni "Romano Avazo" transmeton 24 orë në gjuhën rome dhe është aktiv që nga viti 2007. Radio "Romano Avazo" është gjithashtu në dispozicion në internet, përmes faqes së internetit dhe rrjeteve sociale.⁷⁵ Në Gjakovë, programet radio dhe televizive në gjuhën rome "Jivdipe Tumenca" prodhohen nga OJQ "Roma in Action" [Romët në Veprim] dhe transmetohen në TV Syri dhe Radio Gjakova. Edhe Radio Graçanica transmeton radioprograme në gjuhën rome. Në Ferizaj, stacioni lokal "TV Most" transmeton një program ditor televiziv në kohëzgjatje prej 30 minutave në gjuhën rome, me mbështetjen e ZKKK-së, gjersa radiostacioni lokal "Radio Kontakt Plus" transmeton programe në gjuhën rome herë pas here. Veç kësaj, në rajonin e Prizrenit, përmbajtje në gjuhën rome ofrojnë edhe revista kulturore "Yekhiphe" dhe një teatër.

⁷⁵ <http://radiatoromanoavazo.com/?fbclid=IwAR1mNI5ClyjpQUBmrKqI0Ncuc-QZp7bWw1X5Cit3DNjgkAxVfj2HZIUtYM> dhe <https://www.facebook.com/radiatoromanoavazo> (Qasur në dhjetor 2023).

9. Trashëgimia kulturore dhe fetare, liritë fetare

Komuniteti rom i Kosovës është në përgjithësi i lirë që ta shprehë identitetin e tij kulturor, besimet fetare dhe zakonet, ndërsa objektet e trashëgimisë fetare dhe kulturore i ka të përbashkëta me komunitetet shqiptare dhe joshqiptare.

Komuniteti rom i Kosovës është kryesisht i besimit mysliman sunit, me një përqindje të vogël që ndjekin sufizmin dhe protestantizmin në Gjakovë dhe krishterimin ortodoks në Prishtinë, si edhe disa pjesëtarë të komunitetit rom të Kosovës në Kamenicë që janë dëshmitarë të Jehovait. Komuniteti rom i ndjekë shërbesat fetare në xhami të ndryshme sunitë, teqe *sufi*, dhe kishat e krishtera ortodokse dhe protestante ungjillore, pavarësisht se cili komunitet i drejton ato. Për shembull, besimtarët romë të Kosovës frekuentojnë teqen *sufi* dhe xhaminë suni në Gjakovë të drejtuar nga egjiptianët e Kosovës.

Komuniteti shënon Ditën Ndërkombëtare të Romëve (8 Prill) për ta kremtuar kulturën rome dhe për të rritur ndërgjegjësimin për problemet me të cilat përballen romët. Nga data 6 deri më 15 maj, Romët e Kosovës e festojnë festën e Shën Gjergjit, e cila kombinohet me festat tradicionale që festojnë fundin e dimrit dhe fillimin zyrtar të verës.

Përkundër faktit se ka një mjedis përgjithësisht të hapur dhe tolerant, në prill të vitit 2020 rreth 30 gurë varresh u dëmtuan në një varrezë në qytetin e Rahovecit, ku shumica e lapidarëve i përkisnin komunitetit rom të Kosovës dhe të tjerët pjesëtarëve të komunitetit egjiptian të Kosovës dhe komunitetit ashkali të Kosovës.

Banorët romë të Kosovës të komunës së Graçanicës për shumë vite janë duke u përballur me sfida në qasjen në varrezat në fshatin Preoc. Rruga është e ndarë ndërmjet komunave të Graçanicës dhe Fushë Kosovës dhe bllokohet shpeshherë nga mbeturinat e ngurta në hyrje.

10. Të drejtat pronësore

Komuniteti rom i Kosovës përballlet me sfida të ngjashme sikurse komunitetet tjera joshumicë në Kosovë, siç është qasja në banim dhe mungesa e dokumentacionit ligjor që vërteton pronësinë e pronës.

Shumë pjesëtarë të komunitetit nuk kanë kontrata apo dëshmi të tjera ligjore për të vërtetuar të drejtën e tyre në pronë. Shpeshherë, qasja në banim kufizohet nga mungesa e informatave rreth mundësive që ofrojnë komunat.

Në Prishtinë, shumë pjesëtarë të komunitetit rom të Kosovës jetojnë në vendbanime joformale pa dëshmi të pronësisë së shtëpive e tokës së tyre. Për shkak se shumë bartje të tokave dhe pronave janë bërë në mënyrë joformale, në zyrat komunale nuk ekzistojnë të dhëna pronësie.

Në rajonin e Gjilanit, qasja në banim vazhdon të jetë problematike, ndonëse janë ndërmarrë disa nisma për të trajtuar këtë çështje. Për shembull, në vitin 2019, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ndërtoi një shtëpi për një familje rome në fshatin Dubravë të komunës së Ferizajt. Në vitin 2013, Këshilli Danez për Refugjatë ndërtoi shtatë shtëpi për të kthyerit romë të Kosovës në fshatin Berivojcë të komunës së Kamenicës, me mbështetjen e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim dhe Komisionit Evropian.

11. Kthimi dhe riintegrimi

Shumë persona të zhvendosur nga radhët e komunitetit rom të Kosovës që jetojnë jashtë vendit ngurrojnë që të kthehen në Kosovë për shkak të kushteve të këqija të jetesës dhe frikës se do të bëhen cak i krimeve të urrejtjes.

Pengesë tjetër për kthimin e qëndrueshëm është rezistenca nga komuniteti pritës duke e penguar riintegrimin e të kthyerve. Përkundër përpjekjeve në mbështetje të gjithëpërfshirjes së romëve të Kosovës, shumë pjesëtarë të komunitetit vazhdojnë të përballen me probleme të lidhura me realizimin e të drejtave themelore si qasja në kujdes shëndetësor dhe ndihmë sociale.⁷⁶

Sipas Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, në periudhën 2011- 2023, 946 romë të Kosovës u kthyen në mënyrë vullnetare në shtëpitë e tyre të para konfliktit, duke e çuar numrin e përgjithshëm të të kthyerve romë të Kosovës që nga viti 2000 në 4077. Megjithatë, të dhënat e disponueshme për komunat nga viti 2015 deri në vitin 2023 tregojnë se në praktikë vetëm 502 persona janë kthyer në mënyrë vullnetare gjatë asaj periudhe.⁷⁷ Rënia e numrit të të kthyerve është pasqyruar në rënien e numrit të vizitave komunale shko-dhe-shih dhe shko-dhe-informohu, dhe vetëm disa komuna kanë zhvilluar vizita të tilla në vitet e fundit. Sipas UNHCR, rreth 152 persona mbeten të zhvendosur brenda Kosovës.⁷⁸

Projektet e financuara nga donatorët kanë mëtuar t'i zbusin sfidat e banimit me të cilat përballlet komuniteti. Programi i BE-së për Kthim dhe Riintegrim ka raportuar se rreth 80 njësi banimi janë ndërtuar për romët e kthyer në Kosovë dhe 96 pjesëtarë të komunitetit kanë përfituar pako për gjenerim të të ardhurave në mbështetje të riintegrimit të tyre.⁷⁹ Nisma të tjera kanë synuar komunitetet e marginalizuara, veçanërisht Romët e Kosovës, nën patronazhin e BE-së, institucioneve të Kosovës dhe organizatave donatore si Këshilli Danez për Refugjatët dhe Arbeiter-Samariter-Bund.

⁷⁶ OSBE, *Pasqyrë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë* (2019).

⁷⁷ UNHCR, Zyra e Shefit të Misionit në Prishtinë, pasqyrë statistikore e zhvilluar deri në dhjetor të vitit 2023. Në vitin 2023, pjesëtarë të komunitetit rom të Kosovës u kthyen (13 Pejë).

⁷⁸ Vizitat shko-dhe-shih u japin personave të zhvendosur mundësinë që të marrin informata të dorës së parë për sa u përket kushtet në vendin e tyre të prejardhjes, dhe që të ndërveprojnë e komunikojnë drejtpërsëdrejti me komunitetin pritës, në mënyrë që të marrin një vendim të informuar në lidhje me kthimin ose zgjidhje të tjera të qëndrueshme.

⁷⁹ Numri i njërive banesore të ndërtuara ose rindërtuara është: Obiliq 37, Pejë 16, Kamenicë 8, Fushë Kosovë 7, Prizren 4, Graçanicë 3, Gjakovë dhe Gjilan 2 dhe Klinë 1.

Të dhënat janë siguruar nga IOM Kosova. Shifrat janë pjesë e programit të BE-së për kthim dhe riintegrim në Kosovë; projekti drejtohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë në partneritet me ZKKK dhe zbatohet nga IOM.

Megjithatë, varësia nga projektet e financuara nga donatorët për të krijuar zgjidhje banimi për të kthyerit ka sfidat e veta, pasi vetëm disa komuna marrin pjesë në këto projekte. Të kthyerit e mundshëm në komunat tjera duhet të mbështeten në ndihmën sporadike nga Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK). Në komunën e Obiliqit, MKK ka miratuar financimin për ndërtimin e pesë shtëpive për Romët e Kosovës. Megjithatë, projekti hasi në pengesa për shkak të vështirësive administrative dhe është në pritje të lëshimit të lejeve të ndërtimit.

Në vitin 2023, MKK bëri një hap të rëndësishëm duke nxjerrë një thirrje për ofrim të ndihmë themelore për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë.⁸⁰ Nisma mëtonte që të trajtonte nevoja të ndryshme, përfshirë sigurimin e artikujve ushqimorë dhe joushqimorë, si dhe mbështetjen për ndërtimin dhe rindërtimin e shtëpive. Për më tepër, Ministria e zgjeroi fushëveprimin e saj për ta përforcuar sektorin e bujqësisë, duke ofruar subvencione për lehtësim të praktikave të qëndrueshme bujqësore. Njëkohësisht, pati përpjekje të dedikuara ndaj mbështetjes së bizneseve të vogla të këtyre komuniteteve. Ndikimi i këtyre përpjekjeve ishte i prekshëm, meqë Ministria i mbështeti me sukses 132 familje romë të Kosovës duke u ofruar atyre artikuj të rëndësishëm ushqimorë e joushqimorë, përfshirë këtu edhe material ndërtimor. Vlen të ceket se nisma në fjalë rezultoi me ndërtimin e dy shtëpive në Fushë Kosovë dhe Istog. Veç kësaj, nismat e MKK-së janë shtrirë edhe në ofrimin e mbështetjes substanciale për katër familje (tri në Prizren dhe një në Zveçan).⁸¹ Kjo ndihmë financiare ishte e destinuar për nxitjen e rritjes në sektorin e bujqësisë ose mbështetjen e bizneseve të vogla.

Rezistenca nga disa komunitete pritëse mund të jetë pengesë për kthimin e qëndrueshëm, duke e penguar riintegrimin e të kthyerve. Megjithatë, disa komuna kanë ndërmarrë nisma për ta mbështetur kthimin e romëve të Kosovës. Për shembull, autoritetet komunale në Kamenicë kanë lehtësuar pastrimin e sistemit të kanalizimit në një vend të kthimit të romëve të Kosovës në Berivojcë. Në Suharekë, kryetari i komunës organizoi një ngjarje ku aktivistët e komunitetit rom të Kosovës mbajtën një prezantim për stereotipat, motivin e paragjyqimit, gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin si dukuri negative që pengojnë marrëdhëniet mes komuniteteve.

Në maj të vitit 2017, Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve⁸² i bëri thirrje OKB-së që të nxjerrë një kërkimfalje publike dhe që të ofrojë kompensim dhe trajtim mjekësor individual për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës që pësuan helmim nga plumbi gjersa banonin në një kamp për persona të zhvendosur që ndodhej në tokë të kontaminuar në Mitrovicën Veriore.

80 Vendimi për vendosjen e procedurave për ofrimin e ndihmës nga Ministria për Komunitete dhe Kthim për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, miratuar më 2 shkurt 2023: [Vendim i procedurave per ofrimin e ndihmes-Odluca o proceduri pruzenja pomoci_compressed_compressed-compressed \(1\).pdf \(rks-gov.net\)](#). (Qasur në dhjetor të vitit 2023).

81 Të dhënat i janë siguruar Misionit të OSBE-së në Kosovë nga Ministria për Komunitete dhe Kthim më 6 shkurt 2024.

82 Shih Qendrën Evropiane për të Drejtat e Romëve, *ERRC kërkon drejtësi për viktimat e helmimit nga plumbi në Kosovë* (2017), <http://www.errc.org/press-releases/errc-demands-justice-for-kosovo-victims-of-lead-poisoning> (qasur në dhjetor të vitit 2023).



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Foto: Yllka Fetahaj

Profili i komunitetit

serb të Kosovës

osbe

Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Profili i komunitetit serb të Kosovës

Komuniteti serb i Kosovës radhitet i dyti për nga madhësia në Kosovë.¹ Numri i serbëve të Kosovës i paraqitur në këtë raport është vlerësuar mbi bazën e të dhënave të nxjerra nga dokumentet e OSBE-së “Profilet komunale” të vitit 2018² dhe “Profilet e komuniteteve” të vitit 2010.³

Serbët e Kosovës përbëjnë komunitetin shumicë në dhjetë komuna në Kosovë: Mitrovicë Veriore (rreth 22,530 pjesëtarë të komunitetit);⁴ Graçanicë (afro 7,210);⁵ Leposaviq (rreth 18,000);⁶ Ranillug (rreth 3,600),⁷ ku 13 fshatra janë të banuar vetëm me serbë të Kosovës;⁸ Zveçan (rreth 16,000);⁹ Zubin Potok (rreth 13,900);¹⁰ Partesh (rreth 3,580,¹¹ që banojnë në tre fshatra të banuar vetëm nga serbë të Kosovës);¹² Kllokot (rreth 3,700);¹³ Shtërpçë (7,000-8,000);¹⁴ dhe Novobërdë (rreth 5,500 banorë,¹⁵ ku më shumë se një e treta syresh jetojnë në fshatin Kufcë e Epërme).¹⁶

Ata janë komunitet joshumicë në disa komuna të tjera në Kosovë. Në pjesën jugore të rajonit të Mitrovicës, komuniteti serb i Kosovës ka prani në komunën e Vushtrrisë: në fshatrat Prelluzhë (rreth 1,700), Bajskë (rreth 50), Gracë (rreth 100) dhe Gojbulë (rreth 120), si edhe në komunën e Skenderajt: në fshatrat Bajë (rreth 185) dhe Syriganë (rreth 150).

1 Regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 nuk i ka përfshirë katër komunat veriore. Me disa përjashtime, serbët e Kosovës nuk morën pjesë në regjistrimin e popullsisë në tërë Kosovën.

2 OSBE, *Profilet komunale 2018* (2019).

3 OSBE, *Profilet e komuniteteve 2010* (2011).

4 OSBE, *Profilet komunale 2018*: https://www.osce.org/files/f/documents/3/9/122119_1.pdf

5 Po aty: https://www.osce.org/files/f/documents/4/6/88762_1.pdf

6 Po aty: https://www.osce.org/files/f/documents/0/c/13120_1.pdf

7 Po aty: https://www.osce.org/files/f/documents/0/c/88760_1.pdf

8 Zyra për informim në Ranillug.

9 OSBE, *Profilet komunale 2018*: https://www.osce.org/files/f/documents/d/7/13136_1.pdf

10 Po aty: https://www.osce.org/files/f/documents/e/b/13135_1.pdf

11 Po aty: https://www.osce.org/files/f/documents/3/4/88761_1.pdf

12 OJQ “Opštinska Parteška Inicijativa” në Partesh; dhe përfaqësues të shkollave në Budrigën e Poshtme.

13 OSBE, *Profilet komunale 2018*: https://www.osce.org/files/f/documents/a/4/88759_0.pdf

14 Po aty: https://www.osce.org/files/f/documents/1/6/13130_1.pdf

15 Po aty: https://www.osce.org/files/f/documents/8/9/13122_1.pdf

16 ZKKK në Novobërdë dhe përfaqësuesit e komunitetit serb të Kosovës nga Kufcë të Epërme.

Në rajonin e Gjilanit, **serbët e Kosovës** banojnë në komnat vijuese: Gjilan (rreth 620 pjesëtarë të komunitetit),¹⁷ Viti (afro 115),¹⁸ dhe Kamenicë (rreth 2,000 **serbë të Kosovës** që banojnë në 19 fshatra ku ata përbëjnë shumicën¹⁹). Në rajonin e Pejës, **serbët e Kosovës** banojnë në komnat e Istogut (rreth 195),²⁰ Klinës (afro 100)²¹ dhe Pejës (rreth 340²²). Në rajonin e Prishtinës, **serbët e Kosovës** banojnë në komnat vijuese: Prishtinë (rreth 430),²³ Fushë Kosovë (rreth 320),²⁴ Lipjan (afro 515),²⁵ dhe Obiliq (afro 280²⁶). Komnat e tjera në të cilat banojnë **serbët e Kosovës** janë: Prizreni (afro 240),²⁷ Rahovec (rreth 135)²⁸ dhe Ferizaj (32).²⁹

17 OSBE, *Profilet komunale 2018*: https://www.osce.org/files/f/documents/c/0/13113_1.pdf

18 Po aty: https://www.osce.org/files/f/documents/7/c/13133_1.pdf

19 ZKKK në Kamenicë.

20 OSBE, *Profilet komunale 2018*: https://www.osce.org/files/f/documents/e/6/13119_1.pdf

21 Po aty: https://www.osce.org/files/f/documents/e/6/13119_1.pdf

22 Po aty: https://www.osce.org/files/f/documents/c/3/13125_1.pdf

23 Po aty: https://www.osce.org/files/f/documents/2/2/13127_1.pdf

24 Po aty: https://www.osce.org/files/f/documents/0/3/13118_1.pdf

25 Po aty: https://www.osce.org/files/f/documents/7/4/13121_1.pdf

26 https://www.osce.org/files/f/documents/2/7/13123_0.pdf

27 OSBE, *Profilet komunale 2018*: <https://www.osce.org/files/Prizren.pdf>

28 Po aty: https://www.osce.org/files/f/documents/7/d/13124_1.pdf

29 Po aty: https://www.osce.org/files/f/documents/a/8/13132_1.pdf

Faktet dhe çështjet kryesore

- Numri i incidenteve të sigurisë që kanë në shënjestër **Serbët e Kosovës** ka shënuar rënie graduale, por **Serbët e Kosovës** dhe pronat e tyre vazhdojnë të përjetojnë numrin më të lartë të incidenteve në krahasim me të gjitha komunitetet e tjera.
- Komuniteti **serb i Kosovës** ka dhjetë ulëse të garantuara në Kuvend dhe të paktën një post ministror në Qeveri. Gjithsej gjashtë komuna udhëhiqen nga **serbë të Kosovës**, ndërsa **Serbët e Kosovës** kanë qenë më të përfaqësuarit në komunat ku këta të fundit përbëjnë pakicë numerike, krahasuar me komunitetet tjera joshumicë.
- Gjendja ekonomike e gjithmbarshme për komunitetin **serb të Kosovës** është e paqëndrueshme. Ky komunitet është i integruar dobët në shoqërinë e gjerë.
- Institucionet e drejtuara nga Beogradi sigurojnë shumicën e vendeve të punës për **serbët e Kosovës**, të cilët janë të punësuar në sektorët e arsimit, shëndetësisë, mirëqenies sociale, dërgesave postare dhe sektorëve të tjerë të drejtuar nga këto institucione.
- Që nga viti 2000, mbi 12,000 **serbë të Kosovës** kanë gjetur zgjidhje të qëndrueshme për t'u kthyer në Kosovë.
- Komuniteti është përgjithësisht i lirë ta shprehë identitetin e tij kulturor, besimet fetare dhe zakonet. Megjithatë, në disa zona me shumicë shqiptare të Kosovës, komuniteti dhe klerikët e Kishës Ortodokse Serbe ndihen akoma të pasigurt që të vizitojnë vizituar vende të caktuara fetare (si kisha, manastire dhe varreza).
- Në fillim të nëntorit të vitit 2022, kryetarët e komunave, anëtarët e kuvendeve komunale, zyrtarët policorë, gjyqtarët dhe prokurorët **serbë të Kosovës** nga katër komunat veriore³⁰ dhanë dorëheqje në shenjë proteste ndaj politikave qeveritare. Dorëheqje dhanë edhe ministri për Komunitete dhe Kthim dhe dhjetë deputetë të Kuvendit të Kosovës nga Lista Serbe (SL).

³⁰ Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan.

1. Siguria dhe rendi

Ndonëse numri i përgjithshëm i incidenteve të sigurisë që kanë në shënjestër komunitetin serb të Kosovës është duke shënuar rënie graduale, serbët e Kosovës dhe pronat e tyre vazhdojnë të përjetojnë numrin më të lartë të incidenteve krahasuar me të gjitha komunitetet e tjera.³¹

Të kthyerit **serbë të Kosovës** ishin më të prekurit deri në vitin 2017. Incidentet më të zakonshme kundër të kthyerve përfshinin vjedhjen e bagëtive, shpezëve, makinave, traktorëve, makinerive bujqësore dhe pompave të ujit; plaçkitjet e shtëpive të pabanuara të të kthyerve, prerjet e paligjshme të druve; dhe uzurpimin e paligjshëm të pronave, por ka pasur edhe raste të zjarrvënies. Numri më i madh i incidenteve cak i të cilëve kanë qenë të kthyerit **serbë të Kosovës** dhe pronat e tyre është regjistruar në rajonin e Pejës, veçanërisht në komunat e Istogut, Klinës dhe Pejës, ku më të shpeshtat kanë qenë incidentet që prekin pronat, si vjedhjet, uzurpimet e paligjshme dhe incidentet e zjarrvënies ose zjarreve (shih më poshtë).

Në vitin 2019, nga 8,861 zyrtarë të Policisë së Kosovës (si staf civil ashtu edhe të uniformuar), 1,037 ishin pjesëtarë të komunitetit **serb të Kosovës**.³² Ky numër ra në 457 (61 gra) në vitin 2023. Gati gjysma e zyrtarëve serbë të Policisë së Kosovës punonin në drejtorinë rajonale të Mitrovicës Veriore, ku 466 zyrtarë serbë të Policisë së Kosovës ishin në detyrë deri në vitin 2022, kur edhe dhanë dorëheqje nga Policia e Kosovës. Pjesa tjetër e zyrtarëve policorë ndodhen janë të caktuar në stacionet e Policisë së Kosovës në Gjilan, Lipjan (përfshirë një nënstacion në Janjevë), Prishtinë (përfshirë një nënstacion në Bërnice), Graçanicë, Ferizaj, Fushë Kosovë, Shtime, Shtërpçë, Kamenicë, Viti, Novobërdë, Klllokot, Partesh, Ranillug, Pejë (përfshirë një nënstacion në Gorazhdec), Istog, Klinë, Rahovec dhe një nënstacion në fshatin Prelluzhë të komunës së Vushtrrisë.³³ Vetëm katër **serbë të Kosovës** shërbenin në polici në rajonin e Pejës, dy në Gorazhdec në nënstacionin policor të Pejës dhe nga një në Istog dhe Klinë.

Që policimi në bashkësi të ketë efektivitet, është me rëndësi që përbërja e Policisë së Kosovës ta pasqyrojë diversitetin e popullsisë në Kosovë dhe që një numër i mjaftueshëm zyrtarësh policorë t'i flasin rrjedhshëm të dy gjuhët zyrtare.

³¹ Sipas monitorimit të brendshëm të OSBE-së, kanë ndodhur 360 incidente në vitin 2013, 309 në 2014; 281 në vitin 2015; 242 në 2016; 194 në 2017; 249 në vitin 2018; 178 në 2019; 181 në 2020; 150 në vitin 2021; 120 në 2022; dhe 120 në 2023.

³² Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, *Sfidat dhe praktikat e gjithëpërfshirjes në sektorin e sigurisë në Kosovë* (2020).

³³ Po aty.

Gjersa Policia e Kosovës vazhdon të jetë proaktive në reagimin ndaj incidenteve që i prekin komunitetet, në mesin e komunitetit **serb të Kosovës** akoma mbizotëron perceptimi se rastet e tyre mund të shoqërohen me zvarritje ose pengesa.

Janë 182 **serbë të Kosovës** në Komitetet Lokale për Siguri Publike (KLSP).³⁴

Peja ka qenë rajoni me numrin më të lartë të incidenteve të sigurisë që prekin komunitetin e kthyer **serb të Kosovës**, deri në janar të vitit 2021, kur u regjistrua numri më i lartë i incidenteve të sigurisë në Mitrovicë. Komuniteti **serb i Kosovës** në rajonin e Pejës, ku shumica e të kthyerve janë të moshuar, është prekur në masë joproporcionale nga incidentet e sigurisë, duke mbajtur parasysh se, krahasuar me pjesët e tjera të vendit, në këtë rajon banon numër më i vogël i **serbëve të Kosovës**.³⁵ Rastet e zjarrvënies ndikojnë negativisht në perceptimin e të kthyerve dhe të kthyerve potencialë, dhe përbëjnë incidentet më të raportuara nga mediat.³⁶

Incidentet që e kanë prekur më rëndom komunitetin **serb të Kosovës** në Gjilan kanë qenë vjedhjet e përsëritura, kryesisht nga pronat rurale. Këto ishin veçanërisht të përhapura në vitin 2018 dhe në fillim të vitit 2019. Incidentet e tjera më të rënda përfshinin sulmet fizike, grafite me gjuhë urrejtjeje dhe zjarrvënie.³⁷ Ndërmjet vitit 2016 dhe marsit të vitit 2019, Policia e Kosovës në rajonin e Gjilanit ka raportuar për rritje të bastisjeve të organizuara dhe të koordinuara nëpër fshatra ana e bandave kriminale që shënjestronin joproporcionalisht komunitetin **serb të Kosovës**. Pas arrestimit të një bande të dyshuar kriminale nga Mitrovica Jugore në mars të vitit 2019, vjedhjet ndaluan menjëherë.

Në rajonin e Mitrovicës, incidentet më të zakonshme kanë qenë sulmet verbale dhe përlëshjet në afërsi të urës kryesore mbi lumin Ibër, që ndan Mitrovicën Jugore nga ajo Veriore, dhe në vendbanimet e përziera etnikisht në Mitrovicën Veriore.³⁸

³⁴ Në nëntor 2023.

³⁵ Në nëntor të vitit 2020, në fshatin Drenoc të komunës së Klinës, janë hedhur gurë në shtëpinë e një të moshuari serb të Kosovës që ishte kthyer dhe ishte thyer një dritare. Në maj të vitit 2022 është raportuar për shqetësime të vazhdueshme gjatë natës ndaj një çifti të moshuar të kthyer serb të Kosovës nga fshati Klinafç të komunës së Klinës. Në komunën e Istogut, në fshatin Lubozhdë, dy herë janë hedhur gurë drejt një shtëpie që i përkiste një të kthyerit serb të Kosovës, fillimisht në maj 2020 dhe më pas në qershor 2020. Në maj 2021, autorë të panjohur hodhën gurë në dy shtëpi të të kthyerve serbë të Kosovës, duke dëmtuar një derë dhe duke thyer tri dritare në fshatin Dubravë. Në shkurt të vitit 2021, në fshatin Gorazhdec të komunës së Pejës, në një mur të një shtëpie të serbëve të Kosovës ishte shkruar mbishkrimi "UÇK Kosova" me sprej. Në korrik të vitit 2021, një burrë serb i kthyer në Kosovë raportoi se një person i panjohur e kishte sulmuar fizikisht atë në fshatin Dollc në Klinë. Policia e Kosovës kishte dalë në vendngjarje. Viktima është transportuar në Spitalin Rajonal të Pejës, ku mori trajtim për lëndime të lehta trupore.

³⁶ Në maj të vitit 2018 ndodhi një shpërthim në shtëpinë e një të kthyerit në Dragolec, vetëm tri ditë pasi i kthyeri kishte pranuar çelësat e shtëpisë së rindërtuar. Në tetor të vitit 2018, iu vu flaka një shtëpie që i përkiste një familjeje të kthyer serbe të Kosovës në fshatin Bellopojë të komunës së Pejës. Në maj të vitit 2020, në fshatin Berkovë të komunës së Klinës, persona të panjohur i vunë flakën një shtëpie që i përkiste një serbi të Kosovës, i cili përkohësisht nuk ndodhej aty. Në shtator të vitit 2021, një zjarr me origjinë të panjohur dogji gjashtë hektarë fushë dhe pyll që i përkisnin një familjeje të kthyerish serbë të Kosovës në fshatin Drenoc të komunës së Klinës, ndërsa persona të panjohur u vunë zjarrin mbeturinave të hedhura pranë një livadhi kumbullash të një serbi të Kosovës në qytetin e Klinës. Zjarrin u përhap, duke i dëmtuar rreth 150 pemë kumbulle. Në dhjetor të vitit 2023, një shtëpi të pabanuar që i përkiste një familjeje serbe të Kosovës në fshatin Bellopojë të Pejës e kapluan flakët.

³⁷ Në shkurt të vitit 2017, në Gjilan, një grup prej 15 - 20 të rinjsh shqiptarë të Kosovës hynë në një rrugë të banuar nga serbë të Kosovës, ku ndodhej edhe një kishë ortodokse serbe dhe një dyqan i drejtuar nga serbët e Kosovës, duke brohoritur parulla antiserbe dhe shkruar grafite antiserbe. Në mars të vitit 2017, në fshatin e përzier me serbë dhe shqiptarë të Kosovës, Mogillë, në komunën e Klllokotit, dy adoleshentë meshkuj shqiptarë të Kosovës sulmuan një serb të Kosovës 17-vjeçar. Në fshatin Cërnicë të komunës së Gjilanit, në dhjetor të vitit 2019, një burrë shqiptar i Kosovës goditi me thikë një fqinj serb të Kosovës. Në maj të vitit 2021, në tri raste, u gjuajtën me me gurë pronat e pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës dhe Kishës Ortodokse Serbe në Viti. Në gusht 2021, një 11-vjeçar serb i Kosovës u sulmua fizikisht. Dyshohet se sulmues ishin dy djem shqiptarë të Kosovës në qytetin e Kamenicës. Në korrik të vitit 2022, një serb i Kosovës në fshatin e përzier Mogillë, komuna e Klllokotit, raportoi se një person(a) i panjohur hodhi një pajisje shpërthyesë në oborrin e tij nga një makinë në lëvizje.

³⁸ Në shkurt të vitit 2021, në Mitrovicë Veriore, një shqiptar i Kosovës iu afrua tre burrave serbë të Kosovës që po qëndronin në rrugë dhe më pas e goditi njërin me thikë disa herë. Në mars të vitit 2021, persona të panjohur vendosën grafite me mbishkrimin "UÇK"

Serbët e Kosovës që jetojnë në komunën e Vushtrrisë kanë qenë shpeshherë shënjestër e incidenteve, përfshirë një rast të frikësimit dhe uzurpimit të paligjshëm të pronës.³⁹

Në rajonin e Prishtinës kanë ndodhur më pak incidente të rënda në krahasim me rajonet tjera. Ato zakonisht ndodhin në zona me komunitete të përziera.⁴⁰ Megjithatë, për dallim nga rajonet tjera,⁴¹ rajoni i Prishtinës ka numër më të lartë të incidenteve të lidhura me grafite dhe incidente në shkollat ku nxënësit i vijnë mësimet në të njëjtin objekt sipas dy sistemeve arsimore.⁴²

Rajoni i Prizrenit ka shënuar numrin më të ulët të incidenteve të sigurisë, njëherësh përgjithësisht më pak të rënda, në krahasim me rajonet e tjera. Incidentet në fjalë kanë pasur të bëjnë në të shumtën e rasteve me pronat e të kthyerve **serbë të Kosovës**, veçanërisht në fshatin e kthimit Novak në komunën e Prizrenit dhe pjesën e sipërme të qytetit të Rahovecit.⁴³

në një mur të klinikës së drejtuar nga Beogradi në fshatin e përzier Suhodoll të Mitrovicës Veriore. Në tetor të vitit 2022, shoferi i linjës së autobusit nga fshati Gorazhdec të komunës së Pejës për në Beograd raportoi në Policinë e Kosovës se një person i panjohur kishte thyer një nga xhamat e automjetit të tij në Mitrovicën Jugore. Raportohet se autobusi po transportonte rreth 30 udhëtarë serbë të Kosovës, ndër ta disa fëmijë, në kohën e incidentit. Në janar të vitit 2023, në ditën e Krishtlindjeve Ortodokse, në Çabër të komunës së Zubin Potokut, iu vu zjarri një shtëpie dhe një stalle që i përkisnin një serbi të Kosovës. Në tetor të vitit 2023, tifozët e ekipit të basketbollit Trepça nga Mitrovica Jugore krijuan një baner të madh ku ishte paraqitur një varrezë ortodokse, një kishë dhe një pemë në të cilën ishin varur njerëz, gjoja serbë, si dhe datën 24/09/2023.

39 Në qershor të vitit 2022, në fshatin Gojbulë të komunës së Vushtrrisë, persona të panjohur e gjuajtën me gurë shkollën fillore të drejtuar nga Beogradi "21 Nëntori", duke thyer një dritare të klasës, si dhe dëmtuan dyert e objekteve të reja dhe të vjetra shkollore. Në janar të vitit 2022, një serb i Kosovës nga fshati Banjë i komunës së Skenderajt u sulmua fillimisht verbalisht dhe më pas fizikisht nga një shqiptar i Kosovës në fshatin Runik, ndërsa po bënte pazar, dhe iu kërkua të largohej nga dyqani. Në shtator të vitit 2023, u raportua se ishte vënë në zjarr një shtëpi në pronësi të një serbi të Kosovës në fshatin Maxhunaj të komunës së Vushtrrisë. Shtëpia ishte djegur fillimisht në vitin 1999 dhe u renovua nga një OJQ ndërkombëtare në vitin 2004.

40 Në mars dhe prill të vitit 2020, në fshatin Carravodicë të komunës së Obiliqit, Policia e Kosovës mori raporte për dy shtëpi që ishin vënë në zjarr. Në gusht të vitit 2020, në fshatin e përzier Babimoc, katër të rinj serbë të Kosovës raportuan se ishin sulmuar nga një grup prej gjashtë shqiptarësh të Kosovës. Në komunën e Prishtinës, në tetor të vitit 2020, katër të mitur serbë të Kosovës raportuan se persona të panjohur kishin qëlluar me armë zjarri në ajër nga hyrja e oborrit të shkollës në fshatin Bërnice e Poshtme. Në prill të vitit 2021, një i mitur serb i Kosovës raportoi se ishte sulmuar nga një grup të rinjsh shqiptarë të Kosovës në fshatin Babimoc, komuna e Obiliqit.

41 Në shtator të vitit 2016, persona të panjohur dëmtuan një pllakë përkujtimore për 14 serbët e Kosovës që u vranë në korrik të vitit 1999 në fshatin Grackë e Vjetër, komuna e Lipjanit, dhe shkruan grafite pranë saj me mbishkrimin *hakmarrja*. Në nëntor të vitit 2017, një grup shqiptarësh të Kosovës nga Grackë e Vjetër dhe fshatrat përreth hynë në oborin e shkollës fillore serbe Braca Aksic dhe dëmtuan fushën e lojërave të shkollës. Në qershor të vitit 2022, në fshatin Kishnicë, komuna e Graçanicës, një serb i Kosovës raportoi në Policinë e Kosovës se persona të panjohur kishin varur një leckë të bardhë me mbishkrimin "UÇK" në gardhin e pronës së tij.

42 "Shkollat në të njëjtën ndërtesë me dy sisteme arsimore" janë shkollat që funksionojnë brenda të njëjtave ndërtesa dhe ofrojnë arsimim nën dy sisteme të ndryshme, konkretisht kurrikula e Kosovës dhe ajo e Serbisë. Këto shkolla ndonjëherë quhen "shkolla të përziera", ndonëse nxënësit dhe klasat nuk janë të përziera.

43 Në maj dhe tetor të vitit 2018, persona të dyshuar të panjohur thyen dritaret e institucionit shëndetësor të vendosur në Novak. Në mars të vitit 2020, u thyen dhjetë shtëpi të kthyerish në Novak. Në prill të vitit 2020, i është vënë zjarri një shtëpie të pabanuar të kthyerish në të njëjtin fshat. Në dhjetor të vitit 2021, persona të panjohur dëmtuan dhe larguan, për herë të tetë që nga 2013, pllakën përkujtimore që përkujtonte dy gazetarë serbë të Kosovës të cilët u zhdukën më 21 gusht 1998 pranë fshatit Zoqishtë. Në janar të vitit 2021, një serb i Kosovës raportoi se janë plaçkitur 13 shtëpi të pabanuara dhe një auto-servis në fshatin Bogoshevoçë, Prizren.

2. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi

Komuniteti serb i Kosovës është i përfaqësuar si në Qeveri ashtu edhe në Kuvend. Nenad Rashiq, udhëheqësi i Partisë Demokratike Progresive (PDS), është ministër për Komunitete dhe Kthim.

Tre **serbë të Kosovës** shërbejnë si zëvendësministra: Nenad Stanojeviq, zëvendësministër i Ekonomisë, Llazar Radulloviq, zëvendësministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe Radoica Radomiroviq, zëvendësministër për Komunitete dhe Kthim.

Kushtetuta garanton dhjetë vende në Kuvend për komunitetin **serb të Kosovës**. Në zgjedhjet e jashtëzakonshme të vitit 2021, që të dhjetë ulëset i fituan kandidatët e Listës Serbe (LS). Deputetët e LS-së u dorëhoqën nga pozitat e tyre si deputetë në nëntor të vitit 2022. Deputetët e rinj të LS-së morën mandatet e tyre dhjetë ditë pasi paraardhësit e tyre kishin dhënë dorëheqje.⁴⁴ Deputetët aktualë që përfaqësojnë komunitetin **serb të Kosovës** janë: Biljana Maksiq, Ksenjia Bozoviq, Millan Joksimoviq, Millan Kostiq, Nenad Radenkoviq, Ollivera Zdravkoviq, Rados Mihajloviq, Svetislav Jokiq, Zoran Maksimoviq (që të gjithë nga radhët e LS), dhe Cvetko Veljkoviq si kandidat i pavarur. Parti tjetër që i përfaqëson interesat e komunitetit **serb të Kosovës** e që mori pjesë në zgjedhjet e vitit 2021 ishte Nisma Qytetare për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë (GI SPO). Në zgjedhjet e mëparshme garuan gjithashtu edhe Partia Liberale e Pavarur (SLS), Partia e **Serbëve të Kosovës** (PKS) dhe Liria (Sloboda). Në këtë mandat, LS mori mbështetjen e përfaqësuesit të komunitetit goran të Kosovës, Adem Hoxha. LS i ka mbajtur dhjetë ulëset e garantuara edhe në zgjedhjet e vitit 2019.

Komuniteti **serb i Kosovës** ka pesë përfaqësues në Këshillin Konsultativ për Komunitete (KKK), që funksionon nën ombrellën e Presidentit. Në nëntor të vitit 2022, përfaqësues nga radhët e këtij komuniteti ishin katër burra dhe një grua.⁴⁵ Pjesëtarë tjerë të komunitetit **serb të Kosovës** që shërbejnë në pozita të larta zyrtare janë Srgjan Sentiq, zëvendësavokat i Popullit, Gordana Llaban-Zuviq, anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sllavisha Mlladenoviq, Komisioner për Gjuhët në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, si dhe Radojica Mërgjinac, anëtar i Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës.

⁴⁴ Deputetët e LS-së që morën mandatet e tyre nuk kanë formuar grup parlamentar dhe nuk marrin pjesë në organet punuese të Kuvendit të Kosovës. Ata marrin pjesë kohë pas kohe për t'i ruajtur mandatet e tyre.

⁴⁵ Nga organizatat joqeveritare (OJQ) "Mlada aktivna Gračanica" (Gračanica e re aktive); "Centar za prava manjinskih zajednica" (Qendra për të drejtat e komuniteteve pakicë); "Prijateljstvo bez granica" (Miqësi pa kufij); dhe "Omladinska Parteska aktivnost" (Aktiviteti i të rinjve të Parteshit).

Në fund të vitit 2023, komuniteti është përfaqësuar në 23 komitete për komunitete (KK) në nivel vendi,⁴⁶ me gjithsej 44 anëtarë (17 gra dhe 27 burra). Në 11 komuna, komuniteti nuk është i përfaqësuar në KK (pavarësisht se figuron në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011).⁴⁷ Katër **serbë të Kosovës** mbajnë pozitën e kryetarit të KK-së.⁴⁸ Tre burra **serbë të Kosovës** janë nënkryetarë për komunitete, në komunat Kamenicë, Obiliq⁴⁹ dhe Zveçan.⁵⁰ Asnjë përfaqësues i komunitetit nuk mban pozitën e zëvendëskryesuesit për komunitete të kuvendit komunal në asnjë komunë.

Serbët e Kosovës janë anëtarë të 22 zyrave komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK), me gjithsej 52 anëtarë (25 gra dhe 27 burra).⁵¹ Krahas kësaj, pjesëtarët e komunitetit **serb të Kosovës** mbajnë pozitën e udhëheqësit të ZKKK-së në 13 komuna.⁵²

Në këshillat komunalë për siguri në bashkësi (KKS) janë 20 **serbë të Kosovës**, për sa vijon: nga një burrë në Ferizaj, Gjilan, Klllokot, Partesh, Ranillug, Shtërpçë, Viti, Skenderaj, Vushtrri, Klinë, Pejë, Lipjan, Obiliq, Prishtinë e Prizren, dhe nga një grua në Deçan, Istog, Kamenicë, Fushë Kosovë e Rahovec.

Ndër OJQ-të më të shquara të këtij komuniteti që veprojnë në Mitrovicë Veriore janë OJQ Aktiv, "Nova društvena inicijativa" (Inicijativa e Re Sociale) (NSI), OJQ "Centar za zastupanje demokratske kulture" (Qendra për Avokim të Kulturës Demokratike) (ACDC), "Centar za afirmativne društvene akcije" (Qendra për Veprime Sociale Afirmative) (CASA), dhe "Žensko Pravo" (Të Drejtat e Grave). Në rajonin e Prishtinës, "Centar za mir i toleranciju i komunikacija za društveni razvoj" (Qendra për Paqe dhe Tolerancë dhe Komunikim për Zhvillim Social) ndodhet në Graçanicë, ndërsa shoqata kulturore-artistike "Sveti Sava" (Shën Sava) ndodhet në Grackë të Vjetër të Lipjanit. Në rajonin e Gjilanit, OJQ të shquara janë "Udruženje žena naš dom" (Shoqata e Grave Shtëpia Jonë), "Centar za depolitizaciju kosovskog društva" (Qendra për Depolitizimin e Shoqërisë së Kosovës), "Prijateljstvo bez granica" (Miqësi pa Kufij), "Naša Budućnost" (E Ardhmja Jonë), "Omladinska Inicijativa" (Inicijativa Rinore), "Fuzija" (Fuzioni), Rebus, dhe "Moravski biser" (Perla e Moravës). Në rajonin e Pejës, "Centar za prava manjinskih zajednica" (Qendra për të Drejtat e Komuniteteve Pakicë) e drejtuar nga **Serbët e Kosovës** punon me të rinjtë **serbë të Kosovës** në fshatrat Osojan dhe Gorazhdec. Ndër OJQ-të tjera janë dhe grave Briga (Kujdesi) dhe media "Radio Goraždevac", që të dyja në fshatin Gorazhdec. Në komunën e Istogut, në vitin 2022 u themelua OJQ "Jefimija" nga një grua **serbe e Kosovës** në qendrën rinore në fshatin Osojan.

46 Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjilan, Graçanicë, Istog, Kamenicë, Klinë, Klllokot, Lipjan, Mitrovicë Veriore, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Pejë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Skenderaj, Shtërpçë, Vushtrri, Zubin Potok dhe Zveçan. Vlen të përmendet se pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme të mbajtura në prill 2023, nuk u themelua KK në Leposaviq.

47 Serbët e Kosovës nuk janë të përfaqësuar në KK në Deçan, Dragash, Gjakovë, Glllogoc, Kaçanik, Leposaviq, Mitrovicë e Jugut, Podujevë, Shtime, Suharekë dhe Viti.

48 Kamenicë (burrë), Partesh (burrë), Skenderaj (grua) dhe Vushtrri (burrë).

49 Në Obiliq, edhe pse romët e Kosovës janë komuniteti joshumicë më i madh (bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011), Zëvendëskryetari për Komunitete është serb i Kosovës. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk kundërshtoi emërimin, pasi ky mekanizëm nuk është i detyrueshëm në komunë (shih gjithashtu profilet e Romëve të Kosovës, Ashkalive të Kosovës dhe Egjiptianëve të Kosovës).

50 Në Zveçan, pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme të prillit 2023, kjo pozitë u plotësua nga një serb i Kosovës.

51 Në Leposaviq, Mitrovicë e Veriut dhe Zubin Potok, ZKKK-të nuk janë themeluar zyrtarisht, ndonëse ekzistojnë zyra me funksione të ngjashme, si zyrat komunale të komuniteteve (ZKK-të). ZKK-të u krijuan sipas Rregullores së UNMIK-ut 2007/30 për Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë, neni 23 (11). Serbët e Kosovës janë të përfaqësuar në ZKK-të në Leposaviq dhe Zubin Potok.

52 Fushë Kosovë, Gjilan, Kamenicë, Klinë, Lipjan, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Skenderaj, Shtërpçë, Viti dhe Vushtrri.

3. Punësimi dhe gjendja socio-ekonomike

Gjendja socio-ekonomike e komunitetit serb të Kosovës ndikohet nga mundësitë e kufizuara socio-ekonomike në Kosovë, shkalla e lartë e papunësisë dhe nivelet e ulëta të të ardhurave.⁵³

Disa pjesëtarë të komunitetit vazhdojnë të ndikohen nga uzurpimi i kundërligjshëm i tokës së tyre bujqësore nga pjesëtarë të komunitetit shumicë, gjë që pengon qasjen në vetëpunësim bujqësor.⁵⁴ Qeveria e Serbisë ofron mbështetje financiare⁵⁵ për komunitetin **serb të Kosovës**, përfshirë këtu paga, pensione dhe ndihmë sociale.⁵⁶ Po ashtu, institucionet e Kosovës dhe donatorët ndërkombëtarë ofrojnë subvencione. Megjithatë, komuniteti **serb i Kosovës** përballet me jetesë të paqëndrueshme për shkak të paqëndrueshmërisë politike.

Në vitin 2018, nga 95,890 persona të regjistruar si të papunë, 7.7 për qind ishin **serbë të Kosovës** dhe më se gjysma syresh ishin gra.⁵⁷ Të dhënat më të fundit tregojnë se shkalla e gjithmbarshme e papunësisë e popullsisë së Kosovës në vitin 2022 ishte 58,081 ose 12.6 për qind (36,184 burra dhe 21,897 gra). Veçanërisht brengosëse ishte shkalla e papunësisë së të rinjve, me 21.4 për qind, ku gratë e reja ishin të prekura joproporcionalisht me 27 për qind krahasuar me 18.6 për qind për burrat e rinj.⁵⁸

Për sa i përket punësimit në shërbimin publik, **Serbët e Kosovës** kanë qenë më të favorizuar se komunitetet tjera joshumicë. **Serbët e Kosovës** mbajnë shumicën e pozitave për komunitetet joshumicë në institucionet qeveritare.⁵⁹ Në vitin 2022, pjesëtarët e komunitetit **serb të Kosovës** përbënin 5.17 për qind të shërbimit civil.⁶⁰ Në nivel komunal, krahasuar me komunitetet e tjera joshumicë, **Serbët e Kosovës** kanë qenë më të përfaqësuarit në komunat ku këta të fundit janë në pakicë numerike.⁶¹ Pjesëtarët e këtij komuniteti mbajnë kryesisht pozita profesionale dhe teknike/administrative.⁶²

53 Ambasada e Suedisë, *Analizë shumëdimensionale e varfërisë – Kosovë*, 2017, f. 8.

54 OSBE, *Raport i vlerësimit të të drejtave të komuniteteve – botimi i katërt*, 2015, f. 23.

Shih po ashtu edhe: Komisioni Këshillëdhënës i Këshillit të Evropës për Konventën Kornizë për Pakicat Kombëtare, *Opinion i Katërt për Kosovën*, 2017, §108, f. 39.

55 Pas miratimit të rregullores së Bankës Qendrore e Kosovës në dhjetor të vitit 2023, me të cilën euro përcaktohet si monedha e vetme e lejuar për transaksionet me para të gatshme në Kosovë, e cila hyri në fuqi më 1 shkurt 2024, ekipet e misionit të OSBE-së në terren në Kosovë pranuan raportime se ky ndryshim ka ndikuar në komunitetin që varet nga mbështetja financiare e qeverisë së Serbisë.

56 Ambasada e Suedisë, *Analizë shumëdimensionale e varfërisë – Kosovë*, f. 4; Shih, për shembull, OJQ Aktiv, *Mundësitë dhe pengesat për bizneset e veriut të Kosovës*, 2017, f. 6.

57 OSBE, *Raport i vlerësimit të të drejtave të komuniteteve, Botimi i 5-të*, (2021) f. 52.

58 <https://ask.rks-gov.net/Releases/Details/6714> (nuk ka kategorizim sipas komuniteteve.)

59 OSBE, "Përfaqësimi i komuniteteve në shërbimin civil në Kosovë" 2017, f. 13.

60 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës: *Raporti vjetor 2022-anglisht.docx(1).pdf* (rks-gov.net)

61 Përveç Novobërdës, ku komuniteti serb i Kosovës ka qenë i nënpërfaqësuar; OSBE, *Përfaqësimi i komuniteteve në shërbimin civil në Kosovë*, (2017), f. 21-22.

62 OSBE, *Përfaqësimi i komuniteteve në shërbimin civil në Kosovë* (2017), f. 17, 24.

Megjithatë, është e vështirë të përcaktohet me saktësi numri i vërtetë i punonjësve në shërbimin publik. Kjo vështirësi lind për faktin se në shumë raste të njëjtit persona figurojnë edhe në listat e pagave të administratës komunale të Kosovës edhe të institucioneve të drejtuara nga Beogradi. Ngjashëm, është pothuajse e pamundur të përcaktohet numri real i të papunëve **serbë të Kosovës** në moshë madhore, meqë të regjistruarit si të papunë në sistemin e Kosovës mund të jenë të punësuar në institucionet e drejtuara nga Beogradi dhe anasjelltas.

Punësimi i komunitetit në nivel vendi

Në **Rajonin e Prishtinës**, në komunën e Obiliqit, rreth 80 **serbë të Kosovës** janë të punësuar në sektorin publik: 13 në komunë, 15 në Policinë e Kosovës, 12 në sektorin e shëndetësisë dhe 40 në fushën e arsimit. Megjithëkëtë, në vitin 2023, shkalla e papunësisë për komunitetin **serb të Kosovës** në këtë komunë ishte 85 për qind,⁶³ si rrjedhim i mungesës së mundësive për punësim dhe vështirësisë së raportuar për t'u punësuar në ndërmarrjet publike-private. Asnjë pjesëtar i komunitetit **serb të Kosovës** nuk ka përfituar nga ndonjë projekt për gjenerimin e të ardhurave në tre vitet e fundit. Shkalla e papunësisë është e lartë edhe në Prishtinë.

Në komunën e Lipjanit, një **serbe e Kosovës** punon në zyrën e gjendjes civile, një **serb i Kosovës** punon në drejtorinë e bujqësisë dhe dy burra **serbë të Kosovës** janë zjarrfikës. Në komunën e Graçanicës, 50 për qind e popullsisë (kryesisht të rinj dhe gra) është e papunë, disa edhe përkundër kualifikimeve. Çdo vit, 40- 55 familje marrin njëfarëlloj mbështetjeje (nga komuna apo donatorët).

Në **Rajonin e Gjilanit**, **Serbët e Kosovës** janë të shpërndarë nëpër komuna të ndryshme dhe përballen me kushte jetese dhe gjendje ekonomike të ndryshme. Disa janë të punësuar në ndërmarrjet në pronësi të shqiptarëve të Kosovës, si fermat e kërpuhave dhe fabrikat e sfungjerëve, si dhe guroret në komunën e Kamenicës dhe prodhim të tullave në komunën e Ranillugut.

Në komunën e Kamenicës, 18 **serbë të Kosovës** janë të punësuar në administratën komunale, kryesisht si shërbyes civilë, gjashtë në Gjykatën Themelore, nëntë në Policinë e Kosovës, një në zyrën postare dhe afro 110 në sektorin e arsimit. Dy pozita të larta të mbajtura nga **Serbët e Kosovës** janë ajo e nënkryetarit për komunitete të komunës dhe e udhëheqësit të ZKKK-së. Sipas ZKKK-së, gati 40 për qind e **serbëve të Kosovës** në moshë madhore janë të angazhuar privatisht në bujqësi. Rreth 100 **serbë të Kosovës**, kryesisht të rinj, punojnë në ndërtimtari. Ata angazhohen edhe në punë sezonale në Beograd. Janë 15 biznese private në pronësi të **serbëve të Kosovës** (dyqane ushqimore, riparime makinash dhe restorante) që punësojnë 33 persona.

63 ZKKK dhe komuna e Obiliqit.

85 punëkërkues **serbë të Kosovës** janë të regjistruar në zyrën komunale të punësimit në Kamenicë, megjithatë ky numër nuk e pasqyron numrin e gjithmbarshëm të serbëve të papunë të Kosovës, meqë ata preferojnë zakonisht të regjistrohen si të papunë në zyrat e shërbimit të punësimit të drejtuara nga Beogradi, duke besuar se një gjë e tillë do t'u ndihmojë të gjejnë punë më shpejt. 40 familje **serbe të Kosovës** marrin ndihmë sociale financiare nga qendra komunale për mirëqenie sociale.

Në komunën e Gjilanit, 14 **serbë të Kosovës** janë të punësuar në administratën komunale si nëpunës civilë që punojnë në drejtoritë e urbanizmit, bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik/regjistrimit të biznesit. Një **serb i Kosovës** është udhëheqës i ZKKK-së. Gjashtëmbëdhjetë **serbë të Kosovës** janë të punësuar në pozita të ndryshme të sektorit publik, përfshirë këtu departamentin e tatimeve, kompaninë shpërndarëse të energjisë elektrike (KEDS), zyrën postare, kompaninë rajonale të ujësjellësit "Hidromorava", bankën për mikro-ndërmarrje dhe ndërmarrjen publike "Eko-higjiena". Në Gjilan janë rreth 1,300 punëkërkues **serbë të Kosovës**. Në mesin e popullatës **serbe të Kosovës** ka më pak gra të papuna sesa burra, sepse institucionet ku punojnë kryesisht ato, e që financohen nga Beogradi, ofrojnë më shumë vende pune që tradicionalisht janë konsideruar të përshtatshme për gratë, si arsimit dhe shëndetësisë. Në Gjilan janë 25 familje serbe të cilat marrin ndihmë sociale financiare nga qendra komunale për mirëqenie sociale. ZKKK ka theksuar se është sfiduese të fillohet një biznes privat, duke pasur parasysh pengesën gjuhësore dhe mungesën e informacionit në lidhje me procedurat përkatëse ligjore, rregullat e importit dhe eksportit, si dhe mallrat që kërkohen në treg.

Fshati Shillovë është selia e institucioneve të drejtuara nga Beogradi, por njëherësh edhe qendër zhvillimi social e kulturor për **Serbët e Kosovës** që jetojnë në rajonin e Gjilanit. Aty veprojnë rreth 20 biznese të suksesshme, që punësojnë më se 60 **serbë të Kosovës**, si radiotelevizioni RTV Puls, një klinikë shëndetësore pediatrike, restorante, kafene etj.

Organizatrat ndërkombëtare (IOM, CARE International dhe CARITAS) kanë realizuar disa projekte për krijim të të ardhurave të dedikuara enkas për komunitetin **serb të Kosovës** në lokacione si Kamenica, Gjilani, Ranillugu, Novobërda dhe Shtërpca.

Gjendja ekonomike në komunën e Ranillugut mbetet sfiduese për shkak se rreth 40 për qind e personave në moshë pune (ose 450 **serbë të Kosovës**) janë zyrtarisht të regjistruar si të papunë.⁶⁴ Gjendjen e rëndë ekonomike arrijnë ta zbutin sadopak të punësuarit në administratën komunale (59), si edhe në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. Të gjitha pozitat e larta në administratën komunale mbahen nga **serbët e Kosovës**. Më se 90 për qind e familjeve **serbe të Kosovës** janë të angazhuara në bujqësi. Megjithatë, vetëm një e treta e bujqve prodhojnë sasi të mjaftueshme për treg, e prodhimet e tyre i shesin në tregjet në Kamenicë apo edhe Bujanoc të Serbisë. Në komunë janë të regjistruara 180 biznese private në pronësi të pjesëtarëve të komunitetit **serb të Kosovës**, prej të cilave 120 janë aktive. Shtatë **serbë të Kosovës** janë të punësuar në një ndërmarrje në pronësi të shqiptarëve të Kosovës në fshatin Korminjan. Shumica e të papunëve janë gra dhe burra të moshës 18 - 40 vjeç. Afro 150 familje serbe marrin ndihmë sociale financiare nga qendra komunale për mirëqenie sociale.

64 ZKKK.

Gjendja ekonomike e komunitetit **serb të Kosovës** në komunën e Parteshit raportohet të jetë përgjithësisht e mirë, ngaqë më se 1,000 **serbë të Kosovës** që punojnë në Evropën Perëndimore (kryesisht në Gjermani e Zvicër) investojnë në komunë duke ndërtuar shtëpi.⁶⁵ Në këtë komunë është vërejtur një trend në rritje që **Serbët e Kosovës** të gjejnë punësim në bizneset e drejtuara nga shqiptarët e Kosovës. Një pronar shqiptar i një fabrike ka punësuar rreth 40 **serbë të Kosovës** në tre vitet e fundit në fshatin Pasjan.⁶⁶ Pesëdhjetë e gjashtë pjesëtarë të komunitetit janë të punësuar në administratën komunale, 76 në sektorin e arsimit dhe tetë në sektoshëndetësor. Të gjitha pozitat e larta në administratën komunale mbahen nga **serbët e Kosovës**. Tetëdhjetë për qind e familjeve **serbe të Kosovës** në këtë komunë punojnë në bujqësi, disa punojnë në ndërtimtari ose në biznese private (siç janë dyqanet e ëmbëlsirave, automekanikë dhe përgatitja e dekorimeve të dasmave). Në komunë janë të regjistruara 110 biznese në pronësi të pjesëtarëve të komunitetit **serb të Kosovës**, prej të cilave 75 janë aktive. 617 punëkërkues **serbë të Kosovës** nga kjo komunë janë të regjistruar në zyrën rajonale të punësimit në Gjilan. Shumica e të papunëve janë gra dhe burra të moshës 18 - 35 vjeç. Në vitin 2023, afro 44 familje serbe marrin ndihmë sociale financiare nga qendra komunale për mirëqenie sociale.

Mbi 300 **serbë të Kosovës** në komunën e Novobërdës punojnë në sektorin publik të Kosovës. Gjithashtu, rreth 50 **serbë të Kosovës** janë të punësuar në gurthyesit në pronësi të shqiptarëve të Kosovës, në fshatin Strazhë. Qendra e zhvillimit ekonomik, kulturor dhe social të **serbëve të Kosovës** në komunën e Novobërdës gjendet në fshatin Kufcë e Epërme, me afro 2000 banorë. 62 **serbë të Kosovës** janë të punësuar në administratën komunale, 86 në arsim dhe 69 në shëndetësi. Të gjitha pozitat e larta në administratën komunale mbahen nga **serbët e Kosovës**. Shumica e **serbëve të Kosovës** në Novobërdë janë të angazhuar në bujqësi. Afro 120 **serbë të Kosovës** janë të angazhuar në ndërtimtari. OJQ "Majka Devet Jugovića" nga Graçanica, e cila operon me kuzhinat popullore në rajonin e Gjilanit, operon edhe me toka bujqësore në Novobërdë, me disa ferma bagëtish në fshatrat Prekoc dhe Zebinc, ku që të gjitha punësojnë serbë lokalë të Kosovës. Në Novobërdë, rreth 700 **serbë të Kosovës** janë të regjistruar si punëkërkues (qoftë në zyrën rajonale të punësimit të drejtuar nga Kosova në Bostan ose në shërbimin e punësimit të drejtuar nga Beogradi që gjendet në Kufcë të Epërme).⁶⁷ Afro 185 familje serbe marrin ndihmë sociale financiare nga qendra komunale për mirëqenie sociale.

Në komunën e Shtërpçës, një prej bizneseve kryesore që krijon vende pune është qendra e skijimit në Brezovicë. Veç saj janë edhe rreth 400 biznese të regjistruara nga **Serbët e Kosovës** në Shtërpçë, gjysma e të cilave në sektorin e gastronomisë. Afro 800 **serbë të Kosovës** janë të punësuar ose në administratën komunale të Kosovës (320) ose në institucionet e drejtuara nga Beogradi (480).⁶⁸ Zyrat e punësimit në Shtërpçë (si ajo e Kosovës ashtu edhe ajo e Beogradit) kanë regjistruar 2,500 punëkërkues **serbë të Kosovës**. Megjithatë, siç u përmend më sipër, përcaktimi i saktë i shifrave reale të punësimit në shërbimin publik dhe të atyre të regjistruar si të papunë raportohet të jetë i vështirë. 119 familje serbe marrin ndihmë sociale financiare nga qendra komunale për mirëqenie sociale.

65 Përfaqësues i një OSHC-je.

66 Pronari shqiptar i fabrikës e ka marrë tokën nga komuna me kushtin që të punësojë serbët e Kosovës për të punuar në fabrikë.

67 Shifra specifike se sa prej tyre të regjistruar në secilën zyrë nuk janë të disponueshme.

68 Zyra e Kryetarit.

Në komunën e Kllokotit, banorët **serbë të Kosovës**, ashtu si edhe komunitetet tjera, mbijetesën e sigurojnë nga bujqësia. Vëç kësaj janë rreth dhjetë dyqane dhe kafene të vogla në fshatin Vërboc dhe në qytezën e Kllokotit në pronësi të **serbëve të Kosovës**. 100 shërbyes civilë **serbë të Kosovës** punojnë në sektorin publik, përfshirë 40 në administratën komunale, në pozita të ndryshme, dhe 60 në sektorin e shëndetësisë dhe arsimit.⁶⁹ Rreth 600 **serbë të Kosovës** janë të regjistruar si punëkërkues në këtë komunë.⁷⁰

Pas decentralizimit në Kosovë ndërmjet viteve 2008 dhe 2010, Binça ishte i vetmi fshat i banuar nga **Serbët e Kosovës** që mbeti pjesë e komunës së Vitisë.⁷¹ Viteve të fundit, bujqit **serbë të Kosovës** raportohet të mos jenë përfshirë në programet e financuara nga komuna që kanë për qëllim mbështetjen e ndërmarrjeve bujqësore. Thirrjet për aplikim janë nxjerrë vetëm në gjuhën shqipe në faqen e komunës dhe/ose në hyrje fizike të objektit të komunës, duke e vështirësuar kështu qasjen, me kohë, në informata për pjesëtarët e komunitetit që banojnë në zonat rurale. Gjendja u përmirësua pak në vitin 2023, pas avokimit të Misionit të OSBE-së që rezultoi në shpalljen e njoftimeve publike nga ana e komunës për ndarje të subvencioneve në gjuhën serbe në fshatin Binçë. 62 **serbë të Kosovës** (26 gra dhe 36 burra) punojnë në sektorin e arsimit në shkollën fillore me planprogram serb në Viti dhe në paralelen e saj në fshatin Binçë.⁷² Gjashtë **serbë të Kosovës** nga Vitia janë të punësuar në sektorin publik.

Në komunën e Ferizajt, shumica e 25 **serbëve të Kosovës** janë në pension dhe marrin pensione si nga institucionet e Kosovës ashtu edhe nga Beogradi. Një **serb i Kosovës** punon si zyrtar për të drejtat e komuniteteve në ZKKK.

Në rajonin e **Prizrenit**, **Serbët e Kosovës** banojnë në komunën e Prizrenit (rreth 60-70, kryesisht të moshuar, të cilët varen nga pensionet dhe ndihma sociale të cilat i marrin qoftë nga institucionet e drejtuara nga Beogradi ose ato të Kosovës, ose nga të dyjat) dhe në komunën e Rahovecit. Tetë **serbë të Kosovës** janë të punësuar në sektorin publik, gjegjësisht një në ZKKK-në e Prizrenit dhe shtatë në ZKKK-në e Rahovecit. Sipas statistikave të punësimit nga Zyra e Agjencisë së Punësimit të Kosovës në komunën e Prizrenit, janë gjashtë punëkërkues aktivë (tri gra). Disa familje banojnë në fshatin Novak të komunës së Prizrenit, dhe merren kryesisht me bujqësi. Në komunën e Rahovecit, disa pjesëtarë të komunitetit jetojnë në qytet (rreth 250) dhe të tjerët në Hoçë të Madhe (rreth 600). Këta të fundit merren kryesisht me bujqësi (vreshtari dhe lavërtari), ndërsa ca kanë shitore të vogla ushqimore ose dyqane artizanale tradicionale.

Në rajonin e **Mitrovicës**, **Serbët e Kosovës** nga komunat e Skenderajt dhe Vushtrrisë varen në masë të madhe nga përkrahja financiare nga Serbia. Disa janë të punësuar në institucionet e drejtuara nga Beogradi (shkolla, posta, shëndetësi), ndërsa të tjerët marrin mbështetje sociale (pagë minimale, pensione, mbështetje në para për fëmijët etj.). Në mungesë të burimeve tjera të të ardhurave, shumica e pjesëtarëve të komunitetit **serb të Kosovës** përfjetojnë ndonjë formë të varfërisë. Komuniteti është

69 Zyra Komunale e Punësimit në Kllokot

70 Zyra Komunale e Punësimit në Viti.

71 Fshatrat e tjera u bënë pjesë e komunës së Kllokotit.

72 Ish-drejtori i shkollës fillore që zhvillon mësimin sipas planprogramit të Serbisë "Mlladen Markoviq" në Viti.

prekur edhe nga ndalimi aktual i importit të mallrave serbe. Në Skënderaj janë pesë **serbë të Kosovës** të punësuar në ZKKK, një në Policinë e Kosovës dhe një në shërbimin pyjor. Në Vushtrri janë tetë **serbë të Kosovës** në ZKKK, si dhe shtatë në Policinë e Kosovës, që të gjithë të caktuar në nënstacionin e Prelluzhës. Në komunat veriore, punësimi i **serbëve të Kosovës** në sektorin publik ndryshoi në mënyrë drastike pas 5 nëntorit 2022, kur thuajse të gjithë **Serbët e Kosovës** dhanë dorëheqje nga pozitat e tyre në institucionet e Kosovës, përfshirë këtu komunën, Policinë e Kosovës, gjykatat, doganën dhe prokurorinë, fillimisht si reagim ndaj pezullimit të drejtorit serb të Drejtorisë Rajonale të Policisë së Kosovës për rajonin verior. Siç raportohet, të dorëhequrit, ndër ta 24 gjyqtarë dhe dhjetë prokurorë, thuhet se marrin rrogë nga fondet e siguruar nga Serbia. Ndonëse janë ca **serbë të Kosovës** të punësuar në komunat veriore ose në Policinë e Kosovës, monitorimi i OSBE-së ka shpalosur se këta persona janë punësuar rishtazi dhe nuk ishin punësuar në këto institucione para nëntorit 2022. Në disa komuna, **Serbët e Kosovës** që mbanin pozita si në komuna ashtu edhe në këshillat e përkohshme të drejtuara nga Beogradi, i kanë mbajtur pozitat e tyre në këto të fundit.

Shkalla e papunësisë vlerësohet të jetë rreth 50 për qind në komunat Vushtrri dhe Skënderaj, sipas krerëve të ZKKK-së si edhe bashkëbiseduesve të tjerë në këto komuna.

Të kthyerit serbë të Kosovës janë në përgjithësi përfitues të projekteve të gjenerimit të të ardhurave (kryesisht makineri bujqësore, bagëti dhe farëra) të ofruara nga donatorë ndërkombëtarë si IOM, Këshilli Danez për Refugjatët, Bashkimi Evropian, si edhe Ministria për Komunitete dhe Kthim, institucionet e drejtuara nga Beogradi, Kisha Ortodokse Serbe dhe komunat.

Dinamika e migrimit të komunitetit serb të Kosovës nuk mund të vlerësohet në mënyrë tërësore për shkak të mungesës së informatave mbi flukset migrimit. Përfaqësuesit e komunitetit pohojnë se si rrjedhojë e mundësive të kufizuara ekonomike, disa **serbë të Kosovës** emigrojnë në Serbinë Qendrore ose në vendet e Evropës Perëndimore për të kërkuar vende më të mira pune, arsimim dhe jetesë të sigurt e të qëndrueshme. Gjatë dy viteve të fundit, ekipet në terren të Misionit të OSBE-së kanë pranuar raportime për rritje të konsiderueshme të shkallës së emigrimit të **serbëve të Kosovës** nga komunat veriore në veçanti.

ZKKK-të në komunat e Kamenicës, Gjilanit, Ranillugut, Parteshit dhe Novobërdës kanë raportuar se, gjatë tri-katër viteve të fundit, nga 100 - 400 të rinj **serbë të Kosovës** kanë emigruar nga secila prej komunave në fjalë drejt Nishit, Jagodinës dhe Beogradit në Serbi apo për në shtete tjera evropiane.

Gjatë katër-pesë viteve të fundit, ndërmjet 800 dhe 1,000 të rinj **serbë të Kosovës** kanë emigruar nga komuna e Shtërpçës, siç raportohet për shkak të mungesës së mundësive për punësim si edhe për arsimim të lartë më cilësor në Nish e Beograd. Çdo vit, rreth 60 për qind e maturanëve regjistrohen në fakultete në Serbi dhe pas përfundimit të studimeve nuk kthehen më në Shtërpçë.⁷³

⁷³ Zyra e Kryetarit të Shtërpçës.

Punësimi në institucionet e drejtuara nga Beogradi

Punësimi i **serbëve të Kosovës** në Kosovë ndikohet në masë domethënëse nga prania dhe funksionimi i institucioneve të drejtuara nga qeveria serbe. Këto institucione, sidomos ato të fushës së arsimit, shëndetësisë e shërbimeve komunale, ofrojnë mundësi punësimi. Shumë **serbë të Kosovës** punojnë në shkolla që zhvillojnë mësimin sipas planprogramit të Serbisë, e që financohen dhe administrohen nga Ministria e Arsimit të Serbisë. Mësimdhënësit dhe personeli administrativ punësohen nga institucionet e drejtuara nga Serbia, duke siguruar përafrim me standardet serbe. Ngjashëm, institucionet e shëndetësore në zonat me shumicë serbe drejtohen shpesh nga institucionet serbe, ku spitalet dhe klinikat financohen, mbikëqyren dhe pajisen me personel, përfshirë mjekë, infermierë dhe profesionistë tjerë shëndetësorë, nga Serbia. Në zonat me popullsi të madhe serbe, strukturat e pushtetit lokal ngandonjëherë punojnë nën patronazhin e institucioneve të Serbisë, me punonjës që marrin paga dhe mbështetje nga qeveria serbe.

Sipas kreut të ZKKK-së në Kamenicë, Zyra e Qeverisë së Serbisë për Kosovë dhe Metohi (ZSKM) ka financuar punësimin e afro 150 të rinjve **serbë të Kosovës** nga viti 2020 deri në vitin 2023 në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë të drejtuar nga Serbia, si dhe në këshillin e përkohshëm të drejtuar nga Beogradi. Në komunën e Gjilanit, sipas ZKKK-së, rreth 340 punëtorë punojnë në institucionet e drejtuara nga Beogradi. Ngjashëm, në Ranillug, rreth 450 punonjës punojnë në institucionet e drejtuara nga Beogradi, ku 80 syresh janë punësuar ndërmjet viteve 2020 dhe 2023. Në Partesh, burim kryesor i vendeve të punës është materniteti i udhëhequr nga Beogradi në fshatin Pasjan, me të paktën 100 **serbë të Kosovës** të punësuar. Komuna e Novobërdës ka rreth 1,000 **serbë të Kosovës** që punojnë në institucionet e drejtuara nga Beogradi, me rreth 400 të rinj **serbë të Kosovës** të punësuar që nga marsi i vitit 2020, sipas ZKKK-së. Katër **serbë të Kosovës** punojnë në një klinikë të vogël në fshatin Babush të komunës së Ferizajt. Në rajonin e Mitrovicës, që nga viti 2015 institucionet e drejtuara nga Beogradi kanë mbështetur bizneset e vogla të **serbëve të Kosovës** në Skënderaj dhe Vushtrri, duke u ofruar makineri bujqësore dhe ndihmë e mbështetje tjetër.

4. Qasja në infrastrukturë dhe shërbime publike

Përmirësimet e infrastrukturës rrugore ndër vite dhe zhvillimi i sektorit të energjisë kanë qenë të dobishme për komunitetin serb të Kosovës. Megjithatë, problematikat me të cilat vazhdon të përballlet ky komunitet janë ndërprerjet e shpeshta të energjisë elektrike, mungesa e furnizimit me ujë në zonat malore rurale, rrugët e ekspozuara ndaj rrëshqitjeve të shpeshta të shkëmbinjve dhe të dheut, mungesa e trotuareve dhe rrugët e asfaltuara keq, dhe menaxhimi i dobët i mbeturinave, si grumbullimi sporadik i mbeturinave.

Procesi aktual i shpronësimit për autostradën Prishtinë–Gjilan-Dheu i Bardhë është karakterizuar me ankesa nga pronarët **serbë të Kosovës** në komunat e Gjilanit dhe Novobërdës. Në janar të vitit 2020, Dega në Novobërdë e Gjykatës Themelore të Gjilanit pranoi 161 parashtresa kundër vendimeve për kompensim, nga të cilat 102 i përkisnin pronarëve serbë të pronave. Dega e Gjykatës në Novobërdë i referoi të gjitha lëndët në procedurë të ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Gjilan,⁷⁴ mirëpo palët nuk ishin dakord të shkonin në procedurë ndërmjetësimi. Si rrjedhim, Dega e Gjykatës në Novobërdë i mori sërish lëndët, u mbajtën seancat gjyqësore dhe, që atëherë, disa lëndë janë zgjidhur me marrëveshje ndërmjet palëve ndërgjyqëse.

Në **rajonin e Prishtinës**, ku qasja në infrastrukturë është përgjithësisht e mirë, probleme sporadike me të cilat përballlet komuniteti janë ndërprerjet e gjata të furnizimit me ujë, ndotja e lumit Graçanka dhe mosriparimi i rrugëve. Në komunën e Prishtinës, gjuha raportohet të jetë pengesa e vetme për marrjen e shërbimeve të plota, për sa u përket shërbimeve publike. Disa nga zyrtarët e shërbimeve publike nuk e flasin serbishten, përkundër obligimit për ofrim të shërbimeve në të dyja gjuhët zyrtare. Në anën tjetër, vetëm një përqindje e vogël e **serbëve të Kosovës** flasin shqip Pjesëtarët e komunitetit të cilët e flasin shqipen kanë raportuar se kanë marrë shërbime pa asnjë problem. Në komunën e Obiliqit, ka pasur raportime se një pjesë e madhe e komunitetit **serb të Kosovës** ballafaqohet rregullisht me ndërprerje dhe avari të ujësjellësit, veçanërisht në fshatin Babimoc. Rrugët kryesore janë në gjendje të mirë, gjersa ato më të voglat dhe rrugët që të çojnë në lagjen e banuar me familje **serbe të Kosovës** janë në gjendje të keqe.

74 Në pajtim me Rregulloren nr. 4/2019 të nxjerrë nga Këshilli Gjyqësor për procedurat e ndërmjetësimit për çështjet gjyqësore, maj 2019.

Në rajonin e **Gjilanit**, në disa pjesë të komunës së Kamenicës, rrugët që lidhin qytetin me fshatrat Boscë, Leshtarë, Grizimë, Kostadincë dhe Moçarë i Ultë nuk janë të shtruara, përkundër kërkesave të përsëritura drejtuar organeve komunale. Në nëntor të vitit 2022, komiteti për komunitete në Kamenicë prezantoi një listë të projekteve të dëshiruara të infrastrukturës lokale, gjegjësisht projekte për asfaltimin e këtyre rrugëve. Megjithëse komuna e ka pranuar këtë listë projektesh dhe të njëjtat i ka përcaktuar si prioritet për vitin 2023, asnjëri prej tyre nuk u arrit të finalizohet deri në dhjetor, përkundrazi u desh që të planifikohet për vitin 2024. Në gjendje të ngjashme janë edhe rrugët rurale të Novobërdës dhe rrugët malore të Ranillugut, megjithëse në vitin 2020 janë bërë përpjekje për asfaltimin e rrugëve rurale që lidhin fshatrat Ropotovë të Madhe dhe Rajnoc. Në vitin 2023, përmes bashkëpunimit ndërkomunal, u ndërtua një shteg për biçikleta ndërmjet komunave Novobërdë dhe Kamenicë, si dhe 6 km shteg për biçikleta në komunën e Ranillugut. Banorët serbë të fshatit Binçë të komunës së Vitisë janë ankuar disa herë për mungesë të trotuareve nga qendra e fshatit deri te shkolla fillore.

Viteve të fundit, në komunat e Ranillugut dhe Novobërdës, KEDS-i ka bërë përmirësime të cilësisë së rrjetit të furnizimit me energji elektrike duke i zëvendësuar shtyllat e vjetra prej druri që ishin thyer me modele më të reja betoni, e që njëherësh kanë kapacitet për tensione më të larta. Gjatë muajit mars dhe prill 2020, KEDS dhe komuna e Novobërdës kanë bërë përmirësime në rrjetin energjetik të shtatë gurëve të vendosura në fshatin Strazhë, gjë që ka ndikuar pozitivisht në furnizimin me energji elektrike në fshatin Stanishor.

Disa zona kanë sisteme të ujësjellësit dhe kanalizimit, mirëpo në zona tjera familjet varen akoma nga pusët e ujit dhe gropat septike⁷⁵. Fshatrat tjera të komunës së Novobërdës, si Bostani, Qulkoci, Tullari dhe Makreshi i Ulët, nuk kanë furnizim të rregullt me ujë të pijshëm, kryesisht për shkak të borxhit të akumuluar të energjisë elektrike. Kjo ndodh më shpesh në muajt e verës, kur sasi të mëdha uji përdoren për ujitjen e kopshteve bujqësore. Komuna e Klllokotit përballet me sfida me ujësjellësin për shkak të mosarritjes së marrëveshjes me KEDS-in për rimbursimin e borxheve ekzistuese të energjisë elektrike. Në Ranillug, përkundër pranisë së tri sistemeve të ujësjellësit, mirëmbajtja e dobët ka rezultuar që dy sosh të jenë vetëm pjesërisht funksionale dhe njëri tërësisht i papërdorshëm (fshatrat Tomanc dhe Pançell). Në shumicën e fshatrave tani ka sisteme kanalizimi.

Në rajonin e **Gjilanit** nuk raportohet më për deponi "joformale" të mbeturinave. Megjithatë, shumë ekonomi familjare, duke filluar nga Vitia, Parteshi, Gjilani e deri në Ranillug, e përdorin lumin e Moravës së Binçes si destinacion për ujëra të zeza. Gypat e kanalizimit nga këto zona shkarkohen në lumë. Pas reshjeve të dendura, lumi vërshon dhe përmbyt arat e të mbjellat e fshatrave të banuara me **serbë të Kosovës**, Ranillug, Glogovc, Korminjan i Poshtëm dhe i Ulët si dhe Tomanc në komunën e Ranillugut.

Ndërtimi i minihidrocentraleve në shumë lokacione në komunën e Shtërpçës, përfshirë në zonën e Parkut Nacional të Sharrit, ka shkaktuar probleme tjera të lidhura me mbrojtjen e mjedisit dhe ujësjellësin gjatë këtyre viteve të fundit.

⁷⁵ Fshatrat Moçarë, Grizimë, Boscë, dhe Hajnoc në komunën e Kamenicës; fshatrat Rajanoc, Bozhec, Drenoc, Tomanc, Pançell, si dhe Ropotovë e Vogel, por edhe në Strazhë, Makresh i Epërm, Jasenovik, Prekoc dhe Izvor në komunën e Novobërdës.

Përkundër protestave të rregullta të banorëve kundër ndërtimit të hidrocentraleve dhe degradimit të mjedisit, punët ndërtimore janë finalizuar. Ndërtimi i hidrocentralit dhe devijimi i ujit nga lumenjtë dhe përrrenjtë lokalë në tubacione ka ndikuar njëherësh në sasinë dhe cilësinë e furnizimit me ujë për banorët e fshatit Biti e Poshtme.

Në rajonin e **Pejës**, problemet dallojnë nga njëra komunë në tjetrën, megjithatë shumica syresh lidhen me infrastrukturën e dobët, instalimet e vjetra dhe mbështetjen në pusët e ujit për furnizim me ujë, që nuk punojnë gjatë ndërprerjeve të energjisë elektrike. Këto probleme i prekin si vendbanimet ashtu edhe objektet fetare që ndodhen në këtë rajon. Shpeshherë, mbeturinat hidhen ilegalisht në vende të hapura, e banorëve u duhet të organizohen me sisteme vetanake të grumbullimit. Në komunën e Istogut ka pasur përpjekje për përmirësim të infrastrukturës rrugore në zonat e banuara nga **serbët e Kosovës**.⁷⁶ Veç kësaj, është instaluar ndriçimi publik në fshatrat Dragolevc dhe Osojan, që është zgjeruar më pas në vitin 2020 nga IOM/ZKKK, ashtu si edhe në Dobrushë e Kashicë. Në vitin 2022, ndriçimi publik u instalua edhe në Serbobran. Në fshatrat Osojan dhe Lubozhdë, shtyllat e energjisë elektrike janë zëvendësuar nga KEDS në vitin 2022. Më tej, sistemi i kanalizimit është ndërtuar në Dragolevc në vitin 2021. Shumica e fshatrave të banuara nga **Serbët e Kosovës** janë të kyçur në sistemin e ujësjellësit, përveç Tuqepit e Oprashkës, ku komunitetet furnizohen nga pusët. Megjithatë, vazhdon të ketë ndërprerje të vazhdueshme të energjisë elektrike për shkak të shtyllave të vjetruara të transmetimit të energjisë elektrike.

Në komunën e **Klinës**, në zonat rurale, komuniteti i përdorë më së shumti pusët e ujit, pasi disa fshatra, si ai i Binxhës, nuk janë të kyçura në rrjet të ujësjellësit. Gjatë viteve 2022 dhe 2023 janë ndërtuar sistemet e kanalizimit dhe rrugët në fshatrat Berkovë, Drenoc, Dresnik, Dollc, Rudicë, Dugajevë dhe Videjë.

Në komunën e **Pejës**, vendi i të kthyerve **serbë të Kosovës** në Levoshë është i vetmi fshat që përballet me probleme me sistemin e kanalizimit. Në vitin 2022 dhe 2023, komuna ka riparuar ndriçimin publik në fshat i cili ishte jofunksional. Fshati i përzier etnikisht Brestovik është ballafaquar po ashtu me probleme me ujësjellësin, bashkë me fshatrat e tjera në zonën përreth dhe vet qytetin, si dhe me borxhin e akumuluar të energjisë elektrike për përdorimin e pompave të ujit. Fshati përballet me mungesë të menaxhimit adekuat dhe të rregullt të mbeturinave. Komuna dhe kompania rajonale e mbeturinave kanë marrë masa, por grumbullimi i mbeturinave vazhdon të bëhet rrallë. Në fshatin Gorazhdec, komuna ka asfaltuar disa rrugë në vitin 2022, pas kërkesave të pjesëtarëve të komunitetit **serb të Kosovës**, ndërsa kompania rajonale e ujësjellësit "Hidrodrini" ka instaluar rreth 50 ujëmatës nëpër shtëpi dhe ndërtesa publike.

⁷⁶ Në vitin 2020, MKK e asfaltoi oborrin e shkollës dhe vendosi këndin e lojërave në shkollën "Jedinstvo" në fshatin Cërkolez. Mbështetja e ZKKK-së vazhdoi në vitin 2020 me asfaltim në Cërkolez dhe Dragolevc, si dhe rrugën ndërmjet Osojanit dhe Koshit, e më tej në vitin 2023 në Muzhevinë, Lubozhdë dhe Cërkolez. Në vitin 2020, rruga kryesore në lagjen Bllagaq në fshatin Gurakoc ishte e mbuluar me zhavorr.

Në rajonin e **Mitrovicës**, qasja e komunitetit **serb të Kosovës** në energji elektrike dhe rrugë të asfaltuara në zonat rurale është përgjithësisht e mirë. Rruga që çon në fshatin me shumicë serbe të Banjës (Skënderaj) mbetet në gjendje të keqe pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme avokuese nga komuniteti për ta riparuar atë. Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave në zonat e banuara nga **Serbët e Kosovës** në komunat në të cilat ata janë në pakicë numerike funksionon. Të gjitha zonat kanë qasje në sistemin e kanalizimit.

Në rajonin e **Prizrenit**, shumica e rrugëve kryesore që lidhin zonat e banuara nga **Serbët e Kosovës** janë të asfaltuara. Në fshatin Hoçë e Madhe, mungesa e ndriçimit publik është problem i kahershëm, ndonëse banorët kanë kërkuar disa herë mbështetjen e komunës. Për shkak të vonesave në reagimin e komunës, në gusht 2022, banorët i instaluan me vetiniciativë dritat e rrugëve në tre lokacione në fshat. Veç kësaj, në dhjetor të vitit 2022, ZSKM vendosi shtyllat e ndriçimit në rrugën kryesore të fshatit.⁷⁷ Në vitin 2023, komuna e Rahovecit hyri në partneritet publiko-privat me një kompani sllovene të shërbimeve të energjisë (ESCO) për zbatimin e një projekti pesëvjeçar për digjitalizimin e rrjetit elektrik dhe shfrytëzimin efikas të energjisë, megjithatë nuk ka pasur asnjë zhvillim të mëtutjeshëm gjatë tërë vitit. Që nga tetori i vitit 2023, me iniciativën e banorëve **serbë të Kosovës**, me financim nga individë dhe këshilli i përkohshëm i Beogradit në Rahovec, është duke u bërë instalimi i dritave të reja rrugore në rrugët dytësore të fshatit. Në korrik të vitit 2023, komuna e Prizrenit filloi asfaltimin e disa pjesëve të rrugës në fshatin Novakë. Nga ana tjetër, **Serbët e Kosovës** që banojnë në luginën shumetnike të Zhupës shpesh pësojnë nga rrëshqitjet e dheut dhe shkëmbinjve që e rrezikojnë komunitetin, dhe herë pas here bllokojnë rrugën nga Prizreni për në Shtërpçë ku janë zhvendosur një numër i konsiderueshëm i **serbëve të Kosovës** nga rajoni i Prizrenit.

Në komunën e Rahovecit, mungesa e ujit të pijshëm për banorët e Hoçës së Madhe ka qenë problem i vazhdueshëm që nga viti 2009. Prej vitesh, banorët e fshatit përdorin ujin e puseve, i cili nuk është i pijshëm. Janë bërë përpjekje të ndryshme për ta lidhur këtë fshat si edhe fshatrat Zoqishtë e Opterushë me ujësjellësin e Rahovecit, megjithatë nuk është gjetur akoma ndonjë zgjidhje. Në janar të vitit 2024, jashtë periudhës për të cilën raportohet, Ministria e Ekonomisë ndau 500,000€ për projektin e ujësjellësit në Rahovec.

⁷⁷ Shih [në serbisht] në: <https://kim.gov.rs/v5023.php>. (Qasur në dhjetor 2023).

5. Qasja në shërbimet sociale, përfshirë këtu edhe kujdesin shëndetësor

Komuniteti serb i Kosovës ka në përgjithësi qasje në shërbimet sociale të ofruara nga institucionet e Kosovës dhe institucionet e drejtuara nga Beogradi. Sipas statistikave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në vitin 2018, 2,422 familje serbe të Kosovës (6,176 persona) kanë marrë ndihmë sociale, që përbën 9.5 për qind të totalit të përfituesve.⁷⁸

Qendra për Punë Sociale në Mitrovicën Veriore bashkëpunon me sistemin social të drejtuar nga Beogradi, duke marrë kështu kontribute financiare nga të dy sistemet. Numri i gjithmbarshëm i përfituesve që ajo mbështet, nën institucionet e drejtuara nga Beogradi, është afërsisht 3,000 persona në vit në gjashtë komuna: Istog, Klinë, Mitrovicë Veriore, Pejë, Rahovec dhe Zveçan.

Në rajonin e Gjilanit, shumë serbë të moshuar të Kosovës marrin pensione si nga institucionet e Kosovës ashtu edhe nga institucionet e drejtuara nga Beogradi. Në komunën e Gjilanit, 370 serbë të Kosovës marrin pensione nga Serbia, 90 për qind e të cilëve raportohet se marrin edhe pensionin bazë të Kosovës në vlerë prej 100 euro. Shumë serbë të moshuar të Kosovës u ndikuan negativisht nga mungesa e dinarit serb në fund të vitit 2023, kur bankomatet në Shtërpçë, Shillovë dhe Kllokot u vonuan të rimbusheshin për shkak të mbylljes së pikëkalimit kufitar në Jarinjë më 24 shtator. Kjo ndërprerje e qarkullimit normal të parave që vinin nga Serbia shkaktoi vonesa deri dyjavore të furnizimit me këtë valutë.⁷⁹

Serbët e Kosovës që banojnë në komunat e Graçanicës, Prizrenit dhe Mitrovicës Veriore janë përballur me disa sfida në marrjen e pensioneve të tyre nga institucionet kompetente në Kosovë, në veçanti atyre të lidhura me kërkesat nga administrata e pensioneve për dokumente shtesë.⁸⁰ Personat me aftësi të kufizuara përballen me pengesa në qasjen në shtesat e tyre të aftësisë së kufizuar, përfshirë këtu edhe transportin joadekuat për ta bërë udhëtimin e domosdoshëm nga katër komunat veriore drejt Mitrovicës Jugore. Veç barrierave që vështirësojnë qasjen fizike, personat me aftësi të kufizuara që banojnë në komunat veriore duhet të aplikojnë sërish çdo vit, pavarësisht paaftësisë së tyre të përhershme.⁸¹ Përfaqësuesit e komunitetit kanë raportuar se personat me aftësi të kufizuara marrin ndihmë edhe nga institucionet e drejtuara nga Beogradi.

78 Institucioni i Avokatit të Popullit, *Raporti vjetor 2018*, f. 100.

79 Pas miratimit të rregullores nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) në dhjetor 2023, që vendosi euron si monedhën e vetme të lejuar për transaksione me para të gatshme në Kosovë, e cila hyri në fuqi më 1 shkurt 2024, ekipet në terren të Misionit të OSBE-së në Kosovë pranuan raportime se ky ndryshim ka prekur komunitetin që varet nga mbështetja financiare nga qeveria e Serbisë.

80 Institucioni i Avokatit të Popullit, *Raporti vjetor 2018*, f. 98-99.

81 Shih USAID, *Vlerësim mbi gjininë, LGBTI si dhe personat me aftësi të kufizuara*, 2018, f. 54.

Serbët e Kosovës i shfrytëzojnë kryesisht institucionet shëndetësore të drejtuara nga Beogradi.⁸² Në shumicën e komunave ku **Serbët e Kosovës** janë në pakicë numerike, ekzistojnë institucione shëndetësore dhe/ose qendra më të vogla të kujdesit shëndetësor (*ambulanta*) të drejtuara nga Beogradi.⁸³ Megjithatë, është shumë e rëndomtë që pjesëtarët e komunitetit t'i përdorin institucionet shëndetësore të Graçanicës ose Mitrovicës Veriore, të drejtuara nga Beogradi, për shërbime të kujdesit dytësor shëndetësor⁸⁴, për ç'gjë u duhet të udhëtojnë distanca të gjata me kosto shtesë financiare, e që mund të çojë në përkeqësim të shëndetit në rast emergjence.⁸⁵

Në përgjithësi, **Serbët e Kosovës** të cilët jetojnë në komunat me shumicë serbe përballen me më pak barriera financiare në kuptim të qasjes në kujdesin shëndetësor krahasuar me komunitetet e tjera në Kosovë, mirëpo në komunat ku ata përbëjnë pakicë numerike ekzistojnë pengesa financiare.⁸⁶ Pengesat financiare besohet të jenë më të rënda për gratë për shkak të niveleve të ulëta të punësimit dhe roleve ekzistuese gjinore shoqërore, që kufizojnë qasjen e tyre në kujdesin shëndetësor.⁸⁷

Në Novobërdë, gjatë viteve 2022 dhe 2023, kryetari i komunës punësoi 40 infermierë shtesë për të realizuar vizita në shtëpi për popullatën e moshuar, pasi shumica jetojnë në zona rurale me mundësi të pakta transporti për t'i vizituar vet klinikat shëndetësore. Në mbështetje të mëtutjeshme të kësaj nisme, UNMIK-u dhuroi dy furgonë dhe Ministria e Shëndetësisë dhuroi një furgon. Në Kamenicë, njësi shëndetësore e drejtuar nga Beogradi ka organizuar fushatë të ngjashme për shërbimet mjekësore për pensionistët në dy vitet e fundit.

Në rajonin e Gjilanit, sistemi shëndetësor i drejtuar nga Beogradi ka organizuar fushata të ndryshme për ngritjen e vetëdijes. Spitali në Pasjan është i rëndësishëm si ofrues i kujdesit parësor shëndetësor për **Serbët e Kosovës** që jetojnë në rajonin e Gjilanit dhe realizon rregullisht fushata informuese lidhur me shëndetin dhe ofron kontrole pa pagesë për një gamë të gjerë nevojash shëndetësore. Në Kllokot, pas një rekomandimi nga komiteti për komunitete në tetor të vitit 2023, Ministria e Shëndetësisë ka ofruar ekzaminime shëndetësore me mamograf mobil në fshatin shumetnik Mogillë për tri ditë për gratë shqiptare dhe **serbe të Kosovës** që jetojnë në zonat rurale.⁸⁸

Që nga viti 2023, disa qendra shëndetësore të drejtuara nga Beogradi kanë raportuar se përballen me mungesë të furnizimeve me barna dhe materiale tjera. Si pasojë, pjesëtarët e komunitetit **serb të Kosovës** ndonjëherë detyrohen t'i blejnë këto privatisht ose të udhëtojnë në Mitrovicë Veriore ose në Serbi qendrore për të kërkuar trajtim.

82 OSBE, *Raport i vlerësimit të të drejtave të komuniteteve, Botimi i katërt*, 2015, f. 24.

83 Gjilan, Kamenicë, Kllokot, Novobërdë, Skenderaj, Vushtrri, Istog, Klinë, Pejë, Fushë Kosovë, Obiliq, Prishtinë, Prizren, Rahovec. Shih: OSBE, *Profilet komunale 2018*.

84 Po aty. Shih OSBE, *Profilet komunale 2018*: Gjilan, Novobërdë, Pejë, Fushë Kosovë, Obiliq, Prishtinë, Prizren, Rahovec.

85 Këshilli i Evropës, *Komiteti këshillues për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare*, Opinioni i katërt për Kosovën, 2017, §110, f. 40.

86 Shih Rrjeti i Grave të Kosovës, *Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë*, 2016, f. 51.

87 Po aty. Shih f. 44.

88 Kryetari i Komunës së Kllokotit.

Në Kosovë nuk ka barnatore të licencuara të drejtuara nga Beogradi, prandaj **Serbët e Kosovës** mbështeten në spitale, ambulanca e qendra shëndetësore të drejtuara nga Beogradi për marrjen e barnave me recetë, që furnizohen kryesisht nga Mitrovica Veriore ose Beogradi. Kjo kufizon furnizimin me barna të institucioneve mjekësore që përdoren nga **serbët e Kosovës**. Në fakt, në tetor 2023, qasja në produkte farmaceutike nëpër klinikat shëndetësore të drejtuara nga Beogradi në rajonin e Gjilanit ishte e kufizuar për shkak të një problemi disavjeçar në lidhje me certifikimin e importeve të produkteve mjekësore serbe. Kjo rezultoi në mungesë të furnizimeve kritike shëndetësore në klinikat shëndetësore të drejtuara nga Beogradi, përfshirë bombolat e oksigjenit dhe barnat me recetë, duke i detyruar shumë **serbë të Kosovës** që të udhëtonin përtej vijës kufitare administrative për të blerë ilaçe dhe shërbime të tjera mjekësore.

6. Qasja në arsim

Nxënësit serbë të Kosovës vijojnë mësimin sipas planprogramit të Serbisë të ofruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik (MASHZHT) e Serbisë.⁸⁹ Për shkollat që punojnë sipas planprogramit të Kosovës nuk ka planprogram mësimor të Kosovës në gjuhën serbe, as serbishtja nuk mësohet si lëndë e gjuhës zyrtare apo si lëndë e veçantë për “komunitetin”.

Janë gjithsej 131 shkolla fillore dhe të mesme në 24 komuna që ofrojnë mësim sipas planprogramit të Serbisë, përfshirë këtu edhe arsimin parashkollor dhe arsimin e aftësimin profesional.⁹⁰ Më tej, 14 shkolla fillore në nëntë komuna, që zhvillojnë mësimin sipas planprogramit të Serbisë, kanë objekte të përbashkëta me shkollat që zhvillojnë mësimin sipas planprogramit të Kosovës.⁹¹ Shumë komuna i mbështesin shkollat që zhvillojnë mësimin sipas planprogramit të Serbisë financiarisht ose në mënyra tjera si, për shembull, duke ofruar transport për nxënësit, duke financuar punët ndërtimore dhe duke punësuar personel ndihmës.⁹²

Komuniteti serb i Kosovës është përballur me një numër sfidash në kuptim të qasjes në arsim në gjuhën serbe. Që nga viti 2015 janë zbatuar ndalesa të shumta ndaj importit të teksteve dhe materialeve mësimore nga Serbia, që kanë krijuar pengesa të konsiderueshme për nxënësit. Këto kufizime kanë shkaktuar qasje të kufizuara në burime themelore didaktike, duke penguar kështu përparimin arsimor dhe duke krijuar sfida substanciale në arritjet akademike.

Shkollat që zhvillojnë mësimin sipas planprogramit të Serbisë punojnë shpesh me ndërrime, me disa shkolla fillore dhe të mesme të akomoduar në të njëjtin objekt shkollor, gjë që krijon mbingarkesë dhe ndikon në qasjen në arsim cilësor. Shqetësim tjetër është mungesa e personelit mësimdhënës të kualifikuar. Krahas kësaj, në disa raste nuk ka transport të organizuar adekuat për në shkollat e mesme që zhvillojnë mësimin sipas planprogramit të Serbisë, veçanërisht nga fshatrat.⁹³

89 Në shkollat që zhvillojnë mësimin sipas planprogramit të Serbisë vijojnë mësimin edhe nxënës të komuniteteve të tjera, kryesisht romë, goranë dhe boshnjakë të Kosovës.

90 OSBE, *Qasja e komuniteteve joshumicë në arsimin parauniversitar në Kosovë*, (2018).

91 Po aty, f. 32.

92 Për shembull, në vitin 2020, komuna e Pejës e ka mbështetur shkollën që zhvillon mësimin sipas planprogramit të Serbisë në Gorazhec duke i rinovuar tualetet.

93 Për shembull, transporti nuk ofrohet për nxënësit serbë të Kosovës që banojnë në Vushtrri dhe Skenderaj.

I vetmi institucion i arsimit të lartë në gjuhën serbe në Kosovë është universiteti në Mitrovicën Veriore. Zakonisht, studentët **serbë të Kosovës** i vijnë studimet e lartë në këtë universitet apo universitete të tjera jashtë Kosovës. Universiteti në gjuhën serbe në Mitrovicën Veriore ka dhjetë fakultete, gjegjësisht Fakultetin e Shkencave Teknike, Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Matematikore, Fakultetin e Mjekësisë, Fakultetin Juridik, Fakultetin Ekonomik, Fakultetin e Bujqësisë, Fakultetin Filozofik, Fakultetin e Edukimit për Mësimdhënës, Fakultetin e Sportit dhe Edukatës Fizike, dhe Fakultetin e Arteve. Universiteti ofron një gamë të larmishme të programeve të studimit, të tilla si arkitekturë, inxhinieri ndërtimi, inxhinieri elektrike dhe kompjuterike, filozofi, mbrojtje të mjedisit dhe inxhinieri të sigurisë, dhe inxhinieri mekanike. Pas përkeqësimit të situatës së sigurisë gjatë viteve 2022 dhe 2023, një numër në rritje i studentëve **serbë të Kosovës** po vendosin që studimet universitare t'i vijojnë në Nish ose Beograd, Serbi.

Diplomat e Universitetit në gjuhën serbe në Mitrovicën Veriore mund të dorëzohen për verifikim në Komisionin për Verifikim të Diplomave⁹⁴ për qëllime të aplikimit për punë, provimeve profesionale dhe licencave në institucionet publike. Qeveria e Kosovës e rithemloi Komisionin në shkurt të vitit 2023, e në tetor të vitit 2023 ia vazhdoi mandatin nga 12 në 18 muaj, duke ia zgjeruar njëherazi dhe fushëveprimin për t'i përfshirë diplomat e lëshuara nga shkollat e mesme që zhvillojnë mësimin sipas planprogramit të Serbisë. Krahas Graçanicës dhe Ranillugut, në janar të vitit 2024, kërkesa për verifikim të diplomave të lëshuara nga Universiteti në gjuhën serbe në Mitrovicën e Veriut ka filluar të pranojë edhe komuna e Mitrovicës Veriore.⁹⁵ Në vitin 2023, Komisioni ka pranuar 296 kërkesa për verifikim, nga të cilat 220 janë verifikuar, ndërsa për pjesën tjetër janë kërkuar informata shtesë ose kanë qenë të mangëta. Mandati i Komisionit pritet të vazhdohet deri në vitin 2025.

Verifikimi i kualifikimeve arsimore të fituara në Serbinë qendrore është objekt i dialogut të ndërmjetësuar nga BE,⁹⁶ Marrëveshjes së Uashingtonit dhe Procesit të Berlinit.⁹⁷ Marrëveshja teknike për njohjen e ndërsjellë të diplomave ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit nuk është zbatuar deri më sot. Kjo ka krijuar me raste vështirësi në qasjen e **serbëve të Kosovës** në punësim në institucionet publike.

Dialogu dhe ndërveprimi me nxënësit e komuniteteve tjera është i kufizuar për shkak të sistemeve të ndara arsimore dhe barrierave gjuhësore ndërmjet fëmijëve serbë dhe atyre shqiptarë të Kosovës. Organizatat ndërkombëtare dhe vendore të shoqërisë

94 Në vitin 2015, nën ndërmjetësimin e OJQ-së Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI) në Kosovë, MESTI dhe UMV-ja kanë arritur një marrëveshje për verifikimin e diplomave. Rregullorja e qeverisë (nr. 21/2015) parasheh themelimin e një komisioni për verifikimin e diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut në gjuhën serbe, me seli në MASHTI, duke mundësuar verifikimin e diplomave për qëllime të punësimit. Pas një periudhe të zgjatuar të pasivitetit, Komisioni është rithemeluar në shkurt 2023 me vendim të ri të qeverisë (nr. 01/130). Në tetor 2023, vendimi i mëparshëm u ndryshua me qëllim të vazhdimin të mandatit të Komisionit nga 12 në 18 muaj dhe zgjerimit të fushëveprimit të tij lidhur me diplomat e lëshuara nga shkollat e mesme që zhvillojnë mësimin sipas planprogramit të Serbisë. Përveç komunave të Graçanicës dhe Ranillugut, më 15 janar 2024, edhe komuna e Mitrovicës së Veriut ka filluar të pranojë kërkesa për verifikimin e diplomave të lëshuara nga Universiteti në gjuhën serbe në Mitrovicën e Veriut.

95 Artikulli i Radio 'Kontakt Plus': <https://radiokontaktplus.org/en/News/Verifikimi-i-diplomave-universitare-në-Mitrovicën-veriore-do-së-shpejti-të-mundësohet-përsëri-dhe-gjimnazist-diplomat-do-verifikohen-së-shpejti/60706/>

96 Veprimi i Jashtëm i Bashkimit Evropian, faqja zyrtare e internetit, https://eeas.europa.eu/diplomatic-network/eu-facilitated-dialogue-belgrade-pristina-relations/349/dialogue-between-belgrade-and-pristina_en (qasur më 9 nëntor 2020).

97 Marrëveshja e Procesit të Berlinit për Njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë në Ballkanin Perëndimor është ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës më 8 shkurt 2023 dhe nga Parlamenti i Serbisë më 28 prill 2023. Megjithatë, deri më sot marrëveshja nuk është funksionale.

civile kanë mbështetur dhe organizuar aktivitete jashtëshkollore, kryesisht në shkollat që zhvillojnë mësimin sipas dy sistemeve arsimore e që i shfrytëzojnë të njëjtat objekte shkollore. Nismë e tillë është trajnimi i mësimdhënësve dhe zbatimi i projektit të Dialogut Nansen⁹⁸ në shkollat që i shfrytëzojnë të njëjtat objekte shkollore në fshatin Jasenovik (Novobërdë), në Ponesh (Gjilan) dhe në Binçë (Viti), që kanë kontribuar në përmirësimin e ndërveprimeve ndërmjet nxënësve shqiptarë dhe **serbë të Kosovës**.

98 Për informata të më tutjeshme, shih: <https://nansen.peace.no/> (Qasur në dhjetor 2023).

7. Qasja në drejtësi

Një pakicë punonjësish të tri institucioneve gjyqësore, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP, Agjencia për Ndhimë Juridike Falas (ANJF) dhe Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave (ZMNV), janë pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës.

Në IAP, pesë nga 74 punonjës janë **serbë të Kosovës**: katër gra dhe një burrë, ku ky i fundit është njëri nga pesë zëvendësit e Avokatit të Popullit; në ANJF, dy nga 32 punëtorët janë **serbë të Kosovës** (të dyja gra); asnjë nga 32 punonjësit e ZMNV-së nuk është serb i Kosovës. Po ashtu, 29 nga 1,383 avokatë të licencuar, anëtarë të Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK), janë **serbë të Kosovës** (25 burra, katër gra).

Monitorimi në terren i OSBE-së ka shpalosur se pjesëtarët e komunitetit **serb të Kosovës** kanë nivele të ndryshme të vetëdijesimit lidhur me shërbimet e ofruara nga ANJF-ja, IAP-i, dhe ZMNV-ja. Pjesëtarët e komunitetit të cilët kanë më së shumti dijeni për këto shërbime janë ata që punojnë ose angazhohen me institucionet komunale, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat, si dhe studentët. Fushatat e ndërgjegjësimit që synojnë komunitetin e gjerë, veçanërisht familjet që jetojnë në zonat rurale, mund të jenë efektive në këtë drejtim. Shembull i tillë janë përpjekjet për të rritur dukshmërinë e ANJF-së. Dallime në nivelin e vetëdijesimit ka edhe ndërmjet komunave. Në Prizren dhe Rahovec, komuniteti **serb i Kosovës** ka njohuri të kufizuara lidhur me shërbimet që ofrohen nga institucionet e lartpërmendura ngaqë këto të fundit veprojnë në nivel rajonesh dhe, për shkak të mungesës së aktiviteteve të ndërgjegjësimit e informimit të dedikuara enkas për komunitetin në këto komuna.⁹⁹ Vrojtimi i ngjashëm është bërë edhe në Pejë, ku përfaqësuesit e komunitetit kanë vënë në dukje nevojën për fushata të ndërgjegjësimit dhe informimit të dedikuara për këtë komunitet mbi shërbimet gjyqësore.¹⁰⁰

Në Mitrovicë Veriore dhe Graçanicë ka fushata ndërgjegjësuese dhe informuese të dedikuara enkas për komunitetin **serb të Kosovës** që si qëllim kanë avancimin e qasjes në drejtësi për banorët dhe të njohurive lidhur me shërbimet gjyqësore.¹⁰¹

⁹⁹ Sipas raporteve të OSBE-së në terren nga rajoni i Prizrenit.

¹⁰⁰ Sipas raporteve të OSBE-së në terren nga rajoni në fjalë.

¹⁰¹ Sipas raporteve të OSBE-së në terren nga rajoni i Mitrovicës.

IAP është institucioni i vetëm që realizon vizita të rregullta mujore dhe *ad-hoc* në komuna të ndryshme dhe, për këtë arsye, ka dukshmëri më të mirë se dy ofruesit e tjerë të shërbimeve juridike. Ndonëse IAP nuk po realizon më vizita mujore në komunat e rajonit të Prishtinës, zyra e saj rajonale në Graçanicë zhvillon vazhdimisht fushata ndërgjegjësimi në zonat e banuara nga **serbët e Kosovës**. Krahas kësaj, IAP organizon tryeza diskutimi në bashkëpunim edhe me OJQ-të dhe me Misionin e OSBE-së për t'i informuar banorët se në ç' mënyrë mund të bien në kontakt me IAP-in.¹⁰² Zëvendësavokati i Popullit i Kosovës i cili është nga radhët e komunitetit serb i ka vizituar disa herë zonat e banuara nga **Serbët e Kosovës** në komunat e Pejës, Istogut dhe Klinës dhe i ka informuar pjesëtarët e komunitetit për punën e IAP-it. Gjithashtu, zyrat rajonale të IAP-it zhvillojnë vizita të herëpashershme në ato zona.

Që nga tetori i vitit 2021, IAP është duke udhëhequr me "Forumit për Dialog" ndërmjet Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC), i cili mbledh OSHC të ndryshme, përfshirë ato që përfaqësojnë **serbët e Kosovës**.¹⁰³

ZMNV, nën patronatin e Zyrës së Kryeprokurorit dhe me mbështetjen e Ambasadës Amerikane, organizon çdo tetor "Javën e të Drejtave të Viktimave të Krimit". Përkundër fushatave të shumta informuese të realizuara nga institucione të ndryshme, përfshirë nga ZMNV, Ministria e Drejtësisë, OAK, dhe informatave që u ofrohen viktimave kur kërkojnë shërbime, **Serbët e Kosovës** kanë pak në mos fare hiq njohuri rreth mundësive të kompensimit për viktimat e krimit (KVK). Në Mitrovicë, siç dëshmohet nga mungesa e kërkesave për kompensim, informatat e pamjaftueshme rreth programit të KVK-së vë në dukje nevojën për sesione informative për t'i edukuar personat mbi të drejtat e viktimave. Në Pejë, OSBE ka vërejtur se fletëpalosjet për programin e KVK-së janë vënë në dispozicion në vende të dukshme në gjykatat themelore dhe degët e tyre, në gjuhën shqipe, serbe dhe atë angleze.

Pesë nga zyrat rajonale të ANJF-së¹⁰⁴ dhe nëntë zyra mobile¹⁰⁵ i mbulojnë komunat e banuara nga **serbët e Kosovës**. Ekipet mobile të ANJF-së gjithashtu kontribuojnë në fushatat ndërgjegjësuese duke vendosur kontakt me komunitetet joshumicë dhe duke realizuar fushata informuese dhe ndërgjegjësuese. Në vitin 2023, me mbështetjen e USAID-it, ANJF ka shpërndarë fletëpalosje dhe pano në gjuhët angleze, shqipe, serbe dhe turke si dhe në alfabetin e brajlit. Ngjashëm, gjatë Javës së Ndihmës Juridike Falas me moton "Mbroni të drejtat tuaja" janë postuar videospote dhe postime në rrjetet sociale në gjuhët zyrtare.

Në nivel vendi, shumica e institucioneve kanë personel që flet disa gjuhë nëpër zyrat e tyre rajonale, të cilët mund të komunikojnë dhe ofrojnë shërbime në gjuhën serbe. Në Prizren, të gjitha institucionet kanë personel që flet disa gjuhë e që mund të ofrojnë shërbime në gjuhët zyrtare. Megjithatë, në Prishtinë, ZMNV nuk ka përkthyes nga gjuha shqipe në atë serbe dhe anasjelltas.

¹⁰² Sipas raporteve të OSBE-së në terren nga rajoni.

¹⁰³ Qëllimi i Forumit është që të krijojë një platforme të përbashkët për bashkëpunim ndërmjet IAP-it dhe OSHC-ve, për avancimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, për identifikimin e sfidave dhe shkeljeve të të drejtave dhe lirive themelore dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta për promovimin dhe mbrojtjen e tyre.

¹⁰⁴ Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjilan

¹⁰⁵ Fushë Kosovë, Istog, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok, Graçanicë, Skënderaj

Njëjtë qëndron edhe Gjilani, ku zyrës i duhet herë pas here që t'u drejtohet përkthyesve të Prokurorisë ose Gjykatës kur është e nevojshme. Për më tepër, jo të gjitha dokumentet e hartuara nga këto institucione janë të disponueshme në gjuhën e këtij komuniteti, ose përkthimi i tyre vonohet. Në rajonin e Pejës, sipas burimeve të shumta, shumica e zyrtarëve janë në gjendje të komunikojnë në të dyja gjuhët lokale. Për shembull, tre nga katër zyrtarët e ZMNV-së mund të komunikojnë në të dyja gjuhët lokale, përfshirë këtu një zyrtar që gjuhën boshnjake e ka gjuhë amtare. Në rastet kur klientët kanë pengesa gjuhësore, institucionet përkatëse (gjykata, prokuroria, ZMNV) kanë në dispozicion përkthyes për t'i mbështetur palët që nuk flasin shqip ose për të përkthyer dokumentet përkatëse, megjithatë homologët gjyqësorë kanë evidentuar si shqetësim cilësinë e dobët dhe vonesat në sigurimin e përkthimeve në procedurat gjyqësore.

Për sa u përket përfituesve të shërbimeve¹⁰⁶, në vitin 2023, ANJF ka ofruar shërbime për 6,070 persona (përfshirë 2,883 gra), prej të cilëve 164 ishin pjesëtarë të komunitetit serb. IAP ka pranuar 1,595 ankesa në vitin 2022, ku 77 sosh janë paraqitur nga pjesëtarë të komunitetit **serb të Kosovës**.¹⁰⁷ ZMNV i ka trajtuar 2,883 raste në vitin 2023, ku 98 viktimat ishin **serbë të Kosovës**, shumica syresh gra.

Pjesëtarët e komunitetit janë të lirë t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre ligjorë. Megjithatë, në rastet e përfaqësimit sipas detyrës zyrtare në lëndët penale, OAK cakton avokatë sipas radhës së avokatëve të regjistruar në listë, të cilët flasin rrjedhshëm gjuhën e komunitetit që e përfaqësojnë ose janë pjesëtarë të komunitetit përkatës.

Dorëheqjet e gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë të Kosovës

Në bazë të Marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013 dhe Marrëveshjes për Drejtësinë të vitit 2015, gjyqtarët, prokurorët dhe personeli administrativ **serb i Kosovës** e kryen integrimin e tyre në sistemin e drejtësisë së Kosovës më 24 tetor 2017. Në Gjykatën Themelore të Mitrovicës dhe degët e saj të sapokrijuara në Leposaviq e Zubin Potok u caktuan 25 gjyqtarë **serbë të Kosovës**, në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës u caktuan nëntë prokurorë **serbë të Kosovës**, dhe në Divizionin e Gjykatës së Apelit në Mitrovicë Veriore u caktuan pesë gjyqtarë **serbë të Kosovës**. Në fillim të nëntorit 2022, gjithë gjyqtarët **serbë të Kosovës** dhe personeli administrativ i Gjykatës Themelore dhe i Divizioni të Gjykatës së Apelit në Mitrovicë Veriore dhanë dorëheqje nga pozitat e tyre në gjyqësorin e integruar. Dorëheqje dhanë po ashtu edhe gjithë prokurorët **serbë të Kosovës** dhe personeli administrativ i Prokurorisë Themelore të Mitrovicës Veriore nga pozitat e tyre në prokurorinë e integruar.¹⁰⁸ Deri në fund të periudhës për të cilën raportohet, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) nuk i kanë pranuar dorëheqjet e dorëzuara, duke thënë se ato nuk konsiderohen vullnetare dhe se zyrtarët e drejtësisë mund të kthehen.

¹⁰⁶ Intervistat dhe shkëmbimi me email me ZMNV-në, ANJF-në, IAP-in dhe OAK-un në dhjetor 2023 dhe janar 2024.

¹⁰⁷ Nuk ka ende të dhëna të disponueshme për vitin 2023, në pritje të publikimit të raportit vjetor më 31 mars 2024. Të dhënat paraprake të publikuara nga Avokati i Popullit më 26 dhjetor 2023 nuk ofrojnë informatat të zërthyer sipas komunitetit.

¹⁰⁸ Më 5 shkurt 2024, jashtë periudhës për të cilën raportohet, me kërkesë të KGJK-së, Misioni i OSBE-së ka monitoruar testin kualifikues për rekrutimin e pozitave të lira të rezervuara për gjyqtarët serbë të Kosovës. Të tre kandidatët që kanë aplikuar e kanë kaluar testin. Në përgjithësi, megjithatë, ekziston një mungesë e aplikantëve për gjyqtarë serbë të Kosovës, e cila me sa duket është pjesërisht për shkak të mosnjohjes së kualifikimeve akademike.

Kryesuesit e KGJK-së dhe KPK-së kanë deklaruar se janë të përkushtuar që të sigurojnë që Kosova të ketë një sistem shumetnik të drejtësisë, dhe se kanë diskutuar po ashtu edhe rreth strategjive të rekrutimit që synojnë rritjen e përfaqësimit të komuniteteve joshumicë në të.

8. Përdorimi i gjuhës dhe mediat

Mundësia e pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës për ta përdorur lirisht gjuhën serbe është përmirësuar ndër vite, duke qenë se pjesëtarët e përdorin atë si në ndërveprimet e përditshme ashtu edhe në mjediset zyrtare.

Si gjuha shqipe ashtu edhe ajo serbe dhe alfabetet e tyre përkatëse janë përcaktuar si gjuhë zyrtare të Kosovës me Ligjin për përdorimin e gjuhëve të vitit 2006¹⁰⁹ dhe me Kushtetutë.¹¹⁰

Gjuha serbe është gjuhë zyrtare në të gjitha nivelet. Të gjitha dokumentet dhe komunikatat e lëshuara nga institucionet duhet të jenë në përputhje me dispozitat ligjore. Në nivelin qeveritar, Zyra e Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ) është themeluar në vitin 2012.¹¹¹ Përgjegjësitë e ZKGJ-së përfshijnë monitorimin e pajtueshmërisë nga çdo institucion nën juridiksionin e tij me legjislacionin përkatës, përfshirë në veçanti Ligjin për përdorimin e gjuhëve, dhe marrjen e masave të nevojshme nën autoritetin e vet, përfshirë ato përmes ndërmjetësimit, për të siguruar pajtueshmërinë me legjislacionin nga të gjitha institucionet nën juridiksionin e tij. ZKGJ shqyrton dhe jep rekomandime përkitazi me rregulloret ose udhëzimet administrative, zhvillon hetime, qoftë me vetiniciativë ose në bazë të ankesave të bëra nga personat fizikë ose juridikë, për mosrespektim të legjislacionit nga ana e institucioneve sa i përket statusit dhe përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve tjera të komuniteteve gjuha e të cilave nuk është gjuhë zyrtare në Kosovë.

Përkundër përparimit pozitiv në përdorimin e gjuhës serbe, ku dygjuhësia është bërë në përgjithësi standard në administratën komunale dhe gjykata, gëzimi i të drejtave gjuhësore dhe përdorimi i gjuhës amtare nga ana e komunitetit **serb të Kosovës** vazhdon të jetë i kufizuar për shkak të resurseve të pamjaftueshme financiare për shërbime të përkthimit cilësor dhe profesional, mundësive të kufizuara për mësimin e gjuhës përmes sistemit arsimor, mosnjohjes së gjuhës serbe nga ana e zyrtarëve komunalë dhe mosnjohjes së gjuhës serbe nga të rinjtë.

¹⁰⁹ Neni 2 i Ligjit nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, mars 2007.

¹¹⁰ Neni 5 i Kushtetutës, 15 qershor 2008 dhe Amendamentet e Kushtetutës, 07 shtator 2012; 26 mars 2013; 05 gusht 2015; 11 mars 2016 dhe 25 shtator 2020.

¹¹¹ Zyra është themeluar me Rregulloren nr. 07/2012 për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët, në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8364>, qasur më 29 korrik 2024.

Raporti i ZKGJ-së i vitit 2019¹¹² ka vënë në dukje se, në përgjithësi, komunat e Kosovës kanë bërë përparim pozitiv në kuptim të barazisë gjuhësore, janë akoma disa mangësi në përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore, përfshirë mungesën e kapaciteteve njerëzore, ndërrimin e shpeshtë të përkthyesve, mungesën e pajisjeve, mungesën e kriterëve të qarta lidhur me kushtet që duhen plotësuar për pozitat e përkthyesve dhe mungesën e llogaridhënies në trajtimin e ankesave të qytetarëve.¹¹³

Numri i ankesave të pranuar nga ZKGJ-ja është rritur ndjeshëm ndër vite. Në gjysmën e parë të vitit 2024, jashtë periudhës për të cilën raportohet, ZKGJ ka pranuar 15 ankesa, ku disa prej tyre janë në proces të zgjidhjes.¹¹⁴ Faqet e internetit të komunave nuk janë përditësuar në mënyrë të mirëfilltë në gjuhën serbe, gjë që i ka pamundësuar komunitetit t'i qaset informacionit lidhur me konkurset e punës dhe grantet.

Në disa komuna, shenjat rrugore, përfshirë emrat e vendbanimeve dhe të rrugëve, si dhe drejtimet e rrugëve, janë në të gjitha gjuhët zyrtare.¹¹⁵ Në komuna të caktuara, dëmtimi i shenjave rrugore vazhdon të përbëjë problem, zakonisht me versionet në gjuhën serbe të emrave të qyteteve ose fshatrave që mbulohen me ngjyrë. Ka mungesë të përgjithshme përpjekjesh nga strukturat e pushtetit lokal për të investuar në zëvendësimin e shenjave rrugore të dëmtuara, veçanërisht nëpër fshatra. Shqetësuese është sidomos gjendja në komunën e Gjakovës, ku numri i tabelave të lyera të qyteteve dhe fshatrave është shumë i lartë, si jashtë qytetit (konkretisht në rrugën që lidh Gjakovën me Deçanin) ashtu edhe në qytet. Situatë e ngjashme vërehet edhe në komunën e Deçanit, veçanërisht në zonat rurale. Në rajonin e Mitrovicës është vërejtur se disa shenja rrugore kanë jokonsistenca dhe mangësi.¹¹⁶

Në përgjithësi, komuniteti **serb i Kosovës** merr informacione dhe shërbime publike në gjuhën serbe, si gjuhë zyrtare. Megjithatë, vazhdojnë të jenë evidente disa sfida, veçanërisht në nivelin komunal.¹¹⁷ Në periudhën 2017-2019, 22 nga 38 komuna kanë vënë në dispozicion dokumente të informimit publik të tilla si njoftimet për mbajtje të takimeve publike, fletëpalosjet, broshurat informative dhe njoftimet në tabelat e shpalljeve nëpër komuna, në gjuhët zyrtare dhe, sipas rastit, në gjuhë të tjera në përdorim zyrtar.¹¹⁸ Në periudhën 2021-2023, Prizreni, Dragashi dhe Rahoveci kanë nxjerrë dokumente për informim publik në gjuhën serbe. Ndonëse që të 38 komunat kanë faqet e veta të internetit dhe kanë bërë përpjekje që në to të përfshijnë informata me rëndësi për banorët e tyre, vetëm faqet e internetit të 14 komunave ofrojnë

¹¹² Zyra e Komisionerit për Gjuhët, *Raport vjetor për pajtueshmërinë gjuhësore në komuna*, mars 2019.

¹¹³ Po aty.

¹¹⁴ Raport i brendshëm dhe shkëmbim i informatash nga Zyra e Komisionerit për Gjuhët, korrik 2024.

¹¹⁵ Ato janë Ferizaj, Shtërpca, Viti, Kaçaniku, Vushtrria, Leposaviqi, Zubin Potoku, Zveçani, Mitrovica Veriore, Lipjani, Fushë Kosova, Obiliqi, Mamusha, Klinë, Istogu dhe Juniku.

¹¹⁶ Misioni i OSBE-së ka vërejtur se emrat e vendbanimeve në tabelat e reja rrugore të vendosura përgjatë rrugës së sapondërtuar në zonën e komunës së Vushtrisë (që shtrihet nga Mitrovica Jugore drejt Prishtinës) janë të shkruar vetëm në gjuhën shqipe. Në mars të vitit 2024, jashtë periudhës për të cilën raportohet, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) i ka zëvendësuar tabelat e toponimeve në rrugën kryesore ndërmjet Zveçanit dhe Leposaviqit me tabela të reja dygjuhëshe. Ndërsa tabelat e mëparshme i kishin emrat e qyteteve dhe fshatrave të shkruar në serbisht (duke përdorur alfabetin cirilik dhe latin), shenjat e reja janë shkruar fillimisht në gjuhën shqipe dhe përfund në serbisht me alfabetin latin. Ndonëse nuk është e saktësuar qartë në legjislacion se cila gjuhë duhet të vendoset e para, Komisioneri për Gjuhë ka deklaruar se "korniza ligjore parasheh barazinë e gjuhëve zyrtare, por shenjat topografike duhet të marrin parasysh edhe përbërjen etnike të vetë vendbanimeve dhe renditja e gjuhëve në këto shenja duhet të ndryshohet". Deklarata në dispozicion në: <https://kossev.info/kosovo-vesti-srpske-table-uklanjanje-cirilica-aljiju/>, qasur më 15 mars 2024.

¹¹⁷ Bazuar në monitorimin e rregullt nga Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Zyra e Komisionerit për Gjuhë.

¹¹⁸ Prishtinë, Shtime, Fushë Kosovë, Obiliq, Klinë, Istog, Pejë, Mitrovicë Veriore, Mitrovicë Jugore, Podujevë, Vushtrri, Prizren, Rahovec, Ferizaj, Viti, Shtërpocë, Kllokot, Gjilan, Ranillug, Novobërdë, Partesh dhe Kamenicë.

informata në të gjitha gjuhët zyrtare, me përmbajtje dhe përditësime të paraqitura në të njëjtën mënyrë ose të ngjashme edhe në gjuhën serbe.¹¹⁹ Prizreni, Dragashi dhe Rahoveci ofrojnë më shumë informata në të gjitha gjuhët zyrtare. Në Dragash, e tërë përmbajtja është në dispozicion në të gjitha gjuhët zyrtare, siç është udhëzuar nga kryetari i komunës që nga viti 2021, kurse në Prizren e Rahovec, informatat përkatëse ofrohen në të dyja gjuhët zyrtare, por me dallime në sasinë e përmbajtjes së përkthyer. Krahas kësaj, vetëm tetë nga 38 komuna kanë organizuar ngjarje kontaktuese ose informuese për t'i informuar komunitetet e tyre rreth Ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe të drejtat gjuhësore. Faturat e shërbimeve publike janë në dispozicion në gjuhën serbe. Megjithatë, në Graçanicë, pjesëtarët e komunitetit kanë raportuar vështirësi për t'iu qasur dokumenteve ose shërbimeve të ofruesve të shërbimeve publike në gjuhën serbe.

Pothuajse të gjitha komunat ofrojnë shërbime të interpretimit dhe përkthimit.¹²⁰ Megjithatë, vetëm tri komuna kanë raportuar të kenë numër të mjaftueshëm të përkthyesve të punësuar për ta mbuluar plotësisht ngarkesën e punës dhe nevojat ekzistuese (Leposaviqi, Suhareka dhe Mamusha). Në komunat tjera janë bërë përpjekje për ta menaxhuar numrin e pamjaftueshëm të përkthyesve dhe interpretëve si, për shembull, duke u kërkuar punonjësve tjerë të komunës që të ofrojnë shërbime të përkthimit dhe interpretimit sipas nevojës. Katër komuna kanë raportuar se nuk kanë fare staf për përkthim apo interpretim.¹²¹ Pas përpjekjeve avokuese të Misionit të OSBE-së për ta rritur pajtueshmërinë e komunave me Ligjin për përdorimin e gjuhëve, komuna e Vitisë ka finalizuar përzgjedhjen e një përkthyesi/interpreti komunal pas një konkursi që kishte qëndruar i hapur tre vjet. Përkthyesi/interpreti filloi punën në këtë pozitë më 1 shtator 2023, që kishte mbetur e paplotësuar që nga pensionimi i përkthyesit/interpretit të mëparshëm në vitin 2020.

Ankesat për mungesën e materialit të përkthyer i ngritin kryesisht OSHC-të dhe gazetarët në emër të komunitetit **serb të Kosovës**, duke qenë se ata vërejnë vonesa në publikimin e informatave në gjuhën serbe. Ata e theksojnë nevojën për më shumë ndërgjegjësim dhe promovim të shumëgjuhësisë institucionale dhe mësimi të gjuhës zyrtare, përfshirë përmes ofrimit të opsionit të mësimi të gjuhës serbe si gjuhë të dytë në planprogramin shkollor. Ndonëse grupet e shoqërisë civile kanë interes që ta promovojnë mësimin e gjuhëve, ato janë fokusuar më shumë që ta shtytin Qeverinë dhe komunat për t'i zbatuar ligjet ekzistuese, e jo në promovimin e vetë gjuhëve.

Komuniteti **serb i Kosovës** ka qasje në media në gjuhën serbe në platforma të ndryshme. Transmetuesi publik, Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) ka kanal in e vet në gjuhën serbe (RTK2). Sipas Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, RTK ka për obligim të sigurojë 15 për qind të skemës së saj programore në gjuhët e komuniteteve tjera të Kosovës.¹²²

119 Gjilan, Novobërdë, Kamenicë, Ferizaj, Viti, Shtërpçë, Kaçanik, Kllokot, Prishtinë, Shtime, Obiliq, Klinë, Istog dhe Pejë.

120 Njëzet e pesë nga 38 komuna kanë punësuar përkthyes dhe interpretë në përputhje me numrat e paraparë në organogramet e tyre komunale. Në 14 nga 38 komuna, njësitë e përkthimit ekzistojnë si pjesë e organogramit komunal.

121 Hani i Elezit, Gllgoc, Malishevë dhe Shtime.

122 Ligji për Radiotelevizionin e Kosovës, neni 8, pika 3 "Këto dy kanale janë të detyruara të ndajnë 15 përqind të skemës së tyre programore për gjuhët e komuniteteve tjera të Kosovës".

Përveç RTK2, RTK1 transmeton programe të posaçme për komunitetet joshumicë, përfshirë mes tjerash edhe programe në gjuhën serbe.¹²³ Megjithatë, "Vlerësimi i publikut mbi gjendjen e mediave në Kosovë", i porositur nga Misioni i OSBE-së në vitin 2017, ka shpalosur se pjesëtarët e komunitetit **serb të Kosovës** i përcjellin kryesisht stacionet televizive të Beogradit.¹²⁴ Sipas këtij vlerësimi, 59.20 për qind e të intervistuarve kanë deklaruar se i shikonin stacionet televizive të Beogradit "çdo ditë", ndërsa 64,10 për qind deklaruan se nuk e kishin parë kurrë RTK2. Në tetor të vitit 2022, Misioni realizoi një sondazh me pjesëtarët e komunitetit **serb të Kosovës** në 23 komuna në Kosovë, pas monitorimit të shikueshmërisë prej korrikut deri në tetor të vitit 2022.¹²⁵ Kanali më i ndjekur, i përzgjedhur në 32.82 për qind të rasteve, ishte RTS. Në përgjithësi, përcaktues i asaj se cilat media i përcjellë dhe i konsumon rregullisht komuniteti **serb i Kosovës** janë përkatësia e komunitetit dhe njohuritë gjuhësore.

Komuniteti ka qasje në 27 stacione private televizive dhe radio me frekuenca tokësore, pesë kanale televizive të transmetuara përmes operatorëve kabllorë dhe gjashtë operatorë televizivë kabllorë të licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM).¹²⁶ Në nivel komunal veprojnë disa portale online të lajmeve dhe media të tjera. Për shkak të tregut të kufizuar të reklamave në Kosovë, shumica ballafaqohen me vështirësi në kuptim të qëndrueshmërisë financiare dhe varen kryesisht nga donacionet e huaja.¹²⁷ Disa sosh operojnë në nivel rajonal dhe marrin përkrahje të caktuar financiare.¹²⁸ Në përgjithësi, mediat në gjuhën serbe raportojnë sfida të lidhura me qasjen në informata në gjuhën e tyre. Krahas kësaj, shumica e mediave në Kosovë operojnë akoma vetëm në gjuhën e komunitetit të tyre përkatëse dhe, kështu, raportojnë kryesisht për çështje që kanë të bëjnë vetëm me atë komunitet.¹²⁹ Një qasje e përbashkët drejt transformimit të mediave në burime shumëtnike do të ishte pasqyrim i një shoqërie të larmishme dhe do të kontribuonte në integrimin shoqëror.

Të gjitha komunat kanë ofruar programe të aftësimit gjuhësor për përfundimin e zotësive gjuhësore të nëpunësve civilë nëpër komuna.¹³⁰ Megjithatë, këto kurse ofrohen kryesisht nga organizata ndërkombëtare dhe vendore. Me iniciativë të Komisionerit për Gjuhët është krijuar një platformë për mësimin e gjuhës shqipe dhe asaj serbe e quajtur "Vocup" dhe është në dispozicion në internet.¹³¹ Platforma ofron kurse për mësimin e gjuhës shqipe dhe asaj serbe, dhe përdorimi i saj është rritur me kalimin e kohës. Në vitin 2023, Misioni i OSBE-së në Kosovë, së bashku me Qendrën

123 Në vitin 2020, RTK-ja ka raportuar se programi i saj është si vijon: programi 45-minutësh, "Nedeljni Kolaž", në gjuhën serbe, të hënën nga ora 15:15 deri në orën 16:00 dhe programi 45-minutësh në gjuhën serbe i gazetarit Budimir Nčić të mërkurën nga qendra mediale në gjuhën serbe. "Programet e komunitetit" transmetohen në RTK1 dhe janë në dispozicion përmes satelitit. As orari i programit dhe as përmbajtja e programit nuk janë në dispozicion në internet.

124 Numri i mostrës ishte 1,507 banorë në mbarë Kosovën, dhe komuniteti serb i Kosovës është marrë si mostër.

125 Studimi i matjes së audiencës televizive të Kosovës, UBO Consulting për Misionin e OSBE-së në Kosovë, nëntor 2022.

126 <https://kpm-ks.org/telicencuarit/306/llojet-e-licencave/306> (qasur në dhjetor 2023).

127 Sipas Indeksit të Qëndrueshmërisë së Mediave të IREX-it për vitin 2019, mediat në gjuhën serbe janë përgjithësisht të vogla dhe të regjistruara si OJQ.

128 Për shembull, TV Most nga Zveçani, Radio dhe TV Puls nga Shillova, Radio dhe TV Graçanica nga Graçanica, dhe Radio Kosovska Mitrovica nga Mitrovica e Veriut janë pjesë e ndërmarrjes publike me qendër në Beograd, Mreža Most, themeluar dhe mbështetur financiarisht nga qeveria e Serbisë. Për informata të mëtejshme, shih: <https://mrezamost.rs/naslovna/>. (Qasur në dhjetor 2023).

129 Indeksi i Lirisë së Shtypit 2020 nga Reporterët pa Kufij thotë se "qasja në informacion është shpesh e kufizuar në një grup etnik ose politik, me shumicën e mediave që raportojnë kryesisht për çështje që kanë të bëjnë me kombësinë e tyre". Gjetjet janë në dispozicion në: <https://rsf.org/en/kosovo>. (qasur në dhjetor 2023).

130 Zyra e Komisionerit të Gjuhëve, *Raporti vjetor 2019 i Zyrës së Komisionerit për Gjuhët*.

131 Platforma është në dispozicion në <https://www.voc-up.com/> (qasur në dhjetor 2023).

e Gjuhëve në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës, kanë nisur një pilot projekt për ofrimin e kurseve të gjuhës serbe dhe asaj shqipe për grupe të ndryshme të synuara, përfshirë nëpunësit civilë dhe përkthyesit nëpër komuna. Kurset, të nivelit bazik dhe të avancuar, vazhdojnë të kontribuojnë në rritjen e kapaciteteve të Universitetit për t'iu përgjigjur nevojës në rritje për profesionistë gjuhësorë në administratën publike. Kjo është thelbësore për të siguruar pajtueshmërinë institucionale me legjislacionin për gjuhët dhe shumëgjuhësinë.

9. Trashëgimia kulturore dhe fetare, si dhe liritë fetare

Serbët e Kosovës janë kryesisht të krishterë ortodoksë. Komuniteti është përgjithësisht i lirë ta shprehë identitetin e tij kulturor, besimet fetare dhe zakonet. Megjithatë, në zonat me shumicë shqiptare të Kosovës, komuniteti dhe kleri i Kishës Ortodokse Serbe ndihen akoma të pasigurt që të vizitojnë vende të tilla si kishat, manastiret dhe varrezat.

Komuniteti i kremton festat kryesore ortodokse, përfshirë këtu Krishtlindjet Ortodokse (7 janar), Pashkët Ortodokse, Vitin e Ri Ortodoks (13 janar), Vidovdanin (Dita e Shën Vitusit më 28 qershor), Festën e Fjetjes së Virgjëreshës së Shenjtë (28 gusht) dhe Ditët e të Gjithë Shpirtrave (katër herë në vit).

Ekzistojnë po ashtu edhe disa kremte lokale që u kushtohen shenjtorëve mbrojtës ose lokalë (*serbisht* "slava"). Për shembull, Dita e Shën Savës (27 janar) dhe Dita e Shën Vitusit (28 qershor) kremtohen në mbarë Kosovën. **Serbët e Kosovës** i kremtojnë po ashtu ditët e shenjtorëve mbrojtës të Patriarkanës së Pejës: Kreshma e Nënës së Shenjtë të Zotit (14 tetor) dhe kremtja e Shën Arsenije Sremacit (10 nëntor). Më 14 maj, fshati Gorazhdec i bën homazhe të shenjtit mbrojtës Shën Jeremia dhe kremton festën e Lindjes së Virgjëreshës së Bekuar më 21 shtator. Më 10 prill, komuniteti **serb i Kosovës** kremton festën e fshatit Belopojë. Festa e Shpërftyrimin të Zotit (19 gusht) festohet në Istog dhe Klinë. Më 24 nëntor, **Serbët e Kosovës** në Deçan kremtojnë festën e Shën Stefanit të Deçanit, të shenjtit mbrojtës të Manastirit të Deçanit. Kremtimet tjera përfshijnë festën e Shën Nikollës (19 dhjetor dhe 22 maj), festën e Shën Pjetrit dhe Shën Palit (12 korrik) dhe festën e Shën Kryeengjellit Gabriel (26 korrik), si dhe përkujtimin e prerjes së kokës së Shën Gjon Pagëzuesit (11 shtator).

Në Kosovë ndodhen objekte të shumta të trashëgimisë kulturore dhe fetare që janë të rëndësishme për komunitetin **serb të Kosovës**. Më se 40 lokalitete janë klasifikuar si zona nën mbrojtje të veçantë (ZMV), prej të cilave katër sosh janë pjesë e pasurisë së trashëgimisë botërore të UNESCO-s "Vendet mesjetare në Kosovë". Patriarkana Ortodokse Serbe e Pejës, Manastiri Ortodoks Serb i Deçanit (në komunën e Deçanit)¹³² dhe Manastiri Ortodoks Serb i Graçanicës (në komunën e Graçanicës) janë të regjistruar në Listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s.

¹³² Në vitin 2021, Manastiri i Deçanit u përfshi në listën e "Shtatë monumentet më të rrezikuara të Evropës" për vitin 2021 nga federata pan-evropiane e organizatave joqeveritare aktive në fushën e trashëgimisë kulturore, e njohur si EUROPA NOSTRA. Ndër arsyetimet për përzgjedhjen e Manastirit të Deçanit për përfshirje në këtë listë ishte rruga rajonale e planifikuar, që lidh komunat e Deçanit në Kosovë dhe Plavës në Mal të Zi, e cila do ta përshkojë këtë zonë nën mbrojtje të posaçme dhe do të kalonte pranë portave të manastirit, në kundërshtim me legjisllacionin për ZMV-të si edhe aktgjykimin e vitit 2016 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës që konfirmon se prona prej 24 hektarësh tokë përreth i përket Manastirit të Deçanit.

Prizreni ka gjithashtu një numër kishash dhe manastiresh mesjetare, përfshirë këtu objektin e trashëgimisë botërore "Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë të Ljevishës". Përveç lokaliteteve me status ZMV ose të regjistruara në UNESCO, shumë kisha dhe manastire me rëndësi lokale kontribuojnë në karakterin specifik të qyteteve dhe peizazheve. Memoriali i Gazimestanit (në Obiliq, gjithashtu një ZMV) shënon një betejë të rëndësishme për komunitetin.

Në periudhën 2019-2023 janë raportuar disa incidente sigurie të lidhura me trashëgiminë kulturore dhe fetare, përfshirë këtu edhe vjedhje, plaçkitje dhe grabitje në kishat ortodokse serbe. Ka ndodhur një kërcënim ndaj një prifti ortodoks serb dhe një rast ngacmimi ndaj murgeshave. Ka pasur edhe incidente me mbishkrime dhe dëmtime të pronës. Në vitet 2019, 2020 dhe 2021 janë evidentuar raste të zjarrvënies, zjarrit, vandalizimit dhe përdhosjes të varrezave. Në vitin 2023, dy **serbë të Kosovës** u plagosën në vigjilje të Krishtlindjeve Ortodokse.¹³³

OSBE ka evidentuar një sërë incidentesh në vitet e mëparshme. Për shembull, në rajonin e Gjilanit kanë ndodhur incidente me mbishkrime provokuese, thyerje dhe vjedhje cak i të cilave kanë qenë kishat ortodokse serbe.¹³⁴ Ngjashëm, në rajonin e Pejës, incidentet e evidentuara ndaj objekteve fetare ortodokse serbe varionin nga vjedhje me thyerje, sulme dhe kërcënime verbale e deri te mbishkrimet provokuese.¹³⁵ Vlen të ceket se, me mbështetjen e Misionit të OSBE-së, disa komuna kanë reaguar ndaj disa incidenteve të raportuara duke i diskutuar ato në forumet komunale të sigurisë ose duke i dënuar publikisht. Misioni vazhdon të avokojë për dënimin e incidenteve të sigurisë.

Në rajonin e Prishtinës janë raportuar incidente të përsëritura të sigurisë në varrezat ortodokse në Lipjan, që kanë rezultuar në përdhosje të varreve dhe mungesë të përgjithshme të sigurisë së komunitetit. Pas avokimit të OSBE-së, në shkurt të vitit 2020 janë instaluar kamera vëzhguese që janë të lidhura me Policinë e Kosovës dhe, që atëherë, nuk është raportuar më asnjë incident.

Incidentet e sigurisë që prekin kishat ortodokse serbe në rajonin e Mitrovicës janë kualifikuar kryesisht si "vjedhje të rënda". Meqenëse shumica e kishave ortodokse serbe në fjalë nuk kishin kamera vëzhguese, ishte e vështirë të identifikoheshin të dyshuarit, dhe për këtë arsye, rastet mbetën nën hetime. Në fund të vitit 2020 u raportua për mbishkrime fyese në rrënojat e kishës lokale ortodokse serbe në fshatin Syrganë të komunës së Skenderajt.¹³⁶

¹³³ Në janar 2023, në fshatin Gotovushë të komunës së Shtërpocës, dy serbë të Kosovës (një fëmijë 11-vjeçar dhe një burrë 21-vjeçar), u plagosën me armë zjarri, sipas raportimeve nga një pjesëtar shqiptar i Kosovës i Forcës së Sigurisë së Kosovës,

¹³⁴ Në shkurt të vitit 2017, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i Gjilanit mbajti një mbledhje të jashtëzakonshme dhe i dënoi ashpër mbishkrimet fyese antiserbe në ndërtesat që rrethojnë kishën ortodokse serbe në qytetin e Gjilanit.

¹³⁵ Në maj të vitit 2018, një grup protestuesish shqiptarë të Kosovës ndërpreu një ceremoni fetare të organizuar nga KOS-i dhe serbë të Kosovës të zhvendosur në oborrin e kishës së shkatërruar të Trinisë së Shenjtë në Poterq të Ulët të Klinës duke hedhur gurë. Në 2014 dhe 2018, një murg i Manastirit të Deçanit dhe një prift i KOS-it në fshatin Osojan të Istogut u kërcënuan nga grupe të shqiptarëve të Kosovës. Në 2021 dhe 2022, persona të panjohur hodhën gurë drejt Kishës së Prejës së Kokës së Shën Gjoni Pagëzuesit në qytetin e Pejës dhe Kishës së Shën Pjetrit dhe Shën Palit në qytetin e Istogut.

¹³⁶ Në vitin 2019, kishat ortodokse serbe në komunën e Vushtrrisë ishin cak i disa vjedhjeve dhe plaçkitjeve. Në dhjetor të vitit 2020, Policia e Kosovës njoftoi se persona të panjohur kishin hequr dy tabela informuese ku ishte shkruar "Kisha jonë" dhe "Qyteti i Kalasë", e cila është në listën e objekteve të trashëgimisë kulturore. Në dhjetor të vitit 2020, banorët serbë të Kosovës në Syrganë raportuan se në rrënojat e kishës ortodokse serbe të atyshme ishte vendosur një tabelë udhëzuese me tekstin "Kisha Jonë" në shqip dhe "Kisha jonë" në anglisht. Në shkurt të vitit 2023, një roje serbe e Kosovës në shkollën fillore "21 Nëntori", që zhvillon mësimin sipas planprogramit të Serbisë, në fshatin e përzier etnikisht Gojbulë, është sulmuar nga një grup të rinjsh shqiptarë të

Në rajonin e Prizrenit janë raportuar disa incidente të sigurisë që si çak kanë pasur objektet fetare. Këto varionin nga sulmet verbale deri te përdhosja, hedhja e gurëve, vjedhjet dhe plaçkitjet.¹³⁷

Kosovës në oborin e shkollës. Mësohet se të rinjtë kishin nxjerrë dru nga depoja e shkollës dhe kishin ndezur zjarr në oborin e shkollës, kishin shkruar disa mbishkrime në murin e shkollës dhe në rrethana të paqarta e kanë sulmuar rojen.

¹³⁷ Në maj të vitit 2018, u përdhosën katër gurë varresh në varrezat ortodokse serbe të Rahovecit. Në gusht të vitit 2018, në rrugën Prizren–Prishtinë, u sulmua me gurë automjeti i priftit ortodoks serb nga Prizreni. Në maj të vitit 2019, u vjedhur dera e hyrjes së oborrit të kishës ortodokse serbe në fshatin Serbicë e Ulët të Prizrenit. Në shkurt të vitit 2020, u regjistruan raste të hyrjes me forcë në kishat ortodokse serbe në fshatrat Gornjasellë dhe Novak të Prizrenit. Në korrik të vitit 2020 u dëmtuar dryni i kishës ortodokse serbe në Novak.

10. Të drejtat pronësore

Në rajonet e Gjilanit, Prishtinës, Pejës dhe Prizrenit, komuniteti serb i Kosovës përballët me sfida ndjeshëm më të mëdha se komunitetet e tjera joshumicë që jetojnë në Kosovë, të tilla si ndërhyrja në pronën private, shpronësimi, qasja e kufizuar në banim, uzurpimi i kundërligjshëm i pronës,¹³⁸ mosregjistrimi i titujve të pronësisë dhe shitblerje të pronës me qëllim mashtrimi.

Në periudhën 2021-2023, në rajonin e Mitrovicës, Pejës dhe Gjilanit, gjashtë prona të komunitetit **serb të Kosovës** ishin objekt i uzurpimit të kundërligjshëm. Krahas kësaj, në periudhën 2022-2024, në rajonin e Gjilanit, Pejës dhe Mitrovicës, 251 prona (parcela) të komunitetit **serb të Kosovës** ishin objekt i shpronësimit nga institucionet.

Në rajonin e Gjilanit, në vitin 2019, tre pronarë **serbë të Kosovës** u përballën me probleme pasi komuna e Gjilanit filloi me ndërtimin e rrugëve në tokën e tyre bujqësore pa e iniciuar procesin e shpronësimit dhe pa u konsultuar me pronarët e pronave. Si kundërpërgjigje, pronarët parashtruan padi në Gjykatën Themelore në Gjilan, mirëpo gjykata konstatoi se padia ishte e paqartë dhe e hodhi poshtë ankesën. Po të njëjtin vit, në komunën e Parteshit, Ministria e Infrastrukturës filloi me ndërtimin e një rruge rajonale që prekte 98 prona në pronësi të pjesëtarëve të komunitetit **serb të Kosovës**, pa e iniciuar procesin e shpronësimit dhe pa lejen apo dijeninë e pronarëve. Punimet u ndërpre në pas reagimit të komunës së Parteshit.

Nga shpronësimi janë prekur edhe pjesëtarët e komunitetit në komunën e Novobërdës. Pronarët **serbë të Kosovës** i kanë kontestuar vendimet për kompensim për pronën e shpronësuar (për shembull, gjatë janarit 2020, Dega e Gjykatës në Novobërdë pranoi 102 kërkesëpadi nga pronarë **serbë të Kosovës** kundër vendimeve për kompensim të shpronësimeve të pronave). Për më tepër, ata kishin ankesa për gjuhën në të cilën ishin bërë njoftimet.

Në anën tjetër, komuna e Shtërpçës ka ndërtuar katër blloqe banesash kolektive para disa viteve për t'i plotësuar nevojat për banim social të komunitetit **serb të Kosovës**, mirëpo këto banesa nuk janë ndarë akoma për shkak të kërkesës nga Agjencia Kosovare e Privatizimit drejtuar komunës për rikthimin në pronësi të tokës ku janë ndërtuar banesat.

¹³⁸ OSBE, *Mekanizmi i shqyrtimit të kërkesave në masë për të drejtat pronësore: Përvoja e Kosovës (2020) dhe OSBE, Shqyrtim i rasteve të uzurpimit të kundërligjshëm në Kosovë (2015).*

Në vitin 2019, në rajonin e Prishtinës, komuna e Graçanicës ka iniciuar ndërtimin e 36 banesave në fshatin Llapnasellë për familjet në nevojë dhe çiftet e reja të martuara. Deri në fund të vitit, pjesëtarëve të komunitetit serb dhe rom të Kosovës iu ndanë 24 banesa.

Gjatë vitit 2022, nëntë familje serbe në nivel vendi u pajisën me certifikata të legalizimit, duke i formalizuar kështu titujt e tyre të pronës përmes regjistrimit në regjistrin kadastral.

Megjithatë, komuniteti **serb i Kosovës** vazhdon të përballet me sfida në rajonin e Pejës dhe Prizrenit për sa i përket qasjes dhe gëzimit të lirë të të drejtave pronësore, ku pronat e tyre janë objekt i rasteve të uzurpimit të kundërligjshëm dhe shitblerjeve të pronës me qëllim mashtrimi. Pengesë shtesë për qasje dhe shfrytëzim të papenguar të pronës për pjesëtarët e këtij komuniteti janë kohëzgjatja dhe zvarritja e procedurave gjyqësore në rastet e uzurpimit të kundërligjshëm. Ndër ta, rasti më i spikatur është nga rajoni i Pejës, për të cilin Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë aktgjykim në vitin 2016 ku konstaton se të drejtat pronësore të Manastirit të *Deçanit* në 24 hektarë tokë duhet të regjistrohen në regjistrin kadastral.¹³⁹ Në mars të vitit 2024 (jashtë periudhës për të cilën raportohet), Agjencia Kadastrale e Kosovës e regjistroi tokën në emër të Manastirit të *Deçanit*.

¹³⁹ Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese nr. K1132/15, 20 maj 2016. https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/K1132_15_ANG.pdf (qasur në dhjetor 2023).

11. Kthimi dhe riintegrimi

Sipas Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), mbi 12,000 serbë të Kosovës janë kthyer vullnetarisht në Kosovë që nga viti 2000.¹⁴⁰ Në periudhën 2010-2023, në Kosovë janë kthyer 4,369 serbë të Kosovës, rreth 49 për qind syresh gra.¹⁴¹

Në përgjithësi, **Serbët e Kosovës** kanë pasur një numër më të madh të të kthyerve sesa komunitetet tjera, ndonëse ky numër ka rënë me kalimin e kohës.¹⁴² Të zhvendosurit **serbë të Kosovës** janë kthyer në të gjitha rajonet e Kosovës, megjithatë, në periudhën 2015-2023, shumica e kthimeve kanë ndodhur në rajonin e Gjilanit, pasuar nga rajoni i Prishtinës, Pejës dhe Prizrenit.¹⁴³

Gjithsej 164 familje **serbe të Kosovës**, ose 365 persona, jetojnë në qendra kolektive.¹⁴⁴ Akoma ekzistojnë disa qendra kolektive që strehojnë personat e zhvendosur nga radhët e komunitetit **serb të Kosovës**. Ato ndodhen në Mitrovicë Veriore (16 familje), Leposaviq (21 familje), Zubin Potok (gjashtë familje) dhe Zveçan (gjashtë familje).¹⁴⁵ Shumë familje që jetojnë në qendrat kolektive konsiderohen të cenueshme dhe varen nga ndihma e Komisarariatit të Serbisë për Refugjatët dhe projekteve të organizatave donatore, përfshirë këtu Programin e BE-së për kthim dhe riintegrim në Kosovë dhe Këshillin Danez për Refugjatët.

Përkundër masave përkatëse ligjore dhe të politikave, serbët e kthyer përballen me sfida të mëdha në ushtrimin e të drejtave të tyre pronësore. Riuzurpimi i kundërligjshëm i pronave dhe pengesat që pamundësojnë ndarjen e tokës për programe të ndihmës për banim i vështirësojnë përpjekjet për kthim të qëndrueshëm.

Brengë tjetër e përhapur në mesin e të kthyerve **serbë të Kosovës** janë rendi dhe siguria. Ndonëse shumica e incidenteve të sigurisë janë kryesisht vepra të lehta, ato vazhdojnë megjithatë të kenë ndikim negativ në perceptimin e sigurisë nga të kthyerit. Kjo vlen sidomos kur rastet e raportuara nuk zgjidhen, e autorët nuk identifikohen.

140 UNHCR, Zyra e Shefit të Misionit në Prishtinë, *Pasqyrë statistikore* (Prill 2023).

141 Po aty,

142 Numri i të kthyerve serbë të Kosovës: 895 (2010); 474 (2011); 375 (2012); 345 (2013); 398 (2014); 429 (2015); 299 (2016); 148 (2017); 133 (2018); 123 (2019); 238 (2020); 269 (2021); 155 (2022) dhe 87 (2023). Shih UNHCR, Zyra e Shefit të Misionit në Prishtinë, *Pasqyrë statistikore* (Prill 2023).

143 Rreth 783 të kthyer serbë të Kosovës në rajonin e Gjilanit; 349 në rajonin e Prishtinës, 231 në rajonin e Pejës; 76 në rajonin e Prizrenit dhe 23 në rajonin e Mitrovicës.

144 Qendrat kolektive janë ndërtesa dhe struktura paraekzistuese ku një grup personash të zhvendosur gjen strehë për një kohë të shkurtër, ndërkohë që shikohet për gjetjen e ndonjë zgjidhjeje afatgjatë. Në Kosovë si qendra kolektive shfrytëzohen lloj-lloj objektsh, siç janë qendrat komunitare, hotelet dhe ndërtesat e papërfunduara.

145 UNHCR, Zyra e Shefit të Misionit në Prishtinë, *Pasqyrë statistikore* (Prill 2023).

Ndër rastet e raportuara më së shpeshti janë dëmtimet e dyerve dhe dritareve, vjedhja e orendive shtëpiake dhe furnizimeve ushqimore. Me raste janë regjistruar edhe zjarrvënie, shkatërrim i puseve, rrethojave të oborreve dhe objekteve të tjera përreth shtëpive, kryesisht në komunat Klinë, Pejë dhe Istog.

Procesi i kthimit të **serbëve të Kosovës** shpesh has në rezistencë nga komunitetet pritëse, dinamikë kjo që nuk ka shënuar ndonjë përmirësim të dukshëm në vitet e fundit. Në disa komuna, komunitetet pritëse shprehin hapur kundërshtimin ndaj të kthyerve. Ngandongjëherë, komunitetet pritëse nuk janë të gatshme të ndërveprojnë me të kthyerit e mundshëm dhe, gjithashtu, kundërshtojnë organizimin e çfarëdolloj nisme për kthim, përfshirë këtu edhe vizitat "shko-dhe-shih"¹⁴⁶ ose "shko-dhe-informohu".¹⁴⁷ Krahas protestave publike, ka pasur edhe raste kur këshillat e fshatrave kanë bërë peticion kundër kthimit të **serbëve të Kosovës**, konkretisht në fshatin Reçak në komunën e Shtimes dhe në fshatin Lubozhdë në komunën e Istogut, ku 13 **serbë të Kosovës** u kthyen spontanisht.¹⁴⁸ Përkundër qëndrimit të favorshëm të autoriteteve komunale ndaj kthimit në komunat e Istogut, Prizrenit dhe Rahovecit, rezistenca publike ka ushtruar ndikim negativ në proces. Procesi i kthimit të **serbëve të Kosovës** në Mitrovicë Jugore¹⁴⁹ dhe Gjakovë është kthyer në objekt interesi politik dhe mediatik.¹⁵⁰

Gjithsej 20 komuna kanë realizuar vizita "shko-dhe-shih" dhe "shko-dhe-informohu", kryesisht nën udhëheqjen e organizatave ndërkombëtare.¹⁵¹ Veç kësaj, disa komuna janë angazhuar në fushata informimi e komunikimi, si dhe në vlerësimin e nevojave të të kthyerve.¹⁵²

Përkundër mungesës së aktiviteteve të evidentuara të kthimit në komunën e Gjilanit ndërmjet viteve 2020 dhe 2023, në dhjetor të vitit 2023, autoritetet komunale kanë pranuar kërkesa për ndihmë nga pesë familje **serbe të Kosovës**. Kërkesat për ndihmë ishin në pritje të vlerësimit, proces ky që u zvarrit shumë përtej afatit kohor të përcaktuar me rregulloren e Qeverisë së Kosovës 2018/01.¹⁵³ Përkundër dy përpjekjeve për të thirrur një mbledhje, komisioni komunal për kthim nuk arriti kuorum në të dyja rastet dhe, si rrjedhim, ishte e pamundur të iniciohej mbledhja shqyrtuese.¹⁵⁴

146 Vizitat shko-dhe-shih u mundësojnë personave të zhvendosur të marrin informata të dorës së parë për kushtet në vendin e tyre të origjinës dhe për të komunikuar e ndërvepruar drejtpërdrejt me komunitetin pritës në mënyrë që të marrin vendim të informuar në lidhje me kthimin ose zgjidhje të tjera të qëndrueshme.

147 Talinoc i Muhaxherëve (Komuna e Ferizajt); Shtupel (Komuna e Klinës); Korishë (Komuna e Prizrenit); Optrushë (Komuna e Rahovecit); Lubozhdë (Komuna e Istogut). Shih raportin e OSBE-së *Vlerësim i kthimit vullnetar në Kosovë*, dhjetor 2014, gjendet tek: <https://www.osce.org/kosovo/129321>, qasur më 5 maj 2020.

148 OSBE, *Vlerësim i kthimit vullnetar në Kosovë*(2019), f.27.

149 Përveç Mitrovicës Jugore, janë evidentuar edhe këto lokacione ku kthimi është i vështirë: Vërnice (Komuna e Vushtrrisë), Kroi Vitakut (Komuna e Mitrovicës Veriore), si dhe fshatrat Runik e Kuqicë (Komuna e Skenderajt). Shih raportin e OSBE-së *Vlerësim i procesit të kthimit vullnetar në Kosovë* (2012), (qasur më 1 shtator 2022).

150 Për shembull, kthimi i znj. Dragica Gashiq në qershor të vitit 2021 në komunën e Gjakovës.

151 Ferizaj, Gjilan, Kamenicë, Kllokot, Novobërdë, Partesh, Ranillug, Shtërpçë, Viti, Mitrovicë Jugore, Mitrovicë Veriore, Skenderaj, Vushtrri, Deçan, Istog, Klinë, Pejë, Fushë Kosovë, Lipjan, Obiliq.

152 Gjithsej 149 aktivitete informimi janë realizuar në rajonet e Gjilanit dhe Prishtinës.

153 Rregullorja e Qeverisë së Kosovës për kthimin dhe zgjidhjet e qëndrueshme, **REGULLORE (QRK) - NR. 01/2018 PËR KTHIMIN E PERSONAVE TË ZHVENDOSUR DHE ZGJIDHJE TË QËNDRUESHME** (rks-gov.net), miratuar në janar 2018. (qasur në dhjetor 2023).

154 Komisioni Komunal për Kthim në Kosovë ka rol vendimtar në adresimin e nevojave të ndryshme duke shqyrtuar kërkesat për strehim, mbështetje sociale dhe artikuj elementarë. Ai përpilon rekomandime bazuar në nevojat e vlerësuara dhe të njëjtat përcjell ato Komisionit Qendror Shqyrtues të nivelit më të lartë që drejtohet nga Ministria për Komunitete dhe Kthim.

Pesë familjet kishin shprehur interesim për t'u kthyer në komunën e Gjilanit përmes UNHCR-it në mes të vitit 2023. Ngjashëm, vonesa pati dhe me një kërkesë për kthim në komunën e Skenderajt, fshati Bajë, të paraqitur nga një grua **serbe e Kosovës** në vitin 2023.

Deri në dhjetor të vitit 2023, komuna e Obiliqit kishte pranuar gjithsej 310 kërkesa për kthim. Prej tyre, 150 janë regjistruar zyrtarisht në bazën e të dhënave të MKK-së, ndërsa 160 lëndët tjera nuk kanë mundur të procedohen për shkak të mungesës së dokumentacionit të kërkuar. Lëshimi i lejeve të ndërtimit përcillet me pengesa administrative, që krijojnë vështirësi për personat që dëshirojnë të kthehen në Obiliq. Sfidë tjetër e dukshme është numri i madh i kërkesave të pranuar krahasuar me hapësirën e pamjaftueshme të ndarë për ndërtim të shtëpive, sidomos në fshatin Plemetin.

Në komunat e Prizrenit, Rahovecit dhe Suharekës, sfidë kryesore ndaj kthimit të qëndrueshëm është mungesa e mundësive të punësimit. Pengesë tjetër është periudha e stërzgatur e zhvendosjes, më se 20 vjeçare, bashkë me shqetësimet e sigurisë. Disponueshmëria e kufizuar e shërbimeve themelore të tilla si arsimit i lartë dhe ndihma shëndetësore dhe sociale paraqet barrierë shtesë.

Në komunat e Prizrenit, Rahovecit dhe Suharekës, ata që janë zhvendosur për një periudhë të gjatë tashmë kanë krijuar stabilitet në vendndodhjet e tyre aktuale, duke fituar qasje në banim dhe punësim, gjë që ka rezultuar në ngurrim të shumë syresh për t'u kthyer. Në komunën e Prizrenit, personat e zhvendosur të cilët nuk kanë pronë në pronësi të tyre përballen me sfida në kuptim të qasjes në zgjidhje të qëndrueshme të banimit, ngaqë u mungojnë mjetet financiare për të blerë pronë dhe për të marrë ndihmë për ndërtimin ose rinovimin e shtëpive. Këto situata nxjerrin në pah sfidat e hasura gjatë procesit të lehtësimit të kthimit dhe nënvizojnë nevojën për bashkërendim efektiv ndërmjet autoriteteve lokale për të siguruar procese transparente dhe pa vonesë për të kthyerit e mundshëm.

Zgjidhjet për strehim për të kthyerit **serbë të Kosovës** ofrohen kryesisht përmes donatorëve. Projekti i BE-së për kthim dhe riintegrim në Kosovë është i rëndësishëm në fushën e kthimit dhe riintegrimin. Ai financohet nga BE, bashkëfinancohet nga MKK dhe zbatohet nga IOM në Kosovë. Projekti synon të rrisë kapacitetet e institucioneve qeveritare e komunale, si dhe të akterëve joqeveritarë, për të lehtësuar kthimin dhe riintegrimin dinjitoz, të qëndrueshëm të deri 400 familjeve të zhvendosura në vendet e rajonit.¹⁵⁵ Deri në fund të vitit 2020, 11 komuna¹⁵⁶ ishin angazhuar në fazën e fundit të projektit të BE-së për kthim dhe riintegrim në Kosovë, kurse njëzet sosh¹⁵⁷ nuk ishin të angazhuara në asnjë nga projektet mbështetëse. Projekti korri rezultate të konsiderueshme për të kthyerit **serbë të Kosovës**, me rreth 700 njësi banimi të ndërtuara ose rindërtuara, dhe 640 persona të mbështetur me projekte të gjenerimit të të ardhurave. Programi i BE-së për kthim dhe riintegrim në Kosovë është angazhuar po ashtu dhe në projekte të shkallës së vogël që synojnë adresimin dhe

¹⁵⁵ IOM, Projekti i BE për kthim dhe riintegrim në Kosovë, faza V, fletë faktesh (2021).

¹⁵⁶ Novobërdë, Shtërpcë, Gjakovë, Istog, Klinë, Pejë, Fushë Kosovë, Graçanicë, Obiliq, Prizren dhe Rahovec.

¹⁵⁷ Ferizaj, Hani i Elezit, Kaçanik, Killokot, Partesh, Ranillug, Viti, Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri, Glllogoc, Podujevë, Mitrovicë Veriore, Deçan, Pejë, Lipjan, Prishtinë, Shtime, Malishevë dhe Mamushë.

përmirësimin e nevojave infrastrukturore si të të kthyerve ashtu edhe të komunitetit pritës.

Më tej, Projekti i BE-së për stabilizim të komuniteteve III, i zbatuar nga IOM, lehtëson qasjen e komuniteteve në mundësi ekonomike dhe mundëson krijimin e një jetese të qëndrueshme.¹⁵⁸ Projekti "Mbështetje zgjidhjeve të qëndrueshme për banorët e qendrave kolektive në Kosovë" është bashkëfinancuar nga MKK-ja dhe zbatuar nga Këshilli Danez për Refugjatë dhe ka synuar gjetjen e zgjidhjeve për banim, përmirësimin e kushteve socio-ekonomike dhe të kapacitetit të komunës së Shtërpcës për të ofruar kushte adekuate për një integrim të suksesshëm të personave të zhvendosur **serb të Kosovës** dhe familjeve të cënueshme që banojnë në qendrat kolektive.¹⁵⁹

Disa projekte tjera mbështetëse janë realizuar nga Këshilli Danez për Refugjatët, CSSP, Byroja Amerikane e Popullsisë, Refugjatëve dhe Migracionit, Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve (VoRAE), si edhe UNHCR.

Këshilli Danez për Refugjatë ka zbatuar projektin "Riintegrimi dhe stabilizimi i komuniteteve në Kosovë", me financim nga Byroja për Popullsi, Refugjatë dhe Migrim e SHBA-së. Projekti kishte në fokus ndihmën për kthimet përmes financimit të riparimeve të vogla të strehimoreve, harmonizimit të paketave të ndihmës dhe granteve për gjenerimin e të ardhurave, krijimin e mundësive për të kthyerit përmes nismave për stabilizimin ekonomik, si dhe ndihmën për kthim të qëndrueshëm duke rritur qasjen e të kthyerve në shërbimet themelore.¹⁶⁰

Projekti "Lugina e Diellit", në kuadër të të cilit parashihet të ndërtohen 225-300 njësi banesore në komunën e Zveçanit, ka filluar ndërtimet në mes të vitit 2018.¹⁶¹ Në qershor të vitit 2019, qeveria e Serbisë nxori një thirrje të hapur për akomodim të qiramarrësve të parë dhe prioritet u dha personave të zhvendosur në Serbi dhe Mal të Zi.¹⁶²

Në vitin 2023, Ministria për Komunitete dhe Kthim bëri një hap të rëndësishëm duke nxjerrë një thirrje për ofrim të ndihmës së nevojshme për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë.¹⁶³ Nisma mëtonte që të trajtonte nevoja të ndryshme, përfshirë këtu sigurimin e artikujve ushqimorë dhe joushqimorë, si dhe mbështetjen për ndërtimin dhe rindërtimin e shtëpive. Për më tepër, Ministria e zgjeroi fushëveprimin e ndihmës së saj për ta përforcuar sektorin e bujqësisë, duke ofruar subvencione për t'i lehtësuar praktikën e qëndrueshme bujqësore. Njëkohësisht, pati përpjekje për mbështetjen e bizneseve të vogla të këtyre komuniteteve.

¹⁵⁸ Projekti i BE për stabilizim të komuniteteve (<http://kosovo.iom.int/eu-community-stabilization-programme-iii>. (qasur në 2023).

¹⁵⁹ Këshilli Danez për Refugjatë, Projekti "Mbështetje zgjidhjeve të qëndrueshme për banorët e qendrave kolektive në Kosovë"; <http://drc-kosovo.org/supporting-durable-solutions-for-collective-centre-residents-in-kosovo-1>. (qasur në dhjetor 2023).

¹⁶⁰ Po aty.

¹⁶¹ Projekti "Lugina e Diellit", i financuar nga Beogradi, <https://www.youtube.com/watch?v=PNd03F4nTUc>, (qasur në dhjetor 2023).

¹⁶² Thirrje e hapur e publikuar në median Jedinstvo, qershor 2019, <https://jedinstvo.rs/javni-poziv-za-dodelu-stanova-za-socijalno-stanovanje-u-naselju-suncana-dolina-u-zvecanu/> (Qasur në dhjetor 2023).

¹⁶³ Vendim për përcaktimin e procedurave për ofrimin e ndihmës nga Ministria për Komunitete dhe Kthim për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë për të cilët ndihma është e nevojshme, miratuar më 2 shkurt 2023: Vendim i procedurave për ofrimin e ndihmës-Odlika o proceduri pruzenja pomoci_compressed_compressed-compressed (1).pdf (rks-gov.net), (qasur në dhjetor të vitit 2023).


Ndikimi i këtyre përpjekjeve ishte i prekshëm, meqë Ministria i mbështeti me sukses 218 familje **serbe të Kosovës** duke u ofruar atyre artikuj të rëndësishëm ushqimorë e joushqimorë, përfshirë material ndërtimor. Vlen të përmendet se kjo nismë rezultoi në ndërtimin e 26 shtëpive, prej tyre dhjetë në Istog, nëntë në Graçanicë, nga dy në Klinë, Ranillug e Prizren dhe një në Shtërpçë, si dhe rindërtimin e një shtëpie në Istog. Ndër nismat me ndikim të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim ishte edhe ofrimi i mbështetjes substanciale në vlerë prej 1,102,329 eurosh për katër familje. Kjo ndihmë financiare ishte e orientuar në nxitjen e sektorit të bujqësisë ose mbështetjen e bizneseve të vogla. Më konkretisht, nga kjo nismë përfituan 121 familje.¹⁶⁴

¹⁶⁴ Gjashtëdhjetë e katër familje në Graçanicë, 15 në Shtërpçë, nëntë në Leposaviq, shtatë në Kllokot, gjashtë në Ranillug, pesë në Kamenicë, tri në Lipjan, nga dy në Obiliq, Zubin Potok dhe Zveçan, dhe nga një në Novobërdë, Partesh, Prizren, Vushtrri, Mitrovicë Veriore dhe Prishtinë. Të dhënat i janë dhënë Misionit të OSBE-së në Kosovë nga Ministria për Komunitete dhe Kthim më 6 shkurt 2024.



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Photo Credit: Arben Llapashitica



Profili i komunitetit

turk të Kosovës

osbe

Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Profili i komunitetit turk të Kosovës

Komuniteti turk radhitet i katërti për nga madhësia në Kosovë. Ndryshe nga komunitetet tjera joshumicë, komuniteti turk ka shënuar rritje të popullsisë pas shpërbërjes së Jugosllavisë, dhe ka vazhduar të rritet pas konfliktit të vitit 1999.¹ Në regjistrimin e popullsisë të vitit 1981 numri i turqve në Kosovë ishte 12,513 (0.8 për qind e popullsisë),² ndërkaq sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 është vlerësuar se komuniteti turk përbën rreth 1.02 për qind të popullsisë.³

Shumica e turqve të Kosovës jetojnë në pjesën jugperëndimore të vendit, gjegjësisht në komunat e Prizrenit dhe të Mamushës.⁴ Në Prishtinë, numri i vlerësuar i popullsisë turke që jeton në kryeqytet, pa i llogaritur fshatrat apo qytetet përreth, është rreth 2000. Përqendrimi më i madh i turqve është në Prizren, ku ata përbëjnë rreth 5.06 për qind të popullsisë së komunës. Në komunën e Mamushës, që është shumë më e vogël për nga madhësia, turqit e Kosovës përbëjnë komunitet shumicë me afërsisht 92.35 për qind të popullsisë së komunës.⁵ Një numër më i vogël i pjesëtarëve të komunitetit turk të Kosovës banojnë në komunat tjera. Në Gjakovë jetojnë 16 turq të Kosovës, ndërkaq 59 jetojnë në Pejë. Në Mitrovicën Jugore jetojnë 100 familje me gjithsej 450 pjesëtarë, gjersa në Mitrovicën Veriore jetojnë 15 familje me 50 gjithsej pjesëtarë, e në Vushtrri jetojnë 50 familje me 290 pjesëtarë. Sipas raporteve të OSBE-së, 1187 turq të Kosovës jetojnë në komunën e Gjilanit, prej të cilëve 987 banojnë në qytetin e Gjilanit dhe afërsisht 200 në fshatin Dobërçan.⁶

1 Komuniteti turk i Kosovës është i katërti në Kosovë për nga madhësia, pas komunitetit shqiptar, serb dhe atij boshnjak të Kosovës.

2 Raporti i OSBE-së i vitit 2018 "Profilet e Komunave", (janar 2019).

3 Agjencia e Statistikave të Kosovës, statistikat e regjistrimit të popullsisë së Kosovës në vitin 2011.

4 Pesëmijë në Mamushë dhe 7,500-9,000 në Prizren.

5 OSBE, *Profili i komunës së Prizrenit 2018* (janar 2019).

6 Nënkrjetari i komunës për komunitete; zyra e gjendjes civile në fshatin Dobërçan dhe enti rajonal i punësimi.

Faktet dhe çështjet kryesore:

- Siguria e përgjithshme e komunitetit turk të Kosovës konsiderohet të jetë e kënaqshme.
- Komuniteti turk i Kosovës përfaqësohet nga një ministër në qeveri dhe dy përfaqësues në Kuvend.
- Komuniteti është relativisht mirë i përfaqësuar në shërbimin civil në të dyja nivelet, si në qeveri ashtu dhe në nivel komunal, si edhe në organe e institucione të ndryshme komunale.
- Një numër i konsiderueshëm i grave turke të Kosovës janë të angazhuara në ekonominë joformale, sidomos në bujqësinë familjare.
- Në përgjithësi, komuniteti turk i Kosovës nuk ballafaqohet me ndonjë problem për sa i përket qasjes në shërbimet sociale dhe shëndetësore.
- Gjuhë amtare e komunitetit turk të Kosovës është turqishtja. Pjesëtarët e komunitetit e përdorin gjuhën e tyre amtare në hapësira publike. Nuk është e pazakontë që komunitetet e tjera ta flasin, ose të paktën ta kuptojnë, turqishten si gjuhë të dytë a të tretë.
- Turqishtja është gjuhë zyrtare në komunat e Prizrenit dhe të Mamushës. Ajo e ka statusin e "gjuhës në përdorim zyrtar" në komunat e Prishtinës, Gjilanit, Mitrovicës Jugore dhe Vushtrrisë.
- Qasja në dokumente dhe shërbime në gjuhën turke mbetet problematike në komunat ku kjo gjuhë është në përdorim zyrtar.
- Arsimi në gjuhën turke është në dispozicion për nxënësit dhe studentët turq të Kosovës.
- Mungesa dhe cilësia e dobët e teksteve shkollore në gjuhën turke, veçanërisht për arsimin e mesëm të lartë, vazhdon të përbëjë sfidë.

1. Siguria dhe rendi

Siguria e komunitetit turk të Kosovës është përgjithësisht e mirë.⁷ Herë pas here, komuniteti ka qenë cak i vjedhjeve, plaçkitjeve dhe mesazheve të urrejtjes, incidente këto që zakonisht ndodhin në rajonin e Prizrenit ku dhe banojnë shumica e pjesëtarëve të këtij komuniteti.

Ndër to vlen të ceket heqja ose dëmtimi i përsëritur i flamujve turq të shfaqur në publik në vigjilje të festave të caktuara.⁸ Ndonëse incidentet e këtilla shënjestrojnë kryesisht qeverinë turke, ato mund të kenë ndikim negativ në perceptimin e turqve për sigurinë. Incidente që në shënjestër kanë pasur shtetin turk dhe bizneset e shtetasve turq kanë ndodhur edhe jashtë rajonit të Prizrenit.⁹

Në vitin 2018 dhe 2019, disa media dhe gazetarë lokalë patën reaguar negativisht ndaj një imami turk i cili kishte predikuar në gjuhën turke në një xhami në qendër të qytetit të Prizrenit.¹⁰

Në vitin 2023, Policia e Kosovës numëronte gjithsej 83 punonjës nga radhët e komunitetit **turk të Kosovës**, si pjesëtarë të uniformuar ashtu dhe personel civil (përfshirë këtu dhjetë gra).¹¹

Në radhët e Komiteteve Lokale të Sigurisë Publike (KLSP) nuk ka pjesëtarë të komunitetit **turk të Kosovës**.¹²

Në vitin 2017, UNDP financoi instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë në Mamushë. Kamera të tilla u instaluan edhe në tërë qytetin e Prizrenit, por nuk janë mirëmbajtur si duhet. Kamerat u instaluan për qëllime të përmirësimit të sigurisë së përgjithshme të të gjithë banorëve të Prizrenit dhe nuk kishin lidhshmëri me incidente që kanë shënjestruar këtë komunitet në veçanti.

7 Sipas monitorimit të brendshëm të OSBE-së, në vitin 2013 kanë ndodhur 17 incidente. 26 në 2014, një në 2015, nëntë në 2016, dhjetë në 2017, dhjetë në 2018, shtatë në 2019, tre në 2020, gjashtë në 2021, tre në 2022 dhe katër në 2023.

8 Në nëntor të vitit 2016 dhe në shkurt 2018, një grup të rinjsh shqiptarë të Kosovës e hoqën një flamur turk nga një shtyllë në qendër të qytetit të Prizrenit, e kanë incizuar aktin dhe e kanë shpërndanë atë në rrjetet sociale. Në nëntor të vitit 2016, pesë të rinj shqiptarë të Kosovës u arrestuan pasi kishin hedhur një koktej molotovi në konsullatën turke në qendër të Prizrenit, e cila ishte përruar në prill të atij viti. Në nëntor të vitit 2017, Gjykata Themelore në Prizren i dënoi që të pesë të pandehurit me nga një vit burg. Më 17 shkurt 2022, në Prizren, të dyshuar të paidentifikuar e hoqën një flamur turk të vendosur në një shtyllë elektrike nga ana e Kuvendit Komunal të Prizrenit për nder të festës së Ditës së Pavarësisë dhe të njëjtin e hodhur në lumin Lumbardh. Më pas, të dyshuarit u identifikuan si katër të mitur dhe një person i moshës madhore.

9 Në gusht të vitit 2018, në Gjakovë, dy shqiptarë të Kosovës e postuan në rrjetet sociale një videoicizim duke djegur flamurin turk. Në gusht të vitit 2018, persona të panjohur e hoqën logon e një kompanie sponsoruese turke nga tendat në një panair në Prishtinë. Në po të njëjtën ngjarje ka pasur edhe mesazhe vandalizuese në pavijone. Dy ditë më vonë, persona të panjohur tentuan ta digjinin pavijonin e organizatorit turk të panairit të prodhimeve artizanale (TIKA) dhe e dëmtuan panonë në hyrje. Po të njëjtën ditë, të dyshuar të panjohur vendosën pamflete me përmbajtje antiturke në rrethojën e Byrosë Turke të Tregtisë ku shkruhej "me shpatë, heshtë dhe mburojë, me laps e drejtësi, gjithmonë rezistencë antiosmane, poshtë neo-otomanizmi".

10 Imami në xhaminë e Sinan Pashës është kritikuar se nuk ka predikuar në gjuhën shqipe. Ngjashëm, disa media lokale e kanë dënuar një imam turk të Kosovës në Prizren, i cili është lutur për ushtarët turq në Siri, duke nxitur kështu ndjenja antiturke. Në prill të vitit 2019, përfaqësuesit lokalë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) kanë reaguar publikisht ndaj një pankarte të shfaqur në Prizren, ku gjuha turke përdorej para gjuhës shqipe.

11 Deri në vitin 2023, pjesëtarët e komunitetit turk të Kosovës të punësuar në Policinë e Kosovës numëronin sa vijon: 25 në Prizren, 12 në Gjilan, pesë në Mamushë, katër në Prishtinë, dy në Mitrovicën Jugore, dhe dy në Mitrovicën Veriore.

12 Në nëntor 2023.

2. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi

Komuniteti turk i Kosovës ka qenë i përfaqësuar nga një ministër në qeverinë e vitit 2021: ministri i Zhvillimit Rajonal, Fikrim Damka, turk i Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike Turke të Kosovës (KDTP). Veç tij, një turk tjetër i Kosovës, Yildiray Bayram, ka qenë shef i kabinetit në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal.

Në qeverisjen e mëhershme, kjo ministri administrohej nga Enis Kervan (KDTP), njëherësh kryetar i partisë. Komuniteti ka qenë i përfaqësuar edhe nga dy zëvendësministra, zëvendësministri i Punëve të Brendshme Yildiray Bayram dhe zëvendësministri i Ekonomisë dhe Mjedisit Ergin Bunyak (që të dy nga radhët e KDTP-së).

Komuniteti turk i Kosovës i ka dy ulëse të garantuara në Kuvend, të cilat aktualisht i mbajnë Fidan Brina-Jilta dhe Enis Kervan (që të dy nga radhët e KDTP-së).

Aktualisht, në Kosovë ekzistojnë tri subjekte politike turke të Kosovës: KDTP, Partia Turke e Drejtësisë së Kosovës (KTAP) dhe Partia Turke e Lëvizjes Novatore (YTHP).

Komuniteti emëron tre përfaqësues në Këshillin Konsultativ për Komunitete (KKK) në kuadër të Zyrës së Presidentit. Në këtë mandat, komuniteti përfaqësohet nga dy burra dhe një grua.¹³ Veç kësaj, Sekretariati i KKK-së udhëhiqet nga një grua nga radhët e komunitetit turk (Nafiye Gaş). Një anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Müfera Srbica – Şinik, është turke e Kosovës, ashtu si edhe një anëtar i Bordit në Radio-Televizionin e Kosovës, Biroll Urcan.

Që nga viti 2017, turqit e Kosovës kanë shkallë të mirë përfaqësimi në shërbimin civil me 1.47 për qind të pozitave në shërbimin civil në nivel qeveritar. Ngjashëm, komuniteti është përgjithësisht i përfaqësuar mirë në shumicën e komunave ku banojnë turqit e Kosovës, me përjashtim të Prishtinës ku komuniteti nuk ka shkallë të mjaftueshme përfaqësimi në shërbimin civil.¹⁴

Komuniteti turk i Kosovës është ndër komunitetet e përfaqësuar më së dobëti në Komitetet për Komunitete (KK).¹⁵ Komuniteti është i përfaqësuar në tetë KK në mbarë Kosovën, me 12 anëtarë (pesë gra dhe shtatë burra) gjithsej.

¹³ Atakan Koro është kryesues i KKK-së dhe përfaqëson Shoqatën e Mjekëve Turq të Kosovës (Kosova Türk Hekimler Derneği - KTHD), ndërkaq Sevim Birvenik përfaqëson organizatën joqeveritare Shoqata Resim Salih KS (Resim Salih KS Derneği). Anëtari i tretë, Ibrahim Ömer, ka kandiduar si kandidat i pavarur.

¹⁴ OSBE, *Përfaqësimi i komuniteteve në shërbimin civil në Kosovë* (maj 2017).

¹⁵ Krahas komunitetit boshnjak të Kosovës.

Mirëpo, **turqit e Kosovës** nuk janë të përfaqësuar në KK-të e 20 komunave të tjera ku banojnë pjesëtarët e këtij komuniteti.¹⁶ Në Gjilan, Lipjan dhe Prizren, pozitën e kryesuesit të KK-së e mbajnë pjesëtarë të komunitetit **turk të Kosovës** (që të tre burra).

Në Gjilan, një **turk i Kosovës** është emëruar nënkryetar i komunës për komunitete, ndërsa në Prizren një pjesëtar i komunitetit mban pozitën e zëvendëskryesuesit të kuvendit komunal për komunitete (që të dy janë burra).

Gjithashtu, pesë pjesëtarë të komunitetit (tri gra dhe dy burra) janë të punësuar si nëpunës civilë në zyrat komunale për komunitete dhe kthim në Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë Jugore, Prizren dhe Vushtrri.

Pjesëtarët e komunitetit **turk të Kosovës** përfaqësohen aktualisht me shtatë pjesëtarë në Këshillat Komunalë për Sigurisë në Bashkësi (KKSB): Gjilan (një burrë), Mitrovicë Jugore (dy gra), Prishtinë (dy burra) dhe Prizren (dy burra). **Turqit e Kosovës** nuk janë të përfaqësuar në Dragash, Ferizaj dhe Pejë.

Përqendrimi më i madh i organizatave joqeveritare (OJQ) të shquara **turke të Kosovës** është në rajonin e Prizrenit.

Në komunën e Prizrenit janë nëntë OJQ aktive: "Genç Birlik Derneği" (Shoqata Unioni Rinor i Kosovës), "Türkiye Mezunları Derneği" (Shoqata e Studentëve të Diplomuar në Turqi), "Kosova Türk Yazarlar Birliği" (Shoqata e Shkrimtarëve **Turq të Kosovës**), "Esnaf" (Shoqata e Zejtarëve dhe Afaristëve të Prizrenit), "Çok Uluslu Kosova Derneği" (Shoqata Shumëkombëshe e Kosovës), "Doğru Yol" (Shoqatë kulturore në Prizren), "Tum Gencler El Ele" (Të Gjithë të Rinjtë Dorë për Dorë), "Balkan Turk Muziği Derneği" (Shoqata e Muzikës Turke Ballkanase) dhe Shoqata e Vëzhguesve të Rinj të Kosovës. "Aşıkferki", shoqatë kulturore-artistike që punon për zhvillimin kulturor dhe arsimor, dhe "Mamuşa Emekçi Kadınlar Derneği" (Shoqata e Pensionereve të Mamushës), e fokusuar kryesisht në fuqizimin ekonomik të grave, janë dy OJQ të rëndësishme aktive në Mamushë. Në rajonin e Gjilanit ekzistojnë tri OJQ të shquara **turke të Kosovës**: "Gilan", e cila kryesisht organizon kurse rrobaqepësie për gratë e të gjitha komuniteteve, "Halit Gaś" nga fshati Dobërçan, që merret kryesisht me aktivitete kulturore e humanitare, dhe "Yarin" (Nesër), që merret kryesisht me aktivitete kulturore e sportive. Në rajonin e Mitrovicës ekzistojnë gjithashtu tri OJQ të shquara: OJQ-ja kulturore dhe e vallëzimit "Birlik" (Uniteti) dhe OJQ-ja e grave **turke të Kosovës** "Dostluk Kadınları" (Gratë e Miqësisë), që të dyja nga Mitrovica Jugore, si dhe OJQ-ja kulturore dhe e vallëzimit "Çeşme" (Fontana) nga Vushtrria. Në Prishtinë ekziston një OJQ e shquar turke, "Gerçek" (E vërteta), e cila është themeluar në vitin 1950 si organizatë kulturore.

¹⁶ Tetë KK-të ku turqit e Kosovës janë të përfaqësuar përfshijnë Gjilanin, Lipjanin, Mamushën, Mitrovicën e Veriut, Mitrovicën e Jugut, Prishtinën, Prizrenin, Vushtrrinë. Komitetet për komunitete ku turqit e Kosovës nuk janë të përfaqësuar përfshijnë Dragashin, Ferizajn, Fushë Kosovën, Gjakovën, Glllogocin, Graçanicën, Istogun, Kaçanikun, Kamenicën, Klinën, Kllokotin, Novobërdën, Obiliqin, Pejën, Podujevën, Rahovecin, Shtimen, Skënderajin, Suharekën dhe Vitinë. Në mungesë të të dhënave zyrtare të regjistrimit të popullsisë për komunat veriore, vlerësimet e numrit të popullsisë për Leposaviqin, Mitrovicën Veriore, Zubin Potokun dhe Zveçanin janë të bazuara në vlerësimet e OSBE-së në "Profilet e komunave" të vitit 2018.

3. Punësimi dhe gjendja socio-ekonomike

Ashtu si gjitha komunitetet e tjera në Kosovë, edhe komuniteti turk i Kosovës përballlet me mundësi të kufizuara të punësimit dhe atyre ekonomike.

Megjithatë, për këtë komunitet, sfidat ekonomike janë më pak të shprehura se për komunitetet tjera në Kosovë. Ndonëse barriera gjuhësore paraqet me raste problem për të pasur qasje në mundësi, pjesëtarë të shumtë të këtij komuniteti udhëheqin me ndërmarrje private të suksesshme, e një numër i konsiderueshëm syresh janë të punësuar në sektorin publik.¹⁷

Në komunën e Prizrenit, 246 turq ishin të punësuar në sektorin publik. Prej tyre, 170 ishin nëpunës civilë, nga të cilët 112 ishin të punësuar në sektorin e arsimit, 32 në qendrën kryesore të mjekësisë familjare dhe 26 në drejtorinë e administratës. Pozitat në sektorin publik që pjesëtarët e komunitetit i mbanin rëndom ishin si nëpunës civil në drejtori të ndryshme, përfshirë edhe në pozita të larta si koordinator për arsimin në gjuhën turke, drejtor komunal për zhvillim ekonomik dhe ushtrues i detyrës së shefit të zyrës komunale për komunitete dhe kthim. Gjithashtu, në spitalin rajonal të Prizrenit ishin të punësuar 76 pjesëtarë të komunitetit, përfshirë këtu pesë mjekë, 64 infermierë, tre punonjës administrativë dhe katër punonjës të mbështetjes teknike. Në sektorin privat, pjesëtarët e komunitetit turk në Prizren kryesisht drejtojnë biznese private (import-eksport, tekstil, mobilieri, dyqane stolish). Për më tepër, komuniteti është i angazhuar në konsulenca private në fushën e financave dhe shërbimeve të TI-së. Disa ndërmarrje të mëdha prodhojnë orendi shtëpiake. Në vitin 2020, në komunën e Prizrenit ishin të regjistruar si të papunë 525 persona nga radhët e komuniteti **turk të Kosovës**.

Në komunën e Mamushës, sektori publik punëson afërsisht 10 për qind të pjesëtarëve të komunitetit. Disa pozita në sektorin publik janë të plotësuara nga punëtorë që jetojnë jashtë komunës, dhe atë kryesisht në Prizren.¹⁸ Në total, 135 nëpunës civilë ishin **turq të Kosovës**, përfshirë në sektorët e shëndetësisë dhe arsimit. Në këtë komunë, të gjithë drejtorët e drejtorive, zyrtarët e lartë, si dhe shefat e sektorëve (përveç shefit të financave) ishin pjesëtarë të komunitetit **turk të Kosovës**. Ekonomia është e përqendruar kryesisht në bujqësi dhe aktivitete tregtare në shkallë të vogël.¹⁹

17 Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë, *Profili i komunitetit: Komuniteti turk* (dhjetor 2013), f. 5. (Qasur në dhjetor 2023)

18 Komuna e Mamushës; Departamenti i Zhvillimit, Planifikimit, Urbanizmit, Gjeodezisë dhe Kadastrit, *Plani zhvillimor komunal i Mamushës, 2014–2023* (2014), f. 30. (Qasur në dhjetor 2023)

19 OSBE, *Profili i komunës së Mamushës* (2018).

Shumica e banorëve të komunës merren me bujqësi, sektor ky me 55 për qind të të punësuarve. Fermat familjare merren kryesisht me lavërtari, ndërkaq Mamusha është prodhues i madh i domateve në Kosovë. Gjithashtu, disa familje burim të të ardhurave kanë blegtorinë. Bizneset e vogla (afro 800 kompani private janë të regjistruara në këtë komunë) kontribuojnë me 29 për qind në shkallën e punësimit, dhe shumica syresh merren me tregti dhe shitjen e vajrave motorikë e pjesëve të automjeteve. Afërsisht 35 për qind e popullsisë në moshë pune ishte ekonomikisht aktive. Pjesa e mbetur prej 65 për qind e popullsisë ekonomikisht joaktive përfshinte gra që nuk ishin të punësuar formalisht. Megjithatë, marrë parasysh se kjo komunë karakterizohet me shkallë të madhe të aktivitetit bujqësor, shumë gra angazhohen në aktivitete bujqësore shtëpiake.²⁰ Në këtë komunë të vogël, ndërtimet e parregulluara në tokë bujqësore, bashkë me erozionin e tokës, shpyllëzimin dhe mbishfrytëzimin e tokës bujqësore, paraqesin sfida për këtë zonë shumë të varur nga bujqësia.²¹

Në rajonin e Prishtinës, shumë **turq të Kosovës** punojnë në ndërmarrje publike, institucione qeveritare si staf i shërbimit të përgjithshëm dhe në sektorin e arsimit (16 persona). Gratë **turke të Kosovës** janë të punësuar më rrallë se burrat, e edhe ato që janë të punësuar rëndom kryejnë detyra të ndryshme nga profesionet e tyre. Në rajonin e Prishtinës, shumë **turq të Kosovës** punojnë në sektorin e ndërtimit, ndërsa shumë syresh nga zonat rurale dhe komuna e Lipjanit janë zhvendosur në Prishtinë ose Ferizaj në kërkim të mundësive më të mira ekonomike.

Gjendja e përgjithshme ekonomike e **turqve të Kosovës** që banojnë në rajonin e Gjilanit është kryesisht e mirë, e ngjashme me atë të komunitetit shumicë të shqiptarëve të Kosovës. Ata janë të integruar mirë në ekonominë lokale dhe zhvillimet sociale. Shumica e **turqve të Kosovës** janë të vetëpunësuar si shitës në biznese të vogla, siç janë dyqanet e aksesorëve dhe optikës. Vetëm tri familje **turke të Kosovës**, dy nga fshati Dobërçan dhe një nga qyteti i Gjilanit, marrin ndihmë sociale. Një **turk i Kosovës** është i regjistruar si punëkërkues. Tridhjetë e shtatë **turq të Kosovës** punojnë në sektorin publik, prej të cilëve tre burra **turq të Kosovës** punojnë në komunë, 13 (tetë burra dhe pesë gra) në sektorin e arsimit, dhjetë gra punojnë në institucionet e kujdesit shëndetësor, shtatë janë të punësuar në Policinë e Kosovës dhe katër pjesëtarë të komunitetit (tre burra dhe një grua) në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Dhjetë familje që banojnë në qytetin e Gjilanit kanë në pronësi biznese private si restorante dhe dyqane rrobash. Në fshatin Dobërçan, një familje turke ka një dyqan ushqimor, ndërsa tjerat janë të angazhuara kryesisht në bujqësi. Në qytetin e Gjilanit shkalla e papunësisë është 40 për qind, ndërsa në fshatin Dobërçan është përafërsisht 70 për qind. Në të dy vendbanimet nga papunësia janë të prekur të gjitha grupet dhe gjinitë.

Në rajonin e Mitrovicës, komuniteti **turk i Kosovës** ndodhet në tri komuna: Mitrovicë Jugore, Mitrovicë Veriore dhe Vushtrri. Gjendja ekonomike e këtij komuniteti vlerësohet si jo e kënaqshme pasi shumica e pjesëtarëve të komunitetit janë të papunë, ose punojnë në kompani private me paga të ulëta dhe kushte të vështira pune. Shumë pak pjesëtarë të komunitetit udhëheqin biznese. Sipas një përfaqësuesi

20 Komuna e Mamushës; Departamenti i Zhvillimit, Planifikimit, Urbanizmit, Gjeodezisë dhe Kadastrit, *Plani zhvillimor komunal i Mamushës, 2014–2023* (2014), f. 18.

21 Po aty, f. 29–31–32, 34.

të komunitetit, shumica e **turqve të Kosovës** jetojnë me të ardhura mesatare ose nën mesatare. Disa pjesëtarë të komunitetit zotërojnë biznese të vogla profesionale si berberë, sallone parukerie, dyqane të vogla ushqimore dhe kompani shpërndarjeje. Përveç kësaj, disa pjesëtarë të komunitetit varen nga të ardhurat nga ndihma sociale dhe remitencat. Herë pas here, si përgjigje ndaj rrethanave specifike, ambasada turke dhe OJQ e organizata **turke të Kosovës** mbështesin financiarisht komunitetin.

Në Mitrovicën Jugore është një turke (grua) që punon në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, një turk (burrë) në drejtorinë e administratës komunale, një turke (grua) në drejtorinë komunale për planifikim dhe urbanizëm, dhe një turk (burrë) që punon si mjek në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare. Në Vushtrri, një turk (burrë) është drejtor komunal për ekonomi, bujqësi dhe zhvillim rural; një turke (grua) është përkthyes komunale, dhe një turk (burrë) punon në kompaninë publike për deponimin e mbeturinave Uniteti. Në Mitrovicën Veriore është një turk (burrë) që punon në Policinë e Kosovës. Sipas anëtarit turk të Komitetit për Komunitete në komunën e Vushtrrisë dhe përfaqësuesit të komunitetit **turk të Kosovës** në komunën e Mitrovicës Jugore, shkalla e papunësisë e këtij komuniteti është mbi 80% në nivel vendi, dhe atë kryesisht në mesin e pjesëtarëve të komunitetit të moshës 18-40 vjeç. Shkalla e papunësisë është thujse e barabartë për të dyja gjinitë, me rreth 50%. Në nivel qeveritar, pjesëtarët e komunitetit **turk të Kosovës** në shërbimin civil mbanin kryesisht pozita profesionale, pasuar nga pozitat administrative (një burrë nga Mitrovica e Jugut punon në Ministrinë e Administratës Publike dhe një burrë nga Vushtrria punon në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës). Pak **turq të Kosovës** mbanin pozita të larta udhëheqëse dhe menaxheriale (përkatesisht dy dhe katër për qind). Gratë **turke të Kosovës** ishin të përfaqësuara përtej kërkesave të Ligjit për barazi gjinore si në nivelin qeveritar ashtu edhe në atë komunal.²²

Në vitin 2018, nga gjithsej 95,890 persona të regjistruar si të papunë në Kosovë,²³ 0.5 për qind i përkisnin komunitetit **turk të Kosovës**.²⁴ Shkalla e përgjithshme e papunësisë në radhët e komunitetit turk në Prizren ishte rreth 30 për qind. Sipas statistikave të zyrës së Agjencisë së Punësimit të Kosovës në komunën e Prizrenit, janë 149 punëkërkuar aktivë (69 gra) nga radhët e komunitetit **turk të Kosovës**.

Ndër projektet më të rëndësishme të gjenerimit të të ardhurave ku ka qenë i përfshirë ky komunitet kanë qenë ato të realizuara në Prizren dhe Mamushë nga Programi për Stabilizim të Komuniteteve i financuar nga BE. Këto projekte synojnë mbështetjen e pjesëtarëve të komunitetit **turk të Kosovës** të këtyre komunave të cilët kanë biznese fillestare dhe ekzistuese, dhe janë zbatuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM). Një fabrikë për prodhimin e perimeve të konservuara është hapur në Mamushë në vitin 2018 me mbështetjen financiare të Ministrisë për Zhvillim Rural dhe IOM-it, dhe aktualisht është duke ofruar mundësi punësimi të qëndrueshëm për shumë familje.

²² OSBE, *Përfaqësimi i komuniteteve në shërbimin civil në Kosovë* (maj 2017), f. 14, 17, 23 dhe 24.

²³ Nuk ka të dhëna më të përditësuara.

²⁴ Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, *Raporti vjetor 2018*, f. 19.

Përveç kësaj, Caritasi zviceran, së bashku me komunat e Prizrenit dhe Mamushës, ka financuar projekte të fokusuara në prodhimtarinë bujqësore. Gjithashtu, një projekt i financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim ka mbështetur bizneset zejtare dhe të vogla në Prizren.

Drejtoria komunale e zhvillimit rural në Prizren, me përkrahje financiare nga Republika e Turqisë, në tri vitet e fundit ka përkrahur gratë që merren me punë artizanale. Gjithashtu, OJQ "HELP", me kontribute nga komuna, si edhe Agjencia për Zhvillim Rajonal, ofron pajisje për pjesëtarët e komunitetit **turk të Kosovës** të angazhuar në punë artizanale dhe biznese fillestare.

Ndonëse nuk ka të dhëna të sakta për pjesëtarët e komunitetit **turk të Kosovës** të angazhuar në ekonominë joformale, një numër i konsiderueshëm i grave janë të angazhuara në bujqësi dhe, si rrjedhim, nuk janë pjesë e ekonomisë formale. Në këtë komunitet nuk është vërejtur dukuria e punës së fëmijëve, megjithatë në disa raste fëmijët u ndihmojnë prindërve në bizneset e vogla gjatë muajve të verës, veçanërisht në punët bujqësore në Mamushë.

Shkalla e saktë e migrimit në mesin e komunitetit **turk të Kosovës** nuk dihet, megjithëse shumë familje nga ky komunitet kanë migruar në Francë dhe Gjermani në vitin 2015 për arsye ekonomike. Veç kësaj, që nga viti 2000, disa turq nga rajoni i Prishtinës janë zhvendosur në Turqi, por ky trend nuk është i zakonshëm kohëve të fundit. Për më tepër, disa të rinj turq të cilët jetojnë jashtë Prizrenit, veçanërisht ata të Mamushës, janë larguar nga komunat e tyre qoftë për t'i vijuar studimet universitare apo mundësi më të mira punësimi brenda ose jashtë Kosovës.²⁵ Vendet skandinave janë aktualisht destinacion i popullarizuar për këtë komunitet në Prizren, e liberalizimi i vizave do të shpie në rritje të mëtejme të emigrimit të familjeve të tëra. Kohëve të fundit, turqit nga Mamusha kanë migruar kryesisht në Gjermani, Austri, Zvicër dhe Slloveni.

25 Po aty, f. 26.

4. Qasja në infrastrukturë dhe shërbimet publike

Turqit e Kosovës kanë qasje të mjaftueshme në infrastrukturë dhe shërbime publike në mbarë Kosovën. Shumica e pjesëtarëve të komunitetit turk të Kosovës kanë qasje në ujë të pijshëm nga rrjetet lokale të shpërndarjes së ujit, ndërsa në Mamushë kryesisht nga pusët individuale, uji i të cilave nuk është i pijshëm.

Më 13 dhjetor 2023, kryetari i komunës njoftoi se Qeveria kishte ndarë 1.8 milionë euro në buxhetin e vitit 2024 për sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm në këtë komunë. Në fshatin Janjevë të komunës së Lipjanit, i cili është i banuar nga turq të Kosovës dhe komunitete tjera, qasja në ujë të pijshëm nuk është konsistente. Të gjithë pjesëtarët e komunitetit kanë qasje në sistemet e ujërave të zeza.

Mungesa e linjës direkte të autobusëve Prishtinë-Janjevë²⁶ vazhdon të përbëjë shqetësim të madh për banorët e Janjevës të cilët udhëtojnë çdo ditë për në Prishtinë. Më 6 nëntor 2023, një grup prej rreth 20 grave punëtore nga Janjeva, që i përkasin komunitetit turk dhe atij kroat të Kosovës, njëri pakicë numerike e tjetri shumicë, u mbledhën para ndërtesës së komunës për të protestuar, por gjendja nuk ka ndryshuar. Më 12 dhjetor 2023, OSBE mbështeti një punëtor për bashkëpunim ndërkomunal në rajonin e Prishtinës, gjatë së cilës u nënshkrua një marrëveshje kornizë nga kryetarët e komunave të Prishtinës, Podujevës, Obiliqit, Lipjanit, Fushë Kosovës dhe nënkryetarit për komunitete të komunës së Graçanicës. Kjo marrëveshje mbulonte mes tjerash edhe shërbimet e transportit publik. Më vonë, komuna e Lipjanit publikoi një njoftim përmes kanaleve zyrtare në rrjetet sociale se planifikon të krijojë një linjë të re transporti urban në itinerarin Prishtinë - Lipjan - Janjevë.

Në përgjithësi, komuniteti turk i Kosovës ka qasje stabile në energji elektrike. Në të kaluarën, në Mamushë janë raportuar probleme të shumta të lidhura me sistemin e furnizimit me energji elektrike, mirëpo furnizimi me energji elektrike është përmirësuar në masë të konsiderueshme pas modernizimit të rrjetit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike të Kosovës (KEDS) në vitin 2017, gjë që ka ndihmuar në reduktimin e ndërprerjeve gjatë muajve të dimrit. Për më tepër, viteve të fundit komuna ka realizuar projekte për zgjerimin e rrjetit të energjisë elektrike në fushat bujqësore, duke u ndihmuar kështu fermerëve që t'i ulin kostot e prodhimit duke i zëvendësuar gjeneratorët e shtrenjtë me benzinë.

²⁶ Aktualisht, duket se ka vetëm katër nisje në ditë për në Graçanicë, ku mund të merret linja lidhëse me stacionin kryesor të autobusëve në Prishtinë, dhe pesë udhëtime në ditë për në qytetin e Lipjanit përmes fshatrave Gushtericë e Ulët, Gushtericë e Epërme dhe Dobratinë.

Megjithatë, në disa pjesë të qytetit të Prizrenit ku banojnë **turqit e Kosovës**,²⁷ siç është lagjja Kurilla, është raportuar se furnizimi me energji elektrike nuk stabil dhe përcillet me ndërprerje të shpeshta dhe tension të ulët.

Ndriçimi rrugor është në dispozicion në shumicën e zonave të banuara nga komuniteti **turk të Kosovës**. Disponueshmëria e tij është përmirësuar dukshëm viteve të fundit në Prizren dhe Mamushë, duke shpjer kështu në përmirësim të kushteve të përgjithshme të sigurisë për komunitetin. Megjithatë, në pjesë të caktuara të Prizrenit ku banojnë turqit, mungesa e ndriçimit publik vazhdon të jetë akoma problematike. Banorët që jetojnë në lagjen Kurilla dhe në disa zona të tjera më të vogla kanë përcjellë disa herë kërkesa te përfaqësuesit e komunitetit për instalim të ndriçimit rrugor dhe mirëmbajtjen e tij të rregullt. Banorët e këtyre zonave, përfshirë këtu edhe ata të komunitetit **turk të Kosovës**, veçanërisht gratë dhe vajzat, kanë raportuar se kanë frikë që të ecin jashtë natën.

Cilësia e rrugëve mirëmbahet në zonat e banuara nga komuniteti, dhe shumë rrugë lokale janë asfaltuar gjatë dekadës së fundit, ashti si edhe trotuaret në Mamushë. Komuna e ka përmirësuar një rrugë alternative më të shkurtër për në Prizren dhe ka hapur një rrugë tjetër që lidhet me rrugën Suharekë – Rahovec që akoma nuk është riparuar. Komuna ka hapur po ashtu disa rrugë të reja që çojnë te tokat bujqësore, duke synuar lehtësimin e qasjes së fermerëve lokalë në pronat e tyre. Në Prizren, rrugët më të vogla paraqesin rrezik për trafikun dhe sigurinë për të gjitha komunitetet, përfshirë edhe **turqit e Kosovës**, meqë nuk ka trotuare të sigurt për këmbësorë. Mirëmbajtja e këtyre rrugëve vështirësohet edhe për shkak të konfigurimit të ngushtë të tyre.

Një rrugë e vogël në fshatin Dobërçan të komunës së Gjilanit, ku jetojnë dhjetë familje **turke të Kosovës**, është duke u asfaltuar aktualisht.

Banimi nuk paraqet problem për **turqit e Kosovës** pasi shumica e pjesëtarëve të këtij komuniteti kanë shtëpi apo banesa të veta. Megjithatë, në rastin e disa objekteve të banimit kolektiv, disa pjesëtarë të komunitetit **turk të Kosovës** u janë drejtuar udhëheqësve të komunitetit për të kërkuar ndihmën e komunës për riparimin e çative që pikojnë dhe janë të vjetruara, si edhe vendosjen e fasadave ose riparimin e atyre ekzistuese dhe përmirësimin e efijencës së tyre energjetike në përpjekje për t'i ulur kostot e energjisë. Në Prizren, Kryesuesi i KK-së ka informuar se ka familje **turke të Kosovës** që përfitojnë nga skemat e vazhdueshme të mbështetjes komunale për banim (p.sh. banim i përkohshëm, mbështetje me pagesën e qirasë etj.).

Në përgjithësi, komuniteti **turk i Kosovës** përballet me të njëjtat probleme mjedisore si komunitetet e tjera në Kosovë. Përgjashtim këtu bën Mamusha, ku deponia ilegale e mbeturinave vazhdon të përbëjë sfidë për banorët dhe autoritetet komunale, përkundër përmirësimit gradual të gjendjes. Kjo deponi kontribuon në masë të madhe në ndotjen e ajrit, veçanërisht gjatë muajve të dimrit. Autoritetet komunale i pastrojnë deponitë ilegale herë pas here qoftë vetë ose me mbështetjen e kontingjentit turk të

²⁷ Në Prizren, komuniteti turk i Kosovës nuk është i përqendruar në ndonjë lagje apo zonë të caktuar, por jeton në pjesë të ndryshme të qytetit.

KFOR-it. Mbështetje ofrojnë edhe organizata të shumta²⁸ dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për aktivitete që mëtojnë avancimin e mbrojtjes së mjedisit (p.sh. shpërndarje të koshave të mbeturinave për ekonomi shtëpiake dhe në vende publike, pastrim të hapësirave publike, aktivitete ndërgjegjësimi etj.). Sidoqoftë, menaxhimi i mbeturinave vazhdon që të përbëjë sfidë ashtu si në pjesët tjera të Kosovës.

Komuniteti **turk i Kosovës** ka qasje në varreza në të gjitha lokacionet ku ata banojnë, dhe shpesh i shfrytëzojnë varrezat islamike bashkë me komunitetet e tjera.

²⁸ KFOR-i, GIZ-i, Caritas Zvicër, PREDA Plus, etj.

5. Qasja në shërbime sociale, përfshirë këtu edhe kujdesin shëndetësor

Në përgjithësi, komuniteti turk i Kosovës gëzon qasje të papenguar në shërbime sociale, përfshirë këtu dhe qasjen fizike në qendrat për punë sociale.

Në vitin 2018, 74 familje turke të Kosovës, që numëronin gjithsej 213 persona, shumica syresh nga komunat e Prizrenit dhe Mamushës, kishin të drejtë për ndihmë sociale.²⁹ Të dhënat e zberthyer sipas komuniteteve, që do tregonin numrin e saktë të turqve të Kosovës të cilët marrin pension dhe/ose kompensime për aftësi të kufizuar, nuk janë në dispozicion. Sipas zyrtarëve komunalë në Dobërçan, vetëm tre familje turke të Kosovës, dy nga fshati Dobërçan dhe një nga qyteti i Gjilanit, pranojnë ndihmë sociale.

Në përgjithësi, komuniteti turk i Kosovës nuk përballet me probleme të mëdha në kuptimin e qasjes në shërbime shëndetësore. Kjo vlen edhe për komunitetin turk të Kosovës në Mitrovicën Veriore, të cilët priren të kenë qasje në shërbimet sociale dhe shëndetësore në Mitrovicën Jugore. Në komunën e Lipjanit, në fshatin me popullsi të përzier të Janjevës, qasja fizike në shërbimet shëndetësore është problematike, pasi që barnatorja lokale nuk është e furnizuar siç duhet, dhe pjesëtarëve të komunitetit u është dashur që të udhëtojnë drejt zonave urbane për të gjetur furnizime të duhura mjekësore. Në fshatin Dobërçan ekziston një qendër mjekësore, ndërsa banorët të cilët jetojnë në qytetin e Gjilanit i shfrytëzojnë institucionet e kujdesit shëndetësor në qytet. Në Mamushë, banorët marrin shërbimet në një qendër komunale të mjekësisë familjare. Për çështje të ndërlikuara shëndetësore, pjesëtarët e komunitetit udhëtojnë në komunën e Prizrenit.³⁰ Komuna nisi ndërtimin e një qendre të re kryesore të mjekësisë familjare në janar të vitit 2021, duke përmirësuar kështu jo vetëm objektet e kujdesit shëndetësor, por edhe listën e shërbimeve të specializuara në komunë. Statuti i këtij institucioni të ri shëndetësor u miratua në shtator të vitit 2023 dhe hapja e tij pritet në fillim të vitit 2024. Në Prizren, komuniteti kryesisht shfrytëzon qendrën kryesore të mjekësisë familjare, ndërkohë që ka qasje të plotë në shërbimet që ofrohen në spitalin rajonal të Prizrenit. Për më tepër, disa mjekë turq të Kosovës kanë dhe ordinancat e tyre private. Për çështje më serioze shëndetësore, komuniteti turk i Kosovës përdor edhe ofruesit e kujdesit shëndetësor në Turqi.

²⁹ Institucioni i Avokatit të Popullit, *Raporti Vjetor për vitin 2018* (2019), f. 100.

³⁰ OSBE, *Profili i Komunës së Mamushës, 2018* (2019).

Ndonëse kujdesi shëndetësor i përballueshëm është shqetësim në mbarë Kosovën, komuniteti **turk i Kosovës** ballafaqohet relativisht me më pak pengesa financiare në krahasim me komunitetet e tjera. Sidoqoftë, gratë **turke të Kosovës** përballen me më shumë pengesa financiare kur përdorin shërbimet e kujdesit shëndetësor sesa burrat e të njëjtit komunitet.³¹

Kohët e fundit, në disa komuna janë zhvilluar fushata ndërgjegjësimi për shëndetin që synojnë komunitete të ndryshme, përfshirë këtu fushata ndërgjegjësuese për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit. Në suazat e një fushate të tillë, Ministria e Shëndetësisë ka ofruar kontrolle falas përmes mamografit mobil për gratë nga radhët e komuniteteve të ndryshme, përfshirë ato nga komuniteti turk i Kosovës. Pjesëtarët e komunitetit **turk të Kosovës** të cilët banojnë në Gjilan marrin pjesë në të gjitha fushatat ndërgjegjësuese që organizohen në këtë komunë.

Sa i përket procesit të regjistrimit civil, pjesëtarët e komunitetit **turk të Kosovës** në përgjithësi kanë qasje të kënaqshme në këto shërbime.

31 Rrjeti i Grave të Kosovës, [Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë](#) (2016), f. 29, 51 (qasur në dhjetor të vitit 2023).

6. Qasja në arsim

Nxënësit turq të Kosovës kanë qasje në arsimin fillor, të mesëm dhe universitar në gjuhën turke në Kosovë. Disa nxënës turq të Kosovës i vijnë mësimet në gjuhën shqipe, më së shpeshti në shkollë të mesme dhe universitet.

Arsimi i lartë në gjuhën turke është i kufizuar dhe nuk është i përshtatshëm për tërë komunitetin turk të Kosovës. Për më tepër, shumë pjesëtarë të komunitetit konsiderojnë se shkollimi në gjuhën shqipe është më cilësor se ai në gjuhën turke dhe se ofron qasje më të mirë në mundësitë për karrierë në Kosovë.

Sa i përket qasjes në shkollimin në gjuhën turke, sfida kryesore për komunitetin mbetet mungesa e teksteve dhe materialeve shkollore në gjuhën turke. Shumë nxënës detyrohen të mbështeten në materiale të fotokopjuara, sidomos në rastin e librave të shkollës së mesme. Disa nxënës i marrin tekstet shkollore nga Turqia. Megjithatë, jo të gjitha tekstet shkollore të Turqisë i përshtaten kontekstit të Kosovës ose përputhen me kurrikulën e Kosovës. Sipas të anketuarve, shumica e teksteve të përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën turke janë të cilësisë së dobët.

Sfidë tjetër madhore për nxënësit që i vijnë mësimet në gjuhën turke është mungesa e mësimdhënësve të kualifikuar në gjuhën turke për lëndët e specializuara. Disa prindër kanë thënë se ata zgjedhin shkollat në gjuhën shqipe për shkak të mësimdhënies më cilësore. Për shembull, në Gjilan shumë nxënës turq të Kosovës vijnë në shkollën fillore në gjuhën shqipe.

Sipas të dhënave të MASHTI-it, në vitin akademik 2023/2024 në arsimin parauniversitar u regjistruan 2748 turq të Kosovës.³²

Shumica dërrmuese e turqve të Kosovës të regjistruar në arsimin parauniversitar jetojnë në rajonin e Prizrenit, afër njërit prej dy universiteteve që ofrojnë shkollim në gjuhën turke. Arsimi parauniversitar sipas kurrikulës së Kosovës në gjuhën turke ofrohet në komunat Prizren, Mamushë, Prishtinë, Gjilan dhe Mitrovicë Jugore.

Në komunën e Lipjanit, fëmijët turq të Kosovës në fshatin me komunitete të përziera të Janjevës kryesisht e vijnë në shkollimin në gjuhën shqipe. Pas përfundimit të shkollës fillore, ata e vazhdojnë shkollën e mesme të ulët dhe të lartë në Lipjan dhe/ose Prishtinë.

³² Informatë nga MASHTI për vitin akademik 2023/2024 (qasur në dhjetor të vitit 2023).

Një numër i madh syresh udhëtojnë për në Prishtinë për t'i vijuar studimet universitare në gjuhën shqipe, duke u përballur me pengesa për shkak të mungesës së transportit publik që do t'i shërbente fshatit.

Disa **turq të Kosovës** zgjedhin arsimin universitar në gjuhën turke që ofrohet në Prizren dhe Prishtinë.³³ Të tjerët zgjedhin t'i vijojnë studimet në gjuhën shqipe në njërin nga shtatë universitetet publike në Kosovë. Universitetet publike rezervojnë vende për studentët joshqiptarë, përfshirë edhe për **turqit e Kosovës**. Gjithashtu, studentët **turq të Kosovës** mund të aplikojnë në gjuhën turke për programe studimore në gjuhën shqipe.

Komunat e Kosovës nuk ofrojnë apo financojnë bursa universitare të dedikuara enkas për studentët **turq të Kosovës**. Disa komuna ofrojnë bursa dhe rezervojnë një numër të caktuar të tyre për studentët nga radhët e komuniteteve joshumicë. Për vitin akademik 2020/21, Komuna e Prizrenit ndau 80 bursa për nivel universitar, 10 për qind të të cilave ishin të rezervuara për studentët nga komunitetet joshumicë. Në vitin akademik 2021/22, komuna rriti numrin e bursave në 100 dhe konkretisht ka ndarë katër bursa për programet në gjuhën turke dhe boshnjake. Për vitin akademik 2022/23, komuna ndau 130 bursa, përfshirë këtu tetë për programe studimore në gjuhën turke dhe boshnjake në Fakultetin e Edukimit.

Shumë **turq të Kosovës** vijojnë studimet universitare edhe në Turqi. Qeveria e Turqisë dhe ambasada e saj në Prishtinë ofrojnë bursa të plota për arsim universitar në Turqi për studentët që kualifikohen. Veç kësaj, një numër i vogël studentësh vijojnë studimet në kolegjet dhe universitetet private në Kosovë, ndërsa ca të tjerë regjistrohen në Universitetin e Evropës Juglindore në Maqedoninë e Veriut.

Programin e vetëm për aftësim të mësimdhënësve në gjuhën turke e ofron Universiteti i Prizrenit. Ky program ka humbur akreditimin disa herë për shkak të numrit të pamjaftueshëm të kuadrit akademik që plotëson kushtet e akreditimit të programeve të arsimit të lartë.³⁴ Në shkurt të vitit 2024, Agjencia e Akreditimit e Kosovës nuk e riakreditoi programin për po të njëjtat arsye.³⁵ Sipas informatave të siguruar nga Universiteti i Prizrenit, gjatë vitit akademik 2023/2024, 148 studentë nga komuniteti **turk i Kosovës** i kanë vijuar studimet pranë këtij universiteti, ku shumica syresh kanë qenë të regjistruar në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Fakultetin e Edukimit.

Për shkak se pjesëtarët e komunitetit **turk të Kosovës** banojnë kryesisht në zona urbane, nxënësit nuk ballafaqohen me pengesa të konsiderueshme për sa i përket qasjes fizike në shkolla. Me raste nxënësit **turq të Kosovës** udhëtojnë nga një komunë në tjetrën për të vijuar shkollimin, si p.sh., nga Mitrovica Veriore në atë Jugore, ose nxënësit nga Mamusha të cilët vijojnë shkollat e mesme të larta në Prizren.

Viteve të fundit janë regjistruar shumë pak raste të braktisjes së shkollës në mesin e nxënësve **turq të Kosovës**.

³³ Universiteti "Ukshin Hoti" ndodhet në Prizren; Universiteti "Hasan Prishtina" ndodhet në Prishtinë.

³⁴ Ligji nr. 08/L-110 për Agjencinë e Akreditimit të Kosovës.

³⁵ Nga qershori 2024 e tutje, jashtë periudhës për të cilën raportohet, është e pasigurt nëse ky program do të mund të vazhdojë.

Në objektet shkollore në të cilat ka klasë në gjuhën shqipe dhe turke, ndërveprimi ndërmjet nxënësve të komuniteteve të ndryshme është kryesisht pozitiv. Për shembull, sipas raportimeve, fëmijët të cilët flasin gjuhë turke dhe ata të cilët flasin gjuhën shqipe përdorin të njëjtat dyer të hyrjes, oborre dhe hapësirat tjera shkollore. Kuadri mësimdhënës në këto shkolla shfrytëzon të njëjtën sallë arsimtarësh, gjë që ofron mundësi shtesë për komunikim dhe bashkëpunim. Për më tepër, nxënësit marrin pjesë në aktivitete të ndryshme sportive dhe kulturore të organizuara bashkërisht nga shkollat dhe komunikojnë lehtësisht me nxënës të komuniteteve tjera.

7. Qasja në drejtësi

Një përfaqësuese e komunitetit turk të Kosovës është e punësuar në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV), në zyrën rajonale në Prizren, por nuk ka asnjë tjetër të punësuar në ndonjërin nga institucionet tjera jogjyqësore si Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) dhe Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP). Veç kësaj, dy avokatë turq të Kosovës, që të dy burra, janë të licencuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK).

Monitorimi në terren i OSBE-së ka shpalosur se pjesëtarët e komuniteti turk të Kosovës nuk përballen me ndonjë sfidë në qasjen në shërbimet ligjore.

Pjesëtarët e komunitetit turk të Kosovës në përgjithësi janë në dijeni për shërbimet e ofruara nga ANJF, IAP, ZMNV dhe OAK. Vlen të përmendet se në Prizren dhe në komunën e Mamushës me shumicë turq të Kosovës, komuniteti është i përfaqësuar mirë dhe aktiv në institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile për shkak të kontaktit të rregullt dhe të një roli më aktiv të institucioneve të drejtësisë në këtë komunë në dy vitet e fundit.³⁶ E njëjta gjë vlen edhe për komunitetin turk të Kosovës në Prishtinë, duke qenë se ata jetojnë kryesisht në zona urbane.³⁷

Në vitin 2023, me mbështetjen e USAID-it, ANJF ka shpërndarë fletëpalosje dhe afishe në gjuhën angleze, shqipe, serbe dhe turke si edhe në alfabetin e brajlit. Ngjashëm, gjatë Javës së Ndihmës Juridike Falas në rrjetet sociale janë botuar videoklipe dhe postime me moton "Mbroni të drejtat tuaja" në gjuhët zyrtare, shqip dhe serbisht, si edhe në gjuhën turke në komunat e Prizrenit dhe Mamushës.

Çdo tetor, nën patronazhin e Zyrës së Kryeprokurorit dhe me mbështetjen e Ambasadës Amerikane, ZMNV organizon "Javën e të Drejtave të Viktimave të Krimit". Megjithatë, është mendim i përgjithshëm i palëve të interesit të cilat janë intervistuar se fushata të tilla informuese duhet të organizohen gjatë tërë vitit.

Në përgjithësi, pjesëtarët e komunitetit turk të Kosovës nuk janë në dijeni për programin e kompensimit të viktimave të krimit, pavarësisht se IAP, ZMN, ANJF dhe OAK i kanë njoftuar pjesëtarët e komunitetit për të drejtat, mjetet juridike dhe përfitimet e tyre, përfshirë këtu qasjen në programin e kompensimit të viktimave të krimit, gjatë trajtimit të rasteve të ndryshme.

Në vitin 2023, ANJF ka ofruar shërbime për 6,070 persona (përfshirë 2,883 gra), prej të cilit numër 54 ishin pjesëtarë të komunitetit turk të Kosovës. Në vitin 2023, IAP ka pranuar gjithsej 1,660 ankesa (1,162 burra dhe 498 gra),³⁸ që përfshin 4296 persona.

³⁶ Sipas bashkëbiseduesve nga Prizreni.

³⁷ Sipas raporteve në terren të OSBE-së nga rajoni i Prishtinës.

³⁸ Shih, Raporti vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2023.

Nga numri i përgjithshëm i ankesave, 11 janë paraqitur nga komuniteti turk i Kosovës. ZMNV ka trajtuar 2,883 raste në vitin 2023, ku 11 viktima ishin **turq të Kosovës**, shumica syresh gra.

Komuniteti **turk i Kosovës** nuk e percepton gjuhën, e as shpenzimet gjyqësore dhe shpenzimet e udhëtimit, si pengesë në qasjen në institucionet ligjore. Ndonëse Gjykata Themelore në Prizren nuk ka përkthyes të përhershëm të gjuhës turke (aktualisht është duke u zhvilluar procesi i punësimit), përkthimi në gjuhën turke sigurohet nga gjykata nëpërmjet përkthyesve të certifikuar.

8. Përdorimi i gjuhës dhe mediat

Aktualisht, gjuha turke është gjuhë zyrtare në komunat e Mamushës dhe Prizrenit, gjersa në komunat e Prishtinës, Gjilanit, Mitrovicës së Jugut dhe Vushtrrisë, gjuha turke është "gjuhë në përdorim zyrtar" që do të thotë se komuna ka për obligim të ofrojë shërbime dhe dokumente në gjuhën turke sipas kërkesës.³⁹

Për më tepër, ndonëse gjuha turke nuk është gjuhë zyrtare në nivel qeveritar, Gazeta Zyrtare e Kosovës i boton në gjuhën turke të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, rregulloret, marrëveshjet, vendimet dhe aktet tjera të nxjerra nga institucionet. Publikimi i dokumenteve zyrtare në Gazetën Zyrtare në gjuhën turke bëhet në mbështetje të komunave ku gjuha turke është gjuhë zyrtare.⁴⁰

Pjesëtarët e komunitetit turk të Kosovës flasin një dialekt lokal të turqishtes për qëllime të përdorimit të përditshëm dhe turqishte të standardizuar për komunikim zyrtar. Shumë shqiptarë dhe komunitete të tjera të Kosovës, sidomos në rajonin e Prizrenit, e flasin, ose të paktën e kuptojnë, gjuhën turke dhe shumica e turqve të Kosovës mund të komunikojnë në gjuhën shqipe ose atë serbe. Megjithatë, të rinjtë shpesh nuk dinë të flasin as shqip e as serbisht. Pjesëtarët e komunitetit e përdorin shpesh gjuhën shqipe dhe/ose serbe për të komunikuar me zyrtarët komunalë dhe për të pasur qasje në shërbimet komunale, megjithatë përkthimi me gojë ose me shkrim ndonjëherë nuk janë në dispozicion në nivel komunal.

Në komunën e Prizrenit, shumica e tabelave të vendosura në objektet komunale dhe në objektet tjera zyrtare, siç janë entet rajonale për punësim dhe qendra për punë sociale, si edhe në ato të trashëgimisë kulturore, janë në të gjitha gjuhët zyrtare, përfshirë këtu edhe gjuhën turke. Megjithatë, tabelat në objektet e administratës komunale jo çdoherë janë në të gjitha gjuhët zyrtare. Shenjat dhe emrat e rrugëve në Prizren dhe Mamushë janë në të tria gjuhët (shqip, serbisht dhe turqisht), për fjalën "rrugë": "Rr. Ul. Ca". Emrat e plotë të rrugëve janë shkruar në gjuhën e popullsisë shumicë, pra në gjuhën shqipe në Prizren dhe gjuhën turke në Mamushë.

Shenjat e komunikacionit rrugor në zonat rurale janë në vetëm dy gjuhë, atë shqipe dhe serbe.

³⁹ Ligji për përdorimin e gjuhëve i jep gjuhës turke statusin e gjuhës zyrtare në komunën e Prizrenit, pavarësisht nga madhësia e komunitetit turk që jeton atje. Për më tepër, në komunat ku jeton një komunitet, gjuha amtare e të cilit nuk është një nga gjuhët zyrtare të Kosovës dhe që përfaqëson tre për qind të popullsisë së përgjithshme të komunës, gjuha e komunitetit e gëzon statusin e gjuhës në përdorim zyrtar.

⁴⁰ Zyra e Kryeministrit, "Gazeta Zyrtare" (qasur në dhjetor të vitit 2023).

Në Prizren dhe Mamushë, informacionet publike dhe faturat e shërbimeve komunale shtypen pjesërisht në gjuhën turke, ndërsa shumica e njoftimeve dhe tatimeve të nivelit qendror janë vetëm në gjuhën shqipe dhe serbe.⁴¹

Disponueshmëria e dokumenteve dhe shërbimeve me shkrim në gjuhën turke dallon nëpër komunat ku gjuha turke është gjuhë zyrtare ose gjuhë në përdorim zyrtar. Për shembull, në faqen e internetit të komunës së Prizrenit, dokumentet si lajmet ditore komunale, informacionet financiare dhe vendimet e kryetarit janë pjesërisht në gjuhën turke.⁴² Gjendja është përmirësuar në faqen e internetit të komunës së Mamushës, megjithëse informacionet nuk publikohen rregullisht në gjuhën shqipe apo serbe.

Në shkurt të vitit 2020, komuna e Prizrenit kontraktoi një kompani private për të ofruar përkthim të dokumenteve zyrtare komunale në të gjitha gjuhët zyrtare, pra atë shqipe, turke, serbe dhe boshnjake, si edhe në gjuhën angleze, për një periudhë trevjeçare. Si e vetmja komunë në Kosovë me katër gjuhë zyrtare, problem ka qenë mungesa e përkthyesve komunalë për t'i përkthyer dokumentet zyrtare.

Pajisjet jofunksionale të përkthimit simultan kanë paraqitur sfidë shtesë në komunën e Prizrenit, pasi që përfaqësuesve të komunitetit **turk të Kosovës** u është pamundësuar pjesëmarrja e mirëfilltë në takimet zyrtare komunale. Në korrik të vitit 2019, mungesa e përkthimit adekuat shkaktoi tendosje ndërmjet përfaqësuesve turq dhe shqiptarë të Kosovës gjatë një seance të kuvendit komunal.⁴³ Në dhjetor të vitit 2020, komuna e zgjodhi problemin duke blerë pajisje të reja përkthimi dhe sisteme elektronike të votimit për sallën e kuvendit komunal, duke siguruar kështu përkthim simultan në të gjitha gjuhët zyrtare, mirëpo, sipas monitorimit të OSBE-së, janë vërejtur raste kur pajisjet e përkthimit kanë qenë jofunksionale dhe/ose nuk ka mundur të sigurohet përkthim.

Në Prishtinë, pavarësisht se gjuha turke është gjuhë në përdorim zyrtar, komuna nuk ofron dokumente në gjuhën turke me kërkesë të anëtarëve të komunitetit. Në Gjilan, si rrjedhojë e mospërdorimit të alfabetit turk, komuna shpesh i shkruan me gabime drejtshkrimore emrat dhe mbiemrat e **turqve të Kosovës** në dokumentet zyrtare. Në komunat e Mitrovicës Jugore dhe Vushtrisë nuk ka interpretë apo përkthyes zyrtar komunal të gjuhës turke. Shërbimet dhe dokumentet e ofruara në gjuhën turke sipas kërkesës në këto dy komuna janë të rralla, të ngadalta dhe të pakënaqshme.

Duke i marrë parasysh këto sfida, përfaqësuesit e **turqve të Kosovës** nga disa komuna ku gjuha turke është gjuhë zyrtare ose gjuhë në përdorim zyrtar detyrohen që ta përdorin gjuhën shqipe ose serbe për të komunikuar me administratën lokale (përfshirë pranimin e dokumenteve dhe shërbimeve komunale në këto dy gjuhë). Për t'i shmangur procedurat më të gjata dhe më të ndërlikuara, dhe/ose dokumente e

41 Faturat e ujit dhe grumbullimit të mbeturinave shtypen në gjuhën turke, ndërsa faturat e energjisë elektrike jo.

42 Në vitin 2023, nga muaji maj deri në dhjetor, 156 përmbajtje ishin në dispozicion në gjuhën turke, ndërsa 1,186 ishin në gjuhën shqipe për të njëjtën periudhë raportimi.

43 Gjatë diskutimit të një projektstrategjie për turizmin, drejtoresha e turizmit dhe zhvillimit ekonomik, Sevil Kazaz (KDTP), turke e Kosovës, iu përgjigj në gjuhën turke pyetjeve që u parashtruan nga anëtarët shqiptarë të kuvendit komunal, pasi ajo nuk kishte besim që të fliste shqip dhe preferoi që të përgjigjet në gjuhën turke. Deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) kanë deklaruar se përderisa e kanë njohur të drejtën drejtoreshës për të folur në gjuhën amtare, nuk i kanë kuptuar përgjigjet e saj. Znj. Kazaz vendosi t'u përgjigjet pyetjeve me shkrim në një datë të mëvonshme.

informacione të pasakta, **turqve të Kosovës** iu duhet të mbështeten në gjuhët tjera. Ky nuk është rasti me Prizrenin dhe Mamushën, ku gjuha turke është gjuhë zyrtare dhe banorët e përdorin në mënyrë aktive turqishten në ndërveprimin e tyre me gojë dhe me shkrim me komunën. Ky përdorim i paracaktuar i gjuhëve të tjera është vlen sidomos për **turqit e Kosovës** nga rajoni i Gjilanit dhe Mitrovicës, të cilët e përdorin gjuhën shqipe për të pasur qasje në shërbimet komunale. Kjo ka çuar në shqetësime në komunitet në kuptimin e asimilimit gjuhësor, sidomos të të rinjve, të cilët preferojnë ta përdorin gjuhën shqipe në publik dhe në ndërveprime me institucionet.

Komuniteti **turk i Kosovës** gëzon qasje në informacione në gjuhën e tyre amtare përmes mediave elektronike dhe të shkruara. Përveç kësaj, transmetuesi publik RTK 1 transmeton programe të posaçme për komunitetet joshumicë, përfshirë këtu edhe programe në gjuhën turke. Ueb portalet më aktive në gjuhën turke janë "Kosovahaber" dhe "Kosovaport" me seli në Prizren, ndërsa mediat e shkruara si p.sh. "Kosova Imza" dhe "Turk Cem" janë po ashtu të popullarizuara.⁴⁴ Veç kësaj, "Radio Prizreni" transmeton një program ditor teorësh në gjuhën turke në rajonin e Prizrenit, ndërsa dy radiostacione lokale në Gjilan, "Star" dhe "Victoria", transmetojnë programe ditore dyorëshe në gjuhën turke.

Ministria e Arsimit, organizatat e shoqërisë civile si Qendra për Arsim e Kosovës dhe shkolla private "Marif" në Prizren ofrojnë kurse falas të gjuhës turke gjatë pushimeve verore. Kurse të gjuhës turke në internet ofron po ashtu edhe instituti "Yunus Emre", institut kulturor turk.⁴⁵

44 "Kosova Haber" është një faqe lajmesh në gjuhën turke; "Kosova Port" është një ueb portal në gjuhën turke (qasur në dhjetor të vitit 2023).

45 Instituti ofron kurse në gjuhën turke për grupe të ndryshme, përfshirë shërbyesit civil të cilët punojnë në komunën e Prizrenit.

9. Trashëgimia kulturore dhe fetare, si dhe liritë fetare

Komuniteti turk i Kosovës ka qenë prej kohësh i pranishëm në Kosovë dhe kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në trashëgiminë e saj. Turqit e Kosovës janë të integruar mirë në shoqërinë kosovare, duke ndarë shumë tipare kulturore dhe sociale me shumicën dërrmuese të popullsisë shqiptare, përfshirë besimin mysliman.

Në Gjilan, shumë monumente kulturore dhe fetare datojnë nga periudha osmane dhe janë përfshirë në listën e pasurive kulturore nën mbrojtje të përkohshme nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Disa nga lokalitetet më të mirënjohura ndodhen në zonat nën mbrojtje të veçantë të qytetit mesjetar të Novobërdës. Në prill të vitit 2014, u raportua një zjarrvënie në varrin prej druri brenda Tyrbes së shekullit të 16-të në Kala ("varri i kalasë", ku gjendet një varr sufi). Punimet e rikonstruksionit në *Tyrben në Kala* (varri i kalasë) dhe *Xhaminë Osman Efendi* që gjendet në zonën nën mbrojtje të veçantë të qytetit mesjetar të Novobërdës përfunduan në vitin 2023.⁴⁶

Në rajonin e Prizrenit ndodhet një numër objektesh të mirënjohura trashëgimisë, të tilla si Xhamia e Sinan Pashës, Hamami i Mehmet Pashës, Xhamia e Mehmet Pashës, Xhamia e Suziut, Xhamia e Kukli Beut si edhe Teqeja e Kadriut dhe Teqeja e Halvetive (*teqe e sufive*), ndërkaq në Mamushë ndodhet Kulla e Sahatit e Mahmud Pashës. Në fshatin Mazgit në rajonin e Prishtinës ndodhet varri i Sulltan Muratit, i vlarë në Betejën e Kosovës në vitin 1389. Përveç festave myslimane, komuniteti turk i Kosovës shënon Ditën e tij zyrtare të Komunitetit më 23 prill.

⁴⁶ Punimet e rindërtimit u realizuan në kuadër të projektit "Trashëgimia kulturore si shtytës për dialogun mes komuniteteve dhe kohezionin social", financuar nga Shërbimi i BE-së për Instrumentet e Politikës së Jashtme dhe zbatuar nga UNDP.

10. Të drejtat pronësore

Komuniteti turk i Kosovës ka përgjithësisht qasje të papenguar në prona dhe banim.

Megjithatë, monitorimi në terren i OSBE-së ka evidentuar disa shqetësime lidhur me të drejtat pronësore të këtij komuniteti.⁴⁷

Në vitin 2022, tri familje turke të Kosovës në rajonin e Prizrenit u pajisën me certifikata të legalizimit, duke i formalizuar kështu titujt e tyre të pronës përmes regjistrimit në regjistrin kadastral.

⁴⁷ Sipas raportimeve, në shtator të vitit 2021, një grua turke e Kosovës nga komuna e Lipjanit ka raportuar në Policinë e Kosovës se i është dëmtuar prona nga një kompani ndërtimore e angazhuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Familja ka paraqitur ankesë në Inspektoratin Policor të Kosovës, i cili ka nisur hetimet. Sipas raporteve të policisë, e njëjta pronare ka përjetuar incidente të tjera të lidhura me pronën, siç janë thyerja e xhamave, prerja e pemëve (nga autoritetet komunale të Lipjanit për të ndërtuar një shtrat lumi) dhe dëmtimi i oborrit të saj nga zjarri.

11. Kthimi dhe riintegrimi

Çështjet e zhvendosjes, kthimit dhe riintegrimin në përgjithësi nuk përbëjnë shqetësim për komunitetin turk të Kosovës, meqë nuk është raportuar për ndonjë shkallë të shprehur emigrimi si rrjedhojë e konfliktit të vitit 1999.

UNHCR vlerëson se në periudhën 2015-2023 vetëm 16 turq të zhvendosur janë kthyer në mënyrë vullnetare në shtëpitë e tyre të para konfliktit në Mitrovicën Jugore.⁴⁸

Në vitin 2023, Ministria për Komunitete dhe Kthim bëri një hap të rëndësishëm duke nxjerrë një thirrje për ofrim të ndihmës së nevojshme për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë.⁴⁹ Nisma mëtonte që të trajtonte nevoja të ndryshme, përfshirë këtu sigurimin e artikujve ushqimorë dhe joushqimorë, si dhe mbështetjen për ndërtimin dhe rindërtimin e shtëpive. Për më tepër, Ministria e zgjeroi fushëveprimin e ndihmës së saj për ta përforcuar sektorin e bujqësisë, duke ofruar subvencione për t'i lehtësuar praktikantët e qëndrueshëm bujqësorë. Njëkohësisht, pati përpjekje për mbështetjen e bizneseve të vogla të këtyre komuniteteve. Ndikimi i këtyre përpjekjeve ishte i prekshëm, meqë Ministria i mbështeti me sukses tri familje **turke të Kosovës** duke u ofruar atyre artikuj të rëndësishëm, përfshirë material ndërtimor. Ndër nisimat me ndikim të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim ishte edhe ofrimi i mbështetjes substanciale në vlerë prej 444,250.20 eurosh për 34 familje. Kjo ndihmë financiare ishte e orientuar në nxitjen e sektorit të bujqësisë ose mbështetjen e bizneseve të vogla. Më konkretisht, nga kjo nismë kanë përfituar 23 familje në Mamushë dhe 11 në Prizren.⁵⁰ Kjo qasje gjithëpërfshirëse pasqyroi përkushtimin e Ministrisë për të nxitur zhvillimin dhe fuqizimin tërësor të komuniteteve joshumicë.

48 UNHCR, Zyra e Shefit të Misionit në Prishtinë, *Pasqyrë statistikore* (Prill 2020). Tre persona në vitin 2015, shtatë persona në vitin 2016 dhe gjashtë persona në vitin 2017 janë kthyer në baza vullnetare.

49 Vendim për përcaktimin e procedurave për ofrimin e ndihmës nga Ministria për Komunitete dhe Kthim për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë për të cilët ndihma është e nevojshme, miratuar më 2 shkurt 2023: [Vendim i procedurave për ofrimin e ndihmës-Odluka o proceduri pruzenja pomoci compressed compressed-compressed \(1\).pdf \(rks-gov.net\)](#), (qasur në dhjetor të vitit 2023).

50 Të dhënat i janë dhënë Misionit të OSBE-së në Kosovë nga Ministria për Komunitete dhe Kthim më 6 shkurt 2024.



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

